

HALIL RAMA  
SAKIP CAMI



# RRAHMAN PARLLAKU

*një legjendë në kufirin e dy kohëve*

**BOTIMET M&B**

HALIL RAMA  
SAKIP CAMI

# RRAHMAN PARLLAKU

*një legjendë në kufirin e dy kohëve*

**BOTIMET M&B**

*Tiranë, prill 2014*

*Halil Rama, Sakip Cami*

**Një legjendë në kufirin e dy kohëve**

*(Monografi kushtuar Gjeneral Rrahman Parllakut,  
i vetmi "Hero i Popullit" i gjallë, që i mbijetoi  
Luftës së II-të Botërore dhe terrorit komunist)*

Redaktor: Prof.Dr. Shefqet Hoxha

Recensent: Dr. Fejzulla Gjabri

Konsulentë: Tatjana Parllaku

Korrektore letrare: Mariola Gjorga

**BOTIMET M&B**

ISBN: 978-9928-172-24-2

---

*Botimi u mundësua nga:*



*me* **President z.Kadri MORINA**

*dhe* **Hazbi PARLLAKU**



*Gjeneral Krahman Parllaku në moshën 95-vjeçare*



**Organizata e Bashkuar e Veteranëve  
të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL)**

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tirane

Tel: 0682074317

Email-veterani.obvl@yahoo.com

Nr. 18/2 Prot

Tiranë, më 28.02.2014

**L e n d a : PROPOZIM PËR DEKORIMIN E GJENERAL-LEJTENANT**

**(në pension) RRAHMAN PARLLAKU dhe organizimin e**

**Takimit Jubilar me rastin e 95-vjetorit të ditëlindjes së tij**

**Drejtuar : Znj. MIMI KODHELI**

**Ministre e Mbrojtjes**

**E nderuara Znj. Ministre, Kodheli!**

Në kuadrin e 70-vjetorit të çlirimit të atdheut, si dhe me rastin e 95-vjetorit të ditëlindjes së gjeneral-lejtënant (në pension) Rrahman Parllaku, Kryesia e Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL), ju sugjeron të propozoni Presidentit të Republikës për ta dekoruar atë me me titullin “**NDERI I KOMBIT**”, me motivacionin: “Drejtues i talentuar i LANÇ dhe i Ushtrisë Shqiptare, qëndrestar i paepur në burgjet e diktaturës komuniste dhe kontributor i rrallë në mbështetje të demokracisë pluraliste dhe vendosjes e konsolidimit të shtetit ligjor”.

**KRYESIA E OBVL**

**EDIP OHRI**

**Sekretar i Përgjithshëm**

**SKENDER MALINDI**

**Zv/Kryetar**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**I jep**


**GJENERALLEJTËNANT (në lirim)  
RAHMAN PARLLAKU**


**Dekoratën “Nderi i Kombit”**


*“Drejtues i talentuar i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe i Forcave të Armatosura të Shqipërisë, qëndrestar i paepur në burgjet e diktaturës komuniste, veprimtar i rrallë në mbështetje të demokracisë, si dhe vendosjen e forcimin e shtetit ligjor”.*

Nr. Dekretit 8525  
Tiranë, më 02.04.2014

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

  
**BUJAR NISHANI**





*Heroi i Popullit,  
Rahman Parllaku  
në dy kohë*



## TREGUESI I LËNDËS

<i>Parathënie: Një legjendë në kufirin e dy kohëve</i> <i>Nga TEODOR LAÇO</i> .....	11
I. Vendlindja: NOVOSEJ. Pozita gjeografike, historia, tradita .....	15
II Fëmijëria dhe rinia .....	21
III Parllaku, drejtues i talentuar i LANÇ .....	50
IV Drejtuesi dhe parlamentari vizionar i pasluftës .....	93
V Roli i Parllakut në organizimin, modernizimin dhe konsolidimin e ushtrisë .....	99
VI Stoicizmi në burgjet e diktaturës .....	189
VII Kalvari i vuajtjeve të familjes .....	203
VIII Pafajësia dhe vitaliteti i Heroit .....	211
IX Publicistika dhe kontributi i Parllakut në historiografinë shqiptare .....	231
X Bashkëkohësit për gjeneralin .....	303
<i>Pasthënie: Kodet që njeriun e bëjnë gjeneral</i> <i>Nga Dr. FEJZULLA GJABRI</i> .....	336





*Parathënie*

# NJË LEGJENDË NË KUFIRIN E DY KOHËVE

*Nga* TEODOR LAÇO

**N**ë kohën tonë moderne të globalizmit nuk bëhet fjalë për legjenda. Megjithatë, ato ekzistojnë, pavarësisht heshtjes dhe indiferencës së opinionit publik.

Një protagonist me një jetë të jashtëzakonshme sjell para lexuesit edhe ky libër.

Nuk është thjesht një biografi tërheqëse, që për një shkrimtar do të qe një grishje për fantazinë. Është më shumë se kaq. Është një dëshmi për kohën që kemi lënë pas, për një kohë tepër të gjatë, si dhe jeta e heroit të librit, që këtë vit na vjen midis nesh me barrën e 95 viteve të tij që, si rrallëkush, i mbart me freskinë fizike, me mprehtësinë e gjykimit, me fjalën që nuk bie përdhë, me gjallërinë dhe energjinë e një burri shteti në gjysmën e moshës që ka ai.

Qofsh edhe për shumë vite të tjera siç të njohim e të shohim sot, miku ynë Rrahman Parllaku!

Nga jeta e një Matuzalemi si ti, na ulet këmbëkryq historia. Nga lufta dhe përkushtimi yt atdhetar na vjen një model për t'u ndjekur.

Nga ëndrra jote dhe e brezit tënd për një shoqëri të njerëzve të barabartë, që e kërkoi atë nëpërmjet komunizmit si ideologji, vjen edhe zhgënjimi i madh prej kësaj utopie që u përpoq të imponohej nëpërmjet luftës së klasave.

Nga një çerek shekulli i dënimit tënd, nga plumbi dhe vdekjet në qelitë e burgut, mund të njohim një nga pamjet më makabre të dhunës së diktaturës. Nga veprimtaria jote si veteran në këtë çerek shekulli të demokracisë bashkë me të tjerë ish-të dënuar si L.Belishova, E.Ohri, H.Ramohito, etj., mund të mësojmë se kurrë nuk është vonë për njeriun që të bëhet mbështetës aktiv i proceseve demokratizuese të shoqërisë.

Prej jetës së këtij njeriu, vijnë e të zgjohen edhe disa ndjenja, në dukje tepër intime, por që janë në thelbin e moralit të individit. Një prej tyre është dashuria dhe lidhja e tij me vendlindjen, me krahinën e Lumës dhe Kosovën. Historia dhe luftërat e tyre. Rrethanat ia sjellin Parllakut që të punojë në zanatin ëmbëlsues të hallvës. Tregtarët ambulante të saj në Korçë i quanin “gegë”. Ky “gegë” shtathedhur, i fortë fizikisht, i pashëm që bredh deri në Selanik, do të bëhej një nga drejtuesit kryesorë të njësiteve guerrile, pikërisht në Vlorë, aty ku ishte ndezur një nga vatrat kryesore të luftës antifashiste.

Megjithatë, identiteti i tij mbetet i derdhur që nga fëmijëria, aty ku për vite të tëra ndarjeje bashkohej verilindja shqiptare me Kosovën shqiptare, me Kosovën, liria e të cilës ishte “Ëndrra e jetës së tij”.

Dashuria për vendlindjen është një nga ndjenjat më të bukura. Kush e shpërfill, dëshmon për një shpirt të varfër. Jeta, lidhja me vendlindjen është zanafilla e respektit të tij për njeriun e thjeshtë, e humanizmit dhe altruizmit.

Kur më dha për një mendim librin e tij në dorëshkrim “Mirënjohje familjeve vlonjate...”, i thashë se ndoshta iu kishte lënë më shumë vend nënave dhe grave vlonjate, në raport me ngjarjet e tjera të njësitit guerril.

“Përkundrazi, iu kam lënë pak, - më tha. Pa dyert e zemrat e tyre të hapura, ne s’do të mund të bënim asgjë.”.

Këtë modesti dhe altruizëm në raportin e veprës së tij në luftë dhe më pas, kam patur mundësinë ta vërej dhe ta çmoj që nga takimi dhe biseda ime e parë me të rreth 20 vjet të shkuara, kur i kërkova një mendim për Gjeneralin Vaskë Gjino, që ishte nga fshati im dhe kishte vdekur në burgun e Burrelit.

“Po të shkruash ndonjë shkrim për të, thuajse për mua, ai ishte ajka e ajkës së akademistëve, ushtaraku më i aftë që mund të dërgohej në Vietnam, për të vëzhguar luftën që bëhej aty prej vitesh”, - m’u përgjigj Parllaku.

Ushtarak edhe vetë deri në palcë, akademist dhe epror i Gjinos, ai i linte atij vendin e kreut për nga përgatitja si ushtarak.

Dhe të jesh një jetë nën kapotën e ushtarit, do të thotë të pranosh një jetë murgu rreptësisht të programuar, duke e privuar veten nga tekat dhe argëtimet spontane, që ne të tjerët, civilët, ia lejojmë vetes duke anashkaluar disiplinën.

Libri i H. Ramës dhe S. Camit, një punë serioze për jetën e “Heroit të Popullit” Rrahman Parllaku nuk mund të jetë ezaurues, sepse ai është një figurë aq interesante, e madhe do të thosha pa droje, sa të tërheqë edhe më vonë pena të tjera.



# I

Vendlindja: NOVOSEJ  
*pozita gjeografike, historia, tradita*

# NOVOSEJ

## Pozita gjeografike, historia, tradita

Emri Novoseje ka prejardhjen prej sllavishtes, Novosello, fshat i ri. Novosej bën pjesë në komunën e Shishtavecit, në krahinën e Gorës. Novosej dhe Shishtavecit aktualisht janë pjesë e Qarkun të Kukësit. Komuna e Shishtavecit është komunë e krijuar në vitin 1992 dhe ka në përbërjen e saj 7 fshatra: Shishtavec, Novosej, Kollovoz, Shtrezë, Oreshkë, Borje dhe Cernalevë.

Qarku i Kukësit u krijua pas shpërndarjes së tre rretheve nga trunngu i tyre historik, Kosova, për shkak të vendimeve të padrejta të Konferencës së Londrës. Kukësi ka qenë qendra e Prefekturës së Kosovës që nga viti 1925. Pas vitit 1913, Luma u shpërndarë nga Prizreni, Hasi, kurse Malësia e Gjakovës u shpërndarë nga Gjakova.

Sot, Kukësi, Hasi dhe Tropoja përbëjnë Qarkun e Kukësit. Prefektura e Kosovës në vitet '20 të shek. XX përbëhej nga nënprefektura e Lumës me 31514 banorë dhe nga nënprefektura e Bunjajt (Tropojës), Malësi e Gjakovës me 14070 banorë. Kryeqendra e Prefekturës së Kosovës ka qenë Kruma. Nënprefektura e Lumës përfshinte krahinën e Ploshtanit me kryevend Bicaj. Kukësi në atë kohë ka qenë veçse një fshat i vogël me 213 banorë, ndërsa Novosej vendlindja e Parllakut ka patur 497 banorë. Shishtavecit ka patur 554 banorë, Cernaleva 132 banorë, Borja 426 banorë, Kollovozi 133 banorë, Shtrezja 120 banorë dhe Oreshka me 88 banorë. Vlen të theksohet se banorët kanë qenë të besimit myslyman.

Pra, siç del edhe nga statistikat e kohës të viteve '20, Novosej ka qenë një fshat i madh me fise si Mata, Ademi, Mustafa, Pasha, Toçila, etj. Sipas të dhënave të herëshme, ky

fshat u quajt fshat i ri, pasi u ringrit dhe u popullua me banorë rë rinj. Banorët e mëparshëm u shpërngulën për hakmarrje nga turqit në shekullin XVII, pasi në luftime me ta u vranë shumë ushtarë të një ekspedite turke. Dëshmi e luftimeve të asaj kohe janë sot pranë fshatit varret e shumë turqve dhe në gurët e mermerëve janë të gdhendur emrat e tyre.

Pronat e fshatit i ishin dhënë me ferman një oficeri që komandonte forcat turke. Ai me forcat e veta jo vetëm dogjën fshatin, por edhe shpërngulën tërë banorët prej tij.

Cilido që ka qenë në Novosej dhe në Shishtavec, si vizitor apo në kampionatin kombëtar të skive, në festën tradicionale të Shëngjergjit, apo i ftuar në një dasmë tradicionale, është impresionuar pa masë nga bukuritë e këtij vendi piktoresk që do ta kishte zili kushdo.

Kjo pllajë majë mali në Verilindje të Shqipërisë, e mbushur me lëndina të bukura e rudina me lule të panumërta, të mbush me kënaqësi e të ngall krenari.

Rahmani sot është 95 vjeç, por kujtimet i ka si 95 ditë më parë. Në këto vise plot jetë, në këto lëndina të pafundme, në këto izvore (burime) me ujë të ftohtë kristali u rrit heroi.

Dasmat e bukura me curle e lodra, garat e kuajve të zbukuruar me shamitë e dhëndurëve si Muji e Halili, të nuseve si zana mali, të çojnë në një botë irreale që këtu në kryeqytet do të paguaje miliona vetëm t'i shijojë këto çaste mrekullie. Shto edhe garat e mundjes së djemve të rinj që organizojnë minikampionate jo me kupa, por me deshë këmbore që janë ruajtur posaçërisht për këtë ditë.

Dhe kulmin e arrin festa e 6 majit, Dita e Shëngjergjit, që banorët e kanë për shpyqyrllek, që dolën nga dimri i gjatë dhe i ashpër dhe hynë në pranverën e vonë apo në verën e parë. Valle popullore, kostume popullore shumëngjyrëshe, curle tradicionale, pije dhe ushqime bio që çdo turist do të kishte dëshirë për t'i parë dhe provuar.

Në këtë mjedis të bukur, ndonëse jo shumë të pasur ekonomikisht, por të pasur shpirtërisht kaloi fëmijërinë heroi ynë i ardhshëm, Rahman Parllaku.



## Fisi "PARLLAKU"

Ndër ata që ripopulluan Novosejin ishin edhe të parët e Rrahman Parllakut. Ata erdhën nga Mati, të detyruar të largoheshin prej andej pasi kishin rënë në gjak dhe i trembeshin hakmarrjes.

I pari i fisit Parllaku, i ardhur në Novosej quhej Kurt Mata. I gjithë fisi, përjashtuar trungun familjar Parllaku edhe sot mban mbiemrin Mata.

Familja Parllaku u shkëput nga ky mbiemër shtatë breza më parë. Mbiemrin Parllaku e trashëguan nga një stërnip i tyre që quhej Ali, i cili, pas një revolte kundër turqve, u arratis pasi si një nga drejtuesit kryesorë të revoltës kërkohet nga turqit për t'u ekzekutuar.

Aliu ishte shumë i pashëm dhe turqit e kërkonin me llagapin Parllak, që në turqisht do të thotë i ndritshëm. Ai u tradhëtua dhe u kap nga turqit. Me ferman të Sulltanit, u dënua me vdekje dhe iu pre koka. Në nderim të tij, të parët e Rrahmanit morën mbiemrin Parllaku dhe sot janë rreth 50 familje që mbajnë këtë mbiemër.

## **“Djemtë e Lumës hiç s’kanë dert, nga një luftë e bëjnë për vjet”**

Novosej i krahinës së Lumës, aktualisht bën pjesë në Qarkun e Kukësit. Më herët, deri në vendosjen e kufijve Shqipëri-Jugosllavi, kjo krahinë ka qenë administrativisht në Qarkun e Prizrenit, në Kosovë. Si e tillë, Luma dhe veçanërisht Novosej i ka të lidhura traditat, zakonet dhe historinë me Kosovën. Kosova ka qenë një ndër katër vilajetet shqiptare gjatë sundimit osman.

Luftërat dhe kryengritjet e lumjanëve kundër turqve dhe sidomos ndaj serbëve kanë qenë të vazhdueshme dhe shumë të përgjakshme. Luma me historinë e saj ka zënë një vend të veçantë në të gjitha kancelaritë europiane dhe është komentuar nga të gjitha gazetatat e kohës si në Europë, ashtu dhe në Amerikë. Mjafton të ndalemi në panoramën e luftërave të viteve 1912-1913 për liri dhe pavarësi dhe t’i referohemi shtypit të kohës rreth lajmit për shkatërrimin e divizionit serb të gjeneralit Jankoviç dhe masakrat e ndërmarra prej tij.

Djemtë lumjanë të udhëhequr nga Ramadan Zaskoci dhe Islam Spahia kanë hyrë në histori.

Beteja e Lumës kundër forcave të Armatës së III-të serbe, 10 ditë para shpalljes së Pavarësisë sonë kombëtare, beteja e famshme e Kolesjanit, njihet si Termopileja e Lumës.

Rapsodi popullor lumjan këndon:

*“Gjithë Europa duhet ta dijë/Lufton Luma për Shqipni  
Ky krajl Pjetri po ban medet/Luma e kuqe m’faroi krejt  
Të kish zgjat lufta gjatë/Pata me lëshue këtë Beligrad....”*

Në lapidarin e qytetit të Kukësit, të titullar: *"Luma, kjo krahinë luftarake e Prizrenit"*, shkruhet: *"...Nga Qafa e Kolesjanit deri tek Kulla e Lumës, në vitin 1912, populli i Lumës, i Hasit, i Reçit dhe i Dardhës, me një heroizëm të paparë vranë brenda 36 orëve rreth 12 mijë shovinistë serbë që kishin okupuar këtë krahinë"*.

Kundërpërgjigja dhe genocidi serb ka qenë i pashembullt në këto zona. Novosej, fshati i Parllakut, është një nga 28 fshatrat e djegura dhe të bëra shkumb e hi nga serbët, shto këtu edhe qindra burra të pushkatuar nga këto fshatra.

Ja si thotë kënga e popullit që evokon këtë luftë:

*"Krajli i serbit ban medet,  
Ma faroj Luma asqerin krejt,  
M'i faroi asqerët e ngratë.  
Burrat me pushkë e gratë me spatë,  
M'i faroi ushtarët e mi,  
Jo më pak se 12 mijë..."*

.....

Varret e të vranëve të fisit "Parllaku" shtrihen edhe në Kosovë, deri në hapësirën e Nishit. Varri i Kurtish Parllakut dhe të shumë parllakëve të tjerë ndodhen në afërsi të Shtimjes, në Kosovë.

Populli, burrërinë dhe trimërinë e tyre e ka qëndisur në këngë:

*"Te del dielli e te del hana,  
Kësi burrash nuk ban nana..."*

# II

Fëmijëria dhe rinia

## Rrënimi ekonomik

Lumjanët dhe novosejasit jo vetëm u vranë dhe u dogjën nga pushtuesit, por edhe u shkatërruan ekonomikisht. Ata kanë qenë rritës të mrekullueshëm të deleve të racës rudë. Këto dele kullosin në lëndinat dhe rudinat e Malit të Gjalllicës, Korabit e të Sharrit nga blegtorët lumjanë që i verojnë në këto pllaja të mrekullueshme. Ndërsa dimërimi bëhej në vendet e ngrohta deri në Selanik të Greqisë. Edhe gjyshi i Rrahmanit, për 30 vjet rresht, i kishte veruar delet në kullotat dhe fushat e Selanikut.

Por ushtritë plaçkitëse të Ballkanit, serbe, bullgare, etj., grabitën mbi 200 mijë dele të lumjanëve që ktheheshin nga Selaniku për në Lumë. Vetëm familjes së babait dhe xhaxhait të Rrahmanit i grabitën mbi 300 kokë dele. U kthyen në Novosej vetëm qentë dhe barinj të tmerruar.

Kjo humbje e madhe ekonomike dhe traumë psikologjike e shkatërroi së tepërmi familjen Parllaku, por instinkti i mbijetesës së shqiptarit ndër shekuj triumfoi dhe babai i Rrahmanit, Latifi, në vitin 1914 emigroi në Sarajevë të Bosnjës, ku bashkë me një bashkëfshatar të tij hapën një dyqan ëmbëlsirash.

Këtë zanat ua transmetoi edhe fëmijëve, Selimit dhe Rrahmanit.

## Fëmijëri e vështirë

Në këtë familje të thjeshtë dhe punëtore, më 17 prill të vitit 1919, në fshatin Novosej të Lumës u lind Rrahman Latif Parllaku.

Shkollën fillore e kreu në Shishtavec. Mësues i tij ishte Salih Kolgeci nga Kolgecaj i Tropojës. Në moshën 12-vjeçare u detyrua të ndërpriste shkollën dhe të fillonte punë me babanë dhe vëllanë në profesionin e pastiçerit në Cakran të Mallakastrës.

U kthye përsëri për të vazhduar shkollën dhe për të dhënë provimet. Me ndihmën dhe këmbënguljen e mësuesit të tij, Saliut, dhe të drejtorit të shkollës Myslim Sina nga Tërbaçi i Vlorës, arrin ta përfundojë arsimin fillor 5 vjeçar, madje me rezultate të larta. Por, nuk iu dha bursa për të vazhduar studimet e mëtejshme.

Edhe pse ushtronin zanatin e thjeshtë si prodhues ëmbëlsirash ose siç quheshin në gjuhën popullore “hallvaxhinj”, prindërit e Rrahmanit ishin njerëz të nderuar dhe punëtorë. Të shkolluar në shkolla fetare, ata ishin njerëz me shpirt të pasur dhe të ndershëm. Babai i Rrahmanit, Latifi, përveç gjuhës shqipe zotëronte gjuhën turke, serbo-kroate dhe greke. Gjuhën turke e kishte mësuar gjatë sundimit turk, gjuhën greke gjatë verimit të bagëtitive në Selanik, ndërsa gjuhën serbo-kroate nga fqinjët.

Me katër gjuhë, njohës i katër kulturave, Latif Parllaku edhe pa qenë akademik, iu brumosi fëmijëve të tij dashurinë për punën dhe atdheun.

Latifi, si besimtar, thoshte se para imanit, bindjes ndaj Zotit, është vatani.

Edhe nëna e Rrahmanit, Kadimja, një grua me virtyte, bujare dhe punëtore, drejtonte një familje të madhe.

Megjithatë, jeta e vështirë i detyroi vëllezërit Parllaku të emigronin rishtas në Selanik të Greqisë gjatë viteve 1925-1929, por këtë herë jo si blegtorë, por si prodhues ëmbëlsirash, ku hapën edhe një dyqan të tyre për t'i tregtuar ato.

## Në Kukës për të festuar 20 vjetorin e pavarësisë

**Ja si e kujton Rrahmani vizitën e tij të parë në Kukës, më 28 Nëntor 1932, në 20-vjetorin e Pavarësisë:**

*“Isha 13 vjeç. Ne nxënësit e shkollës së Shishtavecit si dhe të shkollave të tjera erdhëm në Kukës për të festuar 20-vjetorin e Pavarësisë.*

*E ruaj ende edhe sot të freskët rrugëtimin e asaj dite nga Borja, Zapodi, Belja, Qafa e Zbinecit, Përbregu deri në Kukës. Me një çantë ushqimesh në krah, mbushur plot me fantazi ëndrrash feminare për të parë qytetin e Kukësit, por u befasova kur pashë Kukësin e asaj kohe edhe më të vogël se Novosej im. Bujtëm të shpërndarë në disa familje të Kukësit dhe të nesërmen na veshën me uniformë basme, me ngjyrat kuq e zi si të flamurit tonë kombëtar, pantallona të zeza dhe këmisha të kuqe.*

*Me këtë uniformë parakaluam para autoriteteve të vendit dhe njerëzve të grumbulluar me këtë rast. Pas parakalimit na dhanë për darkë simite me qofte dhe djathë. Pasdite, shkolla jonë nisi marshimin. Atë mbrëmje fjetëm në fshatin Përbreg dhe të nesërmen u kthyem të rraskapitur në fshat.”*

## Vitet e shkollës fillore dhe mësuesi i tij Salih Kolgeci

Rrahmani kujton:

*“Koha e njohjes me mësues Salihin që vetëm një vit shkollor (1932–1933), në shkollën e Shishtavecit. Me sa më kujtohet, ai ishte emëruar në shkollën tonë me të mbaruar studimet në “Normalen” e Elbasanit.*

*Atë vit, shkolla jonë u riorganizua dhe u plotësua me drejtor dhe 4 mësues. Salihi jepte mësim në klasën e IV e të V-të, ku edhe unë isha nxënës. Drejtor i shkollës ishte caktuar Myslim Sina, nga Tërbaçi i Vlorës dhe mësues ishin Emine Sina, bashkëshortja e Myslimit, Muharrem Domi nga Gjakova e Xhelal Hardalli nga Shkodra.*

*Në shkollë ishte vendosur një rregull e disiplinë e rreptë. Mësimdhënia ishte shumë e mirë. Çdo klasë kishte mësuesin e vet, vetëm klasa e IV-t dhe e V-të, që kishin pak nxënës, ishin në një dhomë. Në këto dy klasa jepte mësim mësues Salihi dhe plotësonte disa orë edhe drejtori. Mësues Salihi ishte rigoroz e kërkues ndaj nesh.*

*Unë isha i shkëputur një vit nga shkolla, pasi më kishte marrë babai me vete për punë në një lokal ëmbëltorje në Cakran të Fierit. Kjo u bë jashtë vullnetit tim, por nga nevojat ekonomike. Aty gjeta një mësues nga Shkodra, Shyqyri Hafizin (kuadër e luftëtar i njohur në Shkodër). Ai ishte beqar dhe shumicën e kohës së lirë e kalonte në lokalin tonë. I kërkova të më jepte mësim për klasën e IV dhe ma plotësoi dëshirën. Bleva librat dhe fillova mësimin. Mësues Shyqyriu më kontrollonte njohuritë. Kështu, jashtë shkolle, po e mbaroja klasën e ndërprerë.*

*Për vitin shkollor 1932–1933 iu luta babës dhe me këmbënguljen e vëllait, Selimit, babai më la që ta vazhdoja shkollën në Shishtavec.*



*Fillimisht u regjistrova në klasën e IV. Pas disa provimeve që më bëri, mësues Salih u bind dhe me porosi të drejtorit më vlerësoi për mbarimin e kësaj klase. Kështu, më 18 janar 1933 dhashë provimet e klasës së IV me nota shumë të mira dhe kalova në klasën e V.*

*Falë kujdesit prindëror dhe ndihmës që më dha mësues Salih si dhe përkushtimit tim, e mbarova shkollën shkëlqyeshëm."*

### **Si iu dogj bursa e studimit për në "Normale"-n e Elbasanit**

Mësues Salih bashkë me drejtorin thirrën Latifin, babain e Rrahmanit dhe e këshilluan që t'ia plotësonte dëshirën, pra ta dërgonte për të ndjekur studimet në Shkollën "Normale" të Elbasanit, pasi profesioni i mësuesit atëherë ishte ideali i të rinjve.

Latifi e pranoi me dëshirë këshillën e tyre. Plotësuan dokumentat bashkë me një shokun e lagjes, Zaid Bakallin, si nxënës të shkëlqyer. Dokumentat i mori drejtor Myslimi që t'i dorëzonte në Ministrinë e Arsimit, kur ai të shkonte për në Vlorë.

Pritën deri në fillim të tetorit të atij viti pa marrë lajm. U interesuan në Inspektorinë e Arsimit të Prefekturës. Aty mësuan se u ishte pranuar kërkesa.

U nisën menjëherë për në Elbasan, të bindur se bursa u ishte dhënë për në Shkollën "Normale". Më 14 tetor 1933 u paraqitën në drejtorinë e shkollës. U thanë se nuk kishin bursë aty dhe se emrat e tyre nuk figuronin.

Të shqetësuar, u nisën drejt Kavajës, pasi aty Zaidini kishte xhaxhallarët dhe më pas, të shoqëruar nga njëri prej tyre shkuan në Ministrinë e Arsimit, Tiranë. Aty morën vesh se meqenëse ishin vonuar, bursat e tyre u ishin dhënë të tjerëve nga Shkolla Teknike e Tiranës. Kështu përfundoi ëndrra për Shkollën "Normale", që aq shumë e dëshironte Rrahmani dhe që ia kishte nxitur aq shumë edhe mësues Salih.

## Rini e gjakosur

Më 1930, babai i Rrahmanit, Latifi, së bashku me të vëllain u largua për në Vlorë dhe Cakran të Mallakastrës. Nga viti 1936 deri në vitin 1939, Rrahmani punoi në Selenicë të Vlorës.

Në minierën e Selenicës punonin 400 punëtorë. Selenica e asaj kohe ishte si një fshat me barraka e kasolle. Në qendër të Selenicës ishin zyrat e shoqërisë italiane "SIMS".

Afër tyre ishte lokali i Selim Parllakut, vëllait të Rrahmanit. Ky lokal tregtonte kafe, pije dhe ëmbëlsira të ndryshme. Furnizimin e lokalit në Vlorë e bënte Rrahmani. Sapo të gjente pak kohë të lirë, Rrahmani lexonte libra të ndryshëm që gjendeshin ndër punëtorët e minierës së bitumit. Nëpërmjet trenit që transportonte bitumin nga Selenica në Vlorë, Rrahmani siguronte shtypin e kohës.

7 Prilli 1939 e gjeti Parllakun në Selenicë.

Rrahmani me vëllain Selimin dhe kushëririn, Baftjarin, tre të rinj lumjanë, së bashku me popullin e Vlorës dhe të Selenicës u përfshinë në revoltën kundër fashizmit. Më 5 prill 1939, populli kërkonte armë. Masa e popullit lëvizte nga Konsullata italiane, sot Bashkia e Vlorës, deri në Skelë dhe kthehej prapa. Por autoritetet gënjenin se armë nuk kishin. Më datën 6 prill 1939, në mbrëmje po kalonte deputeti i Vlorës, Sadik Shaskaj, hipur në një makinë që po shkonte drejt Qafës së Koçiu, i rrethuar nga populli që kërkonte armë edhe ai premtonte, por asgjë nuk erdhi deri më 7 prill. Në Vlorë, fashistët u pritën me luftë. I dërguari i Komandës së Përgjithshme, nënkolonel Ali Rizai, nuk mundi të përgatiste rezistencë të organizuar,

por rezistencën e organizoi populli, ndonëse ishte rezistencë spontane dhe vetëm 24 orëshe.

Vëllezërit Parllaku dhe shumë të tjerë nga Selenica u kthyen në qytezën e vogël punëtore, por qëndrimi i mëtejshëm i tyre në Selenicë ishte i pamundur, sepse ishin armiqësuar me autoritetet italiane të minierës.

Të ndodhur në këto kushte, ata u larguan drejt Vlorës ku në nëntor 1939 hapën një lokal pasticerie. Këtu, Rrahmani u lidh me të rinjtë dhe u përfshi në lëvizjen antifashiste.

Në protestën e zhvilluar më 28 Nëntor 1941 kundër pushtuesve, në kulmin e entuziazmit të protestuesve të dalë në krye për të mbajtur flamurin kombëtar që përpiqeshin ta rrëmbejnë fashistët, mori një goditje të fortë në kokë.

### **Mobilizimi me forcë i të rinjve shqiptarë nga Italia fashiste për të shkuar në frontin italo-grek. Dezertimi i shqiptarëve**

Në shërbim të luftës u bë mobilizimi me forcë i të rinjve shqiptarë për të shërbyer në ushtrinë italiane. Në familjen Parllaku mobilizuan vëllain e madh, Selimin.

Kundërshtimin ndaj luftës së fashistëve italianë kundër Greqisë e filluan të rinjtë shqiptarë që iu shmangën në masë thirrjes nën armë për të luftuar kundër fqinjëve grekë. Kundërshtim të hapur dhe në mënyrë demonstrative bënë edhe shumë oficerë patriotë shqiptarë, të cilët i tërhoqën nga fronti i luftës repartet që komandonin, pa përfillur ligjet e luftës, që në këto raste të jepnin dënimin me vdekje.

Me pasojat e braktisjes së frontit nga efektivat e reparteve ushtarake shqiptare Rrahmani u njoh kur takoi vëllain e tij, Selimin. Ai ishte i mbyllur në kampin e Shijakut me gjithë efektivin e çarmatosur të batalionit "Tomorri", pasi me urdhër të komandantit të tyre, major Spiro Moisiut, në mënyrë demonstrative kishin braktisur frontin e luftës, siç kishin bërë

edhe shumë reparte të tjera me urdhër të komandantëve të tyre.

Braktisja e frontit dhe dezertimet në masë të ushtarëve shqiptarë ishin përgjigjja e prerë me të cilën populli shqiptar i tha jo luftës kundër fqinjëve. Këto veprime të ushtrisë shqiptare, Musolini i quajti një nga faktorët kryesorë të disfatës të ushtrisë italiane në luftën kundër Greqisë.

Përkrahjen që shqiptarët i dhanë popullit grek në luftë dhe ndihmën që ua dhanë grekëve të ikur nga lufta, të cilët erdhën deri në krahinat e Vlorës, duke ndarë së bashku kafshatën e bukës së fëmijëve tanë, kurrë nuk e vlerësuan.

### **Ëmbëltorja "Selim Parllaku", qendër e organizimit të rezistencës antifashiste**

Italia fashiste nuk bëri asgjë për të shëruar plagët që lufta u shkaktoi mijëra familjeve shqiptare, përkundrazi. E angazhuar në luftën botërore, ajo përpiqej të rrëmbente ç'të mundte nga pasuritë e vendit tonë, duke shtuar më tepër varfërinë dhe vuajtjet e popullit.

Gjendja e krijuar e shtoi pakënaqësinë dhe urrejtjen ndaj fashizmit. Këtë Selimi dhe Rrahmani e kuptonin nga bisedat e klientëve që vinin në lokalit e tyre. Mes tyre kishte shumë nxënës të Shkollës Tregtare me prejardhje nga fshati që flisnin për gjendjen e rëndë ekonomike të fshatrave të tyre. Tema e ditës ishte urrejtja kundër pushtuesit, e cila sa vinte e rritej dhe po kalohej gradualisht në forma të hapura të rezistencës antifashiste. Në krye të kësaj lëvizjeje ishte rinia shkollore e mbështetur nga mësuesit përparimtarë dhe intelektualët patriotë.

Pushtuesit fashistë filluan ndjekjet e persekutimet, burgosjet e internimet në kampet e përqëndrimit në vend dhe në ishujt e Italisë. Por pa marrë parasysh terrorin fashist, rezistenca popullore ishte duke u rritur dhe duke kaluar në

forma të organizuara. Kështu iu hap rruga aksioneve luftarake.

Në Vlorë, më 9 mars 1940, nxënësit e shkollave i ndërprenë fjalën Ministrin të Brendshëm, Kol Bib Mirakaj, dhe shpërthyen në demonstrata jashtë kinemasë ku po organizohej mbledhja. Me parrulla antifashiste, ata marshuan drejt Sheshit të "Flamurit". Me ta u bashkuan populli i Vlorës dhe të rinjtë. Fashistët kundërvepruan duke arrestuar e internuar në ishullin e Ventotenes, në Itali, dymbëdhjetë të rinj dhe kjo e shtoi edhe më shumë revoltën.

Në lokalin e Selim Parllakut, kjo ngjarje u komentua gjerësisht. Nxënësit flisnin me pakënaqësi për zëvendësimin me një drejtor italian të drejtorit të shkollës, Naum Stralla, i cili gëzonte respekt të veçantë dhe qëndronte krah tyre.

Lëvizja në Vlorë po zgjerohej dhe po organizohej. Një rol gjithnjë në rritje po luanin pjestarët e grupeve komuniste. Në lokal filloi të qarkullojë shtypi antifashist, që i nxiste masat e popullit për t'u bërë pjesë e revoltës së organizuar.

Më 6 gusht 1941, i riu Shyqyri Alimeko kreu një aksion me rrezik për jetën, por që përfundoi me sukses. Ai u vuri zjarrin depove të armatimit dhe të municionit të ushtrisë fashiste, duke i shkaktuar armikut dëm të madh, pasi për tre ditë rresht zjarri shkriu me mijëra ton municione.

Fashistët nuk mundën ta zbulonin burimin e aksionit, ndërsa efekti politik dhe kënaqësia e popullit ishte shumë e madhe tek dëgjonte plasjet dhe shikonte shtëllungat e tymit gjatë ditës dhe flakët ndriçuese gjatë natës.

Viti 1941 erdhi me tronditje të mëdha. Gjermania naziste kishte pushtuar pjesën më të madhe të Europës dhe në qershor të atij viti sulmoi ish-Bashkimin Sovjetik. Kjo ishte tema e ditës që u komentua gjerësisht në lokalin "Parllaku", ku të rinjtë e ndjenin veten të sigurt dhe kishin besim të plotë se nga lokali "Parllaku" nuk u vinte asnjë e keqe.

Të gjithë e dinin se më 7 Prill 1939, kishin qenë në Vlorë, Selim, Rrahman dhe Baftjar Parllaku në kërkim të armëve për të luftuar fashizmin.

Krahas ndikimit të bashkëmoshatarëve të tyre, që iu shprehnin hapur urrejtjen kundër fashizmit, tek ata një ndikim të madh pati edhe leximi i fshehtë i shtypit antifashist që qarkullonte në formë komunikatash dhe shpërndahej nga grupet komuniste.

Me afrimin e festës së Pavarësisë, 28 Nëntorit 1941, situata po tensionohej. Kjo ndihej në bisedat e të rinjve që mbushnin lokalit "Parllaku" ose tek "hallvaxhiu", siç njihej rëndom nga populli dhe që ua shtonte dëshirën për t'u përfshirë sa më parë në luftën çlirimtare, që po merrte formë të organizuar. Edhe pse konspiracioni nuk i lejonte frekuentuesit e lokalit të flisnin hapur me vëllezërit Parllaku, ata kishin dëgjuar se ishte formuar Partia Komuniste Shqiptare dhe po përpiqej të merrte në dorë drejtimin e luftës.

Zhvillimi i vrullshëm i ngjarjeve dhe kontakti i përditshëm me pjesëtarët e kësaj lëvizjeje antifashiste e shtynë Parllakun të përfshihej në të.

Erdhi momenti që urrejtja e grumbulluar brenda tij të shpërthente.

### **Njohja në dyqan me Jani Zaharinë, "duhanxhiun", dhe përfshirja e Parllakut në Lëvizjen Çlirimtare**

Kaluan 10 ditë. Një mëngjes kur Rrahmani ishte vetëm në lokal dhe po përgatiste një kazan me brumë llokumi, në lokal hyri një i panjohur që nuk priti te banaku, por erdhi direkt tek ai. "Rri, mos luaj usta, unë nuk të bezdis", - tha i panjohuri, pastaj tërhoqi një karrige dhe u ul pranë tij.

Paraqitja e tij e jashme ishte moderne dhe elegante, pantallona sport deri nën gju dhe kasketë në kokë si e detektivëve të policisë.

Më pas, i panjohuri vazhdoi: "Ti je nga krahinat e Veriut, përse nuk je rregjistruar në ndonjë kurs ushtarak, mund të kishe të ardhme, pasi ushtarakët tani paguhen mirë".

Rrahmani e sqaroi se zanatin e hallvaxhiut, specialistit të ëmbëlsirave, e kishte trashëguar nga babai dhe se megjithëse nga Veriu, nga krahina e tij vetëm një njeri ishte veshur xhandar dhe pesë ishin oficerë (kreshnikë) që i mbante me vete Mbreti Zog. Ai vazhdonte me të tijën gjoja për t'i mbushur mendjen, duke i thënë se kohët kanë ndryshuar dhe se fashizmi tani iu bën një trajtim më të mirë ushtarakëve, etj.

Parllaku, i bindur se kishte të bënte me një provokator, ia ktheu: "Zotëri, fashizmin nuk e kam ftuar unë të vijë në Shqipëri. Ai na ka pushtuar. Ju i ri jeni dhe mund t'i shërbeni, unë nuk e çoj nëpër mend të vihem në shërbim të tij."

I panjohuri u ngrit të ikte duke thënë: "E kuptova, ju nuk e dashkeni fashizmin, po ne mund të bisedojmë prapë bashkë", dhe e pyeti për emrin.

Aty për aty, Parllaku ia ktheu: "Ju e keni të qartë mendimin tim. Ne bashkë s'kemi për çfarë të diskutojmë dhe sa për emrin tim, atë mund ta shikoni në tabelën përpara dyqanit. E kërkonte rregulli të shkruhej emri i pronarit dhe specialiteti i tij." Në të dalë, Parllaku e pyeti: "Po ju kush jeni e me se merreni, zotëri?".

Burri me veshjen sportive u prezantua. Ishte Jani Zaharia dhe punonte në librarinë e Ibrahim Shytit, që Rrahmani e dinte se ku gjendej dhe kështu u ndanë.

Kurioz për vizitorin e panjohur, donte të sigurohej për adresën e tij. Sa erdhi vëllai, Selimi, menjëherë i tha se do të dilte dhe shkoi te shoku i tij, Hasipi, të cilit i tregoi gjithçka. Vendosën të dilnim bashkë. Duke kaluar pranë librarisë, panë se Jani ishte aty dhe Hasipi i tha se kishin të bënë me një njeri të mirë dhe se gjatë luftës italo - greke e kishte dëgjuar të fliste me shokët e tij kundër italianëve.

Me të hyrë në librari, Jani u kthye nga Rrahmani duke i thënë: "Më thatë s'kemi ç'të bisedojmë, por shumë shpejt ma ktheve vizitën.

-Desha të di ç'përfaqëson vizitori im", iu përgjigj Parllaku.

Kështu, Rrahmani u njoh me Jani Zaharinë me pseudonimin “Duhanxhiu” dhe nëpërmjet tij u lidh me luftën çlirimtare.

Pas kësaj dite u përfshi në njësitet guerrile të qytetit, fillimisht guerrilas i thjeshtë pastaj përgjegjës grupi e njësi, me pranimin si anëtar i Partisë Komuniste.

Kujtimet për jetën dhe luftën në Vlorë janë pasqyruar në një libër të plotë të Rrahman Parllakut me titull “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”.



## “Krajli”, pseudonimi i luftës

*Ja si i rrëfen kujtimet e luftës guerrile heroji, fillimisht si guerrilas i thjeshtë e më pas nga marsi 1942 e deri në dhjetor 1943 si udhëheqës i njësiteve guerrile të qytetit të Vlorës.*

“Shpeshherë kam pyetur veten se kush janë heronjtë e vërtetë të luftës, jemi ne të rinjtë e asaj kohe që vumë jetën në moshën më të re në shërbim të popullit e të atdheut apo ata prindër që u bashkuan me ne e nisën fëmijët e tyre në luftë, me ndërgjegje e bindje se edhe mund të mos i shihnin më.

Kishte edhe prindër që dërguan në luftë edhe fëmijën e vetëm, duke mos kursyer as jetën e tyre. Kishte nga ata që vunë në shërbim të luftës shtëpitë e tyre, edhe pse në murin e jashtëm të banesës ishte vendosur shpallja e fashistëve se kushdo që strehon ilegalë pushkatohet dhe i digjet shtëpia. Ja, këta prindër patriotë meritojnë nderimin, respektin dhe mirënjohjen e kombit. Të tillë prindër e familje Vlora ka patur shumë.

Unë që nuk isha nga Vlora, ndoshta e kam ndjerë më shumë se vlonjatët kanë jo vetëm bujarinë e mikpritjen, por edhe guximin dhe vendosmërinë e tyre për t’u shkrirë me tërë familjen për lirinë e popullit dhe të atdheut.

Çdo lagje e Vlorës kishte familje e baza të luftës. Këta njerëz u bënë për mua shumë të dashur, aq sa mund të them se i konsideroja si prindër e familje. Unë nuk kisha një familje, por një pjesë e mirë e familjeve vlonjate u bënë edhe familja ime.

E kam të vështirë të nis tregimin tim, pasi nuk di nga t’ia filloj më parë. Megjithatë po e filloj nga Llonxha, sot lagjja

“Partizani”, nga nënë Tarika Hoxha, nëna ime e dytë, që po rriste fëmijë jetim, pasi i kishte vdekur i shoqi. Thashë po rriste, se tre prej fëmijëve i kishte ende të vegjël, ndërsa dy të rriturit, Feçorri dhe Hysniu, anëtarë të njësiteve guerrile, vdiqën në kampet naziste.

Ishte 9 tetori i vitit 1943, kur nazistët dhe ballistët tradhtarë rrethuan qytetin e Vlorës dhe bënë kontrollë e arrestime në masë, e midis guerrilasve të tjerë kapën edhe Hysniun e Feçorrin. Ata, të drejtuar nga zëvendësi im, Miço Emini, kishin punuar deri natën vonë për të pastruar 20 pushkë, 12 mitralozë të lehtë, 7 mitralozë të rëndë, 4 mortaja e municionet e tyre, që më pas ua jepnin guerrilasve të tjerë për t’i shpërndarë në disa pika, e nga atje në repartet partizane.

Nënë Tarika tregonte: “Kur u kthyen djemtë në shtëpi, kishte kaluar mesi i natës. U shtrova bukë, hëngrën dhe pastaj ranë të flinin, pasi ishin të rraskapitur. Gjatë gjumit të parë u shpërthye dera dhe fenerët e gjermanëve na zgjuan mua dhe pesë djemtë që flinin krah njëri-tjetrit në rrogzin e shtruar përdhe. (Në ata rrogzë edhe unë kisha fjetur për netë të tëra).

Hyrja e gjermanëve në shtëpi ishte shumë e befasishme, pasi informatori i kishte drejtuar mirë pushtuesit në shtëpinë tonë, aq sa asnjë nga djemtë nuk arriti të merrte armën dhe të shtinte kundër tyre. Edhe në tentativën që bëri Miçua, u kap menjëherë nga gjermanët”.

Pas kontrollit nazistët arrestuan Miçon, nënkomandantin e njësiteve guerrile dhe tri djemtë e nënë Tarikos, ndër ta edhe Gjyshin 12-vjeçar, i plagosur në këmbë pa dashur me automatikun e Hitos. Nëna i ndoqi djemtë deri në qendrën e grumbullimit të të arrestuarve, edhe pse mbante në shpinë djalin e saj Gjyshin, për të cilin iu lut ballistëve të mos e merrnin të voglin, që gjoja kishte thyer këmbën se kishte rënë nga biçikleta. Në këtë moment një nga ballistët i kishte thënë: “Po ta lirojmë djalin, por po të marrësh vesh se ku është Rrahmani, eja e na njofto se do t’i lirojmë edhe dy të tjerët”. Nënë Tarikua mori Gjyshin dhe shkoi në shtëpinë e saj. Kur mësoi se isha

strehuar në një shtëpi aty pranë, në atë të Mulla Sulos (kështu e thërrisnin në Vlorë babanë e akademikut Shaban Demiraj, që ishte hoxhë), erdhi më takoi dhe më dha lajmin e hidhur të arrestimit të Miços dhe të shumë të tjerëve. Më pas, nënë Tariko tha: “Më vjen mirë që ke shpëtuar, pasi armiqtë pyesin çdo të arrestuar për vendndodhjen tënde. Edhe mua kur më lanë që ta merrja tim bir, Gjyshin, më thanë që, nëse mësoja ku ishe ti dhe shkoja e njoftoja, do të lironin edhe Feçorrin, dhe Hysniun. Ata i kam djem gjaku, por edhe ty të kam djalë njësoj si djemtë e mi. Armiqtë me ty e kanë mllefin, por edhe ne atyre inatin ua kemi. Ata m’i morën fëmijët në vatër e po qe shkruar të m’i vrasin, s’jam as e para dhe as e fundit nënë që i vriten fëmijët për Shqipëri. Ruaju e mos bjer në dorë të tyre!”. U përqaftuam e u ndamë me lot në sy.

Kujtimet janë shumë. Por do të ndalem edhe te një tjetër nënë, Hyri Gorishova ose siç e thërrisnim, nënokja. Kjo ishte nëna e tri partizaneve trime, Ylvies, Hënës dhe pionieres luftëtare, Fairesë. Kjo nënë e kishte hapur shtëpinë e saj për gjithë luftëtarët. Në këtë shtëpi bëheshin mbledhje, takime e linin armët ilegalët, pako të tëra me komunikata, mjekoheshin të plagosurit apo mbaheshin dhe spiunë të arrestuar. Ne bënim mbledhje dhe nënokja me shall mbi supe apo pallto veshur na bënte roje në oborrin e shtëpisë, pranë gardhit të mbuluar me manaferra dhe kur do të dilnim nga shtëpia, ajo shikonte rrugën. Kur nënës iu bë i pamundur qëndrimi në qytet, pasi shtëpia e saj kishte rënë shumë në sy të armiqve si bazë, dhe vajzat e saj ishin ilegale, edhe nënokja mori rrugën e malit së bashku me vajzat dhe u bë bashkëluftëtarja jonë. Vajzat e nënokës kanë pjesën e tyre të kontributit në luftë. Ylvija, me karakter burrëror, u mor me shërimin e plagëve të partizanëve të plagosur. Hëna ishte organizatore dhe drejtuese e Rinisë Komuniste, kurse Fairesja na ndihmonte me shërbime të ndryshme si korriere dhe zbuluese.

Pak më sipër shtëpisë së nënokës ishte edhe një tjetër bazë e jona, shtëpia e nënë Havasë, nëna e luftëtarit për pavarësi,

luftëtarit demokrat, Halim Xhelo Tërbaçit. Edhe kjo nënë kishte rritur me mundime dy djemtë e Halimit, luftëtarë që ndoqën rrugën e babait të tyre, Sazanin dhe Nusretin. Ky i fundit është edhe dëshmor i Luftës Nacionalçlirimtare. Shtëpia e saj u bë, ashtu si edhe shumë shtëpi të tjera, bazë e luftës. Shtëpia e nënë Havasë ishte shtëpia e luftëtarëve ilegalë në qytet dhe e atyre që vinin me shërbim nga jashtë tij. Të dy nipat e nënë Havasë dolën partizanë. Sazani e Nusreti fare të rinj u rreshtuan në Brigadën e V-të Sulmuese, e megjithëse komanda e brigadës donte ta mbante afër, Nusreti nuk pranoi, por shkoi në vijën e parë të luftës, në grupin e sulmit ku dhe u vra.

Baza të njësitit ishin të gjitha shtëpitë e patriotëve në Vlorë. Për të sqaruar këtë do të flas për një bazë në lagjen "Llonxhë", shtëpi e nënë Shefikatit. Ajo kishte dy vajza dhe njëren me aftësi të kufizuara fizike. Kjo shtëpi ishte në hyrje të lagjes dhe pozicioni i saj favorizonte veprimtarinë tonë ilegale, pasi na siguronte hyrje e dalje nga qyteti pa asnjë problem. E them sinqerisht se dhjetra ilegalë kanë ndenjur me netë të tëra në atë shtëpi. Atje kemi bërë edhe mbledhje e takime të ndryshme të partisë, rinisë e më vonë të Këshillit Nacionalçlirimtar të lagjes, e të tjera. Aty më kujtohet se mbajtëm të arrestuar edhe dy agjentë të kriminelit Isa Toska, dërguar për të gjurmuar e vrarë një të kërkuarin e tij dhe pas dy ditësh i dërguam në repartet partizane. I morën atje për të nxjerrë prej tyre informata të rëndësishme. Gjatë gjithë kohës që kemi ndenjor e zhvilluar mbledhje në atë shtëpi, nënë Shefikati dhe e bija, Nebije, jo vetëm që na shërbenin me përkushtim, por na ruanin e vigjelonin që të mos na ndodhte gjë. Veprimtarinë e tyre në krahun tonë e paguan, pasi pushtuesit arrestuan dhe interruan të shoqin e Nebijes, i vetmi mashkull në shtëpinë e tyre.

Edhe në Lagjen e Re kishim shumë baza të përshtatshme për veprimtarinë tonë guerrile e një nga këto ishte shtëpia e Rexhep Nuri Arapit, familje me dy breza luftëtarësh. Në shtëpinë e Arapajve nuk kishim vetëm një bazë, por tri, pasi

edhe dhoma ku banonte Sali Ymeri, ishte baza jonë, kurse në pjesën perdhese kishim teknikën, ku shtypeshin komunikatat. Këtë punë e kryente me përkushtim luftëtari trim, tri herë i plagosur, Dhimitër Mandro. Këtë shtëpi e rrethuan dy herë armiqtë, herën e parë isha vetëm me Nuriun dhe të dytën ishim katër, së bashku me Mihalini dhe Dhimitrin. Falë pozicionit të saj, kopshtit që ndodhej në pjesën e pasme, ne arrinim të largoheshim nga atje në baza të tjera. Më kujtohet se herën e dytë arrestuan Rexhepin, por për mungesë faktesh e liruan, sepse nuk gjetën gjë kur kontrolluan, pasi teknikën me të mbaruar punë e vendosnim jashtë shtëpisë. Rexhepi ishte paralajmëruar dhe qëndrimi i mëtejshëm në qytet ishte me rrezik. Kështu, ai u largua familjarisht prej andej.

Duke u ndalur në lagjen e re dua të theksoj mbështetjen që na ka dhënë familja e shoqes sonë Bule Imami. Kjo grua gëzonte në familjen e saj të madhe autoritet absolut. Mund të them pa mëdyshje se Bulja e ktheu të gjithë familjen e saj me luftën dhe atë shtëpi në një nga bazat kryesore të përhershme të aktivitetit ilegal. Në atë shtëpi, ne kemi strehuar njerëzit më të rëndësishëm të luftës që vinin nga qarku e qendra. Në këtë shtëpi janë mbajtur mbledhje të Komitetit të Partisë, të bërthamave të rinisë, të Këshillit Nacionalçlirimtar të qytetit, etj. Bule Imami nuk e kishte shtëpinë bazë vetëm për të tjerët, pasi atje ajo mblidhte dhe drejtonte aktivin e gruas antifashiste edhe në netët kur shtoheshin raprezaljet në qytet e vështirësohej lëvizja. Në ditët e terrorit nazist, të arrestimeve e internimeve masive, kur Komitetit i Partisë ishte i detyruar të largohej nga Vlora, një pjesë të mirë të punës e mori me vete Bulja bashkë me Vitori Gjikonin dhe vajza e gra të tjera dhe e kryen me sukses edhe në këto kushte detyrën e tyre, duke e mbajtur gjallë frymën e luftës nëpërmjet shpërndarjes së materialeve propagandistike. Mbaj mend se në ato ditë terrori na u vranë në qytet shokët tanë, Jonuz Rexhepi nga Peja dhe Elham Doçi, ndërsa Bulja me shoqe organizuan varrimin e tyre me pjesëmarrjen e gjerë të grave.

Dua të përmend edhe një tjetër nga fisi i Imamve, shoku dhe mik i të gjithëve Qazim Imami, që, megjithëse ishte hoxhë me çallmë, ishte një luftëtar i flaktë dhe shtëpinë e kishte vënë në shërbimin tonë, ashtu si edhe vëllezërit e tij. Atje kemi çuar shumë njerëz të rëndësishëm të luftës, pasi shtëpia e hoxhës ishte më e sigurt dhe të gjithë njerëzit përreth ishin pjesëmarrës në luftë ose e simpatizonin atë. Në rast nevoje, ata hapnin dyert e shtëpive për të na pritur dhe kështu nëpërmjet deriçkave kalonim nga një shtëpi në tjetrën. Aty i kemi bërë edhe disa mbledhje dhe kur të tjerët largoheshin, unë qëndroja. Më ka ndodhur të fle në mes të hoxhës dhe priftit, të Qazimit dhe të të atit të Amali Pjerros (Dishnicës) dhe të dëgjoja me ëndje bisedat e tyre. Prifti kishte muhabet të lezetshëm, pasi ishte i njohuri i Fan Nolit dhe bashkë me të kishte luftuar për Kishën Autoqefale Shqiptare. Ai shërbente si prift në Manastirin e Zvërnecit. Qazim Imami e pagoi me jetën e tij pjesëmarrjen në luftë. Ai së bashku me disa hoxhallarë e një prift u arrestuan dhe u internuan në kampet shfarrosëse naziste, nga ku nuk u kthyen më. Dihet që pjesëmarrja e klerikëve në luftën antifashiste tregon se sa të drejta ishin vendimet e Konferencës së Pezës, e sidomos “bashkimi i popullit në luftë pa dallim feje, krahine e ideje”...

### **Pas 28 Nëntorit 1941**

Përfaqësuesit e grupeve kryesore komuniste u mblodhën në datën 4 dhjetor të vitit 1941, në shtëpinë e Demirajve dhe zgjodhën Komitetin Qarkor të Partisë Komuniste për Vlorën të përbërë nga shtatë anëtarë:

Hysni Kapo – sekretar politik

Sinan Gjoni – sekretar organizativ

Namik Xhafa – për çështjet ushtarake

Manush Myftiu – për propagandën e partisë

Ymer Veshi – për rininë

Shemsi Totozani – për intelektualët

Mynyr Xhindi – për financën

Me krijimin e komitetit dhe të organizatave të partisë, lëvizja mori zhvillim të mëtejshëm të organizuar dhe të drejtuar mirë. Erdhi duke u shtuar aktiviteti luftarak brenda në qytet dhe në të gjithë qarkun.

Pas pak kohësh, përgjegjësat politikë dhe ushtarakë u ndryshuan. Me largimin e “Duhanxhiut”, lidhja e Parllakut, “Krajlit”, kaloi direkt te “Besniku”, Hysni Kapo, por edhe ky bëri vetëm një mbledhje se pas një përpjekjeje për ta arrestuar, u largua nga Vlora. Drejtimi i grupit kaloi te “Zequa”, Vehbi Hoxha, i cili drejtoi për afro një vit dhe në janar 1943, ai u largua nga Vlora.

Pa kaluar as tre muaj nga organizimi, Parllaku pranohet në grupin aktiv, njësitin guerril, ku në kryerjen e aksioneve duhet t’u përmbaheshin rregullave të caktuara mirë e qartë. Ato duhet të bëheshin të studiuara dhe të aprovuara nga qendra. Asnjë aksion i rëndësishëm apo atentat nuk mund të bëhej pa autorizimin e Komitetit të P.K. të Qarkut. Çdo aksion duhet të mendohej mirë dhe të kryhej me sukses. Duhej llogaritur reagimi i popullit dhe efekti politik që duhej arritur. Aksioni mund të kryhej pa leje vetëm për vetëmbrojtje ose kur të dilte përpara ndonjë spiun apo agjent i njohur, që kërkohet për asgjësim.

Aksionet guerrilase drejtoheshin vetëm kundër pushtuesve dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Ato preknin policinë politike, karabinierinë, milicinë fashiste, pra veprohej vetëm ndaj personave që shërbenin në organet represive të pushtuesit dhe mes tyre përzgjidheshin më aktivët në ndjekjen dhe zbulimin e aktivistëve si dhe bazave të lëvizjes. Kundër ushtarëve të thjeshtë nuk ndërmerreshin asnjëherë aksione të veçanta, vetëm kur përplaseshin në luftë me ta. Bëhej kujdes që aksionet të mos kishin karakter terrorist dhe të mos dëmtonin persona anësorë. Asnjëherë dhe në asnjë rast, guerrilasit nuk hidhnin materiale plasëse kur kishte grumbullime njerëzish, edhe sikur në mes të tyre të gjendej krimineli më i kërkuar.

## Organizimi i njësiteve guerrile

Në grup njësitin guerril duhej të zbatoheshin rregulla shumë të përpikta si:

Të ishin rigorozë në kryerjen e detyrës që u ngarkohej, pa marrë parasysh sakrificat që do të kërkoheshin në zbatimin e saj.

Të mos flisnin me askënd për lidhjet, për shokët, për bazat dhe nëse binin në dorë të armikut, ta ruanin sekretin deri në vetëflijim.

Në kryerjen e detyrave të para ishin në provë, ndonëse detyrat e ngarkuara ishin fillimisht të lehta si: shpërndarje e materialeve propagandistike, rrëmbim armësh, materiale e mjete për shtypin, medikamente, etj., dhe në çdo rast ishin të shoqëruar e mbikqyrur nga shokë më me eksperiencë.

Rregullat ishin të forta dhe zbatimi i tyre kërkonte përgjegjësi e sakrificë, prandaj para se të pranoheshe në grup njësitin gjuerril qartësoheshe për gjithçka, pyeteshe për pjesëmarrjen dhe a ishte i aftë të përballoje vështirësitë, si edhe të jepej kohë për t'u menduar.

Sigurisht, kjo kërkesë nuk shtrohej për anëtarët e Partisë, pasi ata e kishin kaluar provën. Pranimi i këtyre kushteve fillimisht ishte vullnetar, por më pas ato bëheshin detyra që duhet t'i zbatoje me përpikmëri e përgjegjësi.

"Krajli" punonte në lokal e ndoshta askush s'dyshonte se merrej me veprimtari guerrilase. Kryente detyrat që i ngarkonin si dërgim armësh, materialesh, komunikatash nga një bazë në tjetrën, etj.

Lokalit ku punonte "Parllaku", iu bë kontroll tri herë rresht. Pas kësaj, u detyruan ta mbyllnin dhe "Krajli" ndonëse kërkohesh nga organet represive fashiste, vepronte si ilegal ditën



për diell nëpër qytet pa iu shmangur takimit ballë për ballë me detektivët. Ky ishte guximi që ai e fitoi me punë e veprim.

### **Ngritja e dy njësiteve guerrile**

Në gjashtëmuorin e parë të vitit 1942, në qytet u ngritën dy njësite, i pari me përgjegjës "Patriotin", Arif Hasko, dhe pjesëmarrës "Golikun", "Pilafin", Vehbi Hoxhën, Koço Kllapin e Rrahman Parllakun dhe njësi i rinisë me përgjegjës Hito Çakon dhe pjesëmarrës Babaçe Faikun, Ismet Çakërrin, Fadil Dautin, Hidai Bejon, Shaqo Arapin e Kristaq Çalin.

Drejtimin e njësiteve guerrile e bënte një anëtar i Komitetit Qarkor të Partisë së Qarkut, i cili ishte edhe përgjegjës ushtarak në Komitet. Më vonë, me shtimin e reparteve ushtarake në të gjithë qarkun e me krijimin e Komitetit të Partisë për qytetin e Vlorës, këtë detyrë e kryente përgjegjësi ushtarak në këtë komitet.

Rrahmani gradualisht hyri thellë në vorbullën e luftës, u ndërgjegjësua e u bind plotësisht se ia vlente të sakrifikoje gjithçka. U bë pjesëtar e luftëtar aktiv në çdo aksion, pa e kursyer jetën për Atdheun e lirinë e popullit.

Propaganda e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Qarkun e Vlorës ishte shumë aktive dhe e njoftonte publikun e gjerë me anë të komunikatave, informacionit gojor, që ishte në gjendje ta bënte çdo pjesëtar i lëvizjes. Shfrytëzohej çdo datë e eveniment historik për të organizuar manifestime e protesta kundër padrejtësive, raprezaljeve, e krimeve që bëheshin ndaj popullit. Vihej në dukje gjendja e rëndë ekonomike dhe varfëria e popullit dhe për këtë shkaktarë ishin pushtuesit fashistë dhe qeveritarët kuislingë. Kjo propagandë bëri që Lëvizja Nacionalçlirimtare, duke prekur hallet më të mëdha të vendit, të gjente gjithnjë e më tepër mbështetje në masat e popullit.

## **Demonstrata e bukës**

Vështirësia e krijuar për popullin e qarkut në furnizimin me drithëra buke, e cila vinte nga spekulimet e vjedhjet që bënin njerëzit e organeve shtetërore në bashkëpunim me tregtarë spekulantë, u shfrytëzua për t'u dhënë mbështetje kërkesave të popullit për bukë, ditën e pazarit, më 9 mars 1942, kur në Vlorë kishin ardhur shumë fshatarë, nga të gjitha krahinat dhe bashkë me qytetarët u organizua një demonstratë masive, që u quajt demonstrata e bukës, e drejtuar nga Komiteti Qarkor i Partisë me në krye sekretarin politik, "Besnikun". Qeveritarët, nën presionin e demonstruesve të shumtë, u detyruan të hapnin depot. Fshatarëve, sipas frymëve për çdo familje, iu shpërnda drith. Kjo pati jehonë të madhe në të gjithë qarkun. Populli pa si e mbronin njerëzit e luftës dhe si luftonin për të drejtat e tij.

## **Ardhja e Qemal Stafës në Vlorë**

Një ngjarje e rëndësishme në zgjerimin e luftës ishte edhe krijimi i Organizatës së Rinisë Komuniste të Qarkut. Për organizimin e saj kishte ardhur në Vlorë Qemal Stafa, një nga udhëheqësit më të shquar të luftës.

Qemali, që kishte tronditur regjimin e Zogut me qëndrimin e mbajtur në gjyqin e 1939-ës ndaj të rinjve që gjykoheshin për idetë e tyre komuniste, përparimtare për kohën, ishte njëri nga të rinjtë e burgosur, të cilët në prag të 7 prillit i kërkonin Zogut që të liroheshin e të armatoseshin për të luftuar kundër pushtimit fashist nën komandën e tij, ndonëse ai i kishte dënuar.

Sipas deklarimit të Sadik Bektshit, ish-i burgosur në atë grup, për Qemalin dhe shokët e tij pavarësia e Atdheut ishte mbi gjithçka dhe kapërcente çdo ideologji. Ai ishte nga të parët që u përfshi në luftë dhe aftësitë e tij e nxorën në krye të saj. Ardhja e Qemalit në Vlorë, takimi me një grup të zgjeruar të rinjsh, fjala dhe këshillat e tij u komentuan gjatë nga të rinjtë.

Në takim u zgjodh Komiteti i Rinisë Komuniste për Vlorën dhe sekretar i këtij komiteti u zgjodh "Ylli", Imer Veshi, njëri nga të rinjtë më aktivë që në orët e para të luftës. Të rinjtë, që ishin forca kryesore e luftës, tani kishin krijuar organizatën e tyre.

### **Aksioni i prerjes së linjave telefonike**

Lufta po zgjerohej dhe po forcohej edhe organizativisht, po kalohej nga aksione lokale në shkallë qyteti, krahine e qarku, në aksione në shkallë kombëtare si ai i 24 korrikut 1942, ku u prenë linjat telefonike e kabllore të ndërlidhjes brenda një dite në të gjithë vendin dhe u paralizua aparati shtetëror, duke e shkëputur nga njësitë administrative të vendit. U shkëput Komanda e Përgjithshme, jo vetëm me njësitë ushtarake në Shqipëri, por dhe me ato të dislokuara në Greqi.

Për Vlorën, ky aksion pati rëndësi të veçantë, pasi në Vlorë përveç komandës ushtarake të garnizonit, kishte komandën legjioni i karabinierisë për katër qarqet e jugut. Gjithashtu, në Vlorë ishin komanda e marinës, baza e furnizimit dhe institucione të tjera që lidheshin edhe me forcat italiane në Greqi e me komandat përtej Adriatikut.

Aksioni i 24 korrikut krijoi pësjtjellim e panik në organet më të larta të pushtesve dhe në Komandën e Përgjithshme të Ushtrisë Italiane në Shqipëri.

Për këtë ngjarje, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë njoftonte Kryesinë e Këshillit të Ministrave se në Qarkun e Vlorës "... janë këputur linjat telefonike dhe linjat e marinës e të ushtrisë me nisjen nga Vlora për në Durrës, Fier, Himarë, Brataj, Sevaster, etj."

### **Vrasja e të riut guerrilas Teli Ndini**

Teli, 21-vjeçar, qe përfshirë në luftë që në bangat e shkollës. Ai ishte energjik, i shkathët si sportist dhe entuziast në kryerjen e çdo aksioni, sado i vështirë të ishte.

Në mbrëmjen e 6 gushtit të vitit 1942 do të shpërndareshin komunikata informative në qytetin e Vlorës. Të riut Teli Ndini i ishte caktuar detyra t'i shpërndante ato në lagjen "Muradie", në rrugën kryesore dhe në rrugicat anësore të asaj lagjeje.

Gjatë kryerjes së aksionit, ai u përball me një patrullë të karabinierisë fashiste dhe në përpjekje për t'iu shmangur kërkesës së tyre për të ndaluar, mbi të u hap zjarr. Mundi t'i largohej patrullës, por u përball me një patrullë tjetër që e goditi pa paralajmërim.

Teli, megjithëse i goditur nga plumbat e armiqve, mundi të hedhë një granatë, po pa fuqi ta shpërthente mbi armiqtë. Kështu ra në krye të detyrës trimi Teli Ndini, duke u bërë shembull frymëzimi për të gjithë guerrillasit vlonjatë.

Po atë natë, nga grup njësi, "Krajlit" i ishte ngarkuar detyra t'i shpërndante komunikatat në rrugën e Lagjes së Re, nga çesma te shtëpitë e Gurabardhit deri në Llonxhë (sot Lagja "Partizani"), ku do të takohej me Koço Kllapin, shok i grupit që kishte detyrë të shpërndante komunikatat gjatë rrugës së Spitalit.

Të nesërmen e asaj dite u mësua vrasja e Teli Ndinit. Shokët e tij guerrillas u betuan për hakmarrje, u shtua urrejtja për armikun dhe u rrit vendosmëria për ta vazhduar luftën me më shumë ashpërsi. Shpërthimi i aksioneve të fuqishme e dëshmoi këtë.

Pas dy ditësh u sulmua nga Patrioti, Zeqo, Babaçe Faiku e Çobani fushimi i milicisë fashiste në Qafën e Koçut.

Fashistët të shpartalluar e të lebetitur braktisën fushimin. Kjo i entuziazmoi qytetarët që i panë milicët të hynin në qytet të trembur dhe gjysmë të zhveshur.

### **Katër Heronjtë e "Topanasë"**

Më 16 tetor, të spiunuar nga agjentë të fashizmit, në lagjen "Topana", u rrethuan e u vranë 4 të rinj; Hajredin Bylyshi, Mumin Selami, Bajram Tushi dhe Hiqmet Buzi, që njihen nga

publiku i gjerë si 4 heronjtë e “Topanasë”. Ata, të rrethuar, iu përgjigjën thirrjes së fashistëve për t’u dorëzuar me flakën e armëve, ndonëse e dinin që në shtëpinë e tyre prej gardhi e balte qëndresa do të ishte e pamundur. Ata përsëritën epopenë e heronjve të lagjes “Fire” të Shkodrës, të Perlatit, Jordanit e Kadisë, atë të “Kodrës së Kuqe” në Tiranë, ku Vojo Kushi së bashku me shokët e tij Sadik Stavalecin e Xhorxhi Martinin u përleshën me tankun armik.

Shumë të rinj vlonjatë, pas qëndresës heroike të shokëve të tyre, morën pjesë në mënyrë masive në organizatat e rinisë komuniste dhe në njësitet guerrile. Ata u betuan se do të hakmerreshin ndaj fashistëve e veglave të tyre dhe hakmarrja nuk vonoi.

Muaji tetor për organizatat e partisë, të rinisë e njësitet guerrile që muaji i aksionit për njohjen e propagandimin e dokumentave të ngjarjes më të rëndësishme të luftës, Konferencës Antifashiste Nacionalçlirimtare, të mbledhur në 16 Shtator 1942, në Pezë të Tiranës.

## **28 Nëntor 1942, aksioni për lirimin e 43 të burgosurve nga burgu fashist**

Në Vlorën e qytetit të Flamurit po bëheshin përgatitje për përkujtimin, nën hundën e pushtuesve fashistë, e 30-vjetorit të pavarësisë, me demonstrata e protesta kundër persekutimeve, arrestimeve, burgosjeve dhe internimeve politike, papunësisë, varfërisë dhe shtypjes së egër nacionale. Armiku, nga ana tjetër, me kundërmasa përgatitej të pengonte çdo protestë e demonstratë. Ai kishte grumbulluar forca të shumta për të kontrolluar e për të penguar hyrjet në qytet, për ta izoluar qytetin nga fshati. Për të ruajtur institucionet, fashistët kontrollonin të gjitha lëvizjet dhe grumbullimet e njerëzve në rrugët dhe sheshet kryesore.

Në prag të festës u mblodhën organizatat e partisë, të rinisë, grupet edukative, njësitet guerrile të qytetit dhe të fshatit dhe morën porosi të shkonin shtëpi më shtëpi për të lajmëruar

njerëzit mbi pjesëmarrjen masive në protesta e demonstrata të qytetarëve e të fshatarëve përreth, të drejtonin njerëzit, duke qëndruar në krye të tyre, për të lëvizur jo rrugëve kryesore, ku mund të pengoheshin nga armiku, po rrugicave për të dalë te Sheshi i "Flamurit".

Në orën 09.00, në hyrje të Sheshit të "Flamurit", vërshuan nga të gjitha anët, sikur të mbinin nga dheu, qindra qytetarë e fshatarë. Para ish-Bashkisë së Vlorës, komunistë e guerrilas, të mbërthyer krah për krah, udhëhoqën turmën dhe si ortek shpërthyen gardhin e forcave armike duke vërshuar në Sheshin e "Flamurit" me thirrjet "Poshtë fashizmi, poshtë tradhëtarët!".

Me këngë revolucionare e patriotike, ata ndaluan para varrit të Ismail Qemalit, vendosën lule, vazhduan më tutje te varri i Avni Rustemit dhe pastaj të papërmbajtur u drejtuan për te burgu me thirrjet "Na lironi shokët tanë!".

Tentativat e forcave të shumta të policisë, karabinierisë e milicisë fashiste për të ndaluar demonstruesit, para hotel "Ballkanit", ku ishte edhe komanda e grupit të karabinierisë, nuk ia arritën t'i ndalonin demonstruesit, të cilët pa përfillur paralajmërimet e Komandantit të Legjionit të Karabinierisë se do të hapej zjarr, nga sheshi i xhamisë dhe nga lagja "Karabash", çanë kordonët e forcave fashiste dhe u bashkuan para ish-Luogotenencës (sot Bashkia Vlorë) dhe burgut. Në tarracat e dritaret e Bashkisë si dhe të grupit të karabinierisë ishin vendosur mitralozë gati për zjarr, por demonstruesit nuk pyesnin për rrezikun që i kërcënonte. Të burgosurit nga ana e tyre thyen xhamat dhe përshëndesnin ata, dhe duke mbledhur kashtën e dyshekëve kërcënonin se do t'i vinin zjarrin burgut.

Gjendja u acarua së tepërmi. Autoritetet fashiste, prefekti, Komandanti i Legjionit të Karabinierisë, kuestori e prokurori, kur e panë vendosmërinë e protestuesve, se nuk do të ndaleshin edhe para zjarrit të mitralozëve, shkuan e u morën vesh me organet e larta të shtetit fashist dhe ishin autorizuar prej tyre t'i lironin të burgosurit politik. "Na kërkuan listën e atyre që kërkonim të liroheshin, me kusht që të ishin të burgosur

politikë. Iu kërkua të lironin 43 vetë, pa ua dorëzuar listën e emrave nga frika e ndonjë raprezaljeje ndaj tyre. Listën e lexoi një nga shokët te dera e burgut dhe ata u liruan njëri pas tjetrit”, - tregon Rrahmani.

Me lirimën e të dënuarve, entuziazmi ishte i papërmbajtur. Brohoritje, thirrje, përfaqime që mezi e përmbanin turmën, e cila dyndej te dera e burgut për të parë me sytë e saj djemtë që liroheshin. Pas lirimimit të 43 shokëve, manifestuesit u lëshuan drejt Sheshit të “Flamurit” me këngë e valle për të festuar fitoren mbi fashizmin.

Me të mbërritur te sheshi, u lajmërua se tre nga shokët nuk ishin liruar. I kthyen demonstruesit te dyert e burgut për të kërkuar lirimën e tyre. Autoritetet këmbëngulnin se kishin liruar aq të burgosur sa iu ishin kërkuar. Keqkuptimi ishte në faktin se nuk i njihnin të gjithë dhe në vend të tre shokëve, gjatë apelit ishin përgjigjur dhe liruar tre të burgosur të tjerë. Nga fashistët kërkohet t’i kthenim ata për të liruar të tjerët.

T’i gjeje ata në mes të mijëra manifestuesve ishte e pamundur, prandaj fashistët u detyruan t’i lirojnë edhe tre shokët e tjerë.

Pra, ditën e 28 Nëntorit, 30-vjetorit të Pavarësisë, Vlorën e morën në zotërim bijtë e saj. Forcat e karabinierisë, policisë e të milicisë fashiste u tërhoqën pranë qendrave të tyre. Këngët e vallet vazhduan deri afër mesnate. Në çdo familje atë natë pati festë.

Kështu, në këtë përvjetor, populli i Vlorës njohu, pa dhe preku një arritje të madhe të Luftës Nacionalçlirimtare, pa forcën e pathyeshme të luftëtarëve të lirisë dhe kjo e rriti fuqishëm mbështetjen e tij për luftën.

Demonstrata e 28 Nëntorit në Vlorë pati jehonë të madhe në të gjithë vendin. Ajo tronditi rëndë pushtetin e pushtuesve fashistë dhe kuislingëve.

Ministri i Brendshëm i qeverisë njoftonte në ditët e dhjetorit se “... nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, Vlora mban rekordin e trubullirave”.

# III

Parllaku,  
drejtues i talentuar i LANÇ





*Rrahman Parllaku dhe Reiz Malile gjatë viteve të luftës*

## Largimi nga Vlora

Parllaku ose “Krajli” u largua nga Vlora pasi u emërua si Komisar Batalioni në Brigadën e V S. Pasi përballoi luftimet e ashpra të Operacionit të egër nazist të Dimrit 1943-1944, në mars të vitit 1944 u emërua zv/Komisar i grupit të Vlorës dhe pas dy muajsh mori detyrën e zv/Komisarit të Brigadës së VIII S, që po formohej në Zagori të Gjirokastrës.

Po ndahej nga Qarku i Vlorës dhe krahina e Kurveleshit, të cilat e kalitën luftarakisht dhe ndjente dhimbje që po iu thoshte lamtumirë atyre trojeve, që i lagu gjaku i plagës së tij të parë.

### Zv.Komisar në Brigadën e VIII Sulmuese

Brenda 25 prillit, në krye të një batalioni prej 150 vetësh nga grupi i Vlorës, Parllaku duhet të ndodhej në shtabin e Zonës së Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë.

Për të kompletuar batalionin, së bashku me komandantin e grupit, Refat Bajramin dhe me komisarin Delo Balili zgjodhën fillimisht kuadrin komandues të tij dhe më pas në komandën e batalionit caktuan vetëm komisarin Hasan Kushtën, “Dëshmor i Atdheu”. Hasani ishte nga Dukati i Vlorës, djali i mësuesit patriot Ibrahim Kushta.

Në të gdhirë të 20 prillit u nda me shokët e komandës së grupit dhe me efektivin e batalionit, pasi nisën rrugëtimin nëpër fshatrat Gumenicë, Bashaj e Vërmik, deri sa në mbrëmje vonë mbërritën në Progonat.

Atë natë bujti në familjen e Hito Çakos, te Dadja që e priste gjithmonë si një nënë e dhimbsur.

Të nesërmen në mbrëmje, pasi përshkuan fshatrat Picar, Shtepëz, Hundëkuq e Labovë, arritën në malin e Çajupit. Fusha e Çajupit, ndonëse rrëzës kishte ende plloçka bore, po mbushej nga lulet që ua shpuan hundët me aromën dehëse pranverore.

Në mëngjes zbritën në fshatin Tapovë dhe afër drekës arritën në Sheper, ku ishte vendosur komanda e Zonës së I-rë.

Menjëherë u drejtua për në zyrat e shtabit të zonës, ku takoi Hysni Kapon që e njihnte mirë që kur punonin në Vlorë. Ai e përqafoi, e uroi për detyrën e re dhe e paraqiti te komandanti i zonës, Islam Radovicka, duke e vlerësuar së tepërmi. Gjithashtu, Hysniu e porositi Islamin që ta pajisnin me rroba të reja, në mënyrë që të mos dilte para brigadës me rroba të copëtua.

Komandanti i zonës e njohu me masat e marra për krijimin e brigadës dhe i bëri me dije se si komisar i saj ishte caktuar Qazim Kondi, i cili ato ditë po merrej me organizimin e prurjeve të reja në kompletim të brigadës dhe që do ta orientonte më hollësisht mbi situatën e forcave.

Komandant brigade pritej të vinte Asaf Dragoti, i cili do të zëvendësonte Dervish Hekalin që ishte caktuar më parë në këtë detyrë, por që fatkeqësisht ishte vrarë ato ditë. Rrahmani me Dervishin ishin njohur mjaft mirë si Zv/Komisar të Brigadës së V-të.

Si Zv/Komandant i Batalionit do të vinte Koço Gjeçi, i njohur i hershëm i Rrahmanit, që prej vitit 1936, kur ai kishte lokalit në Selenicë të Vlorës, në pronën e familjes së tij. Së bashku kishin zbritur në Vlorë, në 7 prill të 1939-ës, në kërkim të armëve për të luftuar pushtimin fashist të vendit dhe po bashkë u përfshinë fuqishëm në Luftën Nacionalçlirimtare për çlirimin e vendit.

Me porosi të Islamit, me rastin e ditës së përrurimit të Brigadës, intendentit i shtabit e pajisi me rroba të reja dhe i bëri

me dije se për të banuar e kishin caktuar në familjen e Mitre Ngjelës, babait të Kiço Ngjelës.

Familja Ngjela e priti me përzemërsi dhe për sa kohë qëndroi në Sheper, nuk e ndërroi atë bazë të luftës. Aty mësoi se djali i tyre, Kiço Ngjela, në atë kohë ishte Zv/Komisar i Brigadës së II-të. Më vonë, Kiçoja u bë shoku i tij i ngushtë. Me Kiçon, gjatë vuajtjes së dënimit nga diktatura, do të ndante të njëjtën qeli burgu për 15 vjet rresht dhe po së bashku do ta mbyllnin burgun politik të Shqipërisë në 17 Mars të vitit 1991.

Atë pasdite u takua me komisararin e brigadës dhe së bashku zbritën në sheshin ku ishte vendosur batalioni. U bë prezantimi i komisarit para efektivit dhe me kuadrot e batalionit, pastaj vazhduan rrugën për në fshatrat Nderan e Nivan, ku ishin vendosur forcat e tjera të brigadës.

Qazim Kondi e njohu me kuadrot e batalioneve që vinin nga Qarku i Gjirokastrës, të cilëve u la detyrë që të nesërmen, në 23 prill, në orën 10.00, të gjendeshin në fushën e lisave të fshatit Sheper, ku do të mblidheshin të gjitha forcat e brigadës për të bërë rreshtimin e të gjithë efektivit dhe për të marrë udhëzimet mbi parakalimin e ditës të përrurimit. Me këto detyra, si ish-oficer karriere do të merrej Qazimi, kurse Rrahmani do të merrej me komisarët e zv/komisarët e batalioneve, për t'i informuar mbi gjendjen e organizatave të partisë dhe problemet që ato kishin.

Dita e përrurimit të brigadës, 25 prilli, u kthye në ditë feste jo vetëm për partizanët e për krahinën e Zagorisë, por edhe për të ardhurit e shumë nga Gjirokastra e Përmeti, pasi shumica e partizanëve të brigadës ishin nga këto dy rrethe.

Festën e përshëndetën Komisari i Brigadës, Qazim Kondi, i deleguari i Shtabit të Përgjithshëm, Koçi Xoxe dhe gjenerali Hudson, përfaqësuesi i misioneve angleze pranë ushtrisë Nacionalçlirimtare. Jehuan deri natën vonë këngët labe. Vendi tundej nga vallet, por nuk rreshte as gërneta e violina e këngëve përmetare.

Në Brigadën e VIII pati rreth 20 ditë të qeta, pa veprime luftarake, që Rrahmani i shfrytëzoi për të kaluar nga njëri batalion tek tjetri dhe për t' u njohur nga afër me kuadrot dhe efektivin, kryesisht pa nga afër gjendjen e tyre dhe përcaktoi detyrat.

### **Zv.Komisar dhe Komisar në Brigadën e XII Sulmuese**

Nga mesi i majit, Rrahmani u thirr në Përmet ku e priti Liri Gega dhe Ramadan Çitaku, që në atë kohë ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Ata e urdhëruan të nisej menjëherë për në Teqenë e Sukës, në Dëshnicë, ku do të priste partizanët që do të vinin nga Vlora, nga Mallakastra e nga Kurveleshi për të krijuar, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm, Brigadën e XII.

Ishte i ngarkuar me krijimin dhe organizimin e kësaj brigade dhe do t' i duhej të nisej menjëherë, pasi brigada duhet të përurohej dy ditë para hapjes së punimeve të Kongresit. Fati e ndihmoi që ta mbaronte në kohë këtë detyrë, pasi pjesa më e madhe e kuadrove të brigadës e të batalioneve ishin të njohurit e tij.

Komandanti i Brigadës, Refat Bajrami, komisari Qemal Klosi dhe Zv.Komandanti i Brigadës, Lufter Bakua, vinin nga Qarku i Vlorës. Bashkëpunimi i Parllakut me ta dhe me kuadrot e tjerë të batalioneve bënë që brigada të ishte gati për 22 majin, ditën e përrimit. Po atë ditë u përball me të papriturën se, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, emërohej komisar i asaj brigade.

Kështu, atë pasdite zgjodhën delegatët e Kongresit dhe u nisën për në Përmet.

## Në Përmet në prag të Kongresit

Në Përmet ishin mbledhur delegatë nga të gjitha repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare në shkallë vendi. Dihet se nga krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe sidomos ato të Veriut kishte më pak delegatë, pasi atyre u duhej të udhëtonin në zona të paçliruara, jashtë rrugëve kryesore të cilat ishin të kontrolluara nga armiku, kur udhëtimi bëhej vetëm në këmbë.

Por, pavarësisht vështirësive e pengesave të shumta, delegatët pjesëmarrës ishin nga të gjitha qarqet e vendit. Qyteti i Përmetit gumëzhinte nga gjallëria. Zëra të hareshëm dëgjoje ngado. Shikoje delegatët që shëtisnin grupe-grupe, takoheshin me njëri-tjetrin, shkëmbenin mendime, tregonin për betejat me armikun, për dëshmorët e rënë në luftë, për jetën në ilegalitet në ato qytete e krahina që mbaheshin ende nga okupatori, etj. Në grupe shpaloseshin këngë e valle të krahinave të ndryshme, por sigurisht mbizotëronte pasuria folklorike e jugut të Shqipërisë, pasi andej vinte dhe pjesa më e madhe e delegatëve.

Në ato momente të gjithë përjetonin një mrekulli gëzimi e hareje, që ua sillte fryma e lirisë që po afronte. Nuk kish si ndodhte ndryshe. Ishin pothuajse të gjithë të moshës nga 16 deri 25 vjeç dhe optimizmin e kishin në gjak.

Në prag të Kongresit, Përmeti ishte gjithë gjallëri. Përmetarët si mikpritës të mirë e kishin pastruar qytetin e tyre nga mbeturinat e gjermadhave të djegura e të shkatërruara nga pushtuesi dhe jo vetëm në rrugët e sheshet kryesore, por edhe në rrugicat anësore. Kishin zbardhur me gëlqere muret e suvatë

e shtëpive, duke bërë gati gjithçka për të pritur mysafirë nga e gjithë Shqipëria. Mikpritja e veçantë e çdo familjeje të qytetit dëshmoi edhe një herë për fisnikërinë e popullit të Përmetit.

Një moment të rëndësishëm shënoi mbërritja në Përmet e udhëheqësve kryesorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Të gjithë delegatët e Kongresit dhe populli i Përmetit, me pankarta e parrulla, i pritën ata në hyrje të urës mbi lumin Vjosë. Entuziazmi ishte i madh. Ndalesa e tyre u bë në të vetmen kafene që i kishte shpëtuar djegies së qytetit.

### **“Krajli”, hallvaxhiu nga Luma**

Pas një pushimi të shkurtër filluan takimet e Enver Hoxhës dhe të udhëheqësve të tjerë me delegatët e Konferencës. I pari u prit grupi i Qarkut të Gjirokastrës dhe pas tyre u prit grupi i Vlorës. Kur po takoheshin, Rrahmani u ndalua nga Liri Gega e Hysni Kapo, të cilët e prezantuan te Enveri: “Ky është “Krajli”, hallvaxhiu nga Luma”.

Enveri u përgjigj: “E kam lexuar karakteristikën e tij dhe gëzohem që po takohemi”. “Krajli” mbeti i suprizuar nga kjo ngjarje e veçantë.

Pasdite, Parllaku u ftua në takim nga Nako Spiru, të cilin e takonte për herë të parë, por e njihnin njëri-tjetrin nëpërmjet Ramize Gjebresë, të fejuarës së tij, e cila drejtonte rininë e Qarkut të Vlorës dhe ishte anëtare e Komitetit Qarkor të Rinisë Komuniste.

“Të bisedoje me Ramizenë ishte kënaqësi, - tregon Parllaku. - Jo vetëm mësoja nga mençuria e saj, por edhe informohesha për të rejtat që më sillte nga Tirana, pasi dihej roli i Nakos në luftë, se de facto luftën e udhëhiqte ai.

Nakoja më tha: “Mirë more Rrahman, ta zëmë se Ramizeja u dashurua me Zahon, duke qenë e fejuar me mua, po pse duhej vrrarë. Këto janë ekstremizma, që jo vetëm vrasin njerëz me vlera, por edhe na dëmtojnë luftën”.

Mua më kishte ardhur shumë keq për Ramizenë dhe nuk isha dakord me vrasjen e saj, por të them të drejtën, nën ndikimin krahinor, nuk e di në do të kisha mbajtur qëndrim kulturor të Nakos, po të kisha qenë në vend të tij", pohon Rrahmani.

### **Në Kongresin e Përmetit**

Kongresi u hap në mënyrë solemne. Fjalën e hapjes e mbajti Dr.Omer Nishani, kurse fjalën për arritjet në Luftën Nacionalçlirimtare dhe për fitoret e ushtrisë partizane në këtë luftë e referoi Enver Hoxha, Komisar i Shtabit të Përgjithshëm. Më pas, fjalën e morën disa nga udhëheqësit e luftës si: Koçi Xoxe, Nako Spiru, Ymer Dishnica, Sejfulla Malëshova e të tjerë.

Pas tyre filluan diskutimet e delegatëve. Delegatët ushtarakë u përqëndruan kryesisht te fitoret e arritura me shumë sakrifica dhe në kushte tepër të vështira lufte, por duke demonstruar krenarinë për fitoret, duke prurë përvojën e tyre dhe duke shkëmbyer mendime për të ardhmen.

Delegatët që vinin nga terreni folën për luftën në kushte e rrethana tejet të vështira të ilegalitetit, sidomos në qytete, për raprezaljet e terrorin që kishte ushtruar okupatori me burgime, vrasje e internime. Ata folën për punën e madhe që bënin organizatat e frontit në krahinat e okupuara, për rritjen e rezistencës dhe nxjerjen e vullnetarëve drejt reparteve partizane, kurse për punën në zonat e çliruara, atyre iu dilte si detyrë të organizonin në ndihmë të ushtrisë vullnetarë të rinj, që do të siguronin armatime dhe do të bënin furnizimin me ushqime e me veshmbathje. Gjithashtu, do të merreshin masa për forcimin e pushtetit të zonave të çliruara drejt një qeverisjeje sa më të mirë.

Diskutimet dhe analizat ishin tepër optimiste, të mbështetura në fitoret e arritura dhe mbi këtë bazë parashikoheshin fitoret e reja drejt çlirimit të shpejtë të vendit. Diskutimet entuziaste



të delegatëve, të cilët ishin pothuajse të gjithë të rinj, kishin bazë të fortë në realitetet e kaluara dhe në ato që po jetonin ato ditë. Të gjithë ishin ndeshur e po ndesheshin me armiq shumë herë në raporte më superiore si në njerëz, armatime e në teknikë luftarake, me ushtri të organizuar, të përgatitur mjaft mirë e të drejtuar nga oficerë akademistë.

U bë bilanci i luftimeve të zhvilluara para Kongresit të Përmetit, për operacionin e egër të ushtrisë naziste, që përfshiu të gjithë vendin tonë, nga Tropoja deri në Konispol, në mes të një dimri të acartë, me qëllim asgjësimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe shuarjen e lëvizjes antifashiste në Shqipëri, por kishte ndodhur mrekullia. Partizanët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, edhe pse me mungesa të mëdha në ushqime e veshmbathje, me armatim trofe rrëmbyer ushtrive armike, duke ndenjur ditë pa ngrënë, vetëm me çka u jepte populli, të cilëve iu ishin djegur shtëpitë e iu ishte shkatërruar ekonomia, duke ecur zbathur në borë e akull me këmbët e mbledhura me leckë, që u kullonin gjak, por me kuadro komanduese që u rritën në luftë, e përballuan me guxim Operacionin e Dimrit dhe dolën fitimtarë. Njëri prej tyre ishte edhe "Krajl".

Ushtria Nacionalçlirimtare dhe Lëvizja Antifashiste jo vetëm nuk u asgjësuan, por përkundrazi u zmadhuan e u forcuan.

Në kulmin e operacionit e në vijimësi u krijuan Brigada e VI, e VII, e VIII, e XII, etj.

Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare u zgjerua në të gjithë vendin, duke çliruar krahina e qarqe të tëra. Këtë e dëshmonte edhe qyteti i çliruar i Përmetit, ku po zhvillohej Kongresi. Në shkallë vendi, ushtria naziste gjermane ishte mbyllur brenda qyteteve të paçliruara dhe ishte vënë në mbrojtje të disa rrugëve për të siguruar lëvizjen dhe manovrimin e trupave të saj. Kishte ardhur momenti që Ushtria Nacionalçlirimtare të kalonte në mësymje të përgjithshme për çlirimin e të gjithë vendit. Dhe për këtë vendosi Kongresi.

## **Vendimet ushtarake të Kongresit të Përmetit sipas optikës së Parllakut**

Kongresi mori një sërë vendimesh, të cilat vazhdojnë të gjykojnë nga historia për pasojat e tyre. Vendimet e karakterit ushtarak, Parllaku i ka gjykuar gjithmonë të drejta dhe koha e ka vërtetuar drejtësinë e tyre. Ishte i drejtë vendimi për krijimin e strukturave ushtarake në shkallë taktiko-operative, si krijimi i divizioneve e korparmatave, të afta për të ndërmarrë luftime dhe operacione mësimëse e mbrojtëse të një lufte frontale.

Gjithashtu ishte i drejtë vendimi për dhënien e gradave dhe vendosjen e hierarkisë ushtarake në ushtrinë partizane, etj.

Këto masa çuan në thyerjen me forca të përqëndruara të operacionit të madh dhe të fundit të ushtrisë naziste në Shqipërinë e Jugut, si edhe në ofensivën e përgjithshme për çlirimin e të gjithë vendit, që u arrit pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate, siç kishte ndodhur në shumë vende të Europës.

## **Beteja e Qafës së Kiçokut**

Me të mbaruar punimet e Kongresit të Përmetit, komandën e Brigadës së VII dhe komandën e Brigadës së XII e thirrën në Shtabin e Përgjithshëm. Nga komanda e Brigadës së VII ishin Gjin Marku, Kadri Hoxha dhe Adil Çarçani, kurse nga Komanda e Brigadës së XII, Refat Bajrami, Qemal Klosi dhe Rrahman Parllaku.

Shefi i shtabit, Spiro Moisiu, urdhëroi të ktheheshin sa më parë pranë njërive, pasi po fillonte një operacion i forcave naziste. Dy brigadave u vu si detyrë të zinin pozicionet mbrojtëse, Brigada e VII nga lugina e lumit Osum e deri në Qafë-Shkozë, kurse Brigada e XII në fshatin Zhërepal, në Bulës e në qafën e Kiçokut.

Detyra ishte të thyenin mësymjen e forcave naziste, që pritej të vinin nga Berati në drejtim të Qafës së Këçokut e Paraspuarit, për të dalë në luginën e Dishnicës dhe për të vazhduar mësymjen në drejtim të Këlcyrës me objektiv pushtimin e Përmetit.

Me marrjen e detyrës, të dy komandat e brigadave caktuan kohën dhe vendin e takimit, për të organizuar së bashku mënyrën e ndërlikohjes dhe të bashkëveprimeve luftarake. Takimin e caktuan në Qafë-Shkozë, në datën 2 qershor.

Me kthimin pranë efektivit të brigadës, thirrën komandat e batalioneve, i njohën me detyrën e marrë dhe u dhanë udhëzimet e duhura për përgatitjen e vënien në gatishmëri luftarake të të gjitha reparteve. Detyrat luftarake ua caktuan më konkretisht në terren, pranë pozicioneve më të përshtatshme të mbrojtjes për secilin repart, nisur edhe nga drejtimet e mundshme të mësymjes të armikut. Krahas kësaj u takuan edhe në Qafë-Shkozë me komandën e Brigadës së VII dhe përcaktuan detyrat e bashkëveprimit të dypalshëm.

Brigada që drejtohej nga Parllaku i zuri pozicionet mbrojtëse në anën jugore të lumit të Vokopolës në Qafë-Shkozë, Vokopolë, Qafa e Këçokut, duke i përqëndruar forcat kryesore në drejtimin Parapuar - Uji i Zi - Therepel - Bubës.

Në 3 qershor, në mbrëmje, forcat e brigadës u rreshtuan në sheshin para Teqes së Sukës, për të shpërndarë detyrat sipas batalioneve. Kur po i caktohej detyra batalionit të rinisë të Kurveleshit, të përbërë nga djem e vajza të moshës 13-17-vjeçare, erdhi urdhëri për të shkuar në Himarë për të shkarkuar një anije që sillte ndihma në armatime e materiale të tjera luftarake. Partizanët kundërshtuan njëzëri, duke thënë se kishin dalë partizanë për të luftuar armikun e jo për të bërë punën e hamallit. Parllaku ndërhyri për t'i bindur, pasi ishte i njohur në krahinat nga ata vinin dhe i kishte takuar kur erdhi batalioni i tyre në brigadë, por negociimi me ta ishte i pamundur. Kështu për në Himarë u nis një batalion tjetër, kurse ata i vunë në pozicion mbrojtës, por jo në drejtimin kryesor të luftimeve, pasi ishin të

gjithë të rinj. Të gjithë batalionet morën detyrat e tyre. Gjatë asaj mbrëmjeje zunë pozicionet luftarake dhe në orën 04.00 të datës 4 qershor raportuan se ishin në gatishtëri të plotë.

Po atë ditë, në datën 4 qershor, zbuluesit njoftuan se nga Tërpani, armiku po lëvizte në kolona marshimi gjatë rrugës Berat-Përmet me makina e mjete të blinduara, kurse në drejtim të Paraspuarit lëviznin këmbësorë. Nuk pati veprime luftarake në front, kështu që forcat partizane zunë pozicione pritëse në Qafën e Këçokut. Në disa pjesë të vështira të rrugës u vendosën pengesa me gurë e shkëmbinj, për të penguar mjetet motorrike dhe u vendos përqëndrimi i zjarrit me mitrolozë për të penguar pastrimin e rrugës dhe kalimin e lirë të mjeteve motorrike.

Më 5 qershor, në orën 04.30, armiku goditi me zjarr artilerie të përqëndruar në sektorin Qafë Shkozë - Vokopolë dhe në orën 05.00 kaloi në mësymje. Fatmirësisht, forcat partizane kishin zënë pozicione të favorshme dhe hapën zjarr të dendur në të gjithë frontin. Armiku ishte i detyruar të mësynte nga poshtë-lart dhe sulmi i parë u thye në të gjithë frontin. Pasi zbuloi pozicionet partizane, armiku përsëriti për 20 minuta zjarrin me artileri, duke shkaktuar të vrarët e të plagosurit e parë.

Në orën 07.30 minuta, sulmi i armikut u përsërit dhe pas një sulmi prej 3 orësh arriti të pykëzohet mbi mbrojtjen partizane në Qafë-Shkozë dhe në pika të tjera, deri në 1 km thellësi. Gjithashtu, me qëllim përsëritjen e sulmit, armiku kishte përqëndruar forca të shumta në shpatet perëndimore të Qafë-Shkozës. Vrojttonin me vëmendje përqëndrimin e trupave armike dhe me dy topat e brigadës që përdoreshin nga partizanët italianë që kishin qenë artilierë të përgatitur të ushtrisë italiane, goditën me precizion të lartë, 3 herë rresht, mbi trupat naziste duke krijuar shpërqëndrim dhe shpërndarje në radhët e tyre.

Ky moment u shfrytëzua nga forcat e Brigadës të VII -të që u hodhën në kundërsulm të fuqishëm mbi nazistët, të cilët po tërhiqeshin të çorganizuar. Duke hedhur në luftime të gjitha forcat rezervë, me luftime të ashpra që vazhduan deri në ora

18.00, i zmbrafsën forcat naziste. Çdo përpjekje e tyre për t'iu rikthyer sulmit të mëtejshëm ishte e kotë.

Në këto luftime, Brigada e XII, e drejtuar nga Parllaku, pati 7 të vrarë e 16 të plagosur, por luftimi i parë rezultoi i suksesshëm. U ndeshën me një armik të sofistikuar në forca e sidomos në armatime.

Arritën fitoren e parë të Brigadës, duke i shkaktuar armikut humbje të konsiderueshme. Në terren gjetën 5 të vrarë, por humbjet e gjermanëve ishin të mëdha. Ata, në pamundësi për të vazhduar mësymjen, u tërhoqën në qytetin e Beratit, nga ku edhe ishin nisur.

### Në Brigadën e III

Më 6 qershor, për të bërë analizën e luftimeve dhe për të hartuar një raport të përbashkët për Shtabin e Përgjithshëm, u takuan në afërsi të fshatit Therepel me komandën e Brigadës së VII. Në atë takim erdhi një partizan i ri që u prezantua me emrin Vasil Nathanaili. Ai kërkonte shokun "Krajl", pra Rrahmanin, për t'i dorëzuar Urdhërin e Komandës së Përgjithëshme që e transferonte për herë të tretë brenda 3 muajve për në Brigadën e III, me të njëjtën detyrë si Zv. Komisar Brigade. Në brigadën ku ishte, Rrahmani e ndjente veten mjaft mirë. E gjithë komanda ishte nga Vlora. Ishin jo vetëm bashkëluftëtarë të një qarku, por me Refatin dhe Luftëtarin kishin qenë edhe bashkëdrejtues të një reparti. Veç kësaj, shumica e partizanëve ishin të njohur për të. Do të shkonte në një brigadë krejtësisht të panjohur, për të cilën kishte dëgjuar që, nga humbjet e shumta gjatë operacionit nazist të dimrit, ishte shpërndarë. Për momentin, Brigada e III ishte riformuar dhe po kompletohej. Nuk kishte rrugë tjetër, urdhëri ishte urdhër dhe duhej zbatuar.

Me të mbaruar punë, u kthye në vendkomandë ku i dorëzoi Vasil Nathanailit, që do ta zëvendësonte, dokumentet e organizatave të Partisë dhe e falenderoi për informacionet që i përcolli në lidhje me brigadën ku do të shkonte.

Të nesërmen u nda përmallshëm me shokët e komandës, pa mundur të përshëndetej me efektivat, pasi ata ishin pozicionuar në pozicionet e luftimit. Mori me vete dy shoqëruesit e tij të pandarë që nga Brigada e V-të, Islamin e Merkon dhe u nisën për në Frashër, pasi, sipas urdhërit të marrë, atje duhet të takohej me komandën e brigadës.

Më 8 qershor arritën në Frashër, por aty nuk gjetën askënd nga brigada. Shokët e Frontit Nacionalçlirimtar u thanë se brigada mbrohet në perëndim të lumit Osum e në malin e Rodonit, në Kolonjë. Kështu u desh të merrnin rrugën në atë drejtim. Pasi kaluan shkëmbin e malit të Qelqit, në afërsi të Qafë- Dëllenjës u takuan me një kolonë forcash partizane, me në krye komisarin e kompanisë, Sejdin Abdinë. I pyeti se ku do të shkonin dhe pasi i thanë se donin të takoheshin me ndonjë repart partizan të Brigadës së III, u tha se edhe ata ishin të Brigadës së III dhe kishin marrë urdhër të ktheheshin në Frashër, pasi aty do të vinte komandanti i brigadës.

U bashkuan me ta dhe u kthyen në Frashër, por atë natë nuk mundën të takohen me komandën e brigadës.

Të nesërmen, Parllaku u takua me Komandantin e Brigadës, Hulusi Spahiun dhe me Zv.Komandantin e Brigadës, Myzafer Spaho, të cilët po drejtonin luftimet në malin Kakoja të Frashërit.

Përshtypja e parë ishte pozitive. Ata po drejtonin luftimet nën breshërinë e predhave të artilerisë armike, kujdeseshin t'i shpërndanin partizanët dhe t'i vendosnin në pozicione sa më të përshtatshme, që të mos dëmtoheshin nga zjarri i artilerisë armike.

“Krajli” u prezantua duke u bërë me dije se me urdhër të Komandës së Përgjithshme ishte emëruar zv.komisar i asaj brigade. Ata ishin të informuar për emërimin e tij dhe e njohën menjëherë me detyrën, që ishte të qëndronin në mbrojtje dhe të shmangnin sulmin armik gjatë natës.

Mësymja e forcave naziste ishte tepër e fuqishme dhe e pamundur t'i rezistojë. Për t'i rezistuar sulmit duhet të

shmangeshin duke hyrë te Bredhi i Hotovës, por në atë pyll ua kishte ndaluar hyrjen Komanda e Përgjithshme, pasi atje ishte spitali partizan, me shumë të plagosur, që nuk duhej të diktohej nga gjermanët. Kështu, tërheqjen e detyrueshme me luftim e bënë në drejtim të Përmetit.

U tërhoqën me luftime të pandërprera dhe në mbrëmje kaluan Vjosën e hynë në Përmet.

Të nesërmen edhe në marëveshje me Zonën e Parë Operative, bënë një tërheqje të thellë deri në Kurvelesh. Gjatë tërheqjes, Brigadës së III iu bashkuan edhe 150 partizanë të shkëputur nga repartet e tyre, që i përkisnin brigadave IV dhe II.

Pasi kaluan në Kurvelesh, Hulusiu e Myzaferi kërkuan nga "Krajli" të merrte drejtimin e këtyre forcave që iu bashkangjitën brigadës, në mënyrë që të pakësohej efektivi i brigadës dhe ata ta kishin më të lehtë manovrimin në terren.

"Krajli" e pranoi me kënaqësi propozimin e tyre, pasi e njihte mirë krahinën e Kurveleshit dhe kishte mundësi t'i komandonte në terrenin e panjohur për ta, duke i mbrojtur, për t'ua kthyer pa humbje reparteve të tyre.

U nda me Hulusiun e Myzaferin dhe me forcat e brigadës u fut në luginën e lumit të Kardhiqit, ndërsa i rreshtoi forcat duke i ndarë sipas reparteve nga vinin. Vuri t'i drejtonin komandat e reparteve të tyre dhe i vendosi në mbrojtje rrëzë kodrave mbi rrugën Gjirokastrë-Tepelenë, nga Humelica deri në rrëzë të Malit të Shtëpëzit. I porositi të mos lëviznin dhe të qëndronin të maskuar në pjesët e pyllëzuara, të vendosnin roje dhe të pushonin.

Gjendja e partizanëve ishte rënduar shumë. Ata kishin rrugëtuar nga rrethi i Korçës deri në Kurvelesh. Ishin të rraskapitur, pa kujdesin e një komande të tyre dhe u kishte munguar ushqimi minimal. Në rajonin ku gjendeshin, gjithçka ishte e djegur dhe e shkatërruar, fshatrat ishin të braktisur, popullsia jetonte pyjeve dhe i kishte me vete bagëtitë e mbetura gjallë.

Kishte me vete një shumë stërlinash që ia kish dhënë Hulusiu kur u ndanë. Me to mund të bleje nga fshatarët

qumësht, djath, mish, por nuk kishte kripë. Nuk mund të hahej gjithçka pa kripë. Ditën e parë e kaluan me nga një okare qumësht e me nga një copë djathë pa kripë që e blenë në stane, por ky ushqim nuk ua shtoi fuqitë.

Nga pozicionet e tyre vrojtoheshin forcat naziste që kishin marshuar duke u vënë zjarrin fshatrave të Zagorisë, pasi nuk kishin hasur rezistencë. Ata kishin kaluar Çajupin dhe po zbrisnin në fshatrat e Lunxhërisë.

Nisur nga situata në të cilën ndodheshin, së bashku me kuadrot e reparteve vendosën që gjatë natës të kalonin në prapavijat e gjermanëve. Rrahmani vendin e njihte mjaft mirë pasi më parë kishte kaluar në ato anë me forcat e Brigadës së VIII dhe kishte mundësi të siguronte ushqimin e nevojshëm për forcat që drejtonte, por kur po bëheshin gati të kalonin rrugën automobilistike dhe lumin Drino, rojet armike u shtuan shumë dhe një kolonë gjermane doli në Urën e Kardhiqit duke ua bërë të pamundur kalimin.

### **Luzati i djegur**

Gjatë kalimit, gjermanët kishin djegur pothuajse krejtësisht fshatin Luzat. Partizanët e lodhur e të pangrënë mezi u ngjitën në çezmat e fshatit Picar. Ishin në kushte të vështira dhe nuk kishin fuqi të lëviznin që andej. Një fshatar nga Luzati informoi se pas djegies së fshatit të tyre, fshatarët ishin shpërngulur në luginën pyjore mbi Luzat, kështu që ata vendosën të shpërngulen pranë tyre.

Në grykën e malit, me pyje dhe ujë të akullt, partizanët gjetën të gjithë banorët e fshatit me gjithçka kishin mundur të mernin nga orenditë e shtëpive dhe bagëtitë, si të vetmen pasuri të çmuar e jetike që u kishte mbetur.

Thirrën anëtarët e Këshillit të Frontit të fshatit dhe, megjithëse një ditë më parë u ishte djegur fshati, kërkuan ndihmën e tyre për bashkëpunim. Gatishmëria ishte e menjëhershme.



Pasdite kaluan në pyllin mbi Shtepëz dhe në të errur kapërcyen rrugën automobilistike Gjirokastër-Tepelenë dhe lumin Drino në afërsi të fshatit Hundëkuq, duke shmangur rojet gjermane. Mëngjesi i gjeti në Labovën e Madhe.

### Në Labovën e Madhe

I lanë partizanët të pushonin, ndërsa Parllaku thirri anëtarët e këshillit dhe u kërkoi t'i jepnin një thes me miell nga rezerva e Brigadës së VIII, pasi si ish Zv.Komisar i asaj brigade e dinte që rezervat e tyre ushqimore ruheshin atje. Pasi hëngrën drekën, ngarkuan në kalë edhe miellin e darkës dhe u nisën duke iu ngjitur me marshim malit të Çajupit. Në freskun e atij mali ngarkuar me aroma lulesh ranë në një gjumë të thellë, që u kishte munguar gjatë. Atë natë, me ndihmën edhe të stanarëve që veronin bagëtitë në atë mal, përgatitën ushqimin e zakonshëm dhe të nesërmen zbritën në luginën e Zagorisë.

Të gjitha shtëpitë e asaj zone vazhdonte t'i mbulonte për të dytën herë tymi i djegieve shkaktuar nga nazistët. Në furrën e fshatit Sheper u përgatitën një çorbë të shijshme dhe drekën e kaluan aty. Pasdite iu ngjitën qafës së Dhëmbelit dhe në darkë mbërritën në Përmet, që nuk ishte më ai i ditëve festive të Kongresit. Ishin djegur edhe ato pak shtëpi që kishin mundur t'i shpëtonin djegies së parë. Tymi i zi u përvëlonte sytë dhe nuk ngopeshin dot me frymë.

### Ndarja me partizanët e Brigadës së IV

Me partizanët e Brigadës së IV u ndanë në fshatin Kosin. Në vesh, Parllakut i qëndrojnë akoma fjalët e tyre në përqafimin e përzemërt të ndarjes: "Po erdhe në Devoll do të gostisim me byrek, se je kujdesur shumë për ne". Nga kuadrot e asaj brigade nuk harrohet Qaniu, ish-zv.komandant batalioni,

“Dëshmor i Atdheut”. I kujtohen Agron Frashëri, Nerko Minarolli, (Baholli), Mitat Goskova, etj. Të gjithë kuadro trima e të vendosur që fituan besimin e tij, se e mbështetën pa rezerva në vendimmarrjet e asaj situatë të vështirë të drejtimit në terrene krejt të panjohura për ta.

Bashkë me ta ishte edhe Rrahman Beragozhda, ish-kapiteni i xhandarmarisë, që, në ditët kur zhvillonte punimet Kongresi i Përmetit, hapi dyert e burgut të Korçës duke u arratisur.

Me t’u ndarë me partizanët e Brigadës së IV, “Krajli” u nis për në krahinë e Dishnicës. Kishte me vete edhe Komandantin e Batalionit të IV të Brigadës, Xhorxhi Zeron. Po shkonin në atë krahinë pasi kishin një batalion nga fshatrat aty afër. Një pjesë që e njihnin mirë vendin, kishin shkuar në shtëpitë e tyre, prandaj duhet të bënin grumbullimin.

Fillimisht shkuan në Fratar, në shtëpinë e patriotit Ali Kamja, babai i dëshmorit të luftës së Spanjës, Musa Fratari. Në atë fshat kishin edhe Qani Didinin, komandant kompanie në brigadën e tyre dhe Demir Talarin nga fshati Talar, gjithashtu komandant kompanie. Bashkë me ta brenda 4-5 ditëve i grumbulluan të gjithë partizanët që kishin nga kjo krahinë dhe krijuan një forcë me mbi 100 vetë.

Njëkohësisht, Parllaku nisi për në Mallakastër Xhorxhin me një skuadër partizanësh që e njihnin vendin, pasi edhe në atë krahinë kishte mjaft partizanë që kishin kaluar në prapavijë. Brenda 8 ditësh jo vetëm që grumbulluan të gjithë partizanët e asaj zone që ndodheshin në prapavijë, por krahas tyre u bashkuan edhe shumë vullnetarë të rinj.

### **Dy aksionet kundër forcave naziste në krahinë e Dishnicës**

Gjatë qëndrimit në krahinë e Dishnicës organizuan dy aksione kundër forcave naziste. Në aksionin e parë goditën një kolonë me ushtarë gjermanë, të cilëve u kishin zënë pritë

te Rrapi i Paramithit. I qëlluan në befasi, kur kolona qëndroi pranë çezmës për të pushuar. Prita ishte e maskuar, zjarri ishte i papritur për forcat naziste dhe prej tyre mbetën 10 të vrarë. Goditën si rrufe dhe u tërhoqën si shigjetë, por fatkeqësisht gjatë tërheqjes për në thellësi të pyllit u plagosën dy partizanë.

Aksionin e dytë e ndërmorën kundër një toge prej afro 25 ushtarësh gjermanë, të cilët ishin vendosur në çadra në fushën e Teqesë së Sukës. Qëllimi ishte të siguronin kalimin në rrugën Këlcyrë-Qafa e Kiçokut. Pasi u siguruan për vendndodhjen e trupave armike, dërguan një skuadër me partizanë vendas, të cilët të maskuar mirë, u afruan deri 200 metra larg vendndodhjes armike, bënë zbulimin e vendit dhe përcaktuan rrugë afrimet. Pas kthimit të tyre, pajisën një grup partizanësh prej 20 vetësh, me armë automatike dhe 2 mitralozë që në mbrëmje hapën zjarr të dendur kundër armikut, duke lënë shumë të vrarë e të plagosur. Të mbeturit gjallë u çoroditën nga zjarri i befasishëm dhe nuk mundën të kundërpërgjigjeshin. Siç iu treguan fshatarët e zonës, autoambulanca gjermane kishte udhëtuar 3 herë drejt Përmetit për të çuar atje të vrarët e të plagosurit e shumë.

### Në Helmës të Skraparit

Në datën 22 qershor morën urdhër nga Komanda e Përgjithshme se duhet të niseshin për në Helmës të Skraparit. Organizuan forcat e grumbulluara nën komandën e Xhorxhi Zeros dhe pa prituri Hulusiun e Myzaferin, u nisën menjëherë drejt Helmësit.

Më 26 qershor mbërritën. Forcat i vendosën në Straveckë, kurse Parllaku qëndroi pranë Komandës së Përgjithshme derisa erdhën komandanti e komisari me forcat e tjera të brigadës.

Atje, përveç Enverit, Spiro Moisiut e Bedri Spahiut, "Krajli" u njoh edhe me Dr. Omer Nishanin, Ymer Dishnicën, Sejfulla Malëshovën, Medar Shtyllën, etj.

Omeri, Ymeri e Sejfullai rrinin më shumë në një kopësht

me mollë, ku komentoni kryesisht gjendjen e luftës brenda vendit, por edhe mbi frontet e luftës në Lindje e Perëndim. Në bisedat e tyre nuk mungonin tregimet e anekdotat e kripura, ku spikaste Dr.Nishani.

Enveri, Spiroja e Bedriu ishin të zënë me drejtimin e operacioneve luftarake dhe me ta takoheshin kur uleshin në tavolinë për të ngrënë drekë e darkë ose kur dilnin për të pirë ndonjë kafe.

Me të mbërritur Hulusiu e Myzaferi me forcat e brigadës, kontrolluan gjendjen e forcave pas përfundimit të operacionit dhe bënë përqëndrimin e tyre në fshatin Straveckë.

Ato ditë, Komanda e Brigadës u prit nga Shefi i Shtabit, Spiro Moisiu, dhe zëvendësi i tij, Bedri Spahiu. Fillimisht raportoi Komandanti i Brigadës mbi gjendjen aktuale të saj, për veprimet luftarake gjatë operacionit armik, humbjet që kishin pasur, për partizanët e shkëputur, kthimin e shumicës së tyre pranë brigadës dhe rreth organizimit që po përfundonte ato ditë. Më pas, Spiroja e Bedriu bënë mjaft kritika, sidomos për tërheqjen gjatë operacionit deri në Kurvelesh, por vlerësuan ecurinë e veprimeve luftarake. Kritikat u drejtuan ndaj komandant Hulusiut, që nuk kishte nxjerë mësimet e duhura nga humbjet e brigadës në luftë, por ishte shpërqëndruar. Për "Krajlin" nuk patën vërejtje pasi kishte ardhur në brigadë në fund të operacionit, por porosinë që Parllaku dhe Myzaferi të përcillnin në këtë brigadë eksperiencën e punës së tyre dhe frymën e aksionit që i karakterizonte. Pra, duhet të forconin punën për edukimin e efektivit me frymën e aksionit, të disiplinës dhe të rrisnin gatishmërinë për përballimin e situatave të vështira luftarake. I prisnin detyra të reja e tepër të rëndësishme dhe duhet të ishin në lartësinë e duhur.

Po atë ditë i priti edhe Enveri, që nuk hyri në analizën e gjendjes së brigadës, por i këshilloi të mbanin në vëmendje porosinë e Spiros e të Bedriut dhe të ngrinin në shkallë sa më të lartë fuqinë luftarake të efektivit. Gjatë bisedës u komunikoi detyrën e kalimit të brigadës në Shqipërinë e Mesme për

veprime luftarake në rajonet e Tiranës dhe të Elbasanit, në mbështetje të Divizionit të I-rë, që po zhvillonte luftime për çlirimin e rajoneve verilindore të vendit. Në fund u bëri me dije se po i dërgonin në ato zona, pasi Brigada e III që ishte krijuar në rajonin e Tiranës, një pjesë të kuadrove komandues të saj e kishte nga Tirana dhe se atje me siguri do të gjenin edhe mbështetje për ta shtuar efektivin e brigadës. U nda me ta me besimin se do t'i plotësonin të gjitha detyrat e ngarkuara dhe iu uroi suksese.

### Gjatë kalimit të Shkumbinit

Më 14 korrik u nisën drejt rajonit të caktuar, në marshim për veprime luftarake në rrugëkalimet Straficë e Dardhë, ku në Qafë-Dardhë patën një përpjekje me një repart xhandaroballist, por pa humbje pasi që në krismat e para ata u tërhoqën. Më pas vazhduan pa asnjë aksident marshimin gjatë luginës së Torovicës, në Gramsh, Gjinar dhe Polis. Më 19 korrik kaluan lumin Shkumbin dhe dolën në Labinotin e Sipërm. Gjatë kalimit të Shkumbinit me forcat e Brigadës së III u bashkuan partizanët e Brigadës së IV-ët, të cilët, Parllaku i kishte drejtuar gjatë Operacionit të Qershorit. Ata do të bashkoheshin me brigadën e tyre që po luftonte në Veri të vendit. I kishte pritur dhe po i shoqëronte Eleni Pashko, në atë kohë zv/komisare e batalionit, ku bënë pjesë partizanët. Ajo falenderoi për kujdesin që "Krajli" kishte treguar për partizanët e shkëputur nga brigada.

Të nesërmen, pas kalimit të Shkumbinit, "Krajli", Myzaferi e Hulusiu u takuan në Fush Bizë me komandën e Divizionit të Parë, me Dali Ndreun e Hysni Kapon. Me ta bënë bashkërendimin dhe sqarimin e detyrave që u dëlnin përpara për të siguruar prapavijat e tyre. Ky ishte i vetmi takim me ta, pasi me krijimin e Divizionit të II-të, Brigada e III kaloi në varësi të këtij divizioni.

Takimin e parë komanda e Brigadës së III e bëri në Fushë Bizë, me Tahir Kadarenë, komandant i Divizionit dhe me komisarin Tuk Jakova, të cilëve iu raportuan për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga Komanda e Përgjithshme. Iu bënë të ditur se kishin spastruar nga postat e xhandarmarisë zonat verilindore të kryeqytetit, Zall Herrin, Priskën dhe Qafë-Krrabën. Gjithashtu kishin spastruar zonën e Çermenikës dhe po i shtrinin aksionet brenda qyteteve Tiranë dhe Elbasan.

Komanda e divizionit kërkoi gjatë veprimeve luftarake të mbanin nën presion armikun, në mënyrë që të mbetej e lirë zona Shëngjergj – Labinot për të lehtësuar kalimin e forcave çlirimtare që vinin nga jugu.

### **Ardhja e Brigadës së III në rrethinat e Tiranës**

Ardhja e Brigadës së III në rrethinat e Tiranës u prit shumë mirë nga banorët e këtyre zonave dhe brenda qytetit. Ata e quanin Brigadën e III brigadën e tyre, ndonëse efektivit kishte ndryshuar me riorganizimin e saj pas humbjeve të rënda të Operacionit të Dimrit 1943-1944. Megjithëse në brigadë kishin ardhur efektiva me përvojë luftarake, përsëri shumica e kuadrove ishin në radhët e brigadës që prej krijimit të saj.

Kombinimi dhe shkëmbimi i përvojës me të ardhurit dhe puna intensive edukative që bëhej me ta, i dha rezultatet e saj. Veçanërisht mbajtja në aktivitet të vazhdueshëm luftarak rriti dukshëm aftësitë luftarake të reparteve.

Në këto arritje dhe në plotësimin me sukses të detyrave ndihmuan dhe lidhjet e ngushta me drejtuesit e luftës të Tiranës dhe Elbasanit, duke nisur nga këshillat nacionalçlirimtare të qyteteve deri te ato të fshatit. Sukses i këtij bashkëpunimi ishte edhe shtimi i efektivit të brigadës me partizanë të rinj dhe bashkë me ta erdhën edhe disa kuadro nga qyteti i Tiranës.

E rëndësishme dhe e vyer ka qenë ndihma e udhëheqësit kryesor të luftës për Tiranën, të paharruarit Gogo Nushi.

Ai qëndroi disa kohë pranë komandës së Brigadës së III, në periferi të Tiranës, nga ku drejtonte luftën e qytetit dhe njëkohësisht ndihmonte me informacionet mbi gjendjen e qytetit dhe rrethinave, duke orientuar në planifikimin e vendeve ku duhej goditur armiku. Gjithashtu, ai pruri nga qyteti mjaft kuadro të shkolluar, për të cilët repartet tona kishin shumë nevojë. Mes tyre kishte edhe mjaft intelektualë që në qytet kishin patur përgjegjësi të rëndësishme, prandaj Gogoja porositi që të shfrytëzoheshin aftësitë dhe eksperiencat e tyre të drejtimit në organizatat e partisë dhe të provoheshin në fushën e luftimit, që ta ndjenin erën e barutit dhe fishkëllimën e plumbave në rrzë të veshit. Të tillë luftëtarë si Spiro Pano, Sali Angoni dhe Sofokli Afezolli, jo vetëm e ndjenë fort fishkëllimën e plumbave dhe erën e barutit, por morën edhe detyra me përgjegjësi të lartë. Spiro Pano qëndroi pak kohë pranë Komitetit të Partisë të Brigadës, më pas u bë Komisar Batalioni dhe me krijimin e Brigadës së XXV-të u caktua si zv/komisar i asaj brigade. Sali Angoni u bë zv/komisar batalioni kurse Sofokli Afezolli u caktua si përgjegjës shtypi në brigadë.

### **Parllaku, faktor i fuqishëm në organizimin e Brigadës së III Sulmuese**

Nga 17 deri më 19 shtator u zhvillua në fshatin Surrel të Tiranës, mbledhja e Aktivit të Organizatës të Partisë të Brigadës, në të cilën u analizua e u vlerësua veprimtaria luftarake vjetore.

Parllaku, si Zv/Komisar Brigade raportoi për punën e Partisë në brigadë. Mbi situatën politike dhe detyrat referoi Komisari i Brigadës, Myzafer Spaho, kurse mbi rininë e brigadës referoi Piro Dodbiba, përgjegjës rinie i brigadës.

Aktivi analizoi me hollësi veprimtarinë luftarake të një viti, duke u ndalur në veprimtarinë luftarake të brigadës gjatë

operacionit të dimrit, ku për faj të udhëheqjes brigada kishte patur shumë humbje dhe ishte shpërndarë. Gjithashtu, edhe për kohën pas riorganizimit të brigadës, Shtabi i Përgjithshëm bënte vërejtje për veprimet gjatë Operacionit të Qershorit. Krejt ndryshe paraqitej gjendja aktuale e brigadës, ku viheshin re arritjet e dukshme në veprimtarinë luftarake të saj.

Këto suksese të efektivit të brigadës u shfaqën më qartë gjatë luftimeve të zhvilluara në muajt korrik-shtator në rrethet Tiranë dhe Elbasan.

Gjatë kësaj periudhe kohore brigada realizoi 42 aksione, disa me formacione të plota, disa me grupe luftarake, 28 prej të cilave u kryen gjatë natës, kurse brenda qyteteve Tiranë dhe Elbasan armiku mori 19 goditje të fuqishme.

Këto suksese të arritura nga efektivit i brigadës brenda dy muajve, siç u theksua edhe në aktiv, jepnin siguri për suksese edhe më të mëdha në të ardhmen.

Aktivi i Brigadës, pas tri ditë punimesh, vuri në dukje arsyet që çuan në arritjet luftarake të brigadës, si më poshtë:

- Komanda e Brigadës dhe ato të batalioneve përmirësuan punën kolegjiale, bënë mbledhje të rregullta me analiza të thelluara, bënë ndarje detyrash dhe ndihmuan komandat vartëse.
- U bënë përmirësime në punën e partisë, një përmirësim domethënës u bë në celulën e partisë të komandës së brigadës dhe në celulat e partisë të batalioneve. Ato mbledheshin rregullisht, bënë analiza dhe caktonin detyra. Komisari, Zv/Komisari dhe Spiro Pano i ardhur rishtas në brigadë, gati çdo ditë merrnin pjesë në të gjitha celulat e batalioneve dhe të kompanive duke i dhënë një impuls të ri partisë.
- Nën drejtimin e komisarit të brigadës, të komisarëve të batalioneve dhe të kompanive u bë një punë e madhe për edukimin politik e kulturor, si edhe për zhdukjen e analfabetizmit në radhët e partizanëve.
- U intensifikua puna, duke thyer ndonjë ngurim në lidhje



me përgatitjen dhe ngritjen në detyrë të kuadrove të reja; partizanë, partizane e komunistë, veçanërisht duke i plotësuar më mirë organikat me vajza.

- Organizimi më i mirë e më i plotë u bë në shërbimin e prapavijës në rang kompanie, batalioni e brigade, duke përzgjedhur në këto detyra individë të spikatur për zotësi e shkathtësi.
- Komanda e brigadës dhe komandat e batalioneve e të kompanive ndërmorën një punë të madhe sqaruese e bindëse me popullin e fshatrave të Tiranës e të Elbasanit për ngritjen dhe forcimin e këshillave nacionalçlirimtare, si edhe për shtimin e radhëve të brigadës me vullnetarë të rinj.

Masat e marra e rritën ndjeshëm fuqinë luftarake e goditëse të brigadës. Gati çdo ditë bëheshin aksione nga Elbasani në Tiranë, në rrugët e komunikacionit, në qendrat e dislokimit të armikut e brenda në qytete. Gjithashtu u rrit aftësia komanduese e drejtuese e kuadrove, u rrit guximi i partizanëve dhe shpirti i tyre luftarak e sulmues.

### **Marshimi drejt Zerqanit, Dibërës, Lumës dhe Prizrenit**

Pas përfundimit të punimeve të aktivitetit të brigadës, u mblodhën komandat e batalionit dhe dhanë detyrën që të nesërmen të fillonte marshimi, me qëllim që në mbrëmjen e 22 shtatorit të grumbulloheshin në Zerqan. Batalioni i II dhe i IV-ët do të marshonin në rrugëkalimet Shëngjergj - Fushë Bizë - Kaptina e Martaneshit e do të zbrisnin në Zerqan, kurse batalioni i I dhe i III do të marshonin në rrugëkalimet Tujanë - Qafë-Murizë - Gurra e Bardhë - Plan i Bardhë - Bulqizë - Zerqan.

Në Zerqan, sipas organikave të rishikuara, me shtimin e efektivit u bë kompletimi i batalioneve për të patur efektiv të balancuar nga 220 deri në 250 veta, u zëvendësuan disa kuadro

që u transferuan në repartet e reja që po krijoheshin dhe, për plotësimin e vendeve të lira, u emëruan mbi 30 kuadro të ngritur në përgjegjësi ose të emëruar rishtazi.

Pas ndryshimeve të fundit u bë rreshtimi i brigadës dhe Parllaku si lumjan që i njihnte mirë krahinat nga do të kalonte brigada si, Dibrën, Lumën, Hasin e Tropojën, u foli partizanëve për gjendjen e këtyre zonave, për traditat e tyre dhe se si duhet të silleshin në respekt të zakoneve të tyre, pasi gjendjen politiko-ushtarake të këtyre rajoneve e njihnin nga të dhënat e komandës së korparmatës.

Hapësira deri në Lumë ishte e çliruar. Gjermanët i kishin përqëndruar forcat në sigurimin e rrugës Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër, si një nga arteriet më kryesore që siguronte tërheqjen e trupave të tyre nga Jugu i Ballkanit.

Ishin në dijeni se në këto krahina kishin ndikim të madh paria e bajraktarët, të cilët dalloheshin për qëndrimin e tyre jo të qartë antifashist, prandaj duhet të tregoheshin të kujdesshëm në mënyrë që të mos provokonin incidente.

### **Mos(marrëveshja) me Muharrem Bajraktarin**

Pa e mbyllur ende bisedën me partizanët, erdhën dy korrierë. Komandant Hulusiu bëri me shenjë që "Krajli" të ndërpriste menjëherë bisedën dhe të shkonte tek ai dhe Myzaferi, se kishte ardhur një urdhër urgjent nga komanda e Korparmatës që urdhëronte të niseshin menjëherë në drejtim të Lumës, pasi forcat e Muharrem Bajraktarit kishin goditur në befasi Brigadën e V-të, gjendja e së cilës, siç thuhej në urdhër, ishte tepër kritike.

Por kishte ndodhur e kundërta. Akti i pabesisë, se kishin tradhëtuar Muharrem Bajraktarin dhe se kishin dashur ta vrisnin, e kishte ngritur popullin e Lumës kundër partizanëve.

Muharrem Bajraktari i kishte pritur partizanët në pozicionet ku ishin vendosur forcat e tij, para fshatit Gostil, afërsisht ku

është sot qyteti i Kukësit dhe bashkë me komandën e batalionit të V-të të Brigadës së V-të ishin vendosur krah njëri-tjetrit në të njëjtin front kundër gjermanëve. Por qëndrimi mikpritës i M. Bajraktarit nuk i kishte pëlqyer Enver Hoxhës, prandaj iu kërkua Muharremit t'ia dorëzonte forcat e tij Brigadës së V-të dhe të paraqitej në Shtabin e Përgjithshëm, ku do t'i caktohej vendi në Këshillin e Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar.

Përgjigjja e Muharremit ishte se do të luftonte kundër armikut, por nuk do t'i dorëzonte forcat e nuk do të merrte pjesë në front.

Pas kësaj u urdhërua komanda e brigadës të përhapte një komunikatë në krahinën e Lumës, ku thuhej se Muharrem Bajraktari po sabotonte luftën, me qëllim për ta demaskuar dhe më pas për ta vrarë, pasi ky ishte urdhëri i Enver Hoxhës.

### **Letra e Shefqet Peçit dhe e vërteta mbi vrasjet në Buzëmadh**

Mëngjesi i ditës së nesërme e gjeti efektivin e brigadës të përqëndruar në Peshkopi. Gjatë kohës kur po hanin, erdhi një partizan që quhej Esat Ndreu. Sa pa Hulusiun iu hodh në qafë, pasi kishin qenë të dy shokë rinie dhe oficerë artilerie. Më pas u përshëndet dhe me ne, duke na dhënë lajmin se lëvizja e Muharrem Bajraktarit ishte shtypur dhe ishte vendosur qetësia.

Pasi pyeti se kush ishte "Krajli", pseudonimi i luftës i Rahman Parllakut, i dha një letër nga Shefqet Peçi, ku shkruhej: "I dashur Krajli! Erdhëm në Lumën tënde ku populli na priti mirë, ndërkohë që Muharrem Bajraktari na goditi pas shpine. Patëm mbi 20 partizanë të vrarë, mes tyre Hysen Çinua, që ti e njeh se kenë qenë të dy në një batalion në Brigadën e V-të, po edhe ne e tepruam, vramë 22 veta në Buzëmadh dhe 4 në fshatin tënd, por në luftë kur të vriten shokët nuk e përmban dot veten. Përqaftime, Shefqeti."

Këtë të vërtetë e ka deklaruar Manush Myftiu, në Pleniumin e II-të të Komitetit Qendror në Berat, ku ka qenë i deleguar i Korparmatës pranë Brigadës së V-të, në Pleniumin e KQ të PKSH-së, fakt që është pranuar edhe nga Enver Hoxha.

Të informuar se çështja me M.Bajraktarin ishte mbyllur, i lanë partizanët të pushonin dhe të nesërmen vazhduan marshimin për në Sllatinë - Kalaja e Dodës - Ura e Lapave - Ujmisht e Bicaj, ku ishte qendra e Nënprefekturës së Lumës.

Gjatë rrugës u informuan se forcat e Muharrem Bajraktarit ndodheshin në Tejdrinë, në fshatrat Surroj, Arrn, Mamëz dhe kishin marrë urdhër ta spastronin atë zonë.

U kthyen në fshatin Skavicë, kaluan Drinin te ura e Dodës dhe në të zbardhur të 30 shtatorit hynë në fshatin Arrn, por nuk hasën në forca që kryenin spastrime në atë zonë. E njëjtja gjendje ishte edhe në fshatrat Surroj e deri në Mamës. Forcat e Muharrem Bajraktarit ishin tërhequr.

### **Luftimet në Kukës e Tropojë**

Më 9 tetor ishte përvjetori i parë i krijimit të Brigadës së III. Para efektivit të brigadës e popullit të Bicajt foli Komandanti i Brigadës, Hulusi Spahiu. Ai foli mbi rrugën njëvjeçare luftarake të brigadës, për sukseset e fitoret e arritura, pengesat e kapërcyera me sukses dhe sakrificat e shumta të partizanëve. Gjithashtu, në fjalën e tij u theksua krenaria e brigadës që po shkonte për të ndihmuar në çlirimin e popullit vëlla të Kosovës. Me këtë gëzim u bashkua edhe populli i Bicajt, që e shoqëroi festën me këngët e vallet karakteristike të lumjanëve.

Gjatë ditëve të qëndrimit në krahinën e Lumës, partizanët me sjelljet e tyre korrekte u lidhën ngushtësisht me popullin, u zhvilluan biseda të ngrohta familjare dhe aktivitete të përbashkëta kulturore.

Ato ditë bënë edhe një goditje kundër nazistëve në periferi të Kukësit, duke e tronditur gjendjen e tyre të qetësisë e duke

iu shkaktuar mjaft humbje. Të nesërmen, ata u përgjigjën me demonstrim zjarri artilerie, po pa lëvizur nga pozicionet e tyre. Nga kjo nuk dolën pa humbje. Ranë dy dëshmorë, Dajlan Dervishi dhe Musa Demi.

Natën e 11 tetorit brigada u vu në marshim drejt Hasit. Drinin do ta kalonin në fshatin Bardhoc. Nata ishte me shi dhe Drini ishte fryrë shumë. Pikat e kalimit i kishin caktuar zbuluesit me ndihmën e fshatarëve. Kalimi ishte tepër i vështirë. U zgjodhën notarët më të shëndoshë që pasi e kaluan lumin, hodhën litarët në trungjet e shelgjeve dhe shoqëruan kalimin e partizanëve në anën tjetër. Kalimi i lumit zgjati pothuajse gjatë gjithë natës dhe më e keqja ishte që nuk shpëtuan dot pa viktima. Fatkeqësisht, u mbyt partizania Adile Ali Spahiu.

Po kalonin buzë rrugës Prizren-Kukës, prandaj për të thyer ndonjë sulm gjerman morën masa mbrojtëse në të dy drejtimet. Për fat erdhi vetëm një motoçikletë me dy nazistë, që nga prita e zënë u asgjësua pa vështirësi.

Kullonin ujë, por duhet të marshonin pasi po zbardhte dhe ishin në terren të hapur, ku nga rruga artileria e rëndë gjermane mund t'i dëmtonte keqas. Gjatë marshimit, në ngjitje u ngrohën dhe me të mbërritur në fshatin Pogaj u pritën me dashamirësi nga banorët. Fshatarët u thanë rrobat në vatrat e zjarrit dhe u shtruan mëngjesin.

Nën ndikimin edhe të patriotit Ismail Poga, e gjithë zona ishte me luftën.

Në Krumë ishte krijuar një batalion partizan që nën komandën e Ismailit u radhit me Brigadën e XXV-të të Malësisë.

Afër mesditës mbërritën në Krumë, qendra e Komunës së Hasit. Aty pushuan pesë ditë. Kjo kohë u shfrytëzua për punë politike dhe u dhanë udhëzime të veçanta për sjelljen e partizanëve ndaj popullit të Kosovës.

Në Krumë bënë mbledhjen e dytë të aktivitetit të partisë për të zgjedhur komitetin e partisë në brigadë. Në aktiv mori pjesë edhe i deleguari i Korparmatës, Manush Myftiu. Nga aktivi u zgjodh përsëri Rrahman Parllaku sekretar i Komitetit, kurse

anëtarë u zgjodhën Myzafer Spaho, Spiro Pano, Ibrahim Sina dhe Izmini Papajani.

Në Krumë u zgjodhën edhe delegatët për në kongresin e gruas antifashiste. Nga 45 shoqet që kishin në efektivin e brigadës u zgjodhën 4 delegate, Taibe (Kafazi) Balluku, Xhemile Korbi, Ifi (Palloska) Jatru dhe Andromaqi Manushi.

Megjithëse Shqipëria Verilindore ishte çliruar, përfshi edhe Malësinë e Gjakovës, qendra e rrethit, Tropoja, ende mbahej nga një fuqi e xhandarmarisë së qeverisë kuislinge, nga kapiten Tahir Hoxha. Vendosën ta sulmonin Tropojën për ta çliruar, në mëngjesin e 16 tetorit. U përpoqën të ruanin befasinë e sulmit, por nuk ia arritën; së pari, se Tahir Hoxha, duke qenë vendas, kishte informatorët e tij që i vëzhgonin në çdo lëvizje dhe së dyti, se batalioni i II-të nuk arriti të zinte në kohë pozicionin e nisjes për sulm. Kjo bëri që batalioni i IV-t të hidhej i vetëm në sulmin e parë.

Armiku kishte një mbrojtje të përgatitur mirë, jo vetëm në shfrytëzimin e terrenit, por edhe banesat i kishte kthyer në qendra zjarri. Luftimet u zhvilluan të ashpra për pesë orë rresht, po me hyrjen në luftim të batalionit të dytë, armiku nuk i rezistoi dot forcave partizane dhe u tërhoq në mënyrë të çrregullt drejt maleve.

Humbjet në Tropojë kushtuan shtrenjtë. Brigada la atje tre të vrarë e tre të plagosur, mes të vrarëve komisari i batalionit Birçe Sinemati, që para dy ditësh kishte marrë emërimin si Komisar i Brigadës së XXV-të të Malësisë, e cila do të organizohej ato ditë. U plagosën komandanti i batalionit, Xhorxhi Zero, komandanti i kompanisë, Kosta Shallo, dhe partizani Stavri Kaja, që mbeti invalid përjetë.

Me çlirimin e Tropojës, Komanda e Përgjithshme i kishte ngarkuar si detyrë Brigadës së III që të organizonte krijimin e Brigadës së XXV-të të Malësisë me partizanë nga Tropoja dhe Hasi. Me plotësimin e kësaj detyre nga komanda e Brigadës së III u ngarkuan Komisari i Brigadës, Myzafer Spaho, dhe zv/komandanti Hysni Manushi.

## Detyrat për çlirimin e Kosovës

*(Nga Urdhëri i Komandantit të Korparmatës së I, Gjeneral Dali Ndreu)*

Më 18 shtator, komandën e brigadës e thirrën në Komandën e Korparmatës së I, në fshatin Priskë të Tiranës. Aty Komandanti i Korparmatës, Dali Ndreu, në prani të komisarit Hysni Kapo, të deleguarës të Komitetit të Partisë Komuniste pranë kësaj brigade, Liri Gegës, si dhe të Tuk Jakovës, në atë kohë Komisar i Divizionit të II nga edhe varej Brigada e III, komunikoi urdhërin e Komandës së Përgjithshme se Brigada e III së bashku me Brigadën e V do të shkonin në Kosovë për të ndihmuar popullin vëlla kosovar në luftën për çlirim nga pushtuesit nazifashistë.

Sipas urdhërit të Komandës së Përgjithshme detyrat kryesore për këto brigada ishin:

- Të ndihmonin popullin vëlla kosovar në luftën për çlirimin e tij sa më të shpejtë nga pushtuesit nazifashistë.
- Të nxisnin popullin e Kosovës të merrte pjesë masivisht në luftën kundër forcave naziste, për të fituar në bazë të Kartës të Atlantikut të drejtën për vetëvendosje, se deri atëherë nuk ishte përcaktuar qartë pozicioni antifashist i Kosovës, pasi qeveritë kuislinge donin ta mbanin Kosovën në bllokun fashist, duke organizuar atje forca ushtarake në ndihmë të nazistëve, siç ishin Divizioni SS "Skënderbej" dhe regjimenti "Kosova", që luftuan edhe në Shqipëri kundër partizanëve.
- Të ndihmonin në organizimin e këshillave nacionalçlirimtare si organe të pushtetit të ardhshëm.

- Të godisnin pa ndërprerje forcat naziste të Gruparmatës ERE, që po tërhiqeshin me shpejtësi nga Greqia e Maqedonia, t'i dëmtonin sa më shumë e t'i pengonin, me qëllim që të vonoheshin për në frontin e Perëndimit dhe të çorganizoheshin për të mos e kryer me sukses detyrën e ngarkuar, që ishte lufta kundër aleatëve tanë.

### **Përcaktimi i detyrave luftarake të dy divizioneve në urdhërin e luftimit**

Sipas vlerësimit të Shtabit të Përgjithshëm, rëndësi kishin drejtimit e mësymjes të dy divizioneve.

Në urdhërin e Komandantit të Përgjithshëm theksohej se detyra kryesore i ngarkohej drejtimit të mësymjes të Divizionit të V-të Sulmues, i cili do të luante rolin parësor, pasi dalja e tij në rrugën Priepolje–Priboj rrezikonte forcat gjermane të binin në rrethim, prandaj ato do të tërhiqeshin më me shpejtësi nga rajonet e Malit të Zi. Kjo do të lehtësonte veprimet e Divizionit të VI Sulmues.

Armiku gjithashtu e kishte vlerësuar këtë rrezik, prandaj në frontin e mësymjes të Divizionit të V-të, forcat naziste kishin ndërtuar një mbrojtje të fortifikuar me disa pozicione në thellësi dhe kishin përqëndruar një sasi të madhe forcash dhe armatim të rëndë.

Gjermanët luftuan me tërbim për të mbajtur të lirë rrugën e tërheqjes nga Mali i Zi.

Në vazhdim të urdhërit të 13 dhjetorit, Parllaku dha urdhërin e dytë të 18 dhjetorit, në të cilin përcaktoi detyrat luftarake për forcat e divizionit, pa ndryshuar drejtimin kryesor që përcaktonte se mësymja e divizionit do të zhvillohej në të dy anët e rrugës Senicë - Miloshefdal - Priepolje - Priboj, me detyrë të çlirohej Priepolja e Novi Varoshi e të kapej vija Pripoj – Rudo, për t'u ndërprerë rrugët e tërheqjes forcave gjermane që vinin nga Mali i Zi.



Në urdhër përcaktoheshin edhe detyrat e brigadave:

Brigada e V-të do të mësynte në të djathtë të rrugës Senicë -Priepolje, në frontin Sapotnica - Danje - Lopizhde. Ajo do të bashkëvepronte me Brigadën e VII të Divizionit XXXIV, për të çliruar Novi Varoshin dhe më pas do të bashkëvepronte me Brigadën e III Sulmuese për çlirimin e Priepoljes dhe për të dalë në vijën Priboj-Rude.

Brigada e III Sulmuese do të zëvendësonte forcat e Divizionit të XXII Jugosllav, do të mësynte në të majtë të rrugës Senicë-Priepolje, që në bashkëveprim me Brigadën e V-të Sulmuese, që mësynte në të djathtë të saj, të shpërthente mbrojtjen armike në frontin Shushure - Gornje - Boshavicë - Judovnik, në lartësinë 1591 metra, të vazhdonte mësymjen Miloshefdal - Priepolje dhe në bashkëveprim me Brigadën e V-të Sulmuese të çlironte Priepoljen dhe të merrte kontakt me forcat e Divizionit të VI që mësynin nga Mali i Zi.

Brigada e XXV-të Sulmuese do të vendosej në skalionin e dytë të divizionit, në rajonin juglindor të Senicës, në gatishmëri për të hyrë në luftë nga rajoni i Miloshefdotit me detyrë zhvillimin e mësymjes së mëtejshme për çlirimin e Priepoljes në bashkëveprim me brigadat e III dhe e V-të, në plotësim të detyrës së afërt të forcave të divizionit për të dalë në vijën Priboj - Rudo me detyrë ndalimin e tërheqjes të forcave naziste që tërhiqeshin nga Mali i Zi.

Nazistët, duke vlerësuar situatën, kishin marrë masa për tërheqjen e forcave të Gruparmatës ERE nga Ballkani Jugor, por që tërheqja të bëhej e organizuar, duheshin siguruar rrugët e tërheqjes që ishin të kufizuara në këtë rajon dhe që ishin mjaft të dëmtuara.

Me çlirimin e Kosovës, e vetmja rrugë tërheqjeje që u kishte mbetur gjermanëve ishte nëpërmjet Malit të Zi, por me daljen e forcave shqiptare dhe atyre jugosllave në Sanxhak, forcat naziste që tërhiqeshin nga Mali i Zi rrezikonin të mbeteshin të rrethuara në Bosnjen Jugore, Rudo-Priboj.

Kështu, gjermanët duke shfrytëzuar terrenin malor në

perëndim të Senicës, kishin ndërtuar një brez mbrojtjeje të fortifikuar, me sistem transhesh, hendeklidhje, strehime për efektivin, qendra zjarri të fortifikuara e deri në vendosjen e tankeve e të autoblandave të groposura, që përdoreshin si qendra zjarri.

Pozicionet e pandërprera në drejtimin kryesor shkonin nga 10 deri në 15 kilometra në thellësi. Dendësia e forcave kundërshtarë e bënte të pamundur superioritetin e forcave luftarake shqiptare mbi ta, kurse në armatime e materiale të tjera armiku ndihej i sigurt.

Kushtet e vështira të motit i gjetën forcat partizane të papërgatitura si duhet. Ishin të veshur keq, me mungesa ushqimore, terreni ishte i mbuluar krejtësisht nga bora dhe temperatura arrinte 15 gradë nën zero. Vetëm morali i hekurt dhe vendosmëria e lartë i bënte partizanët t'i përballonin kushtet e vështira dhe të hidheshin në sulm mbi llogoret e armikut.

Sulmi filloi më 20 dhjetor, sapo forcat partizane zunë pozicionet e luftimit, por armiku nuk u zu në befasi, pasi ishte i informuar. Ishin forca që kishin luftuar nëpër Shqipëri dhe e dinin që partizanët shqiptarë nuk do të rrinin pa sulmuar, ashtu siç kishin qëndruar për dy javë rresht forcat jugosllave. Këtë e pohuan 4 robër që u zunë që në ditën e parë të luftimit nga Brigada e III Sulmuese.

Luftimet ishin shumë të ashpra. Armiku i mbrojtur mirë në llogore luftonte me tërbim. Ata duhet ta mbronin me çdo kusht frontin për të mbajtur të lirë rrugën e tërheqjes të forcave nga Mali i Zi.

Përveç vështirësive të shumta të hasura edhe më parë, forcat partizane u përballën me një mbrojtje të organizuar e të fortifikuar mjaft mirë, por jo me taktikën e luftës partizane, godit e tërhiqur ose zër një pozicion të përshtatshëm e mbrohu përkohësisht. Këtë herë po zhvillohej luftë klasike me rregulla të qarta. Mësynin duke shpërthyer pozicionet e fortifikuara mbrojtëse të armikut. Detyrën e plotësuan me nder, por këtë

përvojë e fituan në kushte tepër të vështira dhe e paguan me dëme.

Në fund të dhjetorit u detyruan të bënim ndërrimin e forcave të Brigadës së III me ato të Brigadës së XXV-të, jo vetëm se Brigada e III pati shumë humbje në njerëz, por kryesorja ishte se ra tifua e morrit dhe numri i të sëmurëve po shtohet me shpejtësi.

Hyrja në luftim e Brigadës së XXV-të e rriti tempin luftarak. Forcat shqiptare përparuan në sulm dhe pas marrjes së nyjes kyçe të mbrojtjes armike në rrugën për Prijepolje-Miloshefdolin, Brigada e XXV-të në bashkëpunim me forcat e Brigadës së V-të çliruan Prijepoljen.

Më 12 janar, forcat e Brigadës së V-të çliruan Priboin, ndërprejnë rrugën e tërheqjes së gjermanëve dhe dolën në Bosnjen Jugore, në vijën Priboj-Rudo.

### **Në luftë edhe me sëmundjet epidemike**

*(Nderim dhe respekt për Dr. Selaudin Bekteshi  
dhe Dr. Petraq Progri)*

Gjendja erdhi duke u rënduar gjithnjë e më shumë me përhapjen e infeksionit të tifos, prandaj në marrëveshje me komandën e Korpusit të II-të Jugosllav dhe me aprovimin e Komandës së Përgjithshme, forcat e divizionit e ndërprejnë ndjekjen e mëtejshme të armikut dhe iu përkushtuan luftës kundër epidemisë, kufizimit dhe zhdukjes së saj.

E kaluan Brigadën e III në prapavijë dhe morën masa shëndetësore kundër epidemisë. Mjeku i brigadës, Dr. Petraq Progri, me shpejtësi e pa njohur lodhje, natë e ditë krijoi një mjedis spitalor për të sëmurët, instrukttoi disa vajza e djem nga partizanët që ta ndihmonin në punët e infermierit e të sanitarit. Gjithmonë në mes të të sëmurëve dhe pa e kursyer veten, ai shpëtoi shumë jetë njerëzish.

Nga ushtria jugosllave në ndihmë të tij erdhi një ekip prej tre mjekësh, 4 studentë të mjekësisë dhe disa infermiere. Gjithashtu, me ta erdhi edhe një mjek ushtarak anglez me materiale për dezinfektimin e të gjithë efektivit.

Mjeku i divizionit, Dr.Selaudin Bekteshi, mori masa efektive për ndalimin e përhapjes të sëmundjes, por megjithatë humbjet në njerëz ishin të shumta. Pati mbi 50 të vdekur.

Pati një përpjekje nga ana e jugosllavëve që kërkonte të argumentonte se infeksioni kishte ardhur nga Shqipëria, por mjekët shqiptarë kundërshtuan me fakte, pasi forcat e divizionit kishin luftuar për afro dy muaj në Kosovë dhe nuk kishin patur asnjë të sëmurë. Dr. Petraqi me kolonelin anglez dhe me disa mjekë vendas, i pajisur me informacionin e duhur shkoi në disa fshatra, ku vetë banorët vërtetuan se atje infeksioni kishte ekzistuar prej kohësh, kishte patur të sëmurë dhe kishin vdekur shumë njerëz.

Parllaku shpreh respekt e nderim të veçantë për Dr. Petraq Progrin dhe Prof. Selaudin Bekteshin, për përkushtimin në kryerjen e detyrës dhe për guximin e treguar ndaj rrezikut që iu kanosej në luftë me sëmundjen, për të shpëtuar jetën e luftëtarëve.

### **Dokumenti me firmën e Parllakut i ruajtur që nga lufta nga Dr. S. Bekteshi**

Pavarësisht se ç'kishte ndodhur me burgosjen e Gjeneral Parllakut, Dr. Selaudini kishte ruajtur gjatë një dokument të kohës së luftës që mbante firmën e tij, të cilin ia dorëzoi në vitin 1991, kur u lirua nga burgu. Këtë dokument, në kujtim të tij, Parllaku e ruan sot si diçka tepër të çmuar.

## **Njohja me Ramiz Alinë Zgjedhja kandidat i KQPKSH**

Më 20 dhjetor 1944, ditën e fillimit të luftimeve në krahinën e Sanxhakut, erdhi komisar divizioni Ramiz Alia.

Rahmani dhe Reiz Malile, që e zëvendësonte deri atëherë, nuk e njihnin. Parllaku menjëherë e vuri në dijeni mbi gjendjen e divizionit, përbërjen organike, mbi forcën e çdo brigade, urdhërat e çdo brigade për mësymje, mbi të dhënat që dispononin për forcat armike përballë e për mbrojtjen e tyre dhe për rezultatet e ditës së parë të luftimit.

Ramizi solli letrën e Enver Hoxhës, ku bëhej me dije se mbledhja e Pleniumit të KQ të PKSH-së, mbajtur në Berat e kishte zgjedhur “Krajlin”, Parllakun, kandidat të KQ të PKSH dhe i përcilleshin urimet me këtë rast.

Reizi e njohu Ramizin me gjendjen moralo-politike të efektivit të divizionit, me organizatat e partisë e të rinisë në brigada, punën edukative që po bëhej me efektivin, jo vetëm për të plotësuar detyrat luftarake, por edhe për të përballuar kushtet tepër të vështira të motit.

Ditët në vazhdim, Parllaku dhe Alia shkuan së bashku në frontin e luftimeve të secilës brigadë, për t’u njohur nga afër me komandat e brigadave e të reparteve vartëse, pasi kushtet e luftimeve nuk e lejonin një mbledhje të përbashkët.

Më 13 prill 1945, Ramiz Alia u thirr pranë Bashkimit të Rinisë Antifashiste, në Tiranë, si i zgjedhur në kryesinë e kësaj organizate.

### **Përvoja e re e luftimeve në territorin e ish-Jugosllavisë**

Gjatë luftimeve në territorin e ish-Jugosllavisë, në Mal të Zi, në Sanxhak e në Bosnjen Jugore, komandat e divizioneve, të brigadave e të reparteve vartëse fituan përvojë luftarake në

disa drejtime, në një luftë të rregullt frontale që ndryshonte nga lufta partizane.

Atyre iu desh të organizonin, të drejtonin e të siguronin marshimin e njësave, të një efektivit me mbi 5 mijë veta në një terren të panjohur malor, në një dimër tepër të ashpër, ku në të gjitha rrugët do të shkelnin mbi dëborë e akull. Pra, duhej të merrnin masa për veshmbathjen, për ushqimin e për strehimin e forcave gjatë kohës së pushimit, etj.

Gjithashtu, iu desh të bënin zbulimin e një mbrojtjeje të fortifikuar pozicionale dhe zbulim me luftim për t'u njohur me sistemin e zjarrit të armikut dhe kjo bëhej në kohën kur nuk kishin as zbulim instrumental e jo më zbulim satelitor, si sot.

Në bazë të këtyre të dhënave, për herë të parë komandës së divizionit dhe të brigadave iu desh të bënin një plan të detajuar mësymjeje për të shpërthyer një mbrojtje të fortifikuar armike, në mungesë artilerie dhe teknike luftarake. Për të shpërngulur armikun nga llogoret, do të hidheshin mbi bunkerët me granata dore dhe më pas me ato pak armë personale që zotëronin, do të vazhdonin luftën.

Ushtria shqiptare deri atëherë nuk ishte përballur me luftë të rregullt frontale. Edhe lufta për çlirimin e Tiranës, më shumë ishte luftë në qendrat e banuara se sa luftë frontale.

Në mars 1945, në Bosnje, në prag të fitores të Aleancës Antifashiste mbi nazifashizmin, me pjesëmarrje të forcave të Divizionit të VI Sulmues, në çlirimin e Vishegradit, luftimet e divizioneve shqiptare në tokat e ish-Jugosllavisë përfunduan me sukses.

Parllaku me shumë nderim e respekt kujton shokët dhe bashkëluftëtarët e tij: Reiz Malilen, Spiro Panon, Nuri Arapin, Shpend Degën, oficerë të karrierës Gafur Korçëne Abdurrahman Gurin, të cilët e ndihmuan pa u kursyer në kryerjen e detyrës. Kujton me respekt komandat e brigadës së III e të V, në radhët e të cilave luftuan së bashku. Kujton Komandantin e Brigadës së XXV, oficerin korrekt e të përkushtuar në detyrë, Veli Niman Doçin, oficerin e ndërlihdjes, Mufit Paçarin, që vigjëlonte ditë e natë në përgjim e shumë e shumë të tjerë.

## **Kontributi madhor i Shqipërisë në fitoren e Aleancës kundër nazifashizmit**

Gjeneral Parllaku konkludon se populli ynë prej 1 milion banorësh, në kuadër të Aleancës Antifashiste të popujve të botës që udhëhiqej nga Anglia, nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dha një kontribut të çmuar në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Kjo sipas tij, për faktin se Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare, me luftën për çlirimin e vendit, mbajti të angazhuara në luftë forca të shumta nazifashiste, që llogariteshin gjithsej deri 10 divizione dhe u shkaktoi atyre dhjetra mijë të vrarë, të plagosur e robër lufte.

“Po të mos ishin të angazhuara në frontin shqiptar, këto forca do të luftonin diku tjetër kundër ushtrive aleate.

Me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare për çlirimin e atdheut, me luftën për çlirimin e Kosovës, me luftën e dy divizioneve shqiptare në territorin e ish-Jugosllavisë për çlirimin e Malit të Zi, të Sanxhakut e të Bosnjes dhe me goditjet kundër forcave të Gruparmatës E-RE në tërheqje nga Ballkani Jugor, ushtria shqiptare në Luftën e Dytë Botërore e radhiti me dinjitet Shqipërinë krahas shteteve më të fuqishme të botës që luftuan kundër nazifashizmit.

Ditën e fitores mbi nazifashizmin, shqiptarët u ndjenë krenarë, kur flamuri kombëtar u valëvit krenar krahas flamujve të shteteve fitimtarë”, shprehet gjeneral Parllaku.

## **Vrasja e Miladin Popoviçit**

Në prill 1945 ndodhi vrasja e Miladin Popoviçit, e cila në përgjithësi u prit me keqardhje nga të gjithë të njohurit e tij shqiptarë. Parllaku me Miladinin nuk kishte patur lidhje pune, por në takimet e pakta me të, ai ishte treguar shumë i përzemërt dhe i shprehte shqetësimin e tij për gjendjen në

Kosovë. “Krajli” vinte re tek Miladini keqardhjen e tij për ato që kishin ndodhur, pasi pohonte se gjendjen e krijuar e shfrytëzuan shovinistët serbo-malazezë për të bërë raprezalje.

Këto qëndrime të tij mund të mos ishin të sinqerta, por edhe në bisedat e asaj kohe me shokët kosovarë, ata pohonin se veprimet ishin kryer nga komanda ushtarake dhe Miladini nuk mund t’i ndalonte.

Për varrimin e tij u bënë tubime të përmotshme në qytetet kryesore ku kaloi arkivoli i tij, para varrimit në qytetin e Pejës. Një tubim i tillë u organizua në Mitrovicë dhe komiteti krahinor kërkoi që Parllaku të mbante një fjalim me këtë rast. “Krajli” u vu në siklet pasi dinte shumë pak mbi aktivitetin dhe ardhjen e tij në Shqipëri.

Në kushtet e konspiracionit dhe të ilegalitetit shumë gjëra nuk diheshin dhe me Tiranën nuk kishte lidhje, prandaj ai iu drejtua Abedin Shehut në Kukës, i cili i dërgoi disa të dhëna për kohën kur Miladini kishte qenë i internuar në Peqin, ishte liruar me ndihmën e luftëtarëve shqiptarë dhe se kishte qenë i deleguar i Partisë Komuniste Jugosllave në mbledhjen e krijimit të Partisë Komuniste Shqiptare.

Në fjalim nuk e përmendi Dushan Mugoshën, por u përqendrua vetëm te aktiviteti i Miladinit dhe ndihma e tij në krijimin e partisë dhe në drejtimin e Luftës Nacionalçlirimtare.

Sa zbriti nga podiumi i tubimit, Dushani i tha: “Krajli, Miladini ka qenë më shumë se një i internuar, kemi qenë shumë më tepër”.

Dushani mbase donte që “Krajli” t’i cilësonte ata si krijuesit e Partisë Komuniste Shqiptare, por Parllaku iu përgjigj: “Unë fola mbi ato të dhëna që dija”.

### **Transferimi. Largimi nga Kosova dhe nga shokët e luftës**

Më 20 prill, Parllaku kishte marrë urdhërin e transferimit për në detyrën e re. Para largimit pati një takim të përmallshëm me të gjithë efektivin e Brigadës së III, pasi kishte kaluar me ta



më shumë se 6 muaj në detyrën e zv/komisarit dhe gjatë kësaj kohe brigada pati suksese të vazhdueshme. U katërfishua në numër dhe efektiviteti i saj jo vetëm i përballoi vështirësitë e shumta me sakrificat të panumërta, por pati edhe gëzimin e fitores. Pritja që i bëri efektiviteti, takimet dhe përfaqimet e përzemërta qenë mbresëlënëse.

Nga Prishtina u largua në ditën e festës së 1 Majit. Shokët kosovarë e ndalën në manifestimet e kësaj dite dhe shtruan një drekë lamtumire.

Në darkë, "Krajli" mbërriti në Prizren, ku ishte ftuar si mik në shtëpinë e Gafur Lumës, ish-oficer dhe i biri i Alush Agë Lumës, një nga familjet më të njohura të krahinës. Atë natë përjetuan edhe fitoren e rënies së Berlinit.

Më 2 maj, në darkë, mbërriti në Tiranë. Të nesërmen u prit në mënyrë mjaft të përzemërt nga Komandanti i Përgjithshëm Enver Hoxha, i cili pasi e përgëzoi për sukseset në drejtimin e luftimeve të divizionit, i bëri me dije se Byroja Politike e kishte emëruar Komisar të Korparmatsës së II-të, me besim të plotë se edhe këtë detyrë do ta kryente me sukses. Komandant Korparmata u zgjodh Tahir Kadare, një burrë i pjekur dhe drejtues i suksesshëm në luftë.

### **Komisar i Korparmatsës së II në Berat**

Më 2 prill 1945 mblodhën edhe një herë Aktivin e Divizionit të V-të për të analizuar veprimet luftarake të brigadave në Sanxhak e Bosnje, për të vlerësuar situatën aktuale të forcave luftarake dhe caktuar detyrat për të ardhmen.

Ky ishte takimi i fundit me kuadrot e divizionit, pasi më 20 prill Parlaku mori urdhërin e transferimit në detyrën e Komisarit të Korparmatsës së II-të, në Berat.

Detyrën e mori nga Kristo Themelko, që ishte transferuar në Bashkimet Profesionale. Procedura e transferimit të detyrës ishte e thjeshtë, pasi Korparmata nuk drejtohej nga Komiteti i

Partisë. Funkzioni ishte politik, çështjet organizative të partisë zgjidheshin në divizione e brigada. Korparmata e II-të kishte në varësi divizionin e Gjirokastrës dhe të Korçës. Komandanti, Tahir Kadare, e njohu Parllakun hollësisht në hartë me detyrat e divizioneve në të gjithë frontin e jugut, pasi në atë kohë gjendja me Greqinë ishte e acaruar.

Pas njohjes të situatës në hartë shkuan për të inspektuar gjendjen në terren. Me Tahirin panë nga afër brezin e mbrojtjes të divizionit të Gjirokastrës, kurse në Korçë u shoqërua nga shoku i vjetër Hito Çako, që në atë kohë ishte Zv/Komandant i Korparmatës.

Në qershor të vitit 1945 u bë shkrirja e korparmatave si strukturë dhe në ushtri u vendos drejtimi Komandë e Përgjithshme - Divizion.

Parllaku mbeti në divizion dhe vazhdoi kursin e partisë, organizuar nga Komiteti Qendror për komisarët e divizioneve, për sekretarët e komiteteve të partisë nëpër qarqe, si edhe për kuadrot e larta të administratës shtetërore.

Në kurs, leksionet dhe seminarët zhvilloheshin nga anëtarët e Byrosë Politike. Kursin e drejtonte Sejfulla Malëshova, kurse leksionet mbaheshin nga Enver Hoxha, Nako Spiru, Bedri Spahiu, Koçi Xoxe, Naxhie Dume, Fiqirete Shehu, etj. Kursi kishte një përgjegjës administrativ. Përgjegjës nga partia ishte Rrahmani, si i vetmi kandidat i Komitetit Qendror të Partisë.

Gjatë kursit u njoh nga afër me Sejfulla Malëshovën, i cili e vlerësonte hapur në seminare si një të ri me vullnet të hekurit dhe me dashuri këmbëngulëse në përvetësimin e dijeve.



*Ish-zëvendësministri i Mbrojtjes dhe ish-zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, me kuadro drejtuese të ushtrisë*



# IV

Drejtuesi dhe parlamentari  
vizionar i pasluftës

## **Sekretar Politik i Komitetit Qarkor të Partisë për Shkodrën**

Gjatë kursit u thirr në Komitetin Qendror ku iu komunikua vendimi i Byrosë Politike, se emërohej Sekretar Politik i Komitetit Qarkor të Partisë për Qarkun e Shkodrës.

Me të mbaruar kursin u nis për në detyrën e re, ku e priste një mjedis i panjohur shokësh. Sekretar i dytë sapo ishte emëruar Petraç Magjistari. Anëtarë të Komitetit ishin Zija Dibra që merrej me pushtetin dhe Rrahman Parllaku që e zëvendësoi në detyrën e Sekretarit Politik, Subi Bakiri që merrej me organizatat e masave, Zenepe Ashiku (Golemi) që merrej me gruan, Milka Selenica që merrej me rininë dhe Arif Gjyli që merrej me kulturën.

Në atë kohë, partia vazhdonte të mbahej në ilegalitet. Rrahmani u emërua në detyrën e Sekretarit të Frontit Demokratik të Qarkut në kohën kur Kryetar i Qarkut ishte Don Luigj Pici dhe Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit të Qarkut ishte Riza Dani (i pushkatuar me grupin e deputetëve në vitin 1947).

Detyra e re e Parllakut nuk kishte të bënte me komandën apo rreshtimin ushtarak. Ai, në atë kohë, do të drejtonte punën e qarkut më të madh të Shqipërisë, me popullsi të shtrirë në hapësirën e 5 rretheve të vendit, të cilat mbartnin shumë probleme politike, ekonomike e shoqërore.

Në moshën 26-vjeçare, pa eksperiencën e duhur, jo me emrin real të detyrës, por i maskuar nën një tjetër funksion, po haste një vëllim të madh pune dhe po përballlej me mjaft probleme. Nuk njihnte asnjë nga bashkëpunëtorët e rinj, por kishte besim të plotë se do ta përballonte me sukses detyrën, pasi së pari nuk i mungonte kurajo, vullneti dhe këmbëngulja për të arritur më të mirën dhe së dyti, në kryerjen e detyrave e ndihmonte marrëdhënia korrekte, tolerante dhe mirëkuptuese me njerëzit.

Ky qëndrim e ndihmoi të pranohej me kënaqësi jo vetëm nga anëtarët e Komitetit të Partisë, por edhe nga përfaqësuesit e Frontit e të Pushtetit. Mirëkuptim të plotë dhe bashkëpunim të ngushtë pati me Kryetarin e Frontit, Dom Luigjin, njeri shumë i kulturuar dhe me një etikë për ta patur zili.

Rrahmani beqar e Dom Luigji prift punonin pa pushim së bashku nga mëngjesi deri në mbrëmje e ndaheshin vetëm të dielën, kur ai shkonte në kishë dhe mbrëmjeve, kur largohej për të fjetur në qelë. Ishte kënaqësi të mësoje nga kultura dhe sjellja e tij.

Kështu, Rrahmani përshkoi me makinë dhe me këmbë të gjitha rrethet e qarkut, duke u njohur nga afër me gjendjen e tyre. Problem ishte furnizimi me bukë dhe me ushqimet e domosdoshme. Rrjeti rrugor edhe kur nuk mungonte krejtësisht, ishte shumë i dëmtuar nga lufta. Ndërtuan me urgjencë urën e Baçallëkut, të Gomsiqes, etj.

Gëzim i madh për Parllakun ishte ritakimi me mësues Shyqyriun, i vetmi i njohur i tij tek kuadrot e atij qarku.

Po pinte kafe me shokët e Komitetit të Partisë, kur papritur hyri Shyqyriu. Iu hodh menjëherë në qafë. Ai e shikonte i habitur dhe nuk po e njihte. Rrahmani i tha se ishte nxënësi i tij nga Cakrani i Mallakastrës. Shyqyriu i ra ballit me dorë dhe tha: “Oh sa të paska ndryshuar nacionalçlirimtarja! Ke qenë vocrrak e tani të shoh nënkolonel”.

Shyqyriu për një kohë u zgjodh kryetar i këshillit të qytetit të Shkodrës dhe ata e forcuan edhe më shumë shoqërinë.

Megjithëse në Shkodër Parllaku ndenji pak kohë, bëri shumë miq për kokë si Zenepe (Golemi) Ashiku, Zija Dibra, etj. Fatkeqësisht, shumë prej tyre si Zija Dibra, Zenepe Golemi, Gjovalin Luka, Mark Ndoja, Arif Gjyli, etj., u dënuan nga diktatura.

### **Bashkëpunimi me Sejfulla Malëshovën**

Po ndërmerreshin reforma të rëndësishme. Sejfulla Malëshova po merrej seriozisht me reformën në ekonomi, por nuk ishte për

reforma radikale dhe për sa kohë Parllaku ishte sekretar partie, ai erdhi disa herë në Shkodër për të studiuar ekonominë e qytetit, pasi Shkodra në atë kohë, përveç artizanatit mjaft të zhvilluar, kishte edhe disa ndërmarrje e fabrika industriale si ajo e duhanit, e çimentos, e tisazhit, e sapunit, etj.

Rrahmani dhe Sejfullai u takuan së bashku disa herë me drejtuesit e këtyre ndërmarrjeve, pasi Sejfullai konsultojë me ta për zhvillimin e industrisë në veçanti dhe të krejt ekonomisë së vendit në përgjithësi.

Ideja e Malëshovës, siç shpjegonte atëherë, ishte që shteti të subvenciononte pronarët dhe t'u siguronte atyre lëndën e parë për të rritur sa më shumë prodhimin, bazuar në të ardhurat që shteti merrte nga tatimet. Sipas tij, kjo ishte ekonomia e re, (NEPI) e Leninit, por që nuk u zbatua as në Rusi.

Sejfullai kërkoi që në mbështetje të ideve të tij, të krijohet një komision në qark, i cili të hartonte një studim për t'ia dërguar qeverisë. Kjo bëhet me qëllim si argument mbrojtës për idetë e tij që do t'i paraqiteshin Byrosë Politike, e cila ishte për reforma radikale.

Para zgjedhjeve parlamentare të 1945-ës, Kryesia e Frontit kërkoi propozimet për kandidatët për deputetë. U propozuan kryesisht njerëzit e luftës, por Sejfullai, kur e pa listën, mori në telefon dhe pyeti: "Pse, parlamentin vetëm me komunistë do ta bëjmë?!"

Nga katolikët ishin propozuar vetëm Gjin Marku dhe Mark Ndou. Për këtë problem erdhi në Shkodër edhe Fadil Paçrami. "Kini parasysht Dom Luigjin, që e keni kryetar të Frontit, Zef Haxhinë e ndonjë tjetër", porositi ai.

Nëse Parlamenti i parë ishte pluralist, kjo ishte për meritë të Sejfullait që, si drejtues i Frontit, udhëzonte kë duhet të propozonin. Por nga zgjedhjet parlamentare të 2 dhjetorit 1945 mbeti i pakënaqur krahu ekstremist i Byrosë Politike, prandaj pas 4 ditësh, në 6 dhjetor u mblodh e alarmuar Byroja Politike, e cila pas 5 ditë diskutimesh doli me konkluzionet se vija e Frontit (e partisë) kishte qenë e dominuar nga tendenca oportuniste që nuk ishin për mobilizimin e popullit në luftë sistematike dhe të

vazhdueshme kundër reaksionit. Ishte pranuar të shkohej në zgjedhje dhe në Asamble së bashku me ata që i luftonin fitoret popullore, me borgjezët spekullonjës, me klerin katolik, me intelektualët reaksionarë dhe se ishte kërkuar të bëhej koalicion me klerin katolik në rrethin e Shkodrës.

Në pikën 2 të konkluzioneve thuhej: "Të influencuar nga tendenca oportuniste nuk e kemi orientuar sa duhet popullin drejt vëllazërimit me Jugosllavinë, si një konditë e domosdoshme për ekzistencën e një Shqipërie demokratike popullore." Këto konkluzione në Byro i kundërshtoi vetëm Sejfullai dhe iu bënë të njohura Plenumit të KQ të PPSH vetëm në shkurt të 1946-ës, kur ai u përjashtua nga Byroja Politike e Komitetit Qendror të PKSH-së.

### **Nga puna intensive në parlamentin e parë pluralist**

Rrahman Parllaku ishte zgjedhur deputet i Lumës që në legjislaturën e parë të Parlamentit të parë pluralist. Parlamenti ishte i përbërë nga intelektualë, njerëz të feve e shtresave të ndryshme dhe në përgjithësi ishin pjesëmarrës të luftës çlirimtare, por edhe figura të pakompromentuara me armikun gjatë luftës.

Parlamenti vazhdonte punën intensivisht, pasi po përgatiteshin ligjet bazë të funksionimit të shtetit. Zhvilloheshin debate të zjarrta mbi përmbajtjen e ligjeve që lidheshin me reformat e ndërmarra në të gjitha drejtimet, veçanërisht në ekonomi.

Zërat që dëgjoheshin më shumë në parlament, nga udhëheqja e partisë ishin Sejfulla Malëshova, Nako Spiru, Ymer Dishnica, Shefqet Beja, Riza Dani, Gjergj Kokoshi, Andrea Sahatçi, etj. Diskutime kishte edhe për formën e ligjeve. Aleksandër Xhuvani kërkonte formulimin e çdo ligji në gjuhën shqipe dhe kur gjente gabime debatonte me profesor Kostaq Cipun për rishikimin e ligjit nga ana gjuhësore. Siç theksonte vazhdimisht profesor Xhuvani, ligjet duhet të ishin të sakta si nga ana juridike, ashtu edhe nga ana gjuhësore, pra të ishin shqiptare nga përmbajtja dhe nga forma e tyre.



Sejfulla Malëshova edhe në parlament mbajti qëndrim liberal ndaj forcave të tjera politike, siç kishte vepruar gjatë luftës, për t'i afruar ato me Frontin Nacionalçlirimtar dhe për t'i përfshirë në luftë kundër okupatorit.

Ai dënoi me tone të ashpra si ekstremizmin, ashtu edhe terrorizmin në Pleniumin e Partisë Komuniste, mbledhur në Berat në nëntor 1944. Edhe në parlament, Sejfullai nuk ishte për reforma ekonomike radikale. Këtë e tregoi që në hartimin e ligjit të parë për reformën agrare, ku ai u shpreh kundër kërkesave të partisë për reforma ekstreme. Fatkeqësisht, një pjesë e mirë e këtyre reformave u rishikuan e u ndryshuan pas dënimit të Sejfullait, në pleniumin e shkurtit të Komitetit Qendror të Partisë.

### **Dënimi i deputetëve opozitarë**

Pas dënimit të vijës (oportuniste e liberale) të Sejfulla Malëshovës, u godit edhe opozita në parlament. Opozitarët u quajtën përfaqësues të reaksionit në Parlamentin shqiptar.

Parllaku ndodhej i ulur në sallën e parlamentit mes miqve të tij, Riza Danit dhe Zija Dibrës, të cilët i kishte propozuar vetë si kandidatë për deputet të Shkodrës dhe shtangu kur nga tribuna e parlamentit, Riza Dani u akuzua direkt se përfaqësonte reaksionin në parlament.

Rizai brofi në këmbë dhe u përgjigj vrullshëm: "Unë Riza Dani përfaqësokam këtu reaksionin? Riza Dani, përfaqësues i lëvizjes demokratike në Shqipëri, anëtar i KONARE-së në emigracion, pjesëmarrës i Luftës Antifashiste dhe Kryetar i Frontit Nacionalçlirimtar në Prefekturën e Shkodrës, po mbron në këtë parlament të drejtat demokratike dhe jo ato të reaksionit".

Edhe pse kanë kaluar 68 vjet, ende ushtojnë fjalët e tij. Në momentin kur Rizai erdhi e u ul në mes të Rrahmanit dhe Zijait, ata u ndjenë shumë keq dhe mbetën pa fjalë. Po akuzohej Rizai, një nga përfaqësuesit më të mirë. Por, më pas do të vinte më e keqja, dënimet dhe pushkatimet e grupit të deputetëve.

# V

Roli i Parllakut në  
organizimin, modernizimin  
dhe konsolidimin e ushtrisë



*Gjeneral Parllaku gjatë drejtimit të një stërvitjeje me trupa*



## Përsëri në ushtri

Me kërkesën e tij këmbëngulëse, Parllaku u rikthye në ushtri në kohën kur atje po kryhej reforma për kthimin e saj nga ushtri partizane në ushtri të rregullt kombëtare. Kjo reformë kishte përfshirë të gjithë problematikën dhe veprimtarinë e forcave të armatosura. Po ndryshonte struktura organizative, duke filluar që nga Komanda e Përgjithshme e Shtabit të Përgjithshëm.

Ishte krijuar Drejtoria Politike e Ushtrisë, po krijoreshin komandat, drejtoritë e degët e llojeve të armëve dhe të shërbimeve, përfshi aviacionin dhe flotën luftarake, megjithëse në atë kohë nuk kishte as avionë e as anije luftarake. Po përcaktoheshin me rregullore detyrat dhe kompetencat për të gjitha instancat e komandimit e drejtimit, nga Komanda e Përgjithshme e deri në njësi, reparte e nënreparte. Përgatitja luftarake kishte filluar të zhvillohej e programuar për efektivat e llojeve të armëve e të shërbimeve. Ishin krijuar kurse e shkolla për përgatitjen e oficerëve e nënoficerëve të dalë nga lufta.

U krijua drejtoria e personelit, që po evidentonte gjendjen e oficerëve për të stabilizuar gradat sipas funksioneve, po viheshin në dukje pjesëmarrësit në luftë për të akorduar dekoratat e medaljet, sipas meritës e funksionit të gjithësecilit. Kjo drejtori zgjodhi e grumbulloi oficerë e nënoficerë (mbi 1000 studentë) që ishin të shkolluar dhe i dërgoi për studime në shkolla e akademi ushtarake për të gjitha armët e shërbimet, kryesisht në ish-Bashkimin Sovjetik. Për kompletimin e ushtrisë me djelmosha, në vend të shërbimit vullnetar, u vendos shërbimi i detyruar ushtarak.

Ushtria u sistemua në kazerma, ku po krijoheshin kabinete e klasa mësimore si dhe fusha e poligone për përgatitjen luftarake të efektivit. Pajisja me armatim e teknikë luftarake ishte nga ajo trofe e luftës dhe po përgatitej që çdo njësi apo repart të ishte i pajisur me një lloj të caktuar armatimi.

Për t'i përmbushur me sukses reformat dhe për ta kthyer ushtrinë partizane në ushtri të rregullt, veprimtaria e së cilës të zhvillohej në bazë të ligjeve të rregulloreve ushtarake, duheshin oficerë me eksperiencë dhe të përgatitur profesionalisht. Nga ushtria nacionalçlirimtare kishin trashëguar pak prej tyre, prandaj për të mbushur boshllëkun e krijuar, Komanda e Përgjithshme vendosi të thërrasë për të shërbyer në ushtri një kontigjent oficerësh karriere të përgatitur profesionalisht, të aftë e me eksperiencë. Ata do të shërbenin në organet e Shtabit të Përgjithshëm, në njësitet dhe repartet në bazë dhe do të ndihmonin në organizimin e komandave, drejtorive e degëve të llojeve të armëve e shërbimeve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në drejtimin e reparteve e nënreparteve të armëve e të specialiteteve.

Këta oficerë do të organizonin e drejtonin kurset e shkollat për përgatitjen e oficerëve e nënoficerëve dhe do të ndihmonin oficerët e dalë nga lufta në programimin dhe zhvillimin e procesit mësimor me efektivin. Ky kontigjent oficerësh së bashku me kolegët e tyre pjesëmarrës në luftë formuluan rregulloret e para bazë të ushtrisë dhe ndihmuan në organizimin e planizimin e procesit mësimor e stërvitor me efektivin, në mënyrë që ai të zhvillohej sipas rregulloreve.

Përparimi i shpejtë i ushtrisë është meritë e vullnetit dhe vendosmërisë së oficerëve të Luftës Nacionalçlirimtare që përbënin shumicën dërrmuese të saj e që, megjithëse niveli i tyre profesional ishte i ulët, punuan me këmbëngulje e përkushtim të veçantë në përvetësimin e njohurive ushtarake dhe të ndihmuar nga kolegët e tyre, oficerë karriere, duke u aftësuar dhe plotësuar me sukses detyrat e ngarkuara.

Me punë, përpjekje e përkushtim dhe në sajë të ndihmës

së çmuar të oficerëve patriotë të karrierës, ushtria jonë brenda 3 vjetëve mori përmasat dhe formën e plotë të një ushtrie të rregullt.

Fatkeqësisht, kontributi i oficerëve të karrierës në transformimin e ushtrisë sonë partizane në ushtri të rregullt jo vetëm nuk u vlerësua aspak, por përkundrazi, i liruan nga ushtria pa mbushur moshën e pensionit. Pjesa më e madhe e tyre u persekutuan, u internuan, u burgosën dhe u pushkatuan. I njëjti fat ndoqi edhe oficerët e karrierës që kishin marrë pjesë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

### **Drejtor Personeli në Ministrinë e Mbrojtjes**

Pas rikthimit në shërbimin ushtarak, fillimisht Parllaku u emërua Shef i Degës së Organizimit në Drejtorinë Politike të Ushtrisë, ku qëndroi për pak muaj, pasi u transferua në detyrën e Drejtorit të Personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Drejtoria e Personelit ishte krijuar rishtas në Ministrinë e Mbrojtjes, bazuar në reformat që po bëheshin në ushtri, pasi deri atëherë puna me kuadrin e ushtrisë drejtohej nga Koçi Xoxe, me anë të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë. Pas këtij ndryshimi, Parllaku mori detyrën e Drejtorit të Personelit në ushtri, kurse në drejtimin e degëve vartëse u caktuan djem të sapodalë nga lufta, të rinj e me kulturë, energjikë e të përkushtuar në detyrë si Pertef Pumo, Ylvi Luto, Jani Fullani, Gazali Sejko, etj.

Në ushtri ishte periudhë transformimesh dhe sipas strukturës që po ndryshonte, bëheshin edhe transferime dhe emërimë të reja. Për çdo rast bëheshin studime të hollësishme, që funksionet drejtuese të mbështeteshin jo vetëm në meritat nga koha e luftës, por edhe në aftësitë profesionale të gjithësecilit.

Probleme kishte në dhënien dhe në përcaktimin e gradave. Kishte ankesa se gradat nuk ishin dhënë sipas meritave të

fituara në luftë, por duhej të mbahej parasysh që grada jepej në përshtatje edhe me detyrën e re të secilit.

Problem për Drejtorinë e Personelit në atë kohë ishte edhe dhënia e dekoratave dhe e medaljeve. Kujdes i veçantë tregohesh në verifikimin e deklaratave që lëshonin komandat dhe këshillat nacionalçlirimtare në shkallë vendi si për luftëtarët e lirisë, ashtu edhe për ata që kishin punuar në terren gjatë luftës.

Detyrë tjetër në shërbim të së ardhmes ishte edhe përzgjedhja me kujdes e të rinjve që do të dërgoheshin me studime në shkollat ushtarake jashtë shtetit, pasi ata duhet të kishin kulturën e domosdoshme për të përvetësuar programin mësimor. Në këtë drejtim u bë më e mira e mundshme, pasi me përfundimin e studimeve të tyre, në vitet 1949-1950, rezultatet ishin mbresëlënëse.

Ata ndikuan menjëherë në ngritjen në një shkallë më të lartë të përgatitjes e të gatishmërisë luftarake dhe me kthimin e tyre, ushtria ishte bërë një shkollë e unifikuar. Kuadrot e Drejtorisë së Personelit punonim pa u lodhur, orar e pa orar, ditë e natë duke e përballuar ngarkesën e madhe të punëve me moshën e tyre të re, plot energji dhe me entuziazmin e fitores së luftës.

### **Marrëdhëniet e Parllakut me Hoxhën në Ministrinë e Mbrojtjes**

Drejtorja e Personelit varej nga Enver Hoxha, pasi ai ishte Ministër i Mbrojtjes dhe Komandant i Përgjithshëm. Të gjitha gradimet, emërimet, transferimet dhe propozimet për dekorim bëheshin me firmën e tij. Hoxha e takonte Parllakun zakonisht në Kryeministri, por kishte raste që e priste edhe në shtëpi. E dëgjonte me vëmendje, ndërhynte kur gjërat i dukeshin të pastudiuara mirë dhe jepte porosi të thellohej studimi. Kujtesa e tij ishte mjaft e mirë dhe pyeste kur një emër kalohej për herë

të dytë. E sqaronin se pas vërejtjeve të bëra, e kishin rishikuar dhe po i raportonin përsëri.

Ishin vitet e pasluftës dhe marrëdhëniet ishin konfidenciale, shoqërore dhe tepër korrekte. Nuk ishte krijuar akoma distanca që u thellua më vonë, kur u fry kulturi i individit dhe u thurën lavde për udhëheqësin e madh e të pazëvendësueshëm. Kjo mbase edhe nga fakti se atëherë Komiteti Qendror i Partisë ishte i përbërë vetëm nga 23 vetë dhe me përjashtimin e Sejfulla Malëshovës, Dali Ndreut e Kadri Hoxhës, mbetën 20 anëtarë.

### **Marrëdhëniet me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Mehmet Shehun**

Me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm mbante lidhje të vazhdueshme dhe e njoftonte për të gjitha propozimet dhe urdhërat që përgatiteshin për firmë. Për aq kohë sa punoi me Gjeneral Spiro Moisiun, e veçanta ishte se ai i dëgjonte me vëmendje raportimet, të linte hapësirë vetëveprimi, nuk hynte në hollësi e nuk bënte vërejtje për vërejtje.

Me ardhjen në krye të Shtabit të Përgjithshëm të Mehmet Shehut, marrëdhëniet ishin edhe më korrekte. Të dy ishin kandidatë të Komitetit Qendror të Partisë. Shehu kishte njohuri të gjëra mbi kuadrin, prandaj mendimi i tij i interesonte dhe ishte ndihmë për Parllakun.

Kur Mehmeti ishte kooptuar kandidat në Byronë Politike të Komitetit Qendror, Enveri e porositi Rrahmanin që për çdo gjë të vinte në dijeni Mehmetin, gjë që ai e kishte bërë vazhdimisht, pasi kjo ishte në të mirë të punës. Po vartësia vazhdoi direkt nga ministri, pra gjithçka bëhej me firmën e Enver Hoxhës.

Ekzistonte edhe një degë kuadri për kuadrin politik pranë Drejtorisë Politike, me të cilën koordinoheshin veprimet, për t'u vënë në dijeni edhe Drejtori Politik, dhe më pas të gjitha



propozimet e tyre kalonin për të marrë firmën e ministrit. Këtë detyrë, Rrahmani e plotësoi me sukses, u vlerësua me gradën Kolonel dhe u emërua Drejtor Politik i Ushtrisë.

### **Ndërhyrja jugosllave në ushtri, mosmarrëveshjet midis dy shtatmadhorive**

Është i njohur dhe i dokumentuar fakti se jugosllavët, pas Luftës së Dytë Botërore, bënë shumë përpjekje për ta bashkuar Shqipërinë me Jugosllavinë dhe për ta bërë Republikë të 7-të të Federatës. Për këtë qëllim, ata kishin punuar që gjatë luftës me emisarët e tyre pranë udhëheqjes së Partisë Komuniste Shqiptare si Miladin Popoviçi, Dushan Mugosha, Vukmanoviç Tempo, etj.

Pas luftës, këto përpjekje u shtuan dhe gjetën mbështetje edhe në disa udhëheqës të lartë të Byrosë Politike. Për ta bërë fakt të kryer bashkimin, ata dërguan shumë këshilltarë e instruktorë jugosllavë në sektorë të ndryshëm të administratës, sidomos në dy sektorët kryesorë: në ekonomi dhe ushtri.

Parllaku pati rastin të shohë nga afër veprimtarinë e tyre në ushtri. Ata u mbështetën te grupi i oficerëve që ishin kryesisht politik, pasi grupi i ushtarakëve të ardhur në ushtri kishin një nivel të lartë profesional karriere dhe kishin studiuar në Akademitë Ushtarake Perëndimore.

Të ashtuquajturit këshilltarë ushtarakë jugosllavë jo vetëm nuk ndihmuan në kryerjen në kohë e me sukses të reformave, në të cilat ishte përfshirë ushtria jonë në vitet 1945-1947, për ta kthyer ushtrinë tonë nga ushtri partizane në ushtri të rregullt kombëtare, po përkundrazi i penguan ato. Ata sollën modelin jugosllav dhe kërkuan të kopjohej ai model, në strukturën organizative, në formulimin e rregulloreve që do të drejtonin ushtrinë, në programet e zhvillimit të përgatitjes luftarake, etj.

Në këtë kohë filluan edhe kundërshtimet ndaj tyre. Mbi ç'baza do të ngrihej ushtria shqiptare? Do të ishte ushtri

kombëtare apo bisht i ushtrisë jugosllave?! Këto kundërshtime u shfaqën hapur kur në krye të Shtabit të Përgjithshëm erdhi Gjeneral Mehmet Shehu.

### **Stërvitja e përbashkët e Shkupit, shkurt 1947, përpjekja e jugosllavëve për ta quajtur ushtrinë shqiptare armatë në përbërje të ushtrisë jugosllave**

Ndërhyrja direkte e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave për ta quajtur ushtrinë shqiptare Armatë të Ushtrisë Jugosllave edhe organikisht, u bë në shkurt 1947, në stërvitjen e përbashkët mes dy ushtrive, në Shkup ku ishin vendosur edhe shtabet që drejtonin stërvitjen.

Ushtria shqiptare merrte pjesë në stërvitje me Shtabin e Korparmatës dhe me dy shtabe divizionesh. Për palën jugosllave stërvitjen e drejtonte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, Koça Popoviç, kurse për ushtrinë tonë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Mehmet Shehu.

Në rolin e komandës së Korparmatës ishin caktuar si komandant Tahir Kadare dhe si komisar Rrahman Parllaku. Në takimin e gjeneral Mehmet Shehut me Shefin e Shtabit të Ushtrisë Jugosllave, Koça Popoviçin, ky i fundit i kishte komunikuar vendimin e komandës jugosllave se Korparmata Shqiptare do të vepronte nën komandën e Rajonit Ushtarak të Shkupit.

Gjeneral Mehmeti nuk kishte qenë dakort me këtë vendim të tyre dhe para se t'u kthente atyre një përgjigje, me materialin dhe hartën në dorë erdhi të konsultohet me Rrahmanin dhe Tahirin. Kadare dhe Parllaku ishin dakord me Gjeneral Mehmetin dhe vendosën të mos e pranonin vartësinë nga Komanda e Shkupit. I vetmi shqetësim i Mehmetit ishte se si do të reagoonte Komandanti i Përgjithshëm ndaj vendimit të tyre. Me Tiranën mund të lidheshin vetëm me anë të linjës telefonike jugosllave dhe të gjitha bisedat kontrolloheshin, pra

paraprakisht ata nuk mund të raportonin, prandaj Rrahmani dhe Tahiri i thanë Mehmetit se përgjegjësinë mbi këtë veprim do ta mbanin të tre.

Pas kësaj, që në mbledhjen e parë me palën jugosllave, Mehmet Shehu deklaroi se nuk ishin dakord me vendimin e tyre që gjatë stërvitjes, Korparmata Shqiptare të ishte nën komandën e rajonit ushtarak të Shkupit dhe as nën komandën e Ushtrisë Jugosllave. Ai theksoi se kishin vajtur për të zhvilluar stërvitje të përbashkët të dy ushtrive mike, për t'u përgatitur që në rast nevojë të ishim të gatshëm për bashkëveprim në mbrojtje të dy vendeve.

Koça Popoviçi, Vukmanoviç Tempo dhe këshilltari sovjetik i tyre, një gjeneral lejtant, u përpoqën t'i bindin se kështu do të organizohej më mirë bashkëpunimi dhe iu drejtuan Mehmetit duke i thënë se do të ishin bashkë me ta në udhëheqje të stërvitjes, por Shehu, Kadare dhe Parllaku nuk pranuan.

Pas komunikimit me Beogradin, jugosllavët bënë me dije se ishin dakord që Korparmata Shqiptare të vepronte më vete, duke bashkëvepruar me forcat e rajonit të Shkupit. Edhe konkluzionet dhe vlerësimet për Korparmatën Shqiptare i bëri Gjeneral Mehmet Shehu.

Kjo ishte përplasja e parë e hapur në mes të dy shtabeve të përgjithshme të ushtrive shqiptare dhe jugosllave, pasi përplasje ndërmjet komandave të njëjsteve me këshilltarët jugosllavë kishte patur edhe më parë.

Pas përfundimit të stërvitjes, Mehmeti do të udhëtonte nga Shkupi në Tropojë dhe Rrahmani e shoqëroi në takimin me popullin e rrethit të Tropojës, pasi, pas vdekjes të Sali Manit, Mehmet Shehu kishte paraqitur kandidaturën për deputet në atë rreth. Gjatë rrugës për në Tropojë pushuan një natë në Gjakovë, në shtëpinë e Ymer Pulës, shok dhe mik i Rrahmanit që gjatë veprimeve luftarake në Kosovë.

## **Shqetësimi i Mehmet Shehut për raportimin tek Enver Hoxha për stërvitjen e përbashkët me jugosllavët**

Parllakut i bënte përshtypje shqetësimi i vazhdueshëm i Mehmetit në lidhje me reagimin që mund të kishte Enver Hoxha për qëndrimin që mbajtën me jugosllavët dhe dyshonte se Shehu mund ta kishte nuhatur që Enveri po u nënshtrohej jugosllavëve, pasi kur u ndanë me Tahir Kadarenë, e porositi t'i shmangej takimit me Komandantin, pasi do t'i raportonin të tre mbi situatën dhe qëndrimin e tyre.

Të nesërmen e kthimit nga Tropoja, Mehmeti, Rrahmani e Tahiri shkuan në takim te Enveri. Mehmeti raportoi mbi zhvillimin e stërvitjes dhe mbi grindjen që patën me Shtabin e Përgjithshëm Jugosllav, me Popoviçin e Tempon, si edhe për qëndrimin në lidhje me përfshirjen e Korparmatës Shqiptare në përbërjen e rajonit ushtarak të Shkupit. Enveri e mbylli bisedën duke thënë se jugosllavët duhet të kishin marrë mendimin tonë më parë, pastaj të vendosnin pasi mbi këtë çështje parimore nuk mund të merreshin vendime të njëanshme.

### **Përplasja e dytë e hapur**

Përplasja e dytë e hapur me udhëheqjen ushtarake ndodhi para të gjithë kuadrove kryesore të ushtrisë në prill 1947, kur Gjeneral Mehmet Shehu kishte përgatitur tezat mbi doktrinën ushtarake shqiptare.

Kundër tyre reagueshan këshilltarët jugosllavë, duke u larguar të nëntë nga mbledhja. Reagim pati edhe nga Drejtoria Politike e Ushtrisë Shqiptare. Kundërshtimi erdhi pasi Mehmeti tezat e tij i mbështeste në eksperiencën e Luftës Nacionalçlirimtare, si edhe në artin ushtarak stalinian, siç shprehej ai për artin e Ushtrisë Sovjetike, pa e përmendur Luftën Nacionalçlirimtare jugosllave dhe rolin e Titos si ideator e organizator i kësaj lufte, që sipas jugosllavëve kishte vlera universale.

Në mbledhjen e pasdites, Zv/Drejtori Politik Pëllumb Dishnica mbajti një ligjëratë, ku ngrinte lart eksperiencën e ushtrisë jugosllave dhe rolin e Titos në Luftën Nacionalçlirimtare dhe vlerat e tij për ushtrinë shqiptare. Kjo ishte bërë me lejen e Enver Hoxhës, pasi Pëllumbi kishte paraqitur te Komandanti një raport mbi qëndrimin e Mehmetit në ndërtimin e marrëdhënieve të ushtrisë shqiptare me atë jugosllave.

Raportin, Pëllumbi ia kishte paraqitur Enverit në 24 prill 1947. Në raport shpreheshin mendimet e tij se gjithçka duhet ta kopjonim nga ushtria jugosllave, të cilën e kishim aleate dhe së bashku të ndiqnim të njëjtën rrugë dhe të shkonim drejt bashkimit.

Gjithashtu, në raport theksohej se këto mendime i kishte diskutuar edhe me Mehmetin, i cili i kishte thënë se bëhej fjalë për një çështje të rëndësishme ku paraqiteshin dy orientime: ose do të vepronin si deri atëherë, ose do të shndërroheshin në pjesë të armatës jugosllave, do të merrnin e kopjonin urdhërat e Koça Popoviçit, do t'i vinin kryq Komandantit të Përgjithshëm dhe do të përzinin këshilltarët sovjetikë.

Sipas Gjeneral Mehmet Shehut, kjo ishte një çështje që duhej prerë mirë, pasi nëse veprohej në mënyrë të gabuar, do të kishte pasoja katastrofale. Siç kuptohet, Enver Hoxha nga një anë si Komandant i Përgjithshëm i kishte aprovuar tezat e Gjeneral Mehmetit, kurse nga ana tjetër grumbullonte të dhëna kundër tij, që i merrte nëpërmjet Drejtorisë Politike të drejtuar nga Kristo Themelko, ku jepej jo vetëm mendimi i tyre, por edhe i jugosllavëve dhe megjithatë nuk u dallua asgjë dhe në pamje të jashtme nuk u shkaktua asnjë reagim i Komandantit të Përgjithshëm ndaj Gjeneral Mehmetit.

### **Përplasja e tretë**

Hera e tretë, mosmarrëveshje e qëllimshme! Ishte korriku i 1947-ës, kur Gjeneral Mehmet Shehu lajmëroi se po vinte në

Tiranë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, Koça Popoviçi, dhe Drejtori Politik i kësaj ushtrie, Vukmanoviçi Tempo.

Shehu porositi që të dilnin për t'i pritur në Qafë-Thanë, pasi mund të vinin nga Struga ose nga Shën Naumi. Në orën 10.00, ushtarakët shqiptarë ishin atje, ku pritën rreth 3 orë, por nuk erdhi njeri.

Gjeneral Mehmeti e humbi durimin e sugjeroi të ktheheshin. Kur mbërritën në Tiranë, oficeri operativ tha se e kishin lajmëruar nga hotel "Dajti" dhe i kishin thënë se Koçaja dhe Tempoja ishin akomoduar aty.

Ashtu siç ishin, të pluhurosur, pasi atëherë rrugët ishin të paasfaltuara, shkuan në hotel. Pasi u përshëndetën, Mehmeti iu tha: "Ne me Kolonel Parllakun kemi dalë që në mëngjes dhe iu pritëm në kufi për më shumë se tre orë. Ju nuk na vutë në dijeni për ndërrimin e itinerarit të rrugës dhe nuk kemi faj nëse nuk ju priti njeri, sepse kjo nuk është në traditën shqiptare të mikpritjes."

### **Ushtarakët jugosllavë qëllimisht vijnë nga Rruga e "Arbërit", në rrugën Dibër e Madhe - Bulqizë - Shkalla e Tujanit - Tiranë**

Ushtarakët jugosllavë kërkuan falje dhe për t'u justifikuar thanë se kishin parë në hartë një rrugë që vinte nga Dibra në Tiranë dhe duke treguar kuriozitet, e përshkuan atë rrugë. Kishin ardhur në rrugën Dibër-Bulqizë-Stanet e Linosit- Tiranë dhe megjithëse e paraqitën si kuriozitet, e kishin parë si rrugë ushtarake, pasi diheshin qëllimet e tyre ndaj nesh.

Gjatë drekimit së bashku u bisedua në përgjithësi për marrëdhëniet e karakterit organizativ, të përgatitjes luftarake, të pajisjes me bazën materiale të nevojshme për ushtrinë, etj., por pa hyrë në detaje. Pasdite, ata u shoqëruan për në takimin me Enver Hoxhën nga Gjeneral Mehmeti dhe Kristo Themelko.

Ndërhyrja jugosllave në ushtri si edhe në të gjithë jetën e vendit, u intensifikua shumë gjatë vitit 1947 dhe në gjysmën e parë të vitit 1948.

Duke njohur kundërshtimin e kuadrove të larta të ushtrisë sonë ndaj tyre, veçanërisht pas ardhjes në krye të Shtabit të Përgjithshëm të Gjeneral Mehmet Shehut, ata i shtuan kundërshtitë e tyre me qëllim që ushtria shqiptare të hynte sa më parë në varësi të ushtrisë jugosllave dhe për ta bërë këtë fakt të kryer krijuan pretekstin se Shqipëria rrezikohej të sulmohej nga Greqia.

Gjoja për ta mbrojtur Shqipërinë nga ky rrezik, kërkuan dislokimin e forcave të tyre në Qarkun e Korçës dhe meqenëse në vend nuk kishte aviacion, kërkuan të merrnin në dorëzim aerodromet, etj., që do të thoshte de facto pushtim i vendit. Kundërshtimet e udhëheqjes së ushtrisë shqiptare bënë që jugosllavët të mos i arrinin qëllimet e tyre.

Këtë problem Enver Hoxha e ka trajtuar sipas konjunkturave politike, duke ia dhënë vetes meritën për kundërshtimet ndaj jugosllavëve dhe ndonjëherë ka folur edhe për të tjerët, si në rastin kur i bëri biografinë Beqir Ballukut në Kongresin e I-rë të Partisë dhe për ta zgjedhur në Byronë Politike të Partisë tha se kur e kishte pyetur Beqirin, në kohën kur kishte qenë Shef i Shtabit të Përgjithshëm se a mund të mbroheshim me forcat tona, Beqiri i ishte përgjigjur pa mëdyshje, se ne ishim në gjendje të mbroheshim vetë, pa patur nevojë për ndihmën e të tjerëve. Kurse vite më vonë, në vitin 1974, kur Beqir Balluku u dënua nga diktatura, ai e akuzoi se ishte takuar në Beograd me Titon dhe kishin rënë dakord që forcat jugosllave të vinin në Shqipëri.

Nuk ishte udhëheqja e ushtrisë që donte bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, por ishte udhëheqja e Partisë me Enver Hoxhën në krye.

Pleniumi i Komitetit Qendror nuk ishte vënë në dijeni as për vendimet e Byrosë Politike për probleme madhore që kishin të bënin me fatet e vendit, si marrëdhëniet me Jugosllavinë, të

shtrira në marrëveshjet për bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve, marrëveshja Tito-Enver për vënien e ushtrisë sonë nën komandën e Ushtrisë Jugosllave, si edhe për përgatitjet që po bëheshin për bashkimin e Shqipërisë me Federatën Jugosllave, për të cilën Byroja Politike dhe Enver Hoxha, siç ishte shprehur Koçi Xoxe, kishin rënë dakord dhe se vetëm duhej pritur momenti politik për shpalljen e saj.

Kjo veprimtari e Byrosë Politike kishte ngjallur kontradikta edhe brenda radhëve të saj. Koçi Xoxe dhe krahu i tij e mbështesnin Enverin, që kishte rënë dakord me politikën jugosllave, kurse Nakoja, i mbështetur nga të rizgjedhurit në Byro, bënte rezistencë duke shpresuar në mbështetjen e Enverit, që ia kishte nxitur mendimet e qëndrimet e tij. Por me shtimin e presioneve të jugosllavëve duheshin parë problemet më qartë dhe Nakoja u braktis.

Këshilltarët ushtarakë jugosllavë nuk ishin të përgatitur sa ushtarakët tanë të karrierës të përgatitur në akademitë perëndimore, megjithatë kërkonin të diktonin gjithçka.

Ata punonin për bashkimin e dy ushtrive dhe për përgatitjen e modaliteteve të bashkimit mbi bazën e të cilave u përgatit promemoria e bashkimit.

### **Vetë(vrasja) e Nako Spirit**

Udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave, duke parë pengesat e vonesat e palës shqiptare në realizimin e planit të bashkimit të Shqipërisë me Federatën Jugosllave dhe shqetësimet e saj se marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik po shkonin drejt prishjes, po e ndjente se plani i tyre i bashkimit rrezikonte dështimin.

Kjo frikë e nxiti udhëheqjen jugosllave të shtonte mbi udhëheqjen e Partisë Komuniste Shqiptare presionin për bashkimin sa më të shpejtë të Shqipërisë me Federatën Jugosllave gjatë viteve 1947-1948. Prandaj, për të arritur këtë



drejtuan akuza direkte mbi Nako Spirun, si pengesa kryesore në Byronë Politike. Ata e akuzuan Nakon si agjent e armik. Enver Hoxha, i mbështetur nga grupi pro jugosllav i Koçi Xoxes, u pajtuan me akuzat e jugosllavëve duke e dënuar Nakon. Edhe nëse u vetëvra Nako Spiru, ai e bëri këtë se e pa veten të tradhëtuar nga Enver Hoxha.

Parllaku ishte ngarkuar me ceremoninë e varrimit të Nakos. Arkivolin me trupin e Nakos e vendosën në hollin e godinës së Kuvendit Popullor, ku iu bënë homazhet. Arkivolin deri te Ministria e Brendshme e shoqëruan disa personalitete, kurse në varreza shkuan Rrahmani me trupprojën, familjarët e Nakos dhe pak shokë e miq.

Homazhet iu bënë si personalitet i lartë shtetëror, kurse varrimi iu bë familjar.

Të gjithë e njihnin Nakon si më inteligjentin, më të kulturuarin dhe më aktivin, si gjatë luftës, ashtu edhe gjatë punës drejtuese në përbërjen e Byrosë Politike. Tani, ky Nako po dilte tradhëtar.

Megjithë orientimet e materialet që u paraqitën në raportin e Byrosë Politike dhe ndërhyrjet e presionit të vazhdueshëm të Enverit dhe Koçit gjatë diskutimeve të anëtarëve të Plenumit, për të grumbulluar materiale mbi fajësimin e Nakos, plenumi nuk po e dënonte atë.

Atëherë, Byroja Politike i ndërpreu për një dy ditë punimet dhe shpërndau për studim materiale plotësuese me akuza ndaj Nakos. Studimi i këtyre materialeve do të bëhej në grup.

Parllaku ishte në një grup me Beqir Ballukun e Kiço Ngjelën dhe mbledheshin në shtëpinë e Kiços. Edhe pas kësaj, mesa u kuptua, Enveri dhe Koçi nuk ishin të sigurt se shumica e anëtarëve të plenumit do ta dënonin Nakon, prandaj kishin thirrur në mbledhjen e plenumit një grup kuadrosh të pazgjedhur në këtë forum

Pas dy ditësh në mbledhje, në sallë ishin aq njerëz, sa ishin edhe anëtarë të Plenumit. Ata ishin kooptuar jashtë çdo rregulli nga Byroja Politike si kandidatë dhe anëtarë të Komitetit

Qendror, për të plotësuar shumicën në dënimin e Nako Spirut dhe në përjashtimin e Mehmet Shehut e Liri Belishovës, pa i thirrur më parë në mbledhje për të dëgjuar mendimet e tyre.

Të kooptuarit ishin: Haki Toska, Bajram Sinoimeri, Adil Çarçani, Tahir Kadare, Teki Kolaneci, Pëllumb Dishnica, Petro Papi, Sotir Kamberi, Koço Titka dhe Vaskë Koleci.

Me shtimin e pjesëmarrësve në plenium dhe pas dy ditë të tjera diskutimesh nën presion të vazhdueshëm pyetjesh, që i bëheshin nga anëtarët e Byrosë Politike, Pleniumi i Komitetit Qendror e dënoi Nakon, pas vdekjes.

### **Ndryshime në parti, qeveri dhe ushtri Parllaku, Drejtor i Drejtorisë Politike të Ushtrisë**

Pas mbledhjes së pleniumit u bënë ndryshime në përbërjen e Komitetit Qendror të Partisë, në qeveri dhe në drejtimin e ushtrisë.

Në vend të Mehmet Shehut, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë u emërua Beqir Balluku.

Kristo Themelko u emërua zëvendës i parë i Ministrisë të Mbrojtjes dhe në vend të tij, si Drejtor Politik u emërua Rrahman Parllaku. Në këtë detyrë qëndroi vetëm 3 muaj, pasi u largua për studime të larta ushtarake në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë të ish-Bashkimit Sovjetik.

Pas vendimeve të Pleniumit të VIII të KQ të PPSH, ndërhyrja jugosllave në punët tona të brendshme u shtua shumë, sidomos u shtuan përpjekjet për bashkimin e ushtrive dhe sjelljen e divizioneve jugosllave në Shqipëri. Ky presion po shtohet edhe për faktin se marrëdhëniet jugosllavo-sovjetike po shkonin drejt prishjes dhe ata shpejtonin vendosjen e forcave të tyre, për sa kohë prishja e marrëdhënieve nuk ishte bërë publike në vendin tonë.

Për t'ia arritur qëllimit, në prill 1948, në Tiranë erdhi një grup ushtarakësh të forcave ajrore jugosllave, i kryesuar nga

zv/komandanti i aviacionit, kolonel Pjero Papidova, për të parë gjendjen e aerodromeve shqiptare dhe mundësinë e dislokimit të aviacionit të tyre. Pra, siç ishte bërë e ditur, Titoja me Enverin, de facto po bënin bashkimin e dy ushtrive.

Në këtë kohë, Enveri mori nga Stalini disa letra ku sqaroheshin marrëdhëniet e tyre me Jugosllavinë, po për këtë nuk u vu në dijeni as Komiteti Qendror dhe as drejtuesit e ushtrisë, të cilët nuk e dinin mendimin e Stalinit se nuk shihej ndonjë rrezik që mund t'i kanosej Shqipërisë nga Greqia.

Parllaku në fund të prillit 1948 u largua për studime në Bashkimin Sovjetik.

Enveri, si gjithmonë, pas marrjes së letrave nga Stalini, punonte në fshehtësi për të vlerësuar situatën, deri sa të bindej se në cilën anë e kishte të sigurt karrigen dhe se si mund të dilte hero e shpëtimtar ndaj synimeve jugosllave, siç edhe doli në Kongresin e I-rë të Partisë, duke ia ngarkuar të gjitha fajet dhe dështimet Koçi Xoxes, i cili vërtet kishte gisht në këto marrëdhënie të krijuara me jugosllavët, por rol kryesor kishte Enver Hoxha.

## **Jeta studentore në Akademinë e Lartë Ushtarake “Voroshilov”, në Ish-Bashkimin Sovjetik**

Studimet në Akademi filluan në ditët e para të majit 1948. Ishin tre studentë nga Shqipëria: Arif Hasko, Panajot Plaku dhe Rrahman Parllaku. Për vijimësinë mësimore i bashkuan në një grup me katër bullgarë: gjeneralët Boris Kopcev e Petër Iliev dhe kolonelët Ivan Boçvarov e Ivan Demirsekev.

Fillimi për ta ishte tepër i vështirë. Mësimet zhvilloheshin në gjuhën ruse, që për shqiptarët ishte krejtësisht e panjohur. Grupet e tjera përbëheshin nga sllavë, bullgarë, serbë e çekë, pjesa më e madhe e të cilëve e njihnin ose e kuptonin gjuhën ruse, pasi një pjesë e tyre kishin mbaruar kurse e shkolla ushtarake në ish-Bashkimin Sovjetik. Pothuajse të gjithë kishin mbaruar shkolla ushtarake, disa edhe akademitë ushtarake të vendeve të tyre, si në rastin e studentëve nga Çekia, kurse oficerët shqiptarë vinin në akademi vetëm me eksperiencën e Luftës Nacionalçlirimtare.

Studimet i filluan pak ditë pas mbërritjes në qytetin e Moskës. Mësimet zhvilloheshin në rusisht dhe nuk u mundësua asnjë kurs parapërgatitor mbi gjuhën ruse apo mbi njohuritë fillestare ushtarake të programit mësimor, por krahas studimeve ushtarake duhet të ndiqnin edhe kursin e gjuhës ruse.

Mësimet i zhvillonin në fakultetin për të huajt, pranë Akademisë, pasi nuk i kishin bashkuar me oficerët sovjetikë. Me ta takoheshin vetëm në takimet ku mbaheshin referate nga personalitete të historisë, kulturës e shkencës ose në raste ceremonish të ndryshme.

## Nga lufta, direkt në akademinë ruse Takimi me Kutuzovin

Pas dy javësh studime, oficerët shqiptarë i priti Shefi i Fakultetit të të Huajve, Gjeneral-Lejtnant Kutuzovi. Ai pyeti mbi përgatitjen e tyre ushtarake dhe mbi detyrat që kishin patur. Kur mësoi se ata nuk kishin mbaruar shkolla ushtarake, por kishin vetëm eksperiencën e komandimit e drejtimit të luftës, tha prerazi se do ta kishin shumë të vështirë të përfundonim studimet në atë akademi. Ai pyeti nëse për këtë ishte në dijeni Gjeneral Mehmet Shehu, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, që megjithëse studioi atje vetëm për një vit, mbase u kishte treguar se sa të vështirë e kishin shqiptarët përfundimin e akademisë.

Vetëm kolonel Hamit Keçi që kishte mbaruar shkollë ushtarake në Itali, u dallua në mësimet dhe mbaroi me rezultate të larta. “Ju duhet ta dini, - u tha Kutuzov të sapombërriturve, - se këtu në Akademinë e Lartë të Ushtrisë Sovjetike, oficerët tanë vijnë për të studiuar pasi kanë mbaruar shkollat ushtarake për oficerë, pasi kanë komanduar reparte nga toga deri nënkomandant regjimenti, pasi kanë mbaruar studimet në Akademinë Frunze, ose në akademitë e llojeve të armëve si artileri, tanke, aviacion, xhenjo, etj. Pastaj kanë komanduar divizione e njësi të barabarta me to dhe me këtë bagazh përgatitjeje dhe eksperience janë dërguar në këtë akademi, kurse ju vini këtu pa përfunduar më parë asnjë shkollë ushtarake”. Në fund theksoi se do t’i shkruante komandës shqiptare që t’i dërgonin në Akademinë Frunze, megjithëse mendonte se edhe atje ata do ta kishin shumë të vështirë.

Drejtuesi i grupit shqiptar, Gjenerali Jairov, ndërhyri duke thënë: “Shoku Gjeneral, këta janë të rinj dhe me shumë vullnet. Kam bindjen se do t’ia dalin ta mbarojnë akademinë. Mos nxitoni ta bëni propozimin”.

Nga takimi me Gjeneral Kutuzovin, Parllakut i kujtohet se dolën tepër të zhgënjyer: “Arif Hasko i futi një të sharë

labçe dhe pastaj shtoi: na e prishi gjakun. Nuk e di a na e hap derën piloti se është më mirë të hidhemi nga avioni, se sa të kthehemi të turpëruar, se nuk ishim të zotët të përfundonim akademinë”.

Megjithë ndikimin e zhgënjimit të madh nga takimi me Gjeneral Kutuzovin, të ndihmuar e të inkujaruar nga pedagogët, ata iu futën me vullnet e durim punës për të përballuar vështirësitë e shumta të fillimit. Këmbëngulja në studime u krijoi besim në forcat e tyre dhe u dha siguri.

Në këtë valë studimesh që i kishte përfshirë në vorbullën e saj, nëpërmjet komunikatës dhe vendimeve të Inform Byrosë të Partive Komuniste mësuan mbi prishjen e marrëdhënieve sovjeto-jugosllave.

Shqetësimi qëndronte në faktin se nuk dinin mbi qëndrimin e Partisë Komuniste Shqiptare dhe të Hoxhës, pasi ajo nuk ishte thirrur në mbledhjen e Inform-Byrosë, ndërsa oficerët jugosllavë të fakultetit kishin hapur fjalë se Partia Komuniste Shqiptare ishte mbështetëse e Partisë Komuniste Jugosllave.

### **Parllaku, student në akademi si dhe atashe ushtarak i Shqipërisë**

Të nesërmen erdhi ta takonte Parllakun në fakultet, zëvendësi për punë politike i komandantit të akademisë, i cili kërkonte të mësonte nga Rrahmani, si anëtar i Komitetit Qendror të Partisë dhe si Atashe Ushtarak, mbi qëndrimin e PKSH-së. Në takim, Rrahmani shkoi bashkë me Arif Haskon dhe me Panajot Plakun. I tha hapur se deri atëherë nuk kishin asnjë informacion as ai dhe as ambasadori, pasi lidhjet me Tiranën i mbanin nëpërmjet Beogradit dhe nuk mund të informoheshin direkt, por përgjigja ishte se sido që të ishin marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë, ata ishin të bindur se PKSH do të mbështeste Inform-Byronë, ku bënte pjesë edhe Partia Komuniste Sovjetike.

Mihal Prifti, në atë kohë ambasador në Moskë, i ftoi menjëherë në ambasadë për t'u konsultuar me Rrahmanin, Arifin e Panajotin, pasi të tre ishin kuadro të larta nga Shqipëria që ndodheshin në Moskë.

Mihali ndodhej në vështirësi. Telefonatat nga kolegët nuk pushonin. Gazetarët qëndronin te dera dhe donin të mësonin me çdo kusht qëndrimin e PKS-së. Vendosën të shmangnin çdo komunikim me shtypin, deri në marrjen e informacioneve të sakta.

Pas dy ditësh tensioni, Radio "Moska" e hapi edicionin kryesor të lajmeve të mbrëmjes me komunikatën e Partisë Komuniste Shqiptare që jo vetëm bashkohej me vendimet e Inform-Byrosë, por edhe shpërthente në akuza të ashpra ndaj Partisë Komuniste Jugosllave.

Oficerët jugosllavë që studionin me oficerët shqiptarë u ngritën në grup, u larguan nga salla dhe pas disa ditësh i ndërprejnë studimet për t'u kthyer në Jugosllavi.

Pas vendimit të PKS për t'iu bashkuar Inform-Byrosë, ata iu kthyen me përkushtim e këmbëngulje studimeve.

Duke parë përpjekjet e tyre të vullnetshme, pedagogët nuk e kursenin ndihmën e tyre.

Gjeneral Jairovi, drejtuesi sovjetik i grupit shprehej i gatshëm t'i ndihmonte me konsultime edhe gjatë natës. Shqiptarëve iu bë edhe një favor i veçantë që i ndihmoi shumë. Jashtë çdo rregulli u lejua që literaturën dhe dokumentat sekrete t'i përdornin edhe natën. Sipas rregullit, kutia me dokumente merrej në mëngjes me firmë dhe pas përfundimit të studimeve, në orën 21.00, dorëzohej në sekretarinë sekrete ku dokumentet numëroheshin fletë më fletë sipas listës së tërheqjes, por drejtuesi i grupit, i bindur në ndershmërinë e tyre, e kishte siguruar komandën se shqiptarët dinin ta ruanin sekretin. Sjellja prindërore e pedagogëve dhe kujdesi për t'i përgatitur pa bërë lëshime në kërkesa, ua shtonte përgjegjësitë. Ata ua kujtonin shpesh faktin se për gjithçka po mësonin, do të përgjigjeshin përpara Komisionit të Lartë të Ministrisë dhe

provimi do të ishte provim edhe për ta, pasi vlerësohej edhe merita përgatitore e punës së tyre. Kjo ua shtonte detyrimin ndaj punës së tyre studimore.

Studionin me të gjitha forcat. Vështirësi më të mëdha kishte Parllaku, sepse nuk kishte mbaruar shkollë të mesme të rregullt. Gjashtë muajt e parë, nga lodhja e pagjumësia humbi 18 kg. Mësonte gjatë gjithë natës duke fjetur vetëm pak orë gjumë, edhe ato me qetësues.

Falë kujtesës së veçantë, vullnetit e këmbënguljes mundi iu shpërblye me vlerësimet e pedagogëve dhe rezultatet e larta të provimeve.

### **Kongresi i I, përjashtimi i Parllakut nga KQ i PKSH**

Gjatë kohës që ata studionin në akademi, në Shqipëri, pas shkëputjes nga Jugosllavia, kishte filluar një luftë brenda partisë, për të cilën ata nuk kishim informacion dhe nuk e dinim si zhvilloheshin ngjarjet në parti dhe çfarë kishte vendosur mbledhja e Pleniumit të XI-të të Komitetit Qendror të Partisë.

Lufta bëhej mes atyre që ishin pro jugosllavëve dhe antijugosllavëve. Flamurin e antijugosllavëve e kishte rrëmbyer Enver Hoxha, që kishte qenë më pro jugosllavi nga të gjithë. Ai që kishte bërë marrëveshje me Titon dhe po e çonte ushtrinë dhe gjithë vendin tonë drejt bashkimit me Jugosllavinë, për ta kthyer Shqipërinë në republikë të shtatë të Federatës Jugosllave. Por në atë kohë gjithçka mbahej në fshehtësi dhe askush nuk e dinte si manipuloheshin dokumentat nga Hoxha.

Tre ushtarakët e lartë shqiptarë, njëkohësisht edhe kuadro partie, u thirrën nga Moska për të marrë pjesë në punimet e Kongresit të I-rë të Partisë.

Në takimin e parë me Mehmet Shehun, ai i vuri në dijeni se me anë të një letre, Gjeneral Kutuzovi i kishte kërkuar



largimin nga akademia të tre oficerëve shqiptarë, përkatësisht Parllakut, Haskos dhe Plakut.

Gjeneral Shehu i ishte përgjigjur se ata ishin krijuesit dhe komanduesit më të mirë të ushtrisë në luftë dhe se detyra e tyre (sovjetikëve) ishte t'i përgatisnin për ta komanduar ushtrinë edhe në të ardhmen.

Në Kongres, në emër të Byrosë Politike, u pritën mjaft mirë nga Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu, veçanërisht Parllakut iu rezervua një pritje e ngrohtë dhe u zgjodh në presidiumin që do të drejtonte punimet e Kongresit të Partisë. Ai ishte në listën që përfaqësia do t'i propozonte kongresit për zgjedhjet anëtar ose kandidat të Komitetit Qendror të Partisë.

Në raportin paraqitur Kongresit mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë u theksua përgjegjësia e anëtarëve të plenumit për gjendjen në parti dhe pati kritika si dhe propozime për masa ndëshkimore ndaj një pjese të anëtarëve të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike, që u akuzuan si të lidhur me jugosllavët.

Për Parllakun nuk pati në raport asnjë kritikë apo vërejtje, por kur filluan pyetjet e diskutimet, delegatët që mund të përfitonin nga situata e krijuar, kërkuan që të jepte sqarime dhe të bënte autokritikë, pasi kishte qenë anëtar i Komitetit Qendror dhe për disa muaj Drejtor Politik i Ushtrisë. Gjithashtu i kërkuan të fliste për lidhjet e tij me Koçi Xoxen.

Në diskutimin e tij, Rrahmani u detyrua të sqaronte se në luftë kishte marrë pjesë që në Vlorë, pa mbështetjen e askujt, se ishte ngritur në përgjegjësi në bazë të vlerësimit që i kishte bërë partia luftës dhe punës së tij, se në parti ishte pranuar në janar të 1943. Ai deklaroi se Koçi Xoxen e kishte njohur pasi ishte kthyer nga lufta në Jugosllavi në vitin 1945, se ishte zgjedhur në Komitetin Qendror të Partisë që në mbledhjen e plenumit, në tetor 1944 në Berat, kur po drejtonte luftimet për çlirimin e Kosovës, dhe se megjithëse kishte komanduar Divizionin V në luftimet e Sanxhakut dhe Bosnjës, asnjëherë nuk kishte qenë i preferuari i jugosllavëve.

Në të tre rastet e përplasjes me jugosllavët nga Gjeneral Mehmeti, ai kishte qenë në krahun e tij.

Qëndrimi i tij në kongres dhe mospranimi i kritikave çoi në heqjen e tij nga lista e të zgjedhurve në Komitetin Qendror. Kjo ishte një goditje e rëndë morale, por që nuk e vuri në pozitë inferiore. E ndjente veten me fat që nuk e penguan të vazhdonte studimet në Bashkimin Sovjetik.

### **Rezultate të larta në Akademinë “Voroshillov”**

Rezultatet e arritura në përfundim të studimeve akademike i shpërblyen përpjekjet e mundimet, netët pa gjumë dhe qëndrimin e gjatë mbi libra e mbi harta.

Pas disa ditësh që u kthyen nga Shqipëria në akademi, dhanë 6 provimet e para mbi të dhënat taktiko-teknike dhe drejtimin në luftë të llojeve të armëve, artilerisë, tankeve, aviacionit, xhenjos, të ndërlydhjes dhe kimisë.

Rezultatet ishin të paparashikueshme si për oficerët shqiptarë ashtu edhe për pedagogët. Shkëlqyeshëm dhe mirë. Përkatësisht, Panajoti të gjitha pesa. Rrahmani katër pesa e dy katra, Arifi tri pesa e tri katra, duke zënë kështu vendet e para mes grupeve të të huajve që studionin në fakultet.

Të nesërmen e mbarimit të provimeve i priti Shefi i Fakultetit, Gjeneral Kutuzovi, që në prani të Jairovit, drejtuesit të grupit, i përgëzoi për rezultatet duke u shprehur: “Lavdi Zotit që gabova unë dhe jo Gjenerali i nderuar Jairov. Tani kam bindjen e plotë se ju do ta mbaroni me sukses akademinë”.

Autokritika e tij ishte inkurajuese për Parllakun dhe oficerët shqiptarë dhe i ndihmoi të vazhdonin me këmbëngulje punën për ta përfunduar me sukses akademinë dhe për t’u kthyer në atdhe të gatshëm për kryerjen e detyrave të reja.

Jeta në akademi ndiqte rrjedhën e jetës të çdo studenti, me gjithë veçantitë e saj, por ata nuk shkonin atje nga bangat e shkollës së mesme. Ata shkonin në akademi pas një shkëputje

30-vjeçare, i ktheheshin përsëri studimit, pasi kishin patur detyra të larta shtetërore. Nuk e kishin patur jetën të lehtë, por duke luftuar e sakrifikuar, kishin arritur deri aty. Ishin djem me stimë për veten, të etur për dije të mëtejshme. Çdo detyrë e merrnin me përgjegjësi të lartë, me objektiv arritjen e suksesit. Kishin lënë pas familjet dhe për fat të keq për tre vjet nuk mundën të vinin pranë tyre.

Ata ishim tre shokë pune, kolegë e bashkëluftëtarë, që jo vetëm shkonin shumë mirë me njëri-tjetrin, por edhe e nxisnin shoku-shokun për të mësuar sa më shumë, me qëllim që të dilnin më të mirët mes grupeve të të huajve që studionin në akademi.

### **Drejtor i Drejtorisë të Organizim-Mobilizimit pranë Shtabit të Përgjithshëm**

Pas dy javë pushimesh u komunikuan detyrat e reja. Parllaku u emërua Drejtor i Drejtorisë të Organizim-Mobilizimit pranë Shtabit të Përgjithshëm.

Mjedisi ku do të punonte ishte i njohur për të, por me sektorin e punës dhe njerëzit me të cilët do t'i duhej të punonte takohej për herë të parë. Zv/drejtor do të kishte Et'hem Barhanin, oficer karriere, burrë i pjekur, pjesëmarrës në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe që kishte eksperiencë pune në sektorin e organizim-mobilizimit. Oficerët e tjerë ishin të gjithë të rinj dhe disa prej tyre ishin shkolluar në shkollat ushtarake të ish-Bashkimit Sovjetik.

Në Drejtorinë e Organizim-Mobilizimit, përveç organikës së personelit, ishte caktuar të punonte me dokumentet sekrete të mobilizimit edhe nga një oficer nga çdo komandë e drejtori që do të mbulonte llojet e armëve dhe të shërbimeve.

Parllaku kishte si këshilltar ushtarak sovjetik Kolonel Pindurinin, që e kishte drejtuar për 30 vjet këtë sektor, i cili zotëronte njohuri të thella dhe kishte eksperiencë të gjatë

pune. Me ndihmën e tij të gjithanshme, Parllaku mundi ta përvetësojë shumë shpejt specifikën e punës. Ai ndihmoi që puna të kryhej mbi baza ligjore, gjë që kishte munguar më parë. Meqenëse puna e drejtorisë shtrihej edhe jashtë forcave të armatosura, duhet të mbanim evidenca për të gjithë qytetarët e vendit nga 18 deri në 45 vjeç, për ekonominë e vendit, për rezervat e shtetit që bënin sigurimin e ushtrisë në kohë lufte dhe për ekonominë e popullit, kryesisht për mjete motorrike të transportit, për kuajt, mushkat dhe qerret, si mjetet kryesore të transportit në ushtrinë e asaj kohe.

Drejtorja duhet të raportonte rregullisht para Kryeministrit për gatishmërinë e mobilizimit të të gjitha resurseve njerëzore, materiale, të transportit, etj. Gjatë raportit ishin të pranishëm Kryetari i Komisionit të Planit të Shtetit, ministrat e Transportit dhe të Tregëtisë ose zëvendësat e tyre. Me prezencën e tyre, Kryeministri fitonte sigurinë se rezervat për kohë lufte ishin të paprekura.

### **Prova e kushtrimit e Brigadës së Elbasanit**

Në vitin 1952, për të vënë në provë gatishmërinë dhe aftësinë për mobilizim në drejtori dhe në degët vartëse në rrethe, si edhe në organet shtetërore që siguronin materialet teknike të mobilizimit, Kryeministri urdhëroi që brenda 24 orëve të mobilizohej, të organizohej dhe të vihej në gatishmëri luftarake brigada e caktuar për kompletim në Qarkun e Elbasanit, me vendqëndrim Labinotin e Poshtëm.

Për të ndihmuar në plotësimin e detyrës, ai kishte urdhëruar ministrat që kishin detyra për sigurimin materialo-teknik, të kishin pranë Parllakut përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu kishte urdhëruar Kryetarin e Qarkut të Elbasanit të ndihmonte me organet lokale për grumbullimin e njerëzve dhe kafshëve pranë qendrave të mobilizimit, kurse Shefin e Punëve të Brendshme e kishte porositur të siguronte rendin dhe kufirin.

Me të marrë sinjalin nga Shtabi i Përgjithshëm, Parllaku hapi zarfin e koduar dhe i dha alarmin Degës Ushtarake të Qarkut të Elbasanit. Gjithçka u vu në veprim të menjëhershëm. Me grupin e drejtimit u nisën me shpejtësi për në vendin e caktuar të dislokimit të Brigadës. Pas 3 orësh mori drejtimin e veprimeve në Labinotin e Poshtëm, Elbasan. Për të ndjekur e kontrolluar veprimet erdhi në rajonin e hapjes e kompletimit të brigadës Kryeministri, i shoqëruar nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe grupi i drejtimit.

Brigada u vu në gatishmëri brenda kohës së planifikuar dhe menjëherë u nis në marshim sipas detyrës që i ngarkoi Kryeministri drejt Labinotit Mal-Fushë Prizë. Kryeministri e ndoqi vetë marshimin e kombinuar me veprime të imituara luftimi deri në plotësimin e detyrës. Ai mbeti tepër i kënaqur dhe në fund falenderoi kolektivin e drejtorisë dhe të degëve ushtarake.

### **Gradimi Gjeneral dhe emërimi Zv/Ministër i Mbrojtjes dhe Drejtor i Përgjithshëm i Prapavijave të Ushtrisë**

Puna e Kolonel Rrahman Parllakut gjatë shërbimit në këtë drejtori u vlerësua mjaft mirë nga Komanda dhe nga Shtabi i Përgjithshëm.

Në bazë të këtyre vlerësimeve, ai ishte në mes të gjashtë gjeneralëve të graduar në 10 korrik 1952, si Petrit Dume, Sadik Bekteshi, Panajot Plaku nga Ministria e Mbrojtjes dhe Kadri Hazbiu e Mihallaq Ziçishti nga Ministria e Brendshme.

Pas disa muajsh, Parllaku u ngrit në përgjegjësi duke u emëruar Zv/Ministër dhe Drejtor i Përgjithshëm i Prapavijave të Ushtrisë.

Kur i komunikoi detyrën e re, Ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku, i tha: “Në këtë detyrë duhet ta ngresh zërin dhe të tregohesh më i rreptë, pasi ke shumë sektorë në varësi që kanë lidhje me sigurimin e jetës dhe të veprimtarisë të efektivave të ushtrisë”.

Parllaku u përgjigj: “ Nuk mund ta ndërroj karakterin sa herë të ndërroj detyrën, por të keni besim se pa bërtitur do ta plotësoj detyrën”.

Ishte i ri në moshë, plot energji, nuk i trembej punës sado e vështirë të ishte. Eksperienca nuk i mungonte, pasi që gjatë moshës së rinisë, në luftë dhe më pas, kishte komanduar e drejtuar sektorë të rëndësishëm të instancave të larta të ushtrisë edhe kur i mungonte shkolla e nevojshme.

Tashmë, përveç eksperiencës në punë, kishte edhe njohuritë e plota ushtarake për të gjitha llojet e armëve e të shërbimeve. Drejtoria do të përfshinte në përbërjen e saj shumë sektorë e degë të rëndësishme si intendencën, që i siguronte ushtrisë ushqimin, veshmbathjen, karburantin, strehimin; degën e financës, që me buxhetin tepër të kufizuar duhet të plotësojë të gjithë sektorët e ushtrisë; degën e transportit me mjete motorrike të kufizuara, që për lëvizjen e armatimit të rëndë e furnizimin brenda repartit mbështetej në kuaj e në mushka; degën e ndërtimeve ushtarake, që duhet të riparonte kazermat e djegura e të shkatërruara nga lufta dhe të ndërtonte kazerma të reja për strehimin e një efektiv prej mbi 40.000 vetësh. Gjithashtu, duhet të ndërtonte banesa për familjet e oficerëve e nënoficerëve; degën e shëndetësisë me personel mjekësor mjaft të kufizuar, që duhet t'i shërbente një ushtrie të madhe e të shpërndarë në të gjithë vendin; degën e shërbimit veterinar, edhe pse me personel të kufizuar, që duhet të siguronte shërbimin e mijëra kafshëve, që atëherë përbënin mjetin kryesor të transportit në ushtri.

Edhe në drejtimin e kësaj drejtorie me shumë probleme e nisi punën me optimizëm, sepse në shtabin që drejtonte gjeti një kolektiv të përgatitur profesionalisht, me kulturë të lartë dhe të përkushtuar në detyrë.

Megjithëse në akademi nuk ishte diplomuar për drejtimin e prapavijave, gjeti gjuhën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit me stafin drejtues. Asnjëherë nuk merrte vendime pa dëgjuar më parë mendimin e shefit të sektorit përkatës. Shefave të

sektorëve u kishte lënë iniciativë të lirë veprimi. Ata zbatonin me shumë korrektësi urdhërat dhe detyrat që iu ngarkonte Gjeneral Rrahman Parllaku. Krijuan marrëdhënie të ndërsjellta mirëkuptimi dhe harmoni në kryerjen e detyrave.

Këtë qëndrim ia diktonte fakti se komandonte kuadro të përgatitura në universitete e akademi ushtarake, specialistë të lartë të sektorëve që drejtonin e që më pas do të bëheshin gjeneralë e kolegë të tij si: Nuri Arapi e Tanush Shyti si dhe dy prej tyre ministra të njohur si Aleks Verli, Ministër i Financave dhe Ibrahim Dervishi, Ministër i Shëndetësisë.

### **Zv/Ministër i Mbrojtjes për përgatitjen luftarake të Forcave të Armatosura**

Pas dy vitesh pune në prapavijat e ushtrisë, u largua nga kjo detyrë i vlerësuar për rezultatet e arritura jo vetëm nga Ministria e Mbrojtjes, por edhe nga qeveria. U emërua në detyrën e zv/ministrit për të drejtuar përgatitjen luftarake të forcave të armatosura.

Vinte në këtë detyrë kur ushtria kishte hyrë në fazën e modernizimit në të gjithë përbërësit e përgatitjes dhe të gatishmërisë luftarake. Duhet të drejtonte me aftësi përgatitjen luftarake që ajo të ngrihej në stad më të lartë, për ta bërë ushtrinë tonë të krahasueshme me ushtritë e vendeve më të përparuara të Europës.

Kishte mbaruar Akademinë e Lartë Ushtarake më me emër të ish- Bashkimit Sovjetik. Ishte gati të përgatiste e të drejtonte stërvitje taktiko-operative të shtabeve, divizion e armatë, si edhe stërvitjet me trupa të këtyre njësive, por nuk ishte përgatitur të drejtonte stërvitje luftarake të efektivave, nuk njihje stërvitjen fillestare bazë, përgatitjen vetmore të ushtarit, të nënoficerit, të skuadrës, të togës e të kompanisë, që janë themelore në përgatitjen e efektivave për luftë.

Eksperienca e luftës tani nuk e ndihmonte më. Me vullnet

të hekurt dhe me durim e këmbëngulje, me shembull vetjak, me ndihma dhe kontrole e procese të gjata stërvitjeje, Parllaku u bë edhe mjeshtër i stërvitjes së vogël.

Koha prej 8 vitesh në detyrën e Drejtorit të Stërvitjes, Zv/ Ministrit për Përgatitjen Luftarake të Ushtrisë, i dha mundësinë Parllakut të bëhet njohës i tërë procesit të përgatitjes luftarake nga veprimtaria e ushtarit tek ajo e nënoficerit e në vazhdim, e të gjithë llojeve të armëve dhe shërbimeve të Forcave të Armatosura Shqiptare.



## Në Traktatin e Varshavës

Me krijimin e Traktatit Ushtarak të Varshavës, në 14 Maj 1955, ushtria shqiptare u bë pjesë e Traktatit bashkë me 8 shtetet themeluese të tij.

Në Traktat bënë pjesë ushtritë europiane të bllokut socialist: Bashkimi Sovjetik, Polonia, Çekosllovakia, Hungaria, Bullgaria, Rumania, Gjermania dhe Shqipëria.

Qëllimi i krijimit të këtij traktati, siç thuhej në dokumentin themelues të tij, ishte të ruhej pavarësia e të gjitha shteteve socialiste veç e veç dhe të kampit socialist në tërësi kundër agresionit imperialist dhe bllokut agresiv të NATO-s, si dhe mosndërhyrjes në punët e tyre të brendshme.

Mosndërhyrja në punët e brendshme nuk u respektua asnjëherë. Këtë e tregoi ndërhyrja e ushtrisë sovjetike për të shtypur revoltat popullore në Hungari e Çekoslllovakia dhe për të mbajtur Bazën Ushtarake të Pashalimanit në Vlorë, duke rrëmbyer anijet luftarake shqiptare.

Shtabi i Traktatit merrej me përgatitjen luftarake të ushtrive pjesëmarrëse, me pajisjen me armatime e teknike luftarake, me mbajtjen në gatishmëri, sidomos të efektivave që përfshiheshin nën Komandën e Traktatit.

Ky shtab jepte udhëzime të përgjithshme për programet e përgatitjes e gatishmërisë luftarake.

Çdo ushtri planizonte e programonte detyrat sipas kushteve të ushtrisë së vet.

Këto plane e programe i dërgoheshin Komandës së Përgjithshme që Shtabi i Traktatit të koordinonte veprimet e

kontrollit e të pjesëmarrjes në stërviçet komando-shtabi e me trupa të çdo ushtrie, u rekomandonte shtabeve të ushtrive se në cilat stërviçe me interes të ushtrive aleate, ku do të merrnin pjesë përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm të dërgonin delegacionet e tyre. Gjithashtu, planizonte mbledhjet vjetore të Shtabit të Përgjithshëm me të gjithë përfaqësuesit e shtabeve të ushtrive të Traktatit, ku analizohej gjendja vjetore e përgatitjes luftarake të çdo ushtrie, promovoheshin armatime të reja në ekspertim, bëheshin kërkesa e propozime nga shtabet e ushtrive për pajisje teknike e armatim, bëheshin vërejtje, vlerësime e propozime të ndryshme.

Këto ishin si mbledhje pune ku këmbëheshin mendime dhe bëheshin propozime e vlerësime.

Parllaku, si drejtues për shumë vite i përgatitjes luftarake të ushtrisë, ka qenë pjesëmarrës dhe drejtues delegacionesh jo vetëm në mbledhjet e analizat që bënte Komanda e Traktatit mbi gjendjen e gatishmërisë luftarake të ushtrive pjesëmarrëse në Traktat, por edhe në disa raste, një ose dy herë në vit, ka marrë pjesë në stërviçet që zhvillonte ushtria sovjetike dhe ushtritë e tjera të Traktatit, ka pritur e u ka demonstruar stërviçe komando-shtabi dhe me efektiva, përfaqësuesve të ekipeve të Komandës të Traktatit dhe të përfaqësuesve të ushtrive mike.

Gjithashtu, ai ka patur kënaqësinë që bashkë me kolegët e tij të dëgjoj vlerësimet që i bëheshin ushtrisë sonë nga Komanda e Traktatit që në mjaft raste e vinin atë të parën, nisur nga stërviçet e zhvilluara prej nesh në prezencë të tyre.

Ushtria jonë në atë kohë radhitej me dinjitet mes ushtrive më të përparuara të Traktatit të Varshavës dhe Parllaku, duke shërbyer për 8 vjet rresht në drejtim të përgatitjes luftarake të ushtrisë, ishte njohur me specifikën e përgatitjes të të gjitha llojeve të armëve, përfshirë edhe aviacionin dhe flotën ushtarako-detare.

Kjo eksperiencë e vyer e aftësoi në drejtimin e stërviçejeve me komandat e shtabeve e njëjësive, si edhe në drejtimin e

stërvitjeve me trupa, ku merrnin pjesë me dhjetëra mijëra vetë e ku përdorej armatimi e teknika luftarake e të gjitha llojeve të armëve e të shërbimeve.

Pas kësaj eksperience të gjatë dhe bashkëpunimi edhe me ushtritë mike dhe aleate, Parllaku emërohet Komandant i Forcave Ushtarake-Detare, njësia më e madhe e ushtrisë sonë, që kishte në vartësi 5 brigada këmbësorie, 2 brigada tankiste, flotën ushtarake-detare, artilerinë bregdetare, reparte të mbrojtjes kundërajrore, reparte shërbimi e të tjera.

### **Skandali që u krijua me ushtarakët e Traktatit ku i prishën drekën marshallit Malinovski**

Ishte nëntor i vitit 1960. Në Moskë, si çdo vit, do të bëhej mbledhja vjetore e radhës e shtabeve të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës e drejtuar nga Komanda e Përgjithshme e këtij koalicioni me qendër në Moskë. Shkuarja e delegacionit tonë në atë vit ndryshonte nga takimet e tjera. Ky takim që po ndërmerrej nga gjeneralët shqiptarë me Moskën zyrtare ishte fill pas takimit të Bukureshtit, ku në mënyrën më të paprecedentë u sulmua delegacioni kinez nga Bashkimi Sovjetik dhe më pas nga shumë vende të tjera.

Kina u sulmua për mënyrën e ndërtimit të shtetit komunist, për politikat e jashtme që ndiqte, të cilat binin ndesh me interesat e koalicionit të madh komunist, pasi kishte vendosur marrëdhënie me Perëndimin sidomos me Amerikën.

Atje, në mënyrë të veçantë, ka dalluar qëndrimi i delegacionit tonë që doli kundër jo vetëm delegacioneve të shumë shteteve, por edhe kundër Bashkimit të madh Sovjetik, duke ndërmarrë riskun e avokatit mbrojtës për delegacionin kinez.

Veprimi i delegacionit shqiptar dihet që ishte shumë befases dhe s'kishte si të mos ngjallte habi kur ne ishim mbështetur për të gjithë ekonominë tonë tërësisht te Bashkimi

Sovjetik. Ky veprim nuk u prit mirë jo vetëm nga udhëheqja e lartë sovjetike, por ai u kritikua direkt nga Hrushovi, aq sa nuk vihej në dyshim se po paralajmërohej një furtunë shumë e madhe në lidhje me marrëdhëniet midis dy vendeve.

Tashmë që shqiptarët shkonin në mbledhjen vjetore të radhës të Traktatit të Varshavës dihej që i priste një situatë jo e këndshme, pasi kryesinë e asaj aleance ushtarake e kishte Bashkimi Sovjetik dhe qendra e saj ishte pikërisht në Moskë. Megjithatë nuk e kishin menduar se mund të arrinte puna deri në atë pikë të tillë siç paraqitej në ato momente.

Delegacioni shqiptar përbëhej nga gjeneralët më të rëndësishëm të ushtrisë shqiptare. Të pranishëm ishin Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe Zëvendësministër i Mbrojtjes, Gjeneral Petrit Dume, Zëvendësministri i Mbrojtjes, Gjeneral Rrahman Parllaku, Drejtori i Drejtorisë Operative të Ushtrisë, Gjeneral Vaskë Gjino dhe Komandanti i Mbrojtjes Kundërajrore të Republikës, Arif Hasko, si dhe Komandanti i Flotës Detare të Republikës, Avdi Mati.

I pritën në aeroportin modern të Moskës, i vendosën në një hotel shumëkatësh luksoz me emrin “Ukrahina”, i cili ndodhej pikërisht në qendër të Moskës. Në atë hotel u vendosën të gjitha delegacionet e vendeve të tjera pjesëmarrëse në mbledhje. Në hotel mësuan se para tyre kishin mbërritur të gjitha delegacionet e vendeve të tjera anëtare të Traktatit, si: Gjermania Lindore, Polonia, Çekia, Hungaria, Bullgaria dhe Rumania.

Pritja e delegacionit shqiptar u bë sipas rregullave të Traktatit të Varshavës. Avioni TU-14, pasi kishte bërë shumë orë fluturime, zbriti në aeroportin “Vnukov” të Moskës. Atje, përveç këshilltarëve sovjetikë që vendoseshin sipas protokollit pranë delegacionit shqiptar, çuditërisht i priste edhe vetë zëvendëskomandanti i Traktatit të Varshavës si dhe një kolonel, i cili ishte oficer shoqërimi për delegacionin.

Për momentin nuk kishin takime zyrtare, por u takuan të gjithë me njëri-tjetrin pasi njiheshin prej kohësh. Me shumicën e tyre njiheshin pasi ishin ndeshur pothuajse në të gjitha

mbledhjet e radhës që zhvillonte Traktati i Varshavës, por edhe pse kishin studiuar së bashku në akademitë ushtarake.

Pas asaj që ndodhi në Bukuresht, ku delegacioni shqiptar doli hapur kundër nismës së Hrushovit për të demaskuar Kinën, kishte patur disa fërkime duke përfshirë dhe provokime, dhe kjo kishte ndodhur me përfaqësuesin tonë të përhershëm në Traktat, Gjeneralin Halim Ramohito, pikërisht menjëherë pas takimit të Bukureshtit.

Delegacionit ushtarak shqiptar prej katër ditësh nuk i rezervohej fjala dhe nuk përfillej. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Petrit Dume, e kishte humbur durimin dhe mezi po priste sa të merrte fjalën që po i pritej në mënyrën më të padrejtë. Ministri sovjetik i Mbrojtjes vazhdonte të fliste e të fliste duke kaluar sa në një temë në tjetrën.

Marshalli sovjetik kishte ngelur në këmbë pothuajse i hutuar në momentin kur i preu fjalën Petrit Dumja. Ishte shtangur dhe zverdhur i tëri pa ditur si të vepronte, pasi nuk kishte asnjë rrugëzgjidhje sepse sa mbaroi Petriti, ngrinte zërin Parllaku nga tavolina tjetër, ndërkohë ishin çuar dy gjeneralët e tjerë Vaskë Gjino dhe Arif Hasko, të cilët të irrituar nga sa kishte ndodhur në ato katër ditë dhe nga sa dëgjuan në atë sallë, kishin mbetur ndoshta më të fyer se të tjerët. Edhe ata bërtisnin me sa kishin në kokë, duke i treguar gishtat dhe duart marshallit të lartë sovjetik që nuk guxonte të mblidhte veten.

Delegacioni shqiptar dhe vetë Shefi i Shtatmadhorisë, Petrit Dume, shpërtheu në revoltë aq sa prishi gjithë drekën dhe shokoi jo vetëm kreun e ushtrisë sovjetike, por edhe të gjitha delegacionet pjesëmarrëse

Do të vinte një moment dhe marshalli sovjetik do të shprehej hapur para të gjithëve se shqiptarët e kishin gojën me piper dhe nuk shfaqnin gjë tjetër veçse harbutëri.

Zhurme dhe klithma të papërballueshme të Gjeneralit Petrit Dume dhe të shokëve që e pasonin në një drekë me gjeneralët më të shquar të vendeve të Traktatit të Varshavës në Moskë.

Protesta shqiptare në atë sallë arriti në atë pikë, sa që gjeneralët kryesorë të ushtrive të disa vendeve të dilnin nga salla të habitur me kurajon shqiptare përballë Marshallit sovjetik Malinovski, i cili mbante në atë kohë dhe postin e Ministrit të Mbrojtjes të Bashkimit Sovjetik, si dhe Komandantit të Traktatit të Varshavës, Greçko.

Marshalli dhe Gjenerali sovjetik, në një gjendje tmerrësisht të rënduar psikologjike, kërkonin me këmbëngulje të uleshin tensionet dhe të sqaroheshin problemi me shqiptarët që po prishnin takimin më të rëndësishëm të vitit midis autoriteteve më të larta ushtarake të shumë vendeve.

### **Gjeneral Rrahman Parllaku, Zv/Ministër i Mbrojtjes, dëshmitar okular i asaj ngjarje, rrëfen:**

“Pas kësaj dolën të gjitha delegacionet e tjera pasi nuk kishte më kuptim dreka. Të fundit mbetën Marshalli Malinovski dhe Gjenerali Greçko, të cilët nga kjo që u ndodhi ndiheshin shumë të pafuqishëm dhe tepër të menduar.

Shkuam menjëherë në hotel dhe në moment u shoqëruam edhe nga delegacionet e tjera, të cilat po arrinin një e nga një atje, duke kërkuar që të sqaroheshin se si ishte puna, pasi u mungonte informacioni i saktë.

Neve, kur nuk kishim asnjë gjysmë ore që kishim shkuar në hotel, na vjen njoftimi se të nesërmen na priste në takim vetë ministri Malinovski.

“Absolutisht jo, - u përgjigj Petrit Dume. Kërkuam katër ditë takim, të na kishte pritur. Ne përfaqësojmë ushtrinë e një populli që nuk e meriton të nëpërkëmbet”.

Dy orë më pas u përsërit në mënyrë ngulmuese kërkesa për t’u takuar. Por Petrit Dume sërish u ktheu të njëjtën përgjigje. “Nesër do të ikim dhe nuk kemi aspak kohë. Madje nuk do të ikim as me avionët tuaj”. Sovjetikët kërkonin të arrihej me patjetër takimi i kërkuar.

Ishim në një periudhë ku kishte mbi tre muaj që grupi i punës po përgatiste fillimin e mbledhjes së 81 partive. Dhe për sovjetikët nuk ishte e thjeshtë një situatë e tillë.

Në darkë na vjen një ftesë tjetër, e cila thoshte se delegacionin shqiptar e kërkonte në takim Komandanti i Komandave të Traktatit të Varshavës, Gjenerali Greçko.

Në këtë rast ishim të detyruar të ndiqnim hierarkinë dhe urdherin, pasi ne ishim pjesëtarë të Traktatit dhe ai mbante postin më të lartë. Nuk kishim si të vepronim ndryshe. Sa shkuam te Gjenerali Greçko, ai hapi bisedën: “Nuk e di si arritët deri në këtë pikë! Si do t’ia bëni po të veproni kështu se ekonomia juaj ka nevojë për t’u rindërtuar dhe për mbështetje, ashtu siç ka dhe industria, bujqësia apo dhe ushtria?! Nuk e di nëse i keni bërë mirë llogaritë me iniciativat e pamenduara që po veproni”.

Në këtë moment fjalën ia pret menjëherë Petrit Dume, i cili tha: “Shoku Greçko, ne nuk lejojmë askënd të tallet dhe të luajë as me autoritetin e udhëheqjes sonë dhe as me atë të popullit tonë. Ai popull di të mbijetojë edhe pa ju, ashtu siç ka bërë dikur”.

Pas kësaj, Gjeneral Dume u çua në këmbë dukë lënë të kuptohej se takimi kishte mbaruar dhe nuk kishte se çfarë të bisedohej më. Pas tij u çuan të gjithë dhe dolën jashtë.

Në mbrëmje delegacioni u nis me avionin me të cilin do të iknin rumunët dhe bullgarët, ndërkohë që Halim Ramohito, atashu ynë ushtarak, do të vijonte misionin derisa jo shumë kohë më pas, Hrushovi do ta shpallte “non grata”.

## **Dalja e ushtrisë sonë nga Traktati Ushtarak i Varshavës**

Dihet se politika e shtetit përcakton strategjinë e ushtrisë, prandaj ishte politika e shtetit ajo që përcaktoi daljen tonë nga Traktati i Varshavës, pas mbledhjes të delegacioneve të partive komuniste e punëtore të botës në Bukuresht, me qëndrimin e mbajtur nga delegacioni shqiptar në mbështetje të Partisë Komuniste të Kinës, në konfliktin e hapur mes Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste të Kinës.

Pas këtij qëndrimi të Partisë së Punës të Shqipërisë, marrëdhëniet mes partisë e shtetit tonë me partinë dhe shtetin sovjetik ishin ftohur e po shkonin drejt acarimit.

Në këtë situatë acarimi, në tetorin e vitit 1960 do të zhvillohej, si çdo vit, mbledhja e Traktatit Ushtarak të Varshavës, ku merrnin pjesë të gjitha delegacionet e ushtrive pjesëmarrëse në traktat, me qëllim analizimin e gjendjes të përgatitjes luftarake të ushtrive, ku nxirreshin detyra për të ardhmen dhe trajtoheshin probleme të gatishmërisë luftarake.

Me mbarimin e punimeve të mbledhjes, delegacionet priteshin rregullisht nga Komandanti i Traktatit, Gjenerali Greçko, i cili shtronte për delegacionet një drekë, në të cilën merrnin pjesë ministrat e mbrojtjes dhe udhëheqësit kryesorë të ministrive pjesëmarrëse.

Delegacioni shqiptar mori pjesë në drekë, pa u pritur më parë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Sovjetike, por megjithëse e kuptonin fare mirë qëndrimin e tyre të ftohtë.



Në drekë, si zakonisht e merrnin fjalën për të përshëndetur e falenderuar mikpritësit, kryetarët e të gjitha delegacioneve.

Për të përshëndetur në emrin tonë e kërkoi fjalën Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Petrit Dume, por Komandanti i Traktatit ia dha fjalën gjeneralit gjerman që ndodhej në krah të Rrahman Parllakut, i cili bëri me dije se nuk kishte kërkuar të fliste.

Ndërhyri Gjeneral Malinovski që sqaroi se iu dha fjala gjeneralit gjerman, pasi kishte ardhur lajmi që qeveria gjermane e kishte emëruar këtë gjeneral Shef të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Gjermane. Pra, lajmin e emërimit po ia komunikonin rusët.

Pas tij filloi të flasë Marshall Malinovski, i cili, pa ia kaluar fjalën delegacionit shqiptar, filloi me retorikë duke folur mbi vizitat në të gjitha shtetet pjesëmarrëse në traktat, ku ishte pritur miqësisht.

Ai tha se kishte vizituar edhe Shqipërinë bashkë me Nikita Sergejeviç Hrushovin, ku ishin pritur me brohoritjet “Shqipëri-Bashkimi Sovjetik” e me shumë tam-tame, por sipas tij këto kishin qenë të gjitha fals, pasi qeveria shqiptare nuk po mbante qëndrimin miqësor që mbanin shtetet e tjera aleate ndaj Rusisë.

Petrit Dume u ngrit vrellshëm me fjalët: “Shoku Marshall, miqësia jonë me Bashkimin Sovjetik nuk është miqësi konjunkturash falso. Ajo lindi e u forcua në luftën e përbashkët kundër nazi-fashizmit. Populli shqiptar iu bashkua Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve, që ka në bazë të saj gjakun e përbashkët që kemi derdhur, prandaj kërkoj t’i merni mbrapsht fjalët që thatë këtu”.

Marshalli shtangu me gotën në dorë, kurse ne ishim ngritur si delegacion në këmbë dhe thërrisnim: “Akuzat tuaja janë të pabaza, tërhiqini fjalët!”.

Marshalli Greçko u përpoq të vinte qetësi, por e gjithë salla u ngrit në këmbë dhe dreka u prish.

Pas dy orësh na erdhi në hotel këshilltari i ministrit të

tyre, që ishte me ne në mbledhje, duke na thënë: “Ç’që kjo që bëtë!? Ju fyet Marshall Malinovskin, ministrin e Mbrojtjes të Bashkimit Sovjetik”. Pa ngurim ia kthjem se ai na kishte fyer ne dhe popullin tonë. Ne nuk mund ta pranonim arrogancën e të madhit.

Ky ishte edhe fillimi i ndarjes nga Traktati i Varshavës.

### **Beqir Balluku, në krye të delegacionit shqiptar në Traktatin e Varshavës**

Në nëntor 1960 u zhvillua në Moskë mbledhja e 81 Partive Komuniste e Punëtore të Botës.

Në këtë mbledhje, delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë, i kryesuar nga Enver Hoxha, mbajti anën e Partisë Komuniste të Kinës dhe pas këtij qëndrimi erdhi prishja përfundimtare e marrëdhënieve tona me Bashkimin Sovjetik.

Më 21 mars 1961 u zhvillua mbledhja e Këshillit të Lartë Konsultativ Politik të Traktatit të Varshavës në Moskë, ku sipas rregullit merrnin pjesë Sekretarët e Parë të Partive dhe Kryeministrat e çdo vendi pjesëmarrës në Traktat. Në këtë mbledhje, nuk shkoi as Enver Hoxha, as Mehmet Shehu, por delegacioni u kryesua nga Ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku.

Kjo mospërfillje i acaroi pjesëmarrësit e mbledhjes dhe me propozim të Hrushovit dhe të Marshallit Malinovski u ndryshua rendi i ditës, duke shtruar për diskutim qëndrimin e qeverisë Shqiptare ndaj Traktatit.

## Si u shpëtua baza ushtarake detare e Pashalimanit

Në hapje të mbledhjes, Hrushovi deklaroi se shqiptarët i kanë shkelur vendimet e Traktatit të Varshavës, prandaj ata duhet të dorëzojnë bazën e Pashalimanit me gjithë kodrinat e saj, pasi aty ishin dislokuar disa njësi detare, përfshirë edhe 3 brigada nëndetësesh të Traktatit të Varshavës. Në fakt kërkohet dorëzimi i Vlorës.

Delegacioni shqiptar e kundërshtoi këtë kërkesë të ndërhyrjes në punët e brendshme të vendit tonë dhe votoi kundër vendimit të Këshillit Konsultativ Politik të Traktatit.

Baza e Pashalimanit ishte vlerësuar lart nga udhëheqja politike e ushtarake si nga Hrushovi, ashtu edhe nga Marshallët Zhukov e Malinovski gjatë vizitave të tyre në vendin tonë dhe në bazën e Pashalimanit.

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, në vitin 1957, Marshalli Zhukov ishte shprehur për Pashalimanin: “Ky është një gji i mrekullueshëm. Deti i Zi, ku ne kemi një pjesë të madhe të flotës sonë, është në fakt një liqen. Ta dislokojmë atë flotë në këtë bazë. Duhet shpuar tejprtej ky mal, Karaburuni, me mjetet moderne që kemi, për t’i nxjerrë nëndetëset tona në hapësirën detare të Adriatikut, të Jonit e të Mesdheut, dhe ju siguroj se prej këtej duke dalë në ngushticat e Gjibraltarit, të Suezit e deri në Dardanele, e gjithë hapësira e Mesdheut do të jetë e jona.”

Kurse Nikita Hrushovi, gjatë vizitës në vendin tonë, kur bashkë me Marshall Malinovskin shkuan në Vlorë e Pashaliman, deklaroi: “Çfarë gji i sigurtë qenka Pashalimani, i shtrirë rrëzë këtyre maleve. Që këtej, me një flotë të fuqishme

ne mund të shtimë në dorë krejt Mesdheun, që nga Bosfori e gjer në Gjibraltar. Pra, që këtej ne mund të bëjmë zap këdo.”

Pas prishjes së marrëdhënieve me BS, sovjetikët ushtruan presion shumë të madh ndaj nesh. Ata kërkuan të na merrnin të gjitha anijet dhe mjetet luftarako-detare me të cilat na kishin furnizuar në bazë të marrëveshjeve dypalëshe për ndihmë ndaj Shqipërisë. Përveç kësaj, ata kërkonin edhe anijet luftarake që drejtoheshin nga detarët tanë, përjashtuar anijet, ku detarët tanë po trajtoheshin për të marrë më vonë drejtimin e tyre.

Për të na rrëmbyer anijet luftarake, ata kërkuan që me të gjithë flotën të zhvillonim bashkarisht një stërvitje në det të hapur dhe që andej me anë të forcës, t'i rrëmbenin të gjitha anijet luftarake.

Këtë ide ne e kundërshtuam prerazi dhe vumë në gatishmëri luftarake artilerinë bregdetare dhe garnizonin e Sazanit, duke shtuar kontrollin e daljeve nga baza e Pashalimanit. Duke e parë se nga pozicioni ku ndodheshin e kishin të pamundur t'ia arrinin qëllimit me forcë, ata u detyruan të tërhiqen nga kërkesa për t'i marrë me forcë anijet që drejtoheshin nga detarët tanë dhe që ishin marrë në dorëzim nga Komanda e Flotës Ushtarako-Detare Shqiptare.

Dihet nga historia se shekuj me radhë, carët rusë ishin përpjekur të siguronin, por pa sukses, një bazë ushtarako - detare në Detin Mesdhe, ndërsa pasardhësit e tyre mundën të siguronin një pozicion mjaft të përshtatshëm në Pashalimanin tonë, bazë të cilën e vlerësonin shumë, u përpoqën ta mbanin me çdo kusht, por që u detyruan ta lëshonin.

### **Mundësia për t'u afruar me Perëndimin dhe përpjekjet e fqinjëve për ta penguar**

Largimi i anijeve luftarake sovjetike dhe i efektivit të tyre, pa konflikt, ishte fitore për ne, pasi u shmangën precedentët për ndërhyrje, si në Çekosllovakia.

Gjithashtu, Italia dhe NATO morën sinjalin domethënës se Shqipëria nuk do të ishte një bazë kërcënimi për ta. Fatkeqësisht, ky moment nuk u shfrytëzua nga qeveria jonë për t'u hapur ndaj Perëndimit, por iu drejtuam Lindjes së Largët. Kjo nuk ishte në interes të popullit tonë, por të Enver Hoxhës, i cili i lidhur me Perëndimin nuk do të kishte një pushtet personal si ai i Maos.

Për të analizuar shkaqet se përse ushtarakët e pranuan atë politikë, duhet t'i drejtohem i gjendjes së asaj kohe.

Sipas gjykimit të Parllakut, ne ballafaqoheshim me faktet që fqinjët rreth e rrotull kishin mbajtur në shekuj qëndrim armiqësor ndaj vendit tonë dhe këtë e dëshmonin të gjithë shqiptarët.

Greqia, në Konferencën e Paqes, në Paris, u përpoq për ta penguar Shqipërinë të pranohej mes shteteve fitimtarë të Luftës kundër nazi-fashizmit, si pjesë e Aleancës Antifashiste në Luftën e Dytë Botërore, duke na akuzuar si aleatë të Italisë Fashiste në luftën italo-greke, bazuar në ligjin e luftës, që e mban edhe sot dhe sipas të cilit pretendonte t'i merrte Shqipërisë krahinat e Jugut të ashtuquajtura, sipas tyre, "Vorio-Epir".

Greqia ndërmoi edhe agresionin e gushtit 1949 kundër vendit tonë, ku mori përgjigjen e merituar të ushtrisë shqiptare. Ndërkohë, Greqia u bë baza e përgatitjes së agentëve e diversantëve që futeshin në Shqipëri për të destabilizuar vendin dhe për të krijuar konflikte për ndërhyrje të armatosura.

Jugosllavia, gjithashtu, kishte bërë përpjekje për ta bërë Shqipërinë pjesë të Federatës Jugosllave, por pa rezultat. Në vitet 1950–1970, regjimi Tito–Ranković ushtroi presion e terror për shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre etnike të ish-Jugosllavisë. Pra, edhe jugosllavët nuk i kishim miq, përkundrazi, edhe ata e kishin kthyer Jugosllavinë në bazë kundër vendit tonë.

Megjithë marrëdhëniet diplomatike me shtetin italian, as Italinë nuk e konsideronim si vend mik, pasi si anëtare e

NATO-s, vlerësohej për kohën si organizatorja dhe drejtuesja e të gjitha veprimtarive armiqësore kundër Shqipërisë.

**Të vetëm kundër të gjithëve, tanimë duhet të përballonim forcat e NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës**

*(Analizë e ish-Zv.Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Rrahman Parllaku)*

Me këto vlerësime të asaj kohe për vendet fqinje dhe për NATO-n, prisnim të përballonim situata të vështira. Populli ushqehej me propagandën se e gjithë bota ishte kundër nesh. Në këtë situatë të rëndë, populli shpresonte në mbrojtjen tonë.

Në ndërgjegje nuk e pranoni atë që thoshte Hoxha në çdo fjalim, se do të luftonim e fitonim kundër dy aleancave më të fuqishme ushtarake të kohës, kundër NATO-s dhe Traktatit të Varshavës, veç e veç, ose kundër të dyjave së bashku. Ishte kjo politikë aventureske e Enver Hoxhës që si Komandant i Përgjithshëm e vuri në vështirësi të mëdha Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, pasi kërkohej përpunimi i një strategjie ushtarake që të përballonte detyra të pabazuara në asnjë llogari e në asnjë shembull të historisë ushtarake botërore.

Detyra të mbroheshim të vetëm kundër të gjithëve, siç pretendonte Enver Hoxha, ishte e papranueshme edhe nga ushtarakët me njohuri minimale, e jo më nga ne, që drejtonim shtabin me kuadro të një niveli të lartë profesional në drejtimin e operacioneve strategjiko-operative.

Lufta në vetvete është shkencë. Në çdo operacion luftarak bëhet vlerësimi i forcave vetjake dhe të kundërshtarit, në njerëz, armatime dhe teknikë luftarake, si edhe raportet që krijohen mes palëve ndërluftuese.

Sigurisht rëndësi kanë edhe faktorët favorizues si lufta për mbrojtjen e atdheut, morali i forcave luftuese, terreni i favorshëm, etj. Pra, si mund të fitonim ne kundër dy superfuqive, ç'raporte forcash e njerëzish apo raporte armatimi

e teknike luftarake do të llogarisnim. Kjo marrëzi ishte vetëm në kokën e atyre që e deklarorin.

Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm nuk planizonin mbrojtjen nga dy superfuqitë e botës, por përgatiteshin të përballonin ndonjë sulm të fqinjëve tanë, të cilët mund të ndërhyenin për të shkaktuar trazira e konflikte të brendshme pas daljes sonë nga Traktati i Varshavës. Prandaj ishim të përgatitur që çdo shtet fqinj ta përballonim me forcat tona.

Për këtë ishim të bindur, pasi ushtria jonë ishte e përgatitur mjaft mirë dhe ishte e pajisur me armatime e teknike luftarake të nivelit, të sasisë dhe cilësisë që kishin edhe fqinjët tanë. Gjithashtu, gjendja moralo-politike dhe disiplina ishin në shkallë të lartë, pasi do të luftohej për mbrojtjen e vendit.

Si ushtarakë, ne e përjashtonim ndërhyrjen dhe mbështetjen e shteteve fqinje nga aleancat e NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës, pasi të dy aleancat nuk donin konflikt në qendër të Europës dhe ishim të bindur që në Shqipëri nuk do të zhvillohej luftë dhe nuk do të përdroreshin armët e dëmtimit në masë.

Detyrë imediate për ne ishte marrja e masave të shpejta për t'u mbrojtur nga fqinjët, që të mos ziheshim në befasi për ta lëshuar vendin, siç veproi ushtria e Mbretit Zog më 1939, por të mbronim çdo pëllëmbë tokë, deri në ndërkombëtarizim të konfliktit, deri në ndërhyrje ndërkombëtare, pasi asnjë shtet nuk ishte i interesuar për konflikte, përfshirë këtu edhe grupimet ushtarake si NATO dhe Traktati i Varshavës.

### **Riorganizimi i ushtrisë sipas situatave të krijuara Parllaku, në krye të Forcave Detare**

Në kushtet e krijuara, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë menduan për përgatitjen e një plani mbrojtjeje bazuar në mundësitë reale me disa ridislokime të

forcave dhe mjeteve luftarake në drejtimet që konsideroheshin si më kërcënueset për lirinë dhe pavarësinë territoriale të vendit, dhe njëkohësisht filloi intensivisht puna për përpilimin e planit strategjik të mbrojtjes.

Bazuar në këtë plan emergjence nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë u vendos të bëheshin ndryshime në strukturën organizative të njërive ushtarake për lehtësi të drejtimit të tyre gjatë veprimeve luftarake. Gjithashtu u vendos të krijoheshin disa njësi operative që do të mbulonin drejtimet kryesore. Njësia më e përshtatshme me eksperiencën e drejtimit të luftës ishte krijimi i Korpuseve të Këmbësorisë, me përbërje 3-5 brigada këmbësorie tokësore, me reparte të artilerisë tokësore, kundërtanke e kundërajrore, me reparte tankesh, xheniere e të shërbimeve, etj. Korpuset e këmbësorisë do të mbulonin kufirin tokësor të vendit.

Këshilli i Mbrojtjes vlerësoi si drejtimin më të rrezikshëm frontin bregdetar, pasi një goditje e desantit e kombinuar me desant ajror të lejuar nga terreni i përshtatshëm e rrezikonin direkt kryeqytetin dhe e ndanin vendin në mes. Hapësira e frontit ishte e gjerë dhe flota jonë luftarake nuk kishte kapacitet për të zhvilluar beteja detare në det të hapur, përveç nëndetseve me kapacitet goditës. Ajo mund të vepronte në ujërat territoriale, nën mbështetjen e artilerisë bregdetare dhe mbulimit nga ajri, kurse forcat tokësore, që do të luanin rolin kryesor në mbrojtjen e bregut, duhet të ishin nën një komandë që do të koordinonte veprimet luftarake jo vetëm ndërmjet tyre, por edhe me flotën luftarake e me armët e tjera, do të bashkëpunonte me Komandën e Mbrojtjes Kundërajrore, për mbulimin nga ajri me artileri kundërajrore, me aeroplanë e raketa.

Mbi bazën e këtij vlerësimi u krijua Komanda e Forcave Ushtarake-Detare (FUD), që përfshiu në përbërje Flotën Luftarake-Detare, Artilerinë Bregdetare, 2 brigada tankesh, 2 regjimente të artilerisë kundërajrore, të artilerisë tokësore, reparte xheniere, kimie, ndërlihdjeje e reparte të tjera shërbimi.



Kjo ishte njësia më e madhe e ushtrisë që i përfshinte të gjitha llojet e armëve, me përjashtim të aviacionit. Komandant të këtyre forcave caktuan Rrahman Parllakun, duke e ngarkuar me një detyrë shumë të rëndësishme, pasi do të përgjigjej për një front që shtrihej nga Shëngjini deri në Porto-Palermo, do të komandonte 1/3 e të gjithë efektivit të atëhershëm aktiv të ushtrisë, që numëronte mbi 42.000 vetë. Parllaku kishte bindjen se do ta kryente me nder detyrën, pasi kishte përgatitjen e plotë profesionale, eksperiencë në punë e drejtim dhe mbi të gjitha ishte shumë aktiv dhe rezultativ në punë.

Komandant i Flotës Luftarake dhe njëkohësisht zëvendës i Parllakut ishte Abdi Mati, me të cilin njiheshin që nga Lufta Nacionalçlirimtare, pasi kishin qenë bashkë në një brigadë. Ai mbante gradën Admiral, ushtarak i talentuar, krijues i Flotës Luftarake-Detare, njeri me zemër të gjerë, me kulturë e njohuri të thella profesionale. Bashkëpunuan në mënyrë të përkryer me njëri-tjetrin. Ai ishte kolegu që e mësoi të drejtonte forcat detare.

Komisar i Flotës ishte Gjeneral Ziqiri Mero.

Zëvendës për punën politike ishte Gjeneral Et'hem Gjinushi. Shefa Shtabi qenë Gjeneral Sulo Kozeli, Gjeneral Sotir Filto, Kolonel Skënder Malindi.

Nga riorganizimi mbeti pa ndryshime Komanda e Mbrojtjes Kundërajrore (MKA), që kishte në përbërje repartet e aviacionit, repartet e artilerisë kundërajrore të të gjithë vendit, raketat kundërajrore, repartet radiollokative të drejtimin luftarak e të zbulimit dhe repartet e shërbimit, përfshirë edhe Uzinën e Riparimit të Avionëve.

Këto ndryshime organizative me krijimet e reja të njësive operative u bënë për të lehtësuar drejtimin nga Shtabi i Përgjithshëm dhe me qëllim që komandat e këtyre njësive të njiheshin me komandat dhe efektivin e njësive vartëse, të bënin përgatitjen e kompaktësimin për veprime të përbashkëta, si edhe nëpërmjet zhvillimit të stërvitjeve në terren, të njiheshin me terrenin e drejtimet kryesore të mbrojtjes. Gjithashtu, duhej

studiuar armiku i mundshëm për të përgatitur e fortifikuar në kohë pozicionet e mbrojtjes.

### **Kur politika del përpara specialistëve ushtarakë...**

Gjatë periudhës së emergjencës, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë duhet të përpunonin Strategjinë Ushtarake në bazë të së cilës do të zhvilloheshin Forcat tona të Armatosura.

Në një material të përgatitur në vitin 1962, referuar nga Ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku, në një mbledhje me kuadrot kryesore të ushtrisë, paraqiteshin disa teza mbi të cilat do të mbështetej zhvillimi i ushtrisë në periudhën e emergjencës.

Ministri Balluku ishte shprehur më pas se nuk pretendonte që ato teza të përbënin bazën e platformës strategjike, ku do të mbështetej zhvillimi i Forcave tona të Armatosura, por ushtarakët iu referuan gjatë atyre dhe ushtria po zhvillohej në mënyrë spontane, pa një platformë me kufij të qartë, se cila do të ishte struktura e ushtrisë në kohë paqeje dhe cila në kohë lufte. Cila do të ishte sasia e forcave tokësore e brenda tyre llojet e armëve, këmbësoria, artileria, tanket, xhenioja, kimia, ndërlihdja, etj. Sa do të ishin Forcat e Mbrojtjes Kundërajrore ku përfshiheshin: aviacioni, raketat, artileria kundërajrore, repartet e zbulimit e të drejtimit radiolokativ, etj. Gjithashtu, sa do të ishte dhe si do të organizohej Flota Luftarako-Detare si nëndetëset, anijet mbiujëse, gjuajtësit detar kundër nëndetseve, katrasilurues, anijet e minim – çminimit, si dhe anijet e drejtimit e të shërbimit.

## Të ashtuquajturat tezat e zeza

Këshilli i Mbrojtjes nuk po i hapte rrugë Shtabit të Përgjithshëm në formulimin e një materiali tekniko-shkencor që do të përbënte bazën e artit ushtarak ku do të mbështetej perspektiva e zhvillimit të Forcave tona të Armatosura. Nuk po aprovoheshin materialet e punuara nga grupe akademikësh ushtarakë të të gjitha llojeve të armëve e të shërbimeve.

Çdo material i paraqitur në Këshillin e Mbrojtjes kthehej me vërejtje absurde, që e hidhnin poshtë punën e bërë se gjoja materiali nuk përmbante elementë të luftës popullore, por mbështetej në artin klasik ushtarak.

Diktohej nga lart si duhet të përgatitej materiali duke pasur në vëmendje luftën kundër të gjithëve, përfshirë edhe NATO -n dhe Traktatin e Varshavës, e cila shmangej nga shkencëtarët ushtarakë si aventurë antishkencore.

Për përgatitjen e Platformës Strategjike u ngarkua të punonte një grup oficerësh të përgatitur në shkollat e larta dhe akademitë e të gjitha llojeve të armëve e shërbimeve. Grupi drejtohej nga Shefi i Drejtorisë Operative të Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Vaskë Gjino, një nga gjeneralët më të përgatitur të ushtrisë.

Grupi përgatiti planin me tezat mbi të cilat do të formulohej platforma e Artit Ushtarak të ushtrisë sonë dhe ia paraqiti për aprovim Këshillit të Mbrojtjes, i cili nuk i aprovoi pasi, sipas tyre, tezat nuk bazoheshin në artin ushtarak të luftës sonë popullore, se ato nuk ishin shkëputur nga arti ushtarak klasik, sidomos ai sovjetik dhe këtu vërejtja u drejtohej kuadrove të grupit të punës që kishin studiuar në Bashkimin Sovjetik.

Arti Ushtarak, si çdo shkencë, nuk mund të shkëputet nga eksperiencia botërore e cilitdo shtet qoftë. Ajo shkon në evoluim me zhvillimin e llojeve të armëve dhe të teknologjisë ushtarake.

Megjithë vërejtjet e Këshillit të Mbrojtjes për tezat, grupi i punës nuk mund të shkëputet nga ligjet, nga normat dhe nga llogaritë shkencore, pasi edhe vetë lufta popullore, kur shteti ka ushtri të rregullt, për të mbrojtur me çdo kusht vendin, zhvillohet që në fillim si luftë me front të rregullt. Pra, ajo nuk mund të fillojë si lufta jonë popullore partizane që zhvillohej në kushtet kur vendi ishte i okupuar dhe luftohej kundër pushtuesit.

Puna e grupit shkoi kot pasi nuk gjeti aprovimin e Këshillit të Mbrojtjes.

Të njëjtin fat pati dhe materiali “rrëshqitja”, i përgatitur sipas vërejtjeve të Këshillit të Mbrojtjes, i cili u hodh poshtë unanimisht nga kuadrot kryesore komanduese si i dëmshëm e disfatist për ushtrinë, pasi në mënyrë të paargumentuar e lëshonte frontin pa rezistencë, me mbrojtjen pëllëmbë për pëllëmbë, sipas planizimit dhe përgatitjes së mbrojtjes. Gjithashtu, në materialin “rrëshqitja” nuk jepeshin argumentat përse lëshoheshin pozicionet dhe brezat e parapërgatitur për mbrojtje dhe përse lëshoheshin armët pa u shkrehur kundër armikut.

Argumenti i vetëm dhe absurd ishte: Të ruajmë forcat dhe teknikën luftarake për luftë popullore.

Materiali u përgatit sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të Enver Hoxhës dhe të Mehmet Shehut.

Kolonel Elami Hado, drejtues i grupit të punës, që u dënua për këtë material, deklaroi se materialit i ishin bërë vërejtje nga Këshilli i Mbrojtjes, duke e kthyer tri herë për ripunim. Pas kësaj, Ministri i Mbrojtjes, Beqir Balluku, e kishte hedhur mbi tavolinë materialin me dëshpërim, duke kërkuar që ai të bëhej siç po kërkohej.

Materiali i përgatitur sipas kërkesave u hodh poshtë nga kuadrot kryesore të ushtrisë. Ata që u detyruan të zbatonin kërkesat e Këshillit të Mbrojtjes u dënuan si autorë të materialit, ndër ta Rahman Parllaku dhe dhjetra kuadro kryesorë të ushtrisë së viteve ‘70.

Kjo ishte kundërvënja e parë e kuadrove kryesore të ushtrisë me mendimet e Enver Hoxhës dhe të Mehmet Shehut mbi zhvillimin e mendimit ushtarak, por ata bënë sikur u pajtuan me mendimet e ekspertëve, duke fajësuar grupin e punës dhe duke fajësuar dhe dënuar drejtuesin e tij, Kolonel Elami Hadon.

Koha po kalonte dhe ushtrisë i mungonte platforma që do të përcaktonte bazën e zhvillimit të saj pas daljes nga Traktati i Varshavës. Kuadrat e larta komanduese të ushtrisë ishin të pakënaqur me situatën e krijuar dhe kundërshtonin nxjerrjen e ushtrisë nga kazermat dhe shpërndarjen e reparteve të gatishmërisë luftarake, që kishin si detyrë të përballonin në rast lufte sulmet e para të armikut, duke siguruar hapjen e kompletimit të njësive dhe reparteve me rezervistë, sipas planeve të parashikuara për kohë lufte.

### **Parrulla e Enver Hoxhës “Ta çojmë ushtrinë atje ku është rezervisti, punëtori dhe kooperativisti” - degradimi përfundimtar i ushtrisë**

Porosia e Enver Hoxhës që “Ta përgatisim ushtrinë sipas mësimëve të Leninit, në Shkollën e Lirë, pasi ushtria është e popullit dhe i gjithë populli është ushtar”, po e çonin ushtrinë në fshat, po shkatërronin punën e bërë prej gati 20 vitesh dhe krejt ushtrinë tonë, që për nga përgatitja ishte e krahasueshme me ushtritë më të përparuara të Europës.

Me ushtrinë nëpër kazerma ishin krijuar të gjitha kushtet për zbatimin me cilësi të planeve e programeve mësimore me oficerët, nënoficerët dhe ushtarët.

Gjithçka funksiononte brenda shkollës, me klasa, kabinete, biblioteka e klube ku zhvilloheshin aktivitetet kulturore. Brenda mjediseve të kazermave kishte edhe fusha për stërvitjet rreshtore dhe terrene sportive për kalitjen fizike, kurse për përgatitjet taktike dhe të zjarrit për të gjitha llojet e armëve

e shërbimeve ishin ndërtuar në terren fusha stërvitje, breza pengesash dhe poligone për qitjeje për të gjitha armët e lehta, pasi për armët e rënda të artilerisë, për tanket e avionët ishin ndërtuar poligonet qendrore.

Fatkeqësisht, ushtria nuk do të kishte më kushte të tilla mësimi e stërvitje, pasi me urdhër të Enver Hoxhës ajo po shpërndahej në të gjithë hapësirën e vendit, duke u shpërbërë në qindra pika hapjeje, aq sa në fund të viteve '80 arritën gati në një mijë të tilla. Kjo mund të quhet edhe goditja e parë shkatërruese për përgatitjen e gatishmërinë luftarake të ushtrisë.

**Porosia tjetër e Hoxhës "T'u qepemi kodrave dhe maleve dhe t'i kthejmë ato pjellore si dhe fushat" kundërshtohet nga Shehu, por pranohet nga Balluku**  
**Konflikti Shehu - Balluku dhe pasojat në ushtri**

E keqja tjetër e madhe erdhi nga parrulla tjetër e Hoxhës: "T'u qepemi kodrave dhe maleve dhe t'i kthejmë ato pjellore si dhe fushat".

Kjo detyrë iu ngarkua ushtrisë. Ajo duhet të hapte toka të reja, të mbillte, të prashiste, të korrote, të krijonte tufa bagëtish dhe këto, krahas ndërtimeve, fortifikimeve dhe mbrojtjes së depove dhe pikave të hapjes.

Të gjitha këto, së bashku, e larguan përfundimisht ushtrinë nga detyra e saj kryesore që ishte përgatitja dhe gatishmëria luftarake. Tashmë, përgatitja luftarake e rekrutëve që do të kryenin shërbim ushtarak 2 e 3-vjeçar ishte reduktuar vetëm në 3 muaj stërvitje ushtarake.

Duhet theksuar fakti se aksionin e hapjes së tokave të reja, për t'i bërë malet pjellore si edhe fushat, Hoxha fillimisht dontte t'ia ngarkonte Qeverisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, por Kryeministri Shehu dhe Ministri i Bujqësisë, Dodbiba, e kundërshtuan me argumentin se nuk duheshin prishur pyjet e kullotat, se tokat e hapura me aksion do të ishin larg qendrave

të banuara dhe shërbimet ndaj bimëve të mbjella në to nuk mund të kryheshin me aksione.

Meqenëse Kryeministri dhe Ministri i Bujqësisë kishin qenë kundër, Enveri ia ngarkoi ushtrisë aksionin për hapjen e tokave të reja. Këtë aksion Beqir Balluku e pranoi pa u konsultuar me Kryeministrin dhe kjo fyerje ndaj Kryeministrit krijoi konflikt mes dy anëtarëve kryesorë të Byrosë Politike, mes Kryeministrit dhe Zv/Kryeministrit të vendit.

Këto zhvillime brenda Byrosë Politike nuk iu ishin bërë të njohura as anëtarëve të Komitetit Qendror që punonin në ushtri. Parllaku, me këtë fakt, u njoh në një mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror, ku ishte marrë në analizë hapja e tokave të reja. Ai iu drejtua Pirro Dodbibës dhe i tha: "Diskuto, se ke rënë dakord të prishen pyje e kullota! - Diskutoni ju, ushtarakët, - iu përgjigj ai, - se ju e morët përsipër këtë aksion, se unë dhe Mehmeti nuk kemi qenë dakord". Përgjigja e tij sqaroi rrjedhën e ngjarjeve, ndërkohë që vihej re se marrëdhëniet shoqërore mes Beqirit e Mehmetit ishin ftohur shumë.

Kryeministri më parë ftohej dhe pritej me kënaqësi e respekt në stërvitjet e manovrat e rëndësishme ushtarake. Ai, në çdo rast, shoqërohej nga Ministri i Mbrojtjes dhe së bashku kalonin ditë të tëra në çadra duke biseduar miqësisht mbi problemet e ushtrisë.

Vetëm në kohën kur Parllaku ishte komandant i FUD-it, kryeministri Shehu dhe ministri Balluku erdhën tre herë për kontroll së bashku në stërvitjet e njëjste dhe reparteve, duke përshkuar vijën bregdetare Velipojë - Porto- Palermo. Ishin kohë të bukura, të një miqësie të singertë, kur mbrëmjeve në çadra, pas lodhjeve ditore të punës radhën e zinte biseda e ngrohtë dhe shakatë. Por kjo nuk zgjati shumë. Retë e errëta të xhelozive se kush ishte i parapëlqyeri i E. Hoxhës, do të eklipsonin marrëdhënie të tilla.

## **Hoxha i trembej dyshes Shehu-Balluku dhe bëri planin për t'i eliminuar që të dy**

Koha vërtetoi se kjo shoqëri mes këtyre dy figurave kryesore të partisë dhe shtetit, pra e dyshes Shehu - Balluku, e trembte E.Hoxhën që rrezikun e karrikes së tij e ka kërkuar gjithmonë te njerëzit më të afërt. Dyshimet kryesore i kishte tek M.Shehu, pasi e njihte ndikimin e tij në ushtri. Lidhja e ngushtë e M. Shehut me B. Ballukun, Ministër i Mbrojtjes, ia përforconin dyshimet, prandaj krijoi e nxiti përçarjen mes tyre, deri sa gjeti edhe "shkaqet" për t'i groposur njëri pas tjetrit, por më e keqja ishte se bashkë me ta groposi edhe gjithë lidershipin e Ushtrisë Shqiptare.

Tensionimi i marrëdhënieve mes Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes e rëndonte gjendjen e ushtrisë, pasi Kryeministri ishte zëri kryesor në Këshillin e Mbrojtjes ku zgjidheshin problemet kryesore të Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes e përjetoi me dhimbje gjendjen e krijuar dhe këtë e pohoi edhe E.Hoxha, kur, gjatë dënimit të Ballukut deklaroi se ai i kishte kërkuar të largohej nga detyra për arsye shëndetsore, por ai nuk ia kishte aprovuar. Me sa kuptohet, që atëherë e kishte vendosur ta lironte e më vonë ta eliminonte fizikisht.

Ushtria përfundimisht po shkonte drejt shkatërrimit. Po shpërndaheshin pika hapje në të gjitha fshatrat e vendit, po i ngarkoheshin detyra që nuk kishin asnjë lidhje me objektivat e saj. Ndërtoheshin kazerma për strehim, kudo ku ajo shkonte, pa u lëvruar fondet e duhura për to, pasi duhej zbatuar parrulla: "Çdo gjë ta bëjmë me forcat tona".

Ushtrisë i ishin ngarkuar shumë detyra. Krahas punimeve fortifikuese në brezat e mbrojtjes, ajo duhet të ruante pikat e hapjes, të hapte toka toka të reja, të mbillte e të korrte dhe të ruante tufat e bagëtive të ekonomive ndihmëse, pra tani ne nuk po përgatisnim vetëm ushtarë, por edhe ndërtues, bujq e çobanë.

Megjithatë, Ministria e Mbrojtjes vazhdonte të hartonte e dërgonte plane e programe vjetore për përgatitjen luftarake,



sikur ushtrinë ta kishim akoma në kazerma, pa llogaritur se ku do të gjendej koha për zbatimin e tyre.

Gjendja e përgatitjes luftarake kishte arritur pikën, kur për zbatimin e planeve dhe programeve, komandantët shfrytëzonin çdo orë, deri edhe ditët e pushimit për të kryer stërvitjen e efektivit dhe shërbimet në bazë të rregulloreve.

Komandat e njësive dhe reparteve po e ngrinin zërin, për dëmin që po i shkaktohej procesit mësimor e stërvitor. Ata kërkonin të liroheshin nga disa punime e shërbime dhe të merreshin më shumë me detyrën kryesore të ushtrisë, përgatitjen për mbrojtje.

Për këto probleme debatohej shpesh në mbledhjet e kolegjiimit të Ministrisë së Mbrojtjes. Ishte debatuar edhe pas stërvitjeve me trupa të korpuseve për rezultatet jo të kënaqshme të tyre. Në qendër të debateve mbetej gjithmonë shqetësimi i komandave për gjendjen e përgatitjes dhe gatishmërisë luftarake.

### **Rivendosja e komisarëve dhe sekretarëve të partisë për të eklipsuar rolin e komandantëve në ushtri**

*Parllaku tregon:*

Ne mendonim se duke i ngritur këto probleme që kishin të bënin me forcimin e mbrojtjes së vendit, Ministria dhe Këshilli i Mbrojtjes do të na mirëkuptonin e do të na lehtësonin nga punimet e shërbimet që dëmtonin përgatitjen e gatishmërinë luftarake, por në fakt po ndodhte e kundërta. Kërkesat tona po shikoheshin me dyshim, po përgjoheshin nga Sigurimi i Shtetit dhe mendimet tona po vlerësoheshin si kundërvënie ndaj vendimeve të partisë dhe ideve të Enver Hoxhës, prandaj Hoxha vendosi që, në kuadër të të ashtuquajturave reforma që shpalli Byroja Politike e Partisë në 24 dhjetor 1965 dhe në Letrën e Hapur të Komitetit Qendror të Partisë në 24 mars 1966, drejtimin e ushtrisë ta marrë në dorë Partia.

Këto vendime të quajtura reforma goditën direkt principet mbi të cilat organizohej e vepronte ushtria. Komandantëve iu hoq e drejta për të komanduar e drejtuar sipas zbatimit të rregulloreve ushtarake të mbështetura në norma ligjore që e veçojnë ushtrinë, në dallim me strukturat e tjera shtetërore e shoqërore, si një organizëm të rregullt dhe me disiplinë, ku urdhëri i komandantit ishte ligj për vartësit. Urdhëri i sanksionuar me ligj i jepte komandantit të drejtën të çonte në luftë mijëra e miliona njerëz të gatshëm për sakrificën sublime në mbrojtje të atdheut.

Vendimet e partisë ua hoqën komandantëve, të të gjitha ranjeve, të drejtën për të komanduar të vetëm. Për t'i zhveshur komandantët nga këto të drejta, u hoqën edhe gradat ushtarake që përcaktonin pozitën e hierarkinë ushtarake, që bënë vartësin në gradë t'i bindej superiorit pa e ditur funksionin e tij, pasi grada jepej bazuar në kulturën, përgatitjen profesionale dhe aftësitë e treguara në kryerjen e detyrave. Shkallët e karrierës ushtarake ngjiteshin jo vetëm nga shkolla e kryer, por edhe nga nivelet e komandimit. Nuk mund të komandos regjiment, pa komanduar batalion apo të komandos divizion pa komanduar regjiment, e kështu me radhë drejt njësave më të larta. Këto rregulla dhe kjo eksperiencë tepër e nevojshme për të drejtuar jetë njerëzish u shkelën në ushtrinë tonë, pasi urdhëri i komandantit nuk kishte më vlerë pa firmën e komisarit, i cili vinte nga jeta civile me një shkollë ose kurs partie.

Në bazë të vendimeve të partisë duhej kudo firma e komisarit. Në këto kushte po ktheheshim prapa, te ushtria e dikurshme partizane. Ushtrinë po e çonim në fshat dhe duhej t'i përshtateshim gjendjes së fshatit.

Fillimisht, në detyrat e komisarëve të njësave të mëdha u emëruan disa nga ish-komandantët e këtyre njësave, kuadro me përgatitje e përvojë drejtimi. Për mendimin tim, kjo u bë nga udhëheqja e partisë për t'i dhënë funksionit të komisarit vlerë dhe autoritet në masë dhe për të na mikluar me idenë se, edhe tani që do të drejtojë partia, përsëri në krye do të jenë ushtarakët

e mirëfilltë. Nga ana tjetër, ushtarakët e vjetër komandues ishin më të pranueshëm në zbatimin e “reformave” nga komandat dhe efektivat vartëse. Gjithashtu, ata ishin krijuesit e ushtrisë dhe po e drejtonin atë prej njëzetë vitësh, dhe këto fakte nuk i anashkaloi udhëheqja e partisë kur i zgjodhi si komisarë, megjithëse ata nuk mund të shkëputeshin nga komandimi unik dhe drejtimi i ushtrisë sipas rregulloreve.

Me organizimin e ri, Parllaku u emërua Komisar i Forcave Ushtarako - Detare, dhe më pas po me këtë detyrë në Komandën e Korpusit të Tiranës, me komandant shokun e tij të ngushtë Vaskë Gjinon.

Shkatërrimi i gjithçkaje erdhi me formimin e komiteteve të partisë në të gjitha komandat, regjiment e lart dhe në byrotë e organizatave të partisë në batalion, grup e poshtë.

Vendimet e këtyre “organeve kolegjiale” ishin mbi çdo urdhër të komandave. Në këto organe zgjidheshin komisari, komandanti, sekretarë të organizatave bazë të partisë, nënoficerë, magazinierë, shoferë e mekanikë, pasi në përbërjen e komitetit duhet të ishin 30% me prejardhje ose përbërje punëtore. Pra, në këto organe, në përbërjen e të cilëve kishte njerëz që nuk e njihnin fare profesionin e ushtarakut, do të jepnin gjykime, do të shqyrtonin e do të vendosnin këta profanë, mbi urdhëra e vendime të formuluar nga Shtabi i Përgjithshëm me pjesëmarrjen e komandave e shefave të llojeve të armëve e shërbimeve në komanda, korpusi apo brigade, të gjithë me shkollë e akademi ushtarake për sektorët që drejtonin.

Me këtë procedurë burokratike edhe sikur Komiteti i Partisë të përbëhej nga specialistë të mirëfilltë ushtarakë, lufta moderne që në ditën e saj të parë do të ishte katastrofë, pasi situata në front që ndryshon orë pas ore nuk mund të presë formulimin, debatimin në komitetin e partisë e firmosjen e urdhërave për t’u dërguar pranë forcave në front.

Urdhëri i komandantit duhet të jetë i menjëhershëm, nga kudo që ai ndodhet, në udhëtim, në kontroll a në komandë.

Me të marrë njohuri mbi ndryshimin e situatës në front, ai menjëherë u jep trupave detyrat e reja në përshtatje me gjendjen e krijuar.

Edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare kur si mjet ndërlidhjeje kishin vetëm korrierin, komandanti, komisari, dhe zëvendësat kishin kompetenca të plota në dhënien e urdhërave dhe në marrjen e vendimeve vepronin me iniciativë, sipas situatave të krijuara, pa pritur për mbledhje e takime, por duke mbajtur përgjegjësi për veprimet e tyre.

### **Hartimi i tezave të mbrojtjes nga Mehmet Shehu**

Në mbështetje të “reformave në ushtri”, Mehmet Shehu formuloi projekt-tezat e Këshillit të Mbrojtjes.

Projekt-tezat u përgatitën nga Kryeministri, që kishte qenë komandant i njësisive më të mëdha të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në luftë dhe kishte kulturë e eksperiencë ushtarake. Puna e tij u vlerësua shumë nga Komandanti i Përgjithshëm Enver Hoxha, që në të njëjtën kohë kritikoi Ministrin e Mbrojtjes kur tha: “Keni vite që nuk mundët të përgatisni një material të tillë, kurse shoku Mehmet Shehu brenda tre muajve na dha një vepër shkencore, projekt-tezat që do t’i vlejnjë përgatitjes së forcave të armatosura”.

Megjithë kritikën e Enver Hoxhës drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, projekt-tezat u pritën me entuziazëm e u vlerësuan lart nga Shtabi i Përgjithshëm, sikur kritikën të mos i adresoheshin Shtabit të Përgjithshëm, që ishte përgjegjës direkt për përpunimin e zhvillimin e Artit Ushtarak në Forcat e Armatosura. U la të kuptohej se sfida ishte personale dhe se Shehu po i kthente Ballukut sfidën që ai i kishte bërë, për hapjen e tokave të reja.

Edhe kuadrot e larta të ushtrisë i pritën fillimisht mirë projekt-tezat, me mendimin se tani do të kishin një material bazë mbi të cilin do të zhvillohej ushtria dhe mendimi ushtarak.

Shpresën për zhvillimin e mendimit ushtarak e shkencor ua ngjalli letra përcjellëse e projekt-tezave, që u dërgohej komandave të njërive dhe që ishte e firmosur nga Enver Hoxha me cilësinë e Sekretarit të Komitetit Qendror të Partisë dhe Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në shkresën përcjellëse thuhej: "Po ju dërgojmë këto projekt-teza të Këshillit të Mbrojtjes, t'i studioni, të thelloheni në to, të bëni vërejtje dhe propozime për korrigjime, që sipas ndryshimeve e plotësimeve tuaja, projekt-tezat të bëhen teza."

Në letrën përcjellëse të projekt-tezave, nga Enveri lihej hapur vazhdimësia e mërive mes Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes, pasi kërkohet nga Ministria e Mbrojtjes dhe kuadrot kryesore të ushtrisë, të bëheshin vërejtje dhe propozime për ndryshime e plotësime të projekt-tezave të përgatitura nga Kryeministri. Pra, përsëri po vihej Ministri i Mbrojtjes kundër Kryeministrit.

Në të vërtetë, gjatë studimit të projekt-tezave, në përmbajtjen e tyre, ushtarakët nuk gjetën atë që prisnin. Në to vazhdonte mbështetja e idesë aventureske të Hoxhës: "Luftë kundër të gjithëve edhe kundër dy superfuqive ushtarake NATO-s e Traktatit të Varshavës të marra së bashku."

Projekt-tezat nuk kishin një bosht të qartë. Në to shkruhej për luftën pozicionale aktive siç e kishin planizuar për të vepruar po të kërkohet mbrojtja e vendit. Me këtë objektiv po përgatiteshin trupat, pozicionet e brezat e mbrojtjes në terren. Nga ana tjetër shkruhej për luftën e shkallës së dytë partizane, por pa u sqaruar mirë, pasi lufta partizane bëhet e detyrueshme, kur në luftën e rregullt ke pësuar disfatë, ke humbur territorin dhe të janë shterruar forcat mbrojtëse.

Në projekt-teza parashikohej që kjo luftë të organizohej dhe planifikohej që në kohë paqeje dhe kjo bëhej për të ruajtur forcat e teknikën luftarake për fazën e dytë të luftës partizane. Nuk ishte e qartë në se do të luftonim siç ishim duke u përgatitur për të mbrojtur vendin pëllëmbë për pëllëmbë, duke sakrifikuar deri në ushtarin e fundit apo do t'i braktisnim të gjitha përgatitjet.

Për ta përgatitur këtë kalim nga lufta e shkallës së parë në atë të shkallës së dytë, me porosi të Mehmet Shehut dhe me pjesëmarrjen direkte të tij u bënë në terren stërvitje prove, ku në njërën prej tyre të zhvilluar në Fan të Mirditës, pas tërheqjes së trupave nga brezi i parë i imituar i mbrojtjes, gjatë bregut perëndimor të Lumit Drin, në vargmalin Zepi i Arnit, Maja e Kumbullave deri në faqen lindore të malit të Munellës, duke përdorur rrugët e shfrytëzimit të pyjeve e minierave, u provua fshehja e armëve të rënda, për t'i përdorur në luftën partizane.

Për të organizuar luftën e shkallës së dytë partizane, u krijuan brenda forcave të armatosura tri struktura ushtarake: ushtria e rregullt me të gjitha llojet e armëve e reduktuar në efektiva, forcat sulmuese, brigadat e lehta sulmuese që vetëm me armatim të lehtë do të dislokoreshin në të gjitha qarqet. Qëllimi i krijimit të tyre, sipas idesë së Këshillit të Mbrojtjes, ishte të siguronin kalimin nga lufta e shkallës së lartë në atë të shkallës së ulët dhe do të ishin bërthama e ushtrisë partizane. Struktura e tretë ishin forcat territoriale të vetëmbrojtjes popullore, çetat vullnetare të fshatit siç i kishim në Luftën Nacionalçlirimtare.

Pra, nga përmbajtja e projekt-tezave nuk dilte qartë se kush do të na i siguronte fitoren, lufta e ushtrisë së rregullt për të cilën po përgatiteshim, po investonim duke u armatosur, po forconim brezat e mbrojtjes me punime xheniere për zhvillimin e një lufte pozicionale aktive në mbrojtje të vendit, apo lufta e shkallës së dytë, pas pushtimit të vendit, që gjithashtu po planizonim.

Në bazë të këtyre teorive ishte aventura dhe falsiteti i luftës kundër të gjithëve që po e detyronte Ministrinë e Mbrojtjes të bënte një plan imagjinar mbrojtjeje, jo vetëm për kufijtë e shtetit, por për të gjithë hapësirën tokësore, detare e ajrore të vendit, që do të mbrohej nga superfuqitë, nga NATO dhe nga Traktati i Varshavës.

Ky koncept, pas dënimit të udhëheqësve kryesorë të ushtrisë, çoi në bunkerizimin e të gjithë vendit, përfshirë edhe varrezat e parqet e të gjitha qyteteve, çoi në shpërndarjen e ushtrisë në qindra pika hapjeje në të gjithë vendin, duke çuar

në humbjen e çdo aftësie të gatishmërisë luftarake të forcave tona të armatosura.

### **Parllaku në Republikën Popullore të Kinës, në delegacionin qeveritar shqiptar. Kina furnizon Shqipërinë me avionë dhe armë të kohës**

Shtimi i forcave të armatosura, që sipas parashikimit dhe mobilizimit për kohë luftime shkonte deri në 500.000 vetë, që duhet të armatoseshin dhe porosia e Këshillit të Mbrojtjes ishte të kërkonim sa më shumë armë nga Kina, që ishte treguar e gatshme të na ndihmonte me të gjitha llojet e armëve që kishte në përdorim ushtria e tyre.

Furnizimi me armatim, teknikë e teknologji ushtarake nga Kina u përshpejtua dhe u shtua pas vizitës që bëri delegacioni i kryesuar nga Kryeministri në vitin 1967 në Kinë, në mbështetje të revolucionit kulturor të Mao Ce Dunit. Pjesë e delegacionit ishte edhe Rrahman Parllaku, që në atë kohë komandonte Forcat Ushtarake-Detare.

Dy javë para nisjes për në Kinë e thirri Kryeministri duke i treguar se kishte biseduar me Beqir Ballukun që të mblidhte të gjithë komandantët dhe drejtorët e llojeve të armëve dhe shërbimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, për të përgatitur listat me kërkesat për furnizimet me armë, me teknikë luftarake dhe materiale logjistike për kompletimin sipas nevojave të ushtrisë. Gjithashtu, të parashikoheshin kërkesat e palës shqiptare në makineri për krijimin e bazave të riparimit të armatimeve, përfshirë edhe tanket, avionët, anijet luftarake, si dhe ngritja e uzinave për prodhimin e armëve e pjesëve të këmbimit.

Gjeneral Parllaku u vendos në Ministrinë e Mbrojtjes dhe brenda 10 ditësh përfunduan listë-kërkesat, që me miratimin e Kryeministrit u shtypën në gjuhët shqipe e ruse.

Një natë para nisjes për në Kinë, Parllaku tregon se Kryeministri nëpërmjet telefonit i tha që listat të mos i merrte me vete, pasi Enver Hoxha e kishte porositur që të mos i bënin

asnjë kërkesë palës kineze, pasi po shkonin me mision politik e jo për kërkesa.

Propaganda që Kina i bëri vizitës së delegacionit shqiptar, të kryesuar nga Kryeministri dhe të përbërë me më shumë se 40 vetë, ishte e jashtëzakonshme. Gjatë vizitës, delegacioni u nda në dy pjesë. Një grup me Ramiz Alinë shkoi drejt Veriperëndimit të Kinës, në vendlindjen e Maos dhe grupi tjetër, ku bënte pjesë edhe Parllaku dhe që kryesohej nga Kryeministri filloi vizitën në veri, nga Port Artur, Shenjan, Cindau e Nanking. Gjatë vizitës, Kryeministrin e shoqëronte Kan Sheni, asokohe një nga udhëheqësit kryesorë të Partisë Komuniste të Kinës, kuse gjatë vizitës në Shangai i shoqëroi Çu En Lai.

Në mitingun e Shangait morën pjesë gati një milion qytetarë. Ishte mitingu më i madh, në krahasim me të gjitha qytetet që kishin përshkuar. Pas tij do të vinte mitingu i Uhanit, ku dhe do të bashkoheshin të dy pjesët e delegacionit.

Gjatë fluturimit nga Shangai në Uhan, Çu En Lai i tha Mehmetit: "Ju keni në delegacion shokun Rrahman që është ushtarak, mbase duhet të takoheni me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë sonë, shokun Jan Ce U dhe të bisedoni për problemet e ushtrisë." Mehmeti vështroi nga Parllaku dhe iu përgjigj si me përtesë: "Të kthehemi në Pekin e ta mendojmë". Më pas, M. Shehu i tha Parllakut: "Kopjen e listave e kemi, por nuk mund të veprojme kundër porosisë të shokut Enver". Parllaku insistoi: "Është propozimi i tyre nuk po ua kërkujmë ne".

"Të shohim, - u përgjigj kryeministri, - të takohemi edhe me Ramizin". U takuan me Ramizin në Uhan dhe ai ra dakord të bisedonin me Jan Ce U, pasi ishte i mendimit se Enveri do t'i mirëkuptonte meqenëse propozimi kishte ardhur nga vetë kinezët.

Uhani ishte qyteti i fundit që vizituan dhe këtë vizitë e bënë me kërkesën e vetë Maos, i cili që në takimin e parë i tha Çu En Lait t'i çonte në Uhan, pasi atje do ta kuptonin më mirë çfarë kishte qenë vërtet revolucion.

Çu En Lai e shfrytëzoi vizitën e delegacionit shqiptar



duke i mbledhur të gjitha kryesitë e këtyre organizatave dhe në fjalimin e tij e paraqiti delegacionin si miqtë e largët nga Shqipëria që kishin ardhur të mbështesnin revolucionin e udhëhequr nga timonieri i madh Mao, dhe premtoi bashkim me njëri-tjetrin.

Punëtorët e atjeshëm kinezë nuk e dinin cila ishte pozita gjeografike e Shqipërisë dhe ç'popullsi kishte, por fjalimin dhe thirrjen e Kryeministrit e dëgjuan me vëmendje. Në përfundim të fjalimit, ata u ngritën me radhë për t'u solidarizuar me Kryeministrin e tyre dhe pas një mbledhjeje 3 orëshe ranë dakord që nën drejtimin e të deleguarit të Maos për qytetin e tyre, po atë ditë të mblidheshin për krijimin e një organizate të vetme.

Këtu përfundonte edhe kontributi shqiptar, pasi të dy pjesët e delegacionit kishin zhvilluar dhjetra mitingje dhe ishin dëgjuar nga gati 15 milion njerëz.

Pas dy ditësh u kthyen në Pekin, ku u takuan me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Kineze, Jan Ce U. Në takim shkuan Rrahmani, Mehmeti dhe Ferrik Hado, atasheu ushtarak pranë ambasadës shqiptare në Pekin. Takimi ishte shumë i përzemërt. Jan Ce U i plotësoi të gjitha kërkesat e palës shqiptare, me përjashtim të armëve që ishin akoma në proces eksperimentimi dhe revolucioni kulturor kishte ndikuar në ngadalësimin e prodhimit të tyre,

Për herë të parë, Shqipëria u furnizua me avionët Mig - 21, me tanke artilerie të të gjitha kalibrave, etj. Në këtë takim u pranua edhe kërkesa për furnizime me teknologji në shërbim të ngritjes të industrisë ushtarake.

Delegacioni mbeti i kënaqur se u plotësuan të gjitha kërkesat, por Kryeministri shqetësohej për reagimin e Enverit.

### **Dy ditë vizitë në Pakistan**

Gjatë kthimit nga Kina, me ftesë të Presidentit të Pakistanit, Eup Khan, drejtuar Kryeministrit të Shqipërisë, M.

Shehu, delegacioni ndaloi për një vizitë zyrtare në Pakistan. Delegacioni shqiptar përbëhej nga 5 veta, me funksione të larta zyrtare, pasi nuk u përfshinë në delegacion funksionarë partie. Pjestarë të delegacionit ishin: Kryeministri Mehmet Shehu, Rrahman Parllaku, Bilal Parruca, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Shkodrës, Telo Mezini, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Gjirokastrës, dhe Ylvi Lulo i atashuar ambasador në Pakistan.

Vizita pati karakter protokollar dhe u përqëndrua në njohjen e dy vendeve dhe paraqitjen e gjendjes së tyre. Për palën pakistaneze prezantimi u bë nga Presidenti Khan, kurse për palën shqiptare nga Kryeministri Shehu. Gjatë dy ditëve qëndrimi në Pakistan, delegacioni shqiptar vizitoi disa ndërmarrje industriale, si edhe objekte kulturore. Vizita përfundoi me pritjen e dhënë nga Presidenti Khan për nder të delegacionit shqiptar. Në pritje ishin të pranishëm ministra, deputetë dhe personalitete nga jeta shoqërore e kulturore e vendit.

### **Ushtria po kthehej në një ndërmarrje bujqësore**

Pas vizitës së delegacionit qeveritar shqiptar në Pekin, me furnizimin me teknikë ushtarake e armatime për ushtri 500.000 vetëshe të planizuar nga Këshilli i Mbrojtjes, po bëhej realitet slogani i Hoxhës “I gjithë populli ushtar”. Sipas kësaj, strukturat ushtarake do të shpërnguleshin sa më pranë resurseve njerëzore, pra në fshat, pasi atëherë 70% e popullsisë jetonte në fshat. Atje do të krijoheshin tokat e reja si dhe tufat e bagëtisë, për të zbatuar detyrën e vënë prej tij: “T’i kthejmë malet në fusha”.

Detyra luftarake kishte mbetur e fundit, pasi efektivit nuk merrej më me stërvitje, por me punë bujqësie, me ndërtime për strehimin e efektivit dhe familjeve të oficerëve e nënoficerëve, me punime operative dhe duke shërbyer si roje pranë pikave të hapjes. Për stërvitje nuk tepronte as një orë në ditë.

Gjatë komandimit të Forcave Ushtarake – Detare, Parllaku e kishte ndjerë pak efektin shpërndarës të ushtrisë dhe ngarkimin me detyra jashtë destinacionit të saj, pasi njësitë e repartet detare kryenin detyra të gatishmërisë luftarake dhe ishin të kompletuara me efektiva aktivë, si repartet e Flotës Luftarake – Detare, të artilerisë bregdetare, të artilerisë kundërajrore e brigadat e tankeve. Edhe brigadat e këmbësorisë, që në 2/3-at komplettoheshin me rezervistë dhe vendndodhjen e kishin në bregdet, efektivin kryesisht e kishin nga qytetet e fshatrat me popullsi të dendur dhe pa shpërndarje të madhe. Gjithashtu duhet theksuar se tokat e bregdetit ishin kryesisht të punuara.

Forcat Ushtarake–Detare merreshin me punime fortifikuese të brezave të mbrojtjes dhe kontribuonin me punë sezonale në fushatat për mbjelljen e ullinjve të brezit bregdetar nga Vora gjer në Vlorë.

Edhe gjatë kohës të shërbimit në Komandën e Mbrojtjes Kundërajrore të Shtetit, forcat në vartësinë e Parllakut ishin të kompletuara me efektiv aktiv. Ato nuk ngarkoheshin me punime, pasi ishin forca të gatishmërisë luftarake të përhershme, si: repartet e aviacionit, të raketave, të artilerisë kundërajrore dhe të aparaturave të zbulimit dhe të drejtimit.

Kjo ishte gjendja e ushtrisë kur Parllaku u rikthye në Ministrinë e Mbrojtjes, pas 9 vjetësh pune në komandimin e dy njëjve më të mëdha të saj, të Forcave Ushtarake–Detare dhe të Forcave të Mbrojtjes Kundërajrore të Shtetit, me detyrën e Komandantit dhe, pas vendosjes të funksionit të komisarit, si komisar.

### **Sërish Zv.Ministër i Mbrojtjes**

Parllaku u emërua sërish si zv/ministër për përgatitjen luftarake dhe shkollat ushtarake, detyrë të cilën e kishte mbajtur edhe më parë, në vitet 1954 –1961. Tani kishte dy zëvendësa të rinj, gjeneralët Thoma Xhixho e Qazim Kapisyzi, që kishin qenë drejtorë të Përgatitjes Luftarake dhe kishin kryer edhe

mjaft detyra të tjera të larta. Mendonte se më së fundi kthehej vëmendja nga përgatitja luftarake si detyra kryesore për rritjen e gatishmërisë luftarake në mbrojtje të vendit, por kthimi në ministri e ballafaqoi me një realitet krejt tjetër. Ushtria kishte ndryshuar në sasi, në strukturë dhe në botkuptimin e përgatitjes dhe të gatishmërisë luftarake. Nuk ishte më ushtria e kazermës që ndodhej në çdo orë në kabinetet mësimore apo në poligonet e stërvitjes, e gatshme që, me dhënien e alarmit, brenda 3 orëve të zinte pozicionet mbrojtëse.

Nga ministria dërgoheshin plane e programe, por nuk llogaritej koha për zbatimin e tyre.

Ushtria ishte e shpërndarë në të gjithë vendin, në qindra pika hapjeje, me një efektiv të limituar dhe tepër të ngarkuar me detyra jashtë destinacionit të gatishmërisë luftarake.

Gjatë vitit stërvitor u përpoqën me të gjitha forcat të nxitnin komandat e njëjseve, për të shfrytëzuar çdo orë të lirë dhe çdo ditë pushimi për stërvitje ushtarake, por veç kohës mungonte edhe baza materiale për mësim e stërvitje, mungonin klasat, fushat e poligonet për kalitje fizike e përgatitje luftarake, që s'mund të krijoheshin e funksiononin në gjithë ato pika hapjeje.

### **Raporti që nuk i pëlqeu udhëheqjes**

Pas një viti pune në drejtim të përgatitjes luftarake, bënë inspektimin dhe vlerësimin e rezultateve të arritura në procesin stërvitor për të gjitha njësitë dhe rezultatet nuk ishin të kënaqshme.

Binte në sy fakti që rezervistët që kishin kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak kur ushtria ishte në kazerma, kishin rezultate më të mira në të gjitha lëndët e përgatitjes luftarake, pasi gjatë shërbimit 2-3-vjeçar stërvitja e tyre kishte qenë intensive dhe shprehitë e fituara i kishin rezistuar kohës.

Në raportin e përgatitur pas inspektimit, u vu në dukje rënia e cilësisë së përgatitjes luftarake dhe dobësimi i rregullit e

disiplinës që cënonte gatishmërinë luftarake. Si shkak kryesor u theksua shpërndarja e efektivit në shumë pika hapjeje dhe ngarkimi i tyre me shumë punime e shërbime që nuk iu linin kohë për stërvitje.

Raporti u diskutua në udhëheqje dhe në Kolegjiunin e Ministrisë dhe për të nuk pati ndonjë vërejtje të veçantë.

Parllaku i propozoi Ministrin të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, para analizës vjetore me kuadrot e ushtrisë, që një kopje të këtij raporti t'ia dërgonin Këshillit të Mbrojtjes me shpresë që gjatë analizës, të ishte i pranishëm Kryeministri për të dëgjuar mendimet e tyre dhe të komandantëve të njësive, mbi dëmet që po i sillte ushtrisë shpërndarja, punimet në bujqësi, në ndërtim e në shërbime të tjera, me qëllim që të binin dakord me ta e të ndihmonin në frenimin e këtij fenomeni.

Pas dy-tre ditësh, Parllakun e telefonoi Kryeministri, i cili nuk kishte gjetur në zyrë B. Ballukun e P. Dumen dhe pasi u informua nga Parllaku se çfarë kërkonte konkretisht, e pyeti për inspektimin. Parllaku e vuri në dijeni për rezultatet jo të mira, për analizën vjetore, për raportin që kishin përgatitur dhe se mund t'ia dërgonte një kopje.

Të nesërmen, me anë të një telefonate, M. Shehu i tha se e kishte lexuar raportin, ishte njohur me gjendjen jo të mirë që kishin gjetur komisionet në njësi e reparte dhe se kopjen e raportit nuk do t'ia kthente, por do t'ia kalonte për dijeni Enver Hoxhës.

Informoi Ministrin e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm që raportin ia kishte dërguar Kryeministrin, por atyre nuk iu erdhi mirë që ishte vënë në dijeni më parë Kryeministri dhe sidomos Komandanti i Përgjithshëm. Nga ana tjetër, Parllaku ndihej i qetë, pasi kërkonte ta lehtësonte ushtrinë nga punimet e shumta që po ia zinin frymën dhe nuk kishte përse ta fshihte gjendjen e krijuar.

Ndërkohë, Drejtori Politik, Hito Çako, kishte dërguar në Komitetin Qendror të Partisë një raport mbi gjendjen moralo

– politike të efektivit të ushtrisë dhe mbi disa probleme të stilit dhe të metodës të drejtimit nga udhëheqja e Ministrisë së Mbrojtjes, për të cilat kishin lindur diskutime.

### **E ashtuquajtura konsultë për ushtrinë**

Këto raporte u bënë objekt i një konsulte të organizuar nga Komiteti Qendror i Partisë, që u drejtua nga Hysni Kapo, Sekretar i Komitetit Qendror të Partisë.

Në konsultë ishin thirrur komandantët e drejtorët kryesorë të llojeve të armëve e shërbimeve në ministri, si edhe komandantët e komisarët e njëjësive kryesore të ushtrisë.

Diskutimet e konsultës u përqëndruan në gjendjen e përgatitjes luftarake të efektivave e të kuadrit oficer, si edhe të problemeve të tjera të jetës dhe veprimtarisë së trupave.

Në konsultë mungonte Ministri i Mbrojtjes, por shumica e kuadrove të ushtrisë radhitën arsyet e uljes së cilësisë në përgatitjen ushtarake, duke theksuar se oficerët në vend që të merren me stërvitje, u zihet koha me drejtimin e punimeve operative ekonomike, se jetojnë larg familjeve dhe u mungojnë kushtet për jetesë normale, studim e përgatitje.

Hysni Kapos nuk i pëlqyen diskutimet që e vinin theksin te arsyet objektive të rënies së nivelit të përgatitjes luftarake. Në fjalën e tij, ai tha se vështirësitë me të cilat përballet ushtria pas “reformave revolucionarizuese” dihen, por duhet të kapërcehen deri në stabilizimin e reparteve në vendet e reja të dislokimit. Gjithashtu, ai tha se kishte edhe shumë mungesa subjektive që nuk mund të justifikoheshin me ato objektive, siç ishin ngritur nga Parllaku në raportin “Mbi gjendjen e përgatitjes luftarake”, pas inspektimit vjetor.

Për çudinë e të gjithëve, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Petrit Dume, aprovoi në një farë mënyre mendimet e H. Kapos, duke theksuar të metat e metodës së drejtimit në Ministrinë e Mbrojtjes, në një kohë që ushtarakët kërkonin të

frenohej shpërndatja e mëtejshme e ushtrisë në pika hapjeje dhe lehtësimi nga detyrat e shumta jashtë destinacionit ushtarak që po e shkatërronin atë.

Parllaku, mendimet e tij, i kishte shprehur hapur në raport dhe ato u mbështetën nga shumica e pjesëmarrësve në konsultë. Ai diskutoi për mendimet që kërkonin shkurtimin e kohës së përgatitjes të studentëve për oficerë në shkollat ushtarake dhe që mbështeteshin nga Hysni Kapo, në një kohë kur Parllaku kërkonte të zgjateshin edhe një vit studimet e tyre dhe kishte rënë dakord me Ministrinë e Arsimit për të shtuar në programet mësimore edhe disa lëndë universitare, në mënyrë që diploma e shkollave ushtarake të bëhej e barazvlefshme me atë të disa instituteve apo fakulteteve. Qëllimi i Parllakut ishte të ndihmoheshin oficerët, që në rast paaftësie ose të daljes në lirim të parakohshëm, të kishin mundësi, sipas diplomës të përftuar, të punonin në institucionet e tjera. Zëvendësi i Parllakut, gjeneral i kulturuar e oficer karriere me akademi të lartë ushtarake, ishte për shkurtimin e kohës së studimit. U dëgjuan edhe absurditete si në rastin kur një komisar dha shembullin se si një ushtar që kishte mbaruar shkollën e nënoficerit e komandonte togën më mirë se oficeri.

Parllaku u detyrua të sqarojë se studentët ushtarakë janë si të gjithë studentët e tjerë që mbarojnë shkollat e mesme. Në universitete zgjerohen njohuritë kulturore dhe bëhen profilizimet në drejtime të caktuara shkencore, e njëjta gjë vlente edhe për studentët ushtarakë, që profilizoheshin sipas armëve, vazhdonin akademitë ushtarake dhe zhvillonin njohuritë e artit ushtarak, si shkencë e të gjitha shkencave. Oficeri përgatitet të drejtojë jo vetëm togën, por duke bërë karrierë do të përgatitet për të komanduar edhe batalion, brigadë, divizion dhe në bazë të aftësive edhe njësi më të mëdha. Nëse arti ushtarak do të vlerësohej si të gjitha shkencat e tjera, atëherë duhet t'i jepej koha e duhur për studim, si mjekut, inxhinierit, etj.

Në sallë pati tension dhe krahasimi i Parllakut nuk i pëlqeu Hysni Kapos, por ai vazhdoi.

Diskutimet e oficerëve përqëndroheshin kryesisht te përgatitja e gatishmëria luftarake, jo te mbjellja e patateve apo te tufat e bagëtive, pasi përgatitja për mbrojtjen e vendit ishte shqetësimi kryesor.

### **Byroja Politike e KQ të PPSH analizon punën e ushtrisë**

Pas kësaj konsulte, u bë mbledhja e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, ku u analizua gjendja në ushtri sipas përfundimeve të konsultës dhe raporteve të dërguara nga MM. Në mbledhje ishte i ftuar dhe Rrahman Parllaku. Diskutuan të gjithë anëtarët e Byrosë Politike të KQ të PPSH, të cilët u përqëndruan te raporti i Drejtorisë Politike, që ngrinte probleme të stilit e të metodës të drejtimit në ushtri, gjithmonë duke u spostuar nga problemi kryesor që ishte përgatitja e gatishmërisë luftarake të ushtrisë dhe kritikuan B. Ballukun e P. Dumen, si drejtuesit kryesorë të ministrisë.

Parllaku kritikohej, pasi në raportin mbi gjendjen e përgatitjes e të gatishmërisë luftarake, të metat e dobësitë e konstatuara i kishte justifikuar me shkaqe objektive dhe jo me të meta të drejtimit, që kishin dalë si të meta kryesore gjatë analizës së zhvilluar. Gjithashtu kritikohej për pikëpamje jo të drejta në lidhje me politikën për përgatitjen e oficerëve.

Kritikat iu adresuan direkt nga Enver Hoxha, gjatë konkluzioneve të tij. Parllaku bëri një ndërhyrje gjatë fjalës së tij, që u cilësua pa takt nga të pranishmit, pasi nuk kishte ndodhur ndonjëherë që të ndërpritej fjala e E. Hoxhës, por në atë moment ndërhyri Mehmet Shehu, i cili i dha të drejtë, pasi stërvitja donte shumë dije dhe energji. M. Shehu tregoi se në fund të një stërvitjeje të zhvilluar në një repart të Vlorës, komandantët e togave e të kompanive i kishin patur rrobat sikur sapo kishin dalë nga uji.

Ndërhyrja e tij e lehtësoi disi Parllakun.

Nga kjo analizë, shumë ushtarakë dolën me vërejtje.



Shpërndarja e mëtejshme e ushtrisë vazhdoi. Detyrat në punime bujqësore, në ndërtime e në fortifikime u shtuan. Kjo lloj taktike tashmë po shtonte edhe efektiva për shërbimin roje. Koha për stërvitje u reduktua në maksimum. Gatishmëria luftarake e fuqia mbrojtëse e vendit u dëmtuan rëndë. Vendi ishte i ekspozuar para rrezikut për dështimin që mund të sillte katastrofë, pasi tani nuk kishte mbetur më asnjë repart gatishmërie që të priste goditjet e para të armikut, derisa të vihej në gatishmëri ushtria e të bëhej mobilizimi i rezervistëve dhe kompletimi i ushtrisë.

Mehmet Shehu, gjatë analizës, të metat e ushtrisë ia ngarkoi kryesisht Beqir Ballukut dhe u përpoq ta largonte atë nga detyra e drejtuesit kryesor të ushtrisë, pasi dihehin marrëdhëniet e tyre të acaruar. Por kjo nuk u arrit dhe në fund të mbledhjes së byrosë, ai propozoi të rishikohej struktura organizative e Ministrisë së Mbrojtjes, për t'iu përshtatur më mirë kushteve të zhvillimit të ushtrisë pas zbatimit të reformave.

Propozimi u pranua nga byroja dhe u vu si detyrë të bëhej një studim, që do t'i paraqitej për aprovim Këshillit të Mbrojtjes.

### **Këshilli i Mbrojtjes zhvesh nga kompetencat Ministrin e Mbrojtjes. Kontradiktat midis M.Shehut dhe B. Ballukut**

Në bazë të këtij vendimi, në fillim të vitit 1971, Këshilli i Mbrojtjes aprovoi projektin për riorganizimin e Ministrisë së Mbrojtjes, paraqitur nga grupi i punës.

Në strukturën e aprovuar u hoqën nga vartësia e Ministrit të Mbrojtjes të gjitha drejtoritë e shërbimeve e llojeve të armëve.

Në vartësi direkte të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm kaluan Komanda e Mbrojtjes Kundërajrore të Shtetit, Komanda e Flotës Luftarake-Detare, Komanda e Artilerisë, e Tankeve dhe drejtoritë, e xhenios, e përgatitjes luftarake, e teknikës dhe e autotraktorëve.

Në vartësi direkte të ministrit mbeti Shefi i Shtabit të

Përgjithshëm, që tashmë ishte drejtori kryesor i ushtrisë dhe Drejtoria e Prapavijave të Ushtrisë.

Për të ndihmuar Shefin e Shtabit të Përgjithshëm në organikë u emëruan dy zv/ ministra. Njëri ishte Rrahman Parllaku, që do të kishte në vartësi Drejtorinë Operative, të zbulimit, të organizim-mobilizimit, të ndërlidhjes, të kimisë, si edhe degën e topografisë e të shërbimeve, kurse zëvendësi i dytë do të ishte Mendu Backa, i cili do të kishte në vartësi Drejtorinë e Xhenios, të fortifikimit xhenier, atë teknike, industrinë ushtarake, si dhe të autotraktorëve.

Motivimi i largimit të Ministrit të Mbrojtjes nga drejtimi direkt i komandave dhe drejtorive të armëve u bë gjoja me arsyen se ai ishte shumë i ngarkuar me detyra të larta partie dhe për arsye shëndetësore, por kjo nuk ishte e besueshme për ushtarakët, që e dinin se marrëdhëniet e Shehut me Ballukun nuk ishin të mira. Kështu, duke mos e larguar dot përfundimisht nga detyra, drejtimi efektiv i ushtrisë po i besohej P. Dumes, si një person më i përshtatshëm për të.

Edhe në kushte pune shumë të vështira për ushtrinë, kuadri oficer po përpiqej me mish e me shpirt për të inkuadruar efektivin që kryente shërbimin aktiv me atë rezervist dhe po bëheshin përpjekje maksimale për të shfrytëzuar kohën në kryerjen e stërvitjeve të gatishmërisë luftarake. Njëkohësisht, punohej ditë e natë për sistemimin e efektivit në vend-dislokimet e reja, nëpër pikat e hapjes.

Puna këmbëngulëse e efektivit oficer çoi në arritjen e disa rezultateve në përgatitjen luftarake të vitit 1970-1971, të cilat u paraqitën si suksese të riorganizimit të udhëheqjes së Ministrisë së Mbrojtjes.

### **Pleniumi i XII-të i KQPPSH dhe porosia e përgatitjes së tezave për mbrojtjen e vendit me forcat tona**

Në korrik të vitit 1971 u bë mbledhja e Plenumit të XII-të të Komitetit Qendror të Partisë të Punës së Shqipërisë, që

do të analizonte gjendjen në ushtri. Para pleniumit, Aparati i Komitetit Qendror, në bashkëpunim me Drejtorinë Politike të Ushtrisë bënë kontrolle mbi zbatimin e reformave në ushtri, në disa njësi e reparte. Siç pritej, konkluzionet ishin pozitive dhe mbi to u bazua raporti i Byrosë Politike që iu paraqit mbledhjes së Pleniumit.

Në mbledhjen e Pleniumit të XII-të , raportin në emër të Byrosë Politike e mbajti Beqir Balluku, Ministër i Mbrojtjes. Në raport analizoheshin arritjet e mungesat e konstatuara gjatë zbatimit të reformave në ushtri.

Në diskutime, siç ndodhte rëndom në atë sistem, mbizotëroi fryma optimiste për arritjet dhe perspektivat e zhvillimit të ushtrisë. Edhe diskutantët e ftuar nga rrethet ku ishin të dislokuara repartet ushtarake folën mirë, veçanërisht për marrëdhëniet e krijuara mes tyre, për sjelljen shembullore të ushtarakëve me popullsinë dhe ndihma që po u jepnin reparteve ushtarake organet e pushtetit vendor, që të sistemoreshin sa më mirë në vendqëndrimet e reja, duke iu krijuar kushte sa më të mira jetese dhe stërvitjeje.

Në mbledhjen e pleniumit u krijuar një atmosferë euforike suksesesh, që nuk lejonte diskutime me nota kritike, por Rrahman Parllaku përsëri ngriti shqetësimin se shpërndarja e madhe e ushtrisë dhe detyrat e shumta jashtë programeve stërvitore po dëmtonin jo vetëm përgatitjen luftarake, por edhe rregullin, disiplinën në ushtri dhe gatishmërinë luftarake.

Konkluzionet e E. Hoxhës në fund të pleniumit ishin shumë pozitive për gjendjen në ushtri. Ai lavdëroi Beqir Ballukun për aftësitë e tij ushtarako - drejtuese, kur faktikisht para pak kohësh e kishte mënjeluar nga drejtimi i ushtrisë dhe përsëriti kërkesën që tani që i kishin studiuar projekt - tezat e Këshillit të Mbrojtjes, të bënin propozimet për korrigjime, plotësime e ndryshime para se projekt-tezat të ktheheshin në teza.

Nuk ishte çudi, pasi këto ishin truket e Enverit, që kërkonte të kishte pushtet absolut, pa pyetur për zërin ekspert. Deri dje kishte lavdëruar Mehmetin për hartimin e shkëlqyer të

projekt -tezave, tani lavdëronte Beqirin për suksese në ushtri dhe kërkonte nga ushtria ndryshime të projekt-tezave, për t'i aprovuar si teza në Këshillin e Mbrojtjes.

Plani i E. Hoxhës funksionoi, pasi kuadrot ushtarake besuan se zëri i tyre do të dëgjohej dhe punët do të shkonin për së mbari.

Dy ditë pas përfundimit të pleniumit, B. Balluku mbledhi komandantët e drejtorët. Parllaku në ato kohë kurohej për arsye shëndetësore. Ministri B. Balluku kishte dhënë urdhër të dorëzoheshin sa më parë vërejtjet e propozimet e tyre për projekt-tezat. Gjithashtu, duke mënjeluar Shefin e Shtabit të Përgjithshëm dhe Institutin e Studimeve Ushtarake, krijoi një grup pune që do ta drejtonte vetë.

Në krye të grupit caktoi Zv/Drejtorin e Institutit të Studimeve Ushtarake, Gjeneral Spiro Shalsin. Grupi përbëhej nga Zv/Drejtori i Zbulimit, Agron Çomo, nga Zv/Drejtori i Organizim-Mobilizimit, Hysen Burba, nga Ilo Furxhi, etj.

Duke shfrytëzuar pushimin e verës, u nis bashkë me grupin në qytetin e Pogradecit, ku të vendosur në shtëpinë e pushimit të ushtarakëve, punuan mbi projekt-tezat.

Me mbarimin e materialit, para se t'ua shpërndante drejtorive të llojeve të armëve e të shërbimeve në ministri, B. Balluku ua dha P. Dumes, H. Çakos dhe Rr. Parllakut, për t'i parë dhe për të dhënë mendimet e tyre.

Të tre, pasi u njohën gjerësisht me materialin, shkuan në takim te ministri me vërejtjet dhe me konkluzionin se materiali nuk duhej t'iu shpërndahej kuadrove kryesore të ushtrisë, pasi nuk i shërbente korigjimit dhe plotësimit të projekt-tezave për të bërë aprovimin e tyre e për t'i kthyer në teza, sipas porosisë së Komandantit të Përgjithshëm.

Ministrit, sigurisht që nuk i erdhi mirë, por ra dakord me kuadrot e larta ushtarake dhe materiali nuk u shpërnda. Ai kërkoi që vërejtjet t'i bënin me shkrim dhe Parllaku me Çakon ia dorëzuan, kurse P. Dumja, sipas tij, nuk pranoi të dorëzonte vërejtje me shkrim për një material që nuk kishte vlerë.

## **Fuqizimi i rolit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm pas dobësimit të rolit të Ministrit të Mbrojtjes**

Duhet theksuar se P. Dume, Shef i Shtabit të Përgjithshëm, megjithë porositë e Komandantit të Përgjithshëm për korrigjime dhe megjithëse kishte vërejtje mbi projekt-tezat, asnjëherë nuk u shpreh hapur mbi to, sepse siç duket ndikonte fakti se autori i projekt-tezave ishte kryeministri i vendit.

Gjatë kësaj kohe, në drejtimin e veprimtarisë së Ministrisë së Mbrojtjes vihej re një sjellje e hapur pavarësie e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, që u jepte urdhëra njësisive e reparteve pa u konsultuar as me Ministrin e Mbrojtjes, as me zëvendësant e tij që zbatonin urdhërat dhe as me komandantët e drejtorët e llojeve të armëve që tashmë i kishte në vartësi direkte.

Vështirësia e zbatimit të urdhërave ishte se ato duheshin siguruar materialisht, pasi kishin të bënin me ndërtime e fortifikime xheniere. Kjo sillte shumë probleme, pasi nuk mund të kërkoje nga komandat e drejtoritë e llojeve të armëve zbatimin e urdhërave, pa siguruar më parë mjetet materiale e financiare për zbatimin e tyre.

Planet e aprovuara më parë nuk kishte të drejtë ndryshimi, prandaj Parlaku, Backa, së bashku me komandantët e drejtorët e ministrisë i kishin ngritur disa herë këto probleme në mbledhjet me ministrin, me Shefin e Shtabit dhe në mbledhjet e Kolegjiumit të Ministrisë, por asgjë nuk po ndryshonte. Situata po rëndohej më shumë dhe ushtria vazhdonte shpërndarjen e saj në më shumë pika hapjeje në të gjithë vendin. Në situatën e krijuar ndikonte shumë keq pavendosmëria e ministrit për të frenuar urdhërat e pastudiuara mirë e jashtë planeve që kishin aprovuar, të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, por ministri Balluku e dinte mbështetjen që Shefi i Shtabit të Përgjithshëm kishte nga Kryeministri i vendit.

## **Parllaku kërkon të largohet nga detyra e Zv. Shefit të Shtabit të Përgjithshëm**

Në kushtet e krijuara ishte e pamundur të punoje qetësisht. Probleme kishte me riorganizimin dhe krijimin e pikave të hapjes. Ato kërkonin strehim për efektivin e vend-dislokimeve të reja dhe depo për armatimin e teknikën luftarake. Komandat e njësitë e reparteve kërkonin ndihmë për përballimin e gjendjes, kur mjetet financiare e materiale nuk mund të plotësonin as 50% të detyrave planizuese dhe as që mund të bëhej më fjalë për detyra plotësuese.

Ishte e domosdoshme që në drejtim të ishte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, pasi ai ishte personi i vetëm që kishte funksionin dhe kompetencat të përqëndronte të gjitha organet drejtuese të ministrisë, që tashmë ishin në vartësi të tij, të studionte problemet dhe të koordinonte veprimet e të gjithë aparatit për zbatimin e detyrave. Vetëm Shefi i Shtabit mund të jepte urdhëra në emër të ministrit, por ai ishte vazhdimisht në lëvizje. Parllaku, si zëvendës, jo vetëm nuk kishte fuqi ligjore që t'u përgjigjej kërkesave të komandave e drejtorive të Ministrisë së Mbrojtjes dhe as kërkesave të njërive e reparteve më poshtë, por edhe nuk donte t'i drejtohej ministrit, duke anashkaluar superiorin direkt, që ishte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, të cilin e vinte në dijeni për çdo detyrë të marrë nga Ministri i Mbrojtjes.

Ishte në pozitë të vështirë dhe puna nuk po i jepte asnjë kënaqësi. Nga ana tjetër, vuante nga diabeti dhe shqetësimet ia kishin rënduar shëndetin.

Prandaj në një takim me Ministrin e Mbrojtjes, me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm dhe me Drejtorin Politik u kërkoj atyre largimin nga detyra. Të tre kundërshtuan duke shprehur vlerësime për punën e tij, për marrëdhëniet shumë të mira me stafin e ministrisë, me komandat e njërive e reparteve, etj. P. Dume i pranoi të gjitha vërejtjet e Rr. Parllakut si të drejta dhe premtoi se do të kufizohej në dhënien e urdhërave pa u

konsultuar me të dhe me Mendu Backën apo me drejtuesit e llojeve të armëve e shërbimeve, por situata vazhdoi po njësoj.

Parllaku u detyrua t'i kërkojë takim Enver Hoxhës për t'i parashtruar problemet dhe kërkesën e tij për largim nga detyra. Pa kaluar 2-3 ditë e telefonoi Hysni Kapo që i tha se Enveri ishte me pushime dhe nëse pranonte mund të bisedonin bashkë. E lanë të bisedonim gjatë zhvillimit të stërvitjes me korpusin e Tiranës, ku ai do të ishte i pranishëm dhe për Parllakun nuk ishte problem të ishin të pranishëm edhe B. Balluku, P. Dume e Hito Çako, se ata ishin në dijeni të kërkesës së tij. Takimi u bë në afërsi të fshatit Rasë të Belshit dhe i pranishëm ishte përveç tyre edhe Adil Çarçani, që kishte ardhur edhe ai për të ndjekur stërvitjen.

Ua bëri prezent edhe njëherë arsyet pse kërkonte të largohej dhe u ndal tek më kryesoret. Sipas Parllakut, nuk po i përshtatej dot stilit të drejtimit në Shtabin e Përgjithshëm dhe nuk mund të bëhej pengesë për mbarëvajtjen e punëve, gjë që e rëndonte dhe anën shëndetësore. Gjithashtu, nëse nuk ishin dakord për largimin nga ushtria, ai mund të drejtonte kudo në korpuset e vendit, ku kishte pasur vetëm suksese për vite me radhë. Mund të shkonte me kënaqësi edhe në korpusin e Pukës, të sapoformuar.

Të gjithë shprehën edhe njëherë konsideratat maksimale për punën e Parllakut dhe vlerësuan arritjet e tij në organizimin dhe koordinimin e punëve pasi kishte eksperiencë si Zv/Ministër i Mbrojtjes dhe si komandues i suksesshëm i njëjve kryesore të mbrojtjes. Veçanërisht, ata u ndalën te komunikimi i shkëlqyer me vartësit kryesorë të llojeve të armëve e të shërbimeve në ministri dhe që ndikonte direkt në realizimin me sukses dhe në afat të detyrave.

P. Dume edhe në atë takim ra dakord se do të kufizonte lëvizjet e tepërta për të qëndruar në krye të punëve që i kërkonte detyra, por asnjëri nuk e pranoi largimin e Parllakut.

Hysni Kapo foli me superlativa për aftësitë e Parllakut, për të cilat ishte dekoruar disa herë, se ai i duhej ushtrisë në

Shtabin e Përgjithshëm dhe këtë shqetësim do t'ia përcillte dhe shokut Enver.

### **Dalin në skenë projekt-tezat e mbrojtjes, përsëri përplasja Shehu-Balluku**

Koha po kalonte dhe materiali për projekt-tezat nuk po përgatitej. Ministri Beqir Balluku ishte i shqetësuar, pasi nuk po zbatoheshin porositë e Komandantit të Përgjithshëm, prandaj kërkoi nga Parllaku të lejonte dy vartësit e tij të Drejtorisë Operative, Vehbi Hoxhën dhe Ernest Jakovën të merreshin me ripunimin e materialit. Sigurisht kërkesa u zbatua.

Me përfundimin e materialit përsëri ua dhanë për rishikim P. Dumes, Hito Çakos dhe Rrahman Parllakut. Pati shumë vërejtje, por për çudi edhe vetë autorët e materialit nuk ishin të kënaqur, pasi puna me korniza e diktimit, se çfarë duhet të bësh e si duhet ta punosh, s'mund të jetë asnjëherë punë krijuese. Ndërsa Beqir Balluku preokupohej që po vonohej zbatimi i detyrës së vënë nga Enver Hoxha, Petrit Dume, indiferent, asnjëherë nuk u mor me këtë punë, ndonëse kjo ishte edhe detyrë e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.

Ministri kërkonte zgjidhje të problemit dhe i mblodhi për herë të tretë kuadrot kryesore. Këtë herë të gjithë vendosën që këtë punë ta merrte përsipër Rrahman Parllaku me Ernest Jakovën. Parllaku pranoi duke vënë si kusht largimin nga detyra deri në përfundim të materialit. Pa mbaruar planin dhe tematikën e punës, Rrahmanin e thirrën me urgjencë në zyrë, pasi P. Dumja, si zakonisht, kishte shkuar në reparte dhe Shtabi i Përgjithshëm kishte mbetur pa drejtim. Ernest Jakova e kërkonte pa pushim, por nga problemet e shumta të zyrës, Parllaku nuk mund të lëvizte. Ministri Balluku pranoi të punonte vetë me Ernestin dhe Rrahmanin të vazhdonte punën në Shtabin e Përgjithshëm. U krijua përshtypja se dëshironte që materiali të mbante firmën e tij.



## Diskutimi i tezave tek Plazhi i Gjeneralit në Durrës

Materiali përfundoi nga fundi i prillit 1973. Me urdhër të ministrit, materiali iu dorëzua për vërejtje e korrigjime kuadrove kryesore të ministrisë dhe njërive. Mendimet mbi materialin u lanë të diskutoheshin në mbledhjen kryesore të radhës, që do të zhvillohej me grupin e Ministrit të Mbrojtjes, në Durrës, në ditët në vijim.

Me urdhër të Shefit të Shtabit, materiali u shpërnda i shoqëruar nga shkresa me porositë e ministrit.

Mbledhjen mësimore me kuadrot kryesore të ushtrisë e drejtonte Zv/Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Rahman Parllaku. Ishin vendosur te pishat e Golemit të Kavajës, te Plazhi i Gjeneralit. Në kohën e lirë, gjatë mbrëmjeve, oficerët diskutonin shpesh për materialin, bënin vlerësime të ndryshme, kishin vërejtjet e tyre herë pro e herë kundër dhe ngrinin edhe zërin në mbrojtje të mendimeve të tyre.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm vinte mbrëmjeve në kampin e stërvitjes, dëgjonte diskutimet e vërejtjet e oficerëve dhe bisedonte me ta.

Në një nga mbrëmjet, ai shkoi në çadrën e Parllakut dhe shprehu shqetësim mbi vërejtjet e dëgjuaara, pasi ato shpesh binin ndesh me projekt-tezat e Këshillit të Mbrojtjes. Parllaku i tha se materiali prandaj ishte përgatitur e shpërndarë për t'u plotësuar me vërejtje e ndryshime. Nga këto diskutime nuk kishte asnjë të keqe, pasi materiali do të korrigohej plotësisht.

Petrit Dume donte ta anulonte diskutimin e materialit, kurse Parllaku mendonte se duhej të përfundonte odiseja 3-vjeçare e studimit të këtij materiali.

Kuadrot e kishin lexuar dhe prisnin të thoshin mendimin e tyre, prandaj Parllaku i bëri të ditur Petrit Dumes se plani ishte aprovuar nga ministri, se ai, si shef shtabi e kishte firmosur, ishte caktuar edhe dita për diskutimin e tij, dhe pa urdhërin e

ministrit plani nuk mund të ndryshohej.

Siç doli më vonë, P. Dumja nuk e donte ndryshimin e projekt-tezave pasi ishin përgatitur nga Kryeministri, prandaj edhe nuk dha asnjëherë mendime për to.

Ditën e fundit, pasi bëri vlerësimet e stërvitjes të zhvilluar në Kryeviidh të Kavajës, me t'u kthyer në çadër, Parllakun e lajmëruan se e priste ministri Balluku në çadrën e tij. Atje, bashkë me ministrin ishte Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Petrit Dume, Drejtori Politik, Hito Çako dhe përfaqësuesi i ushtrisë pranë Komitetit Qendror të Partisë, ndihmës i Hysni Kapos, Dilaver Poçi.

Pasi dëgjoi mendimet e Rrahmanit mbi ecurinë e stërvitjes, ministri tha se mendimi i shokëve ishte të mos bëhej diskutimi i materialit, pasi edhe kohë nuk kishte. Parllaku sugjeroi se do të ishte mirë të dëgjoheshin mendimet e kuadrove në mënyrë që, siç e kishte biseduar edhe me P. Dumen, studimi i këtij materiali të përfundonte një herë e mirë. Atëherë ministri propozoi që mendimet me shkrim të oficerëve të grumbullohen dhe në një kohë të përshtatshme të diskutohen me nge nga komisioni.

U lajmëruan oficerët të mblihdeshin në çadrën e punës ku iu komunikua urdhëri i ministrit Balluku. Parllaku, atë mbrëmje, ndenji zgjuar deri vonë duke hedhur me shkrim mendimet e tij mbi materialin. Kështu u mbyll materiali i përgatitur me mendimet e oficerëve, bashkëngjitur.

### **Raporti i Drejtorisë Politike të Ushtrisë për konfliktin Balluku-Dume**

Në pranverë të vitit 1974, Drejtorja Politike e Ushtrisë bëri një raport për Komitetin Qendror të Partisë, në të cilin raportohej mbi gjendjen moralo-politike të ushtrisë dhe mbi gatishmërinë luftarake të efektivave të saj. Në raport ishte folur edhe për disa probleme të marrëdhënieve në Shtabin e Përgjithshëm dhe

midis Ministrisë dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, por pa sqaruar shkaqet e gjendjes dhe pa hyrë në detaje.

Sipas udhëzimit të Komitetit Qendror të Partisë, çdo raport i Drejtorisë Politike, që bënte fjalë për ushtrinë, duhej cikluar nga të gjithë anëtarët e Komitetit Qendror që ishin në drejtim të ushtrisë. Prandaj edhe Parllaku, pasi e lexoi, bëri ciklimin. Ndërkaq, Halim Ramohito, Zv. Drejtor Politik, e siguroi se me formulimet e bëra nga Drejtoria Politike në raport nuk do të kishte më pakënaqësira.

Më pas, Drejtori Politik, Hito Çako, i bëri me dije Parllakut se Hysni Kapo i kishte thënë që gjatë analizës së raportit në Byronë Politike do të ishte i pranishëm edhe ai, prandaj e porositi që të shprehte mendimet e tij në analizë.

Byroja Politike nuk e mori në analizë raportin, por caktoi Mehmet Shehun e Hysni Kapon të bisedonin me shefat e mëdhenj për problemet e ngritura në raport.

Në takim shkuan Beqir Balluku, Petrit Dume e Hito Çako, ndërsa Parllaku drejtonte një stërvitje të oficerëve të lartë të ushtrisë në Jug të vendit.

Pasi kishin dëgjuar mendimet e tyre, Mehmet Shehu e Hysni Kapo i kishin bërë vërejtje Beqir Ballukut e Petrit Dumes dhe kishin thënë se do t'i raportonin Byrosë Politike dhe Enver Hoxhës, ndërkohë që kishin porositur të merreshin masa të menjëhershme për rregullimin e gjendjes.

### **Petrit Dume akuzon dyshen Balluku-Parllaku si autorë të antitezave**

Sipas pohimeve të Mehmet Shehut dhe Hysni Kapos, në fund të takimit, Petrit Dume kishte deklaruar se marrëdhëniet e tij me ministrin Balluku ishin ideologjike, pasi lidheshin me një material teorik, përgatitur nga Beqir Balluku, ndihmuar nga Rrahman Parllaku, për të revizionuar projekt-tezat e Këshillit të Mbrojtjes. Këto fjalë i ka pohuar me gojë e me shkrim edhe

Enver Hoxha, kur ka deklaruar zbulimin e “veprimtarisë armiqsore të Beqir Ballukut e grupit të tij armiqësor”.

Parllaku lajmërohet të kthehet urgjentisht nga Delvina dhe t’ia lërë drejtimin e stërvitjes Arif Haskos, në atë kohë Zv/Ministër i Mbrojtjes.

Me t’u kthyer në Tiranë, Parllaku i telefonon Petrit Dumes për ta pyetur mbi arsyen e kthimit të parakohshëm nga stërvitja, por ai i tha të sqarohej me Ministrin e Mbrojtjes. Parllaku telefoni Ballukun, por ai nuk iu përgjigj. Atëherë, Parllaku i telefoni Hito Çakos, i cili bëri të paditurin. Rrahmani u detyrua t’i telefonojë përsëri Petrit Dumes, nga i cili mori njoftimin se të nesërmen në orën 09.00 duhet të ishte në zyrën e Kryeministrit. Situatë e nderë, e pakuptueshme, të gjithë bënë të paditurin. Në përgjim, organet e sigurimit inçizonin se çfarë do të bisedonin Rrahman Parllaku e Beqir Balluku.

Kështu pra, materiali që ishte mbyllur para një viti, në maj 1973, që ishte i njohur e i studiuar nga të gjithë kuadrot e larta të ushtrisë, u zbulua në qershor 1974. Vetëm tani që u denoncua nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm në takimin me Kryeministrin Mehmet Shehu dhe me Sekretarin e Komitetit Qendror të Partisë, Hysni Kapon.

Materiali i përgatitur nga Beqir Balluku do të quhej material armiqësor, material i zi, material i antitezave ose thjesht antitezat.

### **Fillimi i akuzës politike dhe ushtarake**

Në korrik 1974, Beqir Balluku dhe Rrahman Parllaku u vunë nën akuzë. Beqiri akuzohej se kishte këmbëngulur për përgatitjen e materialit dhe kishte punuar për formulimin e tij dhe Parllaku si bashkëpunëtor në formulimin e tij dhe që kishte bërë shpërndarjen te oficerët kryesorë të ushtrisë, duke këmbëngulur që ata ta diskutonin dhe të jepnin mendime për

të. Kjo, sipas Enver Hoxhës, mund të sillte çoroditje te oficerët.

Të nesërmen, para se të shkonte në Kryeministri, Parllaku kaloi nga Ministria e Mbrojtjes dhe takoi zëvendësin e tij, Muhamet Prodanin, i cili e njoftoi se edhe atë e kishin thirrur në Kryeministri. Aty i priste Hysni Kapo dhe Mehmet Shehu, i cili hyri menjëherë në temë duke pyetur mbi marrëdhëniet në udhëheqjen e Ministrisë. Parllaku tha se i kishte kërkuar shokut Hysni të largohet nga detyra e Zv.Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, pasi nuk po i përshtatej stilit të punës së Petrit Dumes.

Kur Mehmet Shehu pyeti për materialin e përgatitur mbi projekt-tezat, Parllaku i tha se e kishte studiuar dhe me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm ua kishte shpërndarë për ta studiuar dhe për të dhënë mendimet e tyre, komandave e drejtorëve, zëvendësve të tyre në ministri, si edhe komandantëve, komisarëve dhe shefave të shtabit të njëjsteve.

Gjithashtu, Parllaku i bëri me dije Kryeministrit se diskutimi i materialit në mbledhjen stërvitore u anulua nga ministri Balluku, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe se kuadrot i kishin dorëzuar mendimet e tyre me shkrim.

Atëherë, Kryeministri Shehu e pyeti për mendimin e tij personal mbi materialin dhe Parllaku i tha se edhe ai, si të tjerët, që atë natë kishte bërë vlerësimet dhe vërejtjet e tij, dhe në fund kishte shtuar që materialit duhet t'i bëheshin ndryshime e plotësime sipas mendimeve të dhëna nga kuadrot e ushtrisë, pasi mendonte se në formën që ishte nuk duhet t'i kalonte ushtrisë.

Pas Rrahman Parllakut, Kryeministri iu drejtua Muhamet Prodanit, i cili kur e pyeti për materialin, iu përgjigj se e kishte hedhur poshtë si armiqësor. Me kaq përfundoi takimi në Kryeministri.

### **“Grupi puçist”**

Pas këtij “zbulimi”, të rriturit dhe rinia e asaj kohe, por edhe brezi pasardhës, që ishte i detyruar të lexonte veprat e

Enver Hoxhës dhe historinë e Partisë së Punës, të përgatitur nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, të drejtuar nga Nexhmije Hoxha, mësuan se në udhëheqjen e ushtrisë, në vitin 1974, u zbulua një “grup puçist” që ishte në shërbim të imperializmit, të socialimperializmit e të fuqive të tjera dhe që komplotonte për përmbysjen e pushtetit popullor në Shqipëri.

U përgatitën e u shpërndanë akuza monstruoze, të pabazuara në asnjë fakt e dokument, por të thëna në fjalimet e Enver Hoxhës, në dokumentat e sajuara nga sigurimi famëkeq i shtetit dhe të shpërndara nga aparati i propagandës i Partisë së Punës.

Për të gjykuar “veprimtarinë armiqësore” të Beqir Ballukut ishte mbledhur Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë dhe kishte vendosur shkarkimin e tij nga të gjitha detyrat partiake e qeveritare, dhe kjo pa dijeninë e anëtarëve të Komitetit Qendror dhe pa analizuar më parë akuzat që i bëheshin. Vendimi nuk ishte shpallur ende, por ishte zbatuar faktikisht.

Nga 10 deri më 12 Korrik 1974 u zhvillua mbledhja e aktivitetit të kuadrove të larta të ushtrisë në pallatin mbretëror, në Durrës.

Sipas organizatorëve të mbledhjes, qëllimi kishte qenë që Beqir Balluku fillimisht të gjykohej e dënohej nga masa e oficerëve të lartë të ushtrisë dhe më pas, përfundimet e aktivitetit t’i kalonin mbledhjes së Pleniumit të V-të të Komitetit Qendror të Partisë, që do të gjykonte veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut. Kështu, duke pasur në dorë përfundimet e aktivitetit, pra “zërin e masës”, Byroja Politike do të justifikonte dënimin e Beqir Ballukut dhe në të vërtetë, këtë po e bënte pa dëgjuar as zërin e anëtarëve të Pleniumit të Komitetit Qendror e jo më zërin e oficerëve.

Për ta shfrytëzuar e për ta bërë sa më të besueshëm “zërin e masës”, ishte vendosur që kuadrove pjesëmarrës në aktivitet të mos u thuhej se çfarë kishte ndodhur me Beqir Ballukun, por të shtrohej për diskutim dhe të kërkoheshin mendime

për materialin. Por te organizatorët ishin shfaqur dyshime në lidhje me qëndrimin aprovues apo dënues të materialit dhe të autorit. Edhe mungesa e ministrit në mbledhjen përkujtimore të 10 Korrikut, jubileut të 30-vjetorit të krijimit të ushtrisë, ngjalli pyetje që nuk u sqaruan nga askush.

Këto dyshime e detyruan Petrit Dumen që në momentin e hipjes në autobusin që do t'i çonte në sallën e mbledhjes, t'u komunikonte vendimin që kur të hynte Beqir Balluku në sallën e mbledhjes, të mos ngriheshim në këmbë. Për pjesëmarrësit u bë e qartë se diçka e rëndë i kishte ndodhur Ministrit të Mbrojtjes. Pasi anëtarët e Byrosë Politike me në krye Mehmet Shehun zunë vend në tribunën e mbledhjes, Beqir Balluku u shoqërua në plate nga dy shokë ushtarakë.

Në fjalën e tij, Mehmet Shehu, që drejtonte aktivin, tha se ishin mbledhur në aktiv për të dëgjuar mendimet e ushtarakëve kryesorë për një material teorik, që e njihnin që një vit më parë, material i përgatitur pa dijeninë e Partisë nga Beqir Balluku, mbi projekt-tezat e Këshillit të Mbrojtjes dhe që me ndihmën e Rrahman Parllakut ishte bërë shpërndarja e materialit tek kuadrot e ushtrisë.

Filluan diskutimet. Diskutantët e parë nuk e quajtën materialin armiqësor dhe bënë vërejtje për të, pa propozuar masa ndëshkimore për Ballukun. Edhe në adresën e Parllakut u bënë kritika. Qëndrimi i diskutantëve e irritoi presidiumin që filloi të ndërhynte me pyetje: "Si e vlerësoni ju një material që i kundërvihet projekt-tezave të Këshillit të Mbrojtjes, një material që aq më tepër është përgatitur dhe shpërndarë fshehtas Partisë?".

Pas këtyre ndërhyrjeve, fjala iu dha atyre që ishin përgatitur për të akuzuar e për të propozuar masa. Kush nuk e bënte këtë, i pritej fjala.

Beqir Balluku, në fjalën e tij, në aktiv u përqëndrua te detyra që i kishte vënë Komandanti i Përgjithshëm, pra Enver Hoxha, që t'i studionin, të thelloheshin në projekt-tezat e Këshillit të Mbrojtjes dhe të bënin propozime për korrigjime, plotësime e ndryshime, që ato të aprovoheshin si teza, detyrë kjo që e

kishte përsëritur edhe në mbledhjen e Pleniumit të Komitetit Qendror të Partisë, në Korrik 1971. Ai tha se materiali është përgatitur me dijeninë e bashkëpunëtorëve të tij, se u është dërguar të gjithë kuadrove të larta të ushtrisë dhe se këtu nuk ka asnjë veprim armiqësor.

Ndaj Beqirit filluan pyetjet provokuese si: “Përse nuk u diskutua materiali i shpërndarë? Përse u mbyll në kasafortë e nuk u vu në dijeni Partia? E të tjera si këto. Fjala e tij ndërpritej shpesh dhe pyetjet bëheshin pa radhë. Filluan të pyesin: “Cilët kanë qenë bashkëpunëtorët? Cili ka qenë qëllimi i këtij materiali?”, etj., etj. Nga më të flaktët pati edhe propozime për masa dënimi. Edhe Parllakut iu adresuan vërejtje e kritika si bashkëpunëtor në përgatitjen e shpërndarjen e materialit. Kushdo që diskutonte, thoshte edhe diçka për Parllakun.

Ditën e parë, Parllaku nuk diskutoi. Në mbrëmje, Mehmet Shehu e thirri në çadrën e tij dhe i tha se edhe në adresën e tij ishin bërë shumë kritika, prandaj duhet të përgatitej për të diskutuar. Parllaku filloi të shpjegohet, por ai ia ndërpreu fjalën dhe e paralajmëroi t’u përgjigjej shokëve. Vetëm me lejen e M. Shehut tek Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Preçi, Parllaku mundi të marrë materialin që kishte përgatitur dhe filloi përgatitjet për përgjigjen e pyetjeve.

Me këtë material, ai hidhte poshtë bashkëautorësinë, pasi po ta kishte punuar ai materialin dhe të ishte autori, nuk kishte arsye të bënte vlerësime e propozime për të.

Rrahmani, gjatë diskutimit, lexoi materialin që e kishte dorëzuar një vit më parë. Ato vërejtje e propozime që kishte bërë atëherë dhe i kërkoi aktivitet që t’i vlerësonte. Ai bëri të ditur se nuk e kishte quajtur materialin e përgatitur nga Beqir Ballaku armiqësor, siç po e quanin sot. Me këtë material, Parllaku vërtetoi para aktivitet se nuk ishte bashkëautori i këtij materiali. Theksoi se ishte mbështetës i tij dhe se kishte kërkuar të punohej nga kuadrot. Gjithashtu, Parllaku theksoi se donte ta përfundonin sa më parë, pasi kishin kërkesa nga Komandanti i Përgjithshëm.



Ndaj Parllakut pati kritika nga pjesëmarrësit, por nuk u propozua asnjë masë dënimi, me gjithë ndërhyrjet e shumta nga presidiumi drejtues i mbledhjes.

### **Shkarkimi i Ballukut, emërimi i Shehut edhe si Ministër i Mbrojtjes**

Pas dy ditë diskutimesh, vërejtjesh, kritikash e propozimesh, Kryeministri bëri konkluzionet e punimeve të aktivitetit. Ai përgëzoi qëndrimet e kuadro të larta të ushtrisë që mbështetën plotësisht vendimet e Byrosë Politike dhe theksoi se materiali u vlerësua si armiqësor, se veprimtaria e Beqir Ballukut ishte antiparti dhe e rrezikshme. Gjithashtu, Kryeministri fajësoi edhe Rahman Parllakun, duke e përcaktuar si të vetmin nga kuadrot udhëheqëse që kishte mbështetur e vlerësuar atë material. Sipas Kryeministrit, Parllaku kishte këmbëngulur t'u shpërndahej kuadrove të komandave dhe të diskutohej, gjë që rrezikonte çoroditje mes tyre. Gjithashtu, Mehmet Shehu e fajësoi atë edhe për faktin që nuk mbajti qëndrim dënues për Beqir Ballukun. Ai kritikoi edhe Spiro Shalsin e Ernest Jakovën, që kishin punuar në përgatitjen e materialit. Në fund tha se materialet e aktivitetit do t'i paraqiteshin Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, i cili do të merrte vendimet përkatëse, duke patur parasysh diskutimet dhe propozimet e vlefshme të kuadrove kryesore.

Pa pritur ende vendimet e Plenumit të Komitetit Qendror, po atë natë, aty në çadrat e Golemit ku ishin vendosur, Mehmet Shehu komunikoi vendimet e Byrosë Politike për shkarkimin e Beqir Ballukut nga të gjitha funksionet shtetërore dhe emërimin e tij, pra të Mehmet Shehut si Ministër i Mbrojtjes, kurse të dy shpëtimtarët, siç i quajtën atëherë Petrit Dumen e Hito Çakon, dy zëvendësuar të tij. Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë u emërua Sami Meçollari.

Si Ministër i Mbrojtjes parashtrroi disa detyra për shtimin e vigjilencës dhe rritjen në një shkallë më të lartë të gatishmërisë

luftarake. Në fund u drejtua nga Parllaku duke thënë: “Edhe Rrahmanin, tani të shkarkuar nga detyra e Zv/Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, nuk do ta lëmë pa punë”.

### **Ngjarjet që pasuan**

Ushtarakët e pritën me entuziazëm emërimin e Mehmet Shehut në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes me mendimin se duke qenë edhe Kryeministër, do t’i jepte ushtrisë përparësi. Servilët i bënë elozhe të shumta, por ky qëndrim e gëzim i kuadrove të ushtrisë, mesa u pa më vonë nuk i pëlqeu Enver Hoxhës, që përgatiti bashkë me Hysni Kapon fjalën që do të mbante në 14 tetor të po atij viti para kuadrove të ushtrisë, në sallën e Komitetit Qendror, “Të pastrojmë me fshesë të hekurt veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut e të grupit të tij”.

Në këtë grup u përfshinë të gjithë udhëheqësit e ushtrisë, pra edhe Petrit Dume e Hito Çako. Doli në pah qëllimi i vërtetë i Enver Hoxhës. Preteksti i sajuar ishin antitezat, materiali armiqësor i përgatitur gjoja pa dijeninë e Partisë e të shokut Enver, kur ishte ai vetë që kishte luajtur rolin kryesor në atë lojë. Beqir Balluku e kishte informuar Enver Hoxhën për procesin e përgatitjes së materialit, por ai bëri të paditurin dhe Mehmet Shehu nuk mund të pranonte që Beqir Balluku t’u bënte vërejtje e korrigjime projekt-tezave të shkruara nga ai vetë.

Mehmet Shehu e pranoi me dëshirë emërimin në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes, krahas detyrës së Kryeministrit dhe kjo nuk kish si të mos vihej re nga Enver Hoxha. Pas largimit të Ballukut dhe emërimit të Shehut si Ministër i Mbrojtjes, në ministri gjysma e kudrove kryesorë të saj dhe gjeneralëve ishin pikërisht nga Brigada e I Sulmuese, ku kishte qenë komandant Mehmet Shehu. Ata e duartrokitën Mehmet Shehun, ish-komandantin e tyre dhe ai u shpreh se gjeneralët e ushtrisë nuk ishin të Ballukut, por të partisë, duke nënkuptuar të

vetët. Enver Hoxha e ndjente rrezikun e ushtarakëve të zotë dhe pas këtyre ngjarjeve iu shtua edhe më frika, dyshimi dhe mosbesimi te bashkëpunëtorët e tij. Fuqizimi i pozitive të Mehmet Shehut ia vrau qetësinë atij, deri sa dhëmbët vrasës të makinerisë parti-shtet e eliminuan Kryeministrin dhe Ministrin e Mbrojtjes, një nga figurat kryesore të Partisë, të Qeverisë, të Ushtrisë, të Kuvendit Popullor, këtë gjeneral legjendar të Luftës Nacionaqlirimtare.

Petrit Dume dhe Hito Çako u emëruan Zv/Ministra të Mbrojtjes. Ata ndërmorën rolin e demaskuesit duke mbajtur fjalime të zellshme nëpër repartet e ushtrisë dhe kudo, për armikun e popullit, Beqir Balluku dhe bashkëpunëtorin e tij Rahman Parllaku, a thua se nuk kishin qenë bashkëpunëtorë dhe nuk kishin asnjë lloj përgjegjësie për çfarë kishte ndodhur.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Sami Meçollari ishte njeri i besuar i Petrit Dumes.

Vetëm pak kohë pas pleniumit të korrikut, filloi përgatitja e Pleniumit të VI, në dhjetor 1974.

Rahman Parllaku deri në këtë kohë akoma ishte në ushtri, ndonëse oficer me gradë më të ulët. Kupola ushtarake nuk ishte cënuar fare. Por a mund të besonte dhe pranonte Enver Hoxha që kjo kupolë e cila kishte qenë aq afër Beqir Ballukut dhe tani pranë Shehut do ti bindej atij.

Aparati i KQ të PPSH, sigurimi i shtetit dhe ai në ushtri kishte kohë që po punonte.

# VI

Stoicizmi në burgjet  
e diktaturës



*Rrahman Parllaku gjatë procesit gjyqësor, dhjetor 1974.*

## **Fshesa e hekurt në ushtri**

U dënuan me vdekje Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako dhe me 75 vjet burg Rrahman Parllaku. Meqenëse kushtetuta e atëhershme përveç dënimit kapital me vdekje, dënimin kapital me burg e kishte 25 vjet, Parllakut iu la dënimi 25 vjet.

U dënuan të gjithë ish-anëtarët e KQPPSH që militonin në ushtri si Sadik Bekteshi, Halim Ramohito, etj., si dhe të gjithë ish-gjeneralët e ushtrisë popullore dhe të ushtrisë nacionalçlirimtare që militonin deri atëherë në ushtri si Arif Hasko, Muhamet Prodani, Vaskë Gjino, Todi Naço, Abaz Fejzo, Ernest Jakova, Spiro Shalsi, Andon Sheti, Nikollaq Sallabanda, Elami Hado, etj.

### **Hetuesia**

Për Beqir Ballukun, Petrit Dumen, Hito Çakon dhe Rrahman Parllakun u përdor kriter i paparë deri në atë kohë. U arrestuan në sallë, me hekura në duar dhe helmata në kokë dhe me makina BÇ u transportuan menjëherë në burgun e sigurisë së lartë. Hetimi zgjati 11 muaj. Përveç futjes në qeli, i futën në kafaze hekuri brenda qelisë. Në kafaz flinin, hanin dhe hetoheshin. Për ruajtjen e tyre ishte caktuar një komandë dhe një trupë e veçantë gardianësh që komandohej nga Idriz Seiti (ish-shef sigurimi), i cili kishte dalë në pension, por ishte thirrur për këtë detyrë. Për ironi të fatit edhe Idrizin, pas vdekjes së Mehmet Shehut, e dënuan me burg.

Ishin 4 oficerë sigurimi në 24 orë që i ruanin, i përgjonin, dhe që e kishin të ndaluar të flisnin sepse kontrolloheshin edhe ata nga frëngjitë e dyerve të qelive.

Edhe kur i nxirrnin për nevoja vetjake, nuk ua hiqnin hekurat nga duart dhe helmetën nga koka. Policët u rrinin mbi kokë. Por kjo ishte e vështirë edhe për ta.

Pas dënimit me vdekje, Beqir Ballukun, Petrit Dumen dhe Hito Çakon i pushkatuan në Lanabregas të Tiranës dhe i varrosën në Vranisht të Vlorës, natën pa dijeninë e askujt... Pa varr, pa nam, pa nishan...

A ishte i nevojshëm ky hetim, kur dënimin e kishte përcaktuar kryeprokurori Hoxha që në mbledhjen e Pleniumit të KQPPSH. Por ja që edhe shteti komunist ka ligje, ka formalizëm, ka shtet.

Këtë e vërtetojnë edhe prokurori i çështjes, Murat Kamani dhe hetuesi Piro Dautaj. Në një çast hetimi, Piro Dautaj e pyeti Parllakun: “akoma beson se do të mbrohesh kur akuzën dhe dënimin e ka përcaktuar ai lart?”. “Përse të mos besoj tek drejtësia?!” , - iu përgjigj Parllaku. “Sepse ata që të përjashtuan nga partia, të dhanë edhe dënimin që në atë çast, - vazhdoi Piro. - Dënimin tënd e kanë vendosur ata 100 burrat e pleniumit të KQPPSH. Ne po bëjmë një formalitet këtu”.

Po kështu deklaroi edhe Murat Kamani, prokurori i çështjes.

### **Greva e urisë dhe vizita mjekësore**

Në ditët e vuajtjes, ndodhi që Rrahmani u fut në grevë urie, sepse komanda e burgut nuk ia pranonte kërkesën për t’u trajtuar si diabetik dhe ta lejonte për të bërë lëvizje.

Erdhi për ta vizituar Dr. Hektor Peçi. Ai kishte marrë me vete edhe kartelën mjekësore që vërtetonte faktin se Parllaku vuante në fakt nga diabeti dhe ishte mjekuar deri në momentin e futjes në burg.

Pas vizitës së mjekut u trajtua si diabetik dhe u lejua të bënte lëvizje për rreth 15 minuta, sigurisht me 2 roje anash. Dieta në burg, sidomos gjatë hetuesisë, u zbatua fare pak. Mbas dënimit, me ndihmën e familjarëve, Parllaku e respektoi këtë dietë, gjë që bëri të mundur të mbijetojë pas 16 vjet e 3 muaj burgu.

### **Një portokall në qeli në natën e vitit të ri**

Ishte nata e ndërrimit të viteve 1974-1975. Rrahmani kishte 15 ditë brenda kafazit të hekurt, brenda qelisë. Në mesnatë u bë ndërresa e shërbimit të oficerit që bënte roje në qelinë e tij. Oficeri që mori shërbimin, siç do ta mësonte më vonë Parllaku, quhej Dilaver Muhametaj nga fshati Kajcë i Dishnicës. U sigurua se frëngjia e qelisë që kontrollonte edhe rojen brenda ishte e mbyllur. U ul në karriken e fiksuar të tij dhe filloi të qëronte një portokall.

Parllaku u ndje i ofenduar nga ai veprim dhe mendja i shkoi te njerëzit e dashur të tij. Çfarë bëhej me ta vallë në këtë natë të ndërrimit të viteve?

Parllaku tregon: “Dilaveri qëroi portokallin dhe ma drejtoi mua. Mos lë asnjë gjurmë apo ndonjë bërthamë në shtresa që t’i shohin ata të mëngjesit, më porositi ai.”. Iu mbush zemra dhe bindi veten se kishte njerëz të mirë akoma, madje edhe në atë vend ferri.

Kujtimet i vijnë radhazi. Ai tregon edhe për një rast tjetër humanizmi nga rojet që shërbenin në burg:

“Kisha 10 ditë në kafaz brenda qelisë. Më nxorën në banjo për nevoja vetjake. I kërkova oficerit shoqërues që të më lejonte të laja këmbët. Ishte dhjetor. Ai më lejoi. Uji ishte i ftohtë akull, por unë kisha nevojë për të, sepse po më kalbeshin këmbët. U futa në qeli me këmbët akull. Oficeri më afroi furnelën e tij për të tharë këmbët. Në këtë moment hyri komandanti i tyre, Idriz Seiti, që i bërtiti: “Ç’bën more, ruan apo ngroh të burgosurit



që kanë tradhëtuar partinë dhe Enver Hoxhën?!". Oficeri iu përgjigj: "Bëj detyrën, por jam edhe njeri". Këtij oficeri nuk ia mësova dot emrin dhe nuk e kam takuar më që ta falenderoj thellë nga zemra. Me siguri ky veprim duhet t'i kishte kushtuar shumë, sepse të nesërmen nuk e pashë më".

Mirënjohje, Rrahman Parllaku ka edhe për oficerin Hiqmet Meçe. "Hiqmeti më trajtonte mjaft mirë. Sa herë merrte shërbimin në mesnatë, më sillte një kaush me kafe dhe sheqer, që të mos ia harroja shijen kafesë. Kur merrte shërbimin gjatë ditës, bënte pastrimin e qelisë. Një herë kur e gjeti duke pastruar komandanti Idriz Seiti dhe e qortoi, ai iu përgjigj se e pastronte për vete, për të mbajtur pastërti në vendin e shërbimit.

Hiqmet Meçen dhe Dilaver Muhametin, Rrahmani i ka takuar edhe tani pas lirimit nga burgu, duke u shprehur falenderime.

*Letër nga burgu famëkeq i Burrelit, 18.01.1988*

## **Na burgosët padrejtësisht, mos na vdisni para kohe, ndaloni torturat çnjerëzore!**

*Letër e ish-komandantit të Divizionit të V-të Sulmues, "Heroit të Popullit" Rrahman Parllaku, drejtuar ish-kolegut të tij, ish-komisarit të Divizionit të V Sulmues, tashmë Kryetar i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe Sekretar i Parë i KQPPSH.*

*Kjo letër është shkruar në Burgun e Burrelit, ku nga 318 të burgosur, 298 prej tyre ishin ish-bashkëluftëtarë të Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë*

*Sekretarit të I të KQPPSH, shokut Ramiz Alia*

*(Letra u adresohet njëkohësisht edhe Adil Çarçanit, Manush Myftiut dhe Rita Markos)*

Në këtë letër po ju shkruaj më gjerë për shkeljet e rënda të ligjshmërisë, për masat arbitrare dhe për persekutimet e bëra nga organet e punëve të brendshme dhe të hetuesisë, veprime që kanë vazhduar edhe pas dënimit të Mehmet Shehut.

Në organet e punëve të brendshme nuk shikoj ndryshime në përbërjen, metodën dhe as në veprimet e tyre.

Kur isha në detyra të larta partie dhe shtetërore, kurrë nuk më shkonte ndërmend se bëheshin veprime të tilla antiligjore në pushtetin tonë. Me këtë letër po ju drejtohem ju të katërve, jo vetëm se keni detyrat më të larta në parti dhe shtet, por edhe jeni edhe më të vjetrit në këto detyra.

Në mbledhjen e Pleniumit të KQPPSH na u caktuan vendet ku do të rrinim tamam si në gjyq, me roje anash dhe

me mikrofonë formalë, sepse fjala për të folur nuk u dha asnjëherë, megjithëse statuti i partisë ta jep këtë të drejtë. Na u hodhën hekurat në duar brenda sallës së plenumit, kur dihet që ne ishim të zgjedhur nga Kongresi. Mendoj se një rast i tillë është i paprecedent.

Ne ish-kuadrot e larta ushtarake që jemi këtu në burg, nuk e ndjejmë veten fajtor për akuzën me të cilën jemi dënuar dhe asnjëri prej nesh nuk e ka merituar një dënim të tillë. Sepse siç e dini të gjithë, ne jemi luftëtarë të orëve të para, udhëheqës politikë dhe ushtarakë duke filluar nga çetat e deri në njësitë më të mëdha divizione dhe korparmata.

Masat që u ushtruan kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të egra. Përveç nesh që u arrestuam, pasoja po vuajnë familjet tona, pasoja të pakrahasueshme me ndonjë shembull tjetër. Familjet tona u internuan dhe u degdisën në vendet më të largëta të Shqipërisë, u izoluan nga të afërmit dhe detyruan gratë të ndahen nga burrat.

Me anë të kërcënimit, shantazhit dhe mashtrimit se kështu i shërbejnë partisë dhe është në interes të familjes, organet e sigurimit kanë vënë të akuzojë fëmija prindin, gruaja burrin dhe motra vëllain. Këto veprime bien ndesh me karakterin e shqiptarit. Të gjitha këto bëheshin nën kërcënimin se po nuk e bëtë, do t'ju pijë e zeza. Ata që nuk e bënë e pësuan edhe më rëndë, u internuan gra, pleq dhe fëmijë. Fëmijët u hoqën nga shkolla dhe nga profesioni i fituar në punë. Më vonë, fëmijët u futën në burgje dhe po vuajnë dënimin së bashku me prindërit. Të gjitha këto veprime bëhen me qëllime të caktuara për të çuar mesazhin në popull që t'i shikojnë këta tradhëtarë, t'iu fusin tmerrin.

Të gjitha këto u bënë kundër nesh që nuk kishim bërë gjë, por edhe sikur të ishim kapur me topat drejtuar kundër selisë së qeverisë, disa nga më fajtorët do të pushkatoheshin, të tjerët do të dënoheshin, por raprezaljet nuk duhet të shtriheshin kundër grave, fëmijëve e pleqve dhe regjimi i burgut nuk do të ishte kaq i egër.

Këtë gjendje që përshkrova për ne kuadrot e ushtrisë, siç më kanë thënë shokët që vuajnë dënimin këtu me mua, e kanë vuajtur ata dhe familjet e tyre. Këtë e thonë edhe ata që vijnë nga burgje dhe kampe të tjera. Këto i kam parë me sytë e mi, mbasi në atë kohë, vuaja dënimin në burgun e Tiranës. Aty, çdo ditë, makinat binin me dhjetra të dënuar, nga të gjitha rrethet, sepse niseshin prej aty nëpër burgjet e kampet ku u ishte caktuar të vuanin dënimin. Shokët që kanë vuajtur dënimin në Ballsh, Spaç, Bulqizë e Batër thonë se në këto kampe ka qindra dhe mijëra vetë. Fabrika e Ministrisë së Brendshme prodhon gjithandej armiq.

Këto dënime janë shoqëruar me internime në masë, gjë që i ka kthyer shumë qendra të banuara të zonës bregdetare dhe asaj të brendshme në vende internimi dhe, me sa di unë, asnjëherë internim familjar nuk është bërë me vendim gjyqi, por nga Ministria e Brendshme. Në cilat ligje janë mbështetur këto veprime? Të paktën unë dhe shokët e mi nuk kemi njohur ndonjë ligj të tillë, megjithëse një pjesë e jona për një kohë të gjatë kemi qenë edhe deputetë. Të gjithë dënohen për faj të njërit, përfshi gra, pleq dhe fëmijë. Nuk e di ku është marrë kjo eksperiencë.

Nga Ministria e Brendshme i vazhdojnë hetimet me muaj deri në një vit dhe më shumë, duke përdorur torturat fizike e psikologjike deri sa e detyrojnë të arrestuarin të pranojë ose të gjejnë e të përgatitnin dëshmitarët që u nevojiteshin. Hetuesit thoshin hapur se po qe se je futur brenda pa i marrë 7 deri në 10 vjet burg, nuk shpëton. Shumë herë një njeri arres-tohej me një akuzë e dënohej me një tjetër. Fëmijë të shokëve tanë, edhe të atyre që janë këtu janë arrestuar për të nxjerrë prej tyre të dhëna për prindërit e tyre dhe kur nuk kanë nxjerrë gjë, i kanë dënuar për agjitacion dhe propagandë me 7 deri në 10 vjet burg, me dy dëshmitarë të parapërgatitur.

Ushtarakëve, për t'u rritur dënimin, u kanë shtuar akuzën e armëmbajtjes pa leje. E kujt, atyre që kanë patur të gjithë repartin ushtarak me pistoleta, armë, topa e municione? Edhe thikat e bukës ua kanë quajtur armë të ftohta.

Gjatë hetuesisë, tortura fizike dhe psikologjike u kanë bërë edhe kuadrove të lartë. Shembull tipik është torturimi i Vaskë Gjinos, krejt i pafajshëm, që nga efekti i këtyrave torturave vdiq.

Në ato mijëra gjyqe të bëra gjatë viteve 1974-1980, do të jetë habi po të gjendet se është dhënë ndonjë pafajësi nga Gjykata e Lartë.

Raprezaljet nga organet e punëve të brendshme kanë vazhduar edhe në burg. Këto kanë çuar edhe në dhënien e dënimeve të dyta gjatë vuajtjeve të dënimit. Më tepër se dhjetë raste janë dhënë gjatë kohës që jam unë në burg dhe paradoksi arrin se të burgosurit politik i shtohen vite të tjera burgu për agjitacion dhe propagandë... Dënimet nuk janë dhënë për krime me rrezikshmëri si për shpërthime burgu, arratisje nga burgu, tentativë vrasjeje, etj.

Këtu në të ndarën ku vuaj unë dënimin, ka disa vetë që janë dënuar me 2 dhe 3 herë, me shtyrje dënimi për shkak të njerëzve provokatorë dhe spiunë të futur midis nesh nga Ministria e Brendshme, që për fat të keq kanë qenë oficerë të kësaj ministrie.

Nga torturat në qeli ka gjetur vdekjen në burgun e Qafë Barit në pranverën e vitit 1984 Sadri Sokoli, nipi i Sadik Bektshit. Sadriut, gjatë torturave, i thyejnë kolonën vertebrale dhe për rrjedhojë vdiq gjatë rrugës në makinë kur po e çonin për në Pukë. Oficerët e sigurimit i kërkuan mjekut të firmoste raportin se vdiq nga sëmundja e zemrës.

Këtu kemi njerëz që i kanë rrahur duke u lënë shenja në trup dhe nuk i kanë lënë të ankohen, pasi u kanë nxjerrë dëshmitarë torturuesit e tyre. Autorët e krimit dalin si dëshmitarë duke thënë se nuk ju ka rrahur njeri.

Një nga torturat me pasoja edhe më të rënda se druri për jetën e njerëzve është edhe izolimi në birucë, dhe kjo si rregull bëhet me një raport të policit roje, ndërsa kohëzgjatja e izolimit zgjat 30 ditë. Birucat mbushen plot në periudhën e dimrit. Temperatura brenda birucës është minus 5 gradë. Në mjaft raste të izoluarve u merren edhe batanijet dhe rrobat e trasha. Ato vetëm emrin kanë batanije, sepse i kanë nxjerrë

jashtë përdorimit repartet e Ministrisë së Brendshme. Në këto kushte i shëndoshi sëmuret dhe të sëmurit i afron vdekja.

Ambienti ku jetojmë është shumë i rëndë, orari i veprimeve, gjithashtu.

Nga torturat më të rënda psikologjike është takimi me familjarët, sidomos vendi i papërshtashëm i takimit dhe koha e takimit. Ata që i kanë familjet në internim për vite me radhë nuk i shohin të afërmit, sepse degët e brendshme nuk iu japin leje. Takimi zgjat vetëm 10 minuta dhe vetëm nëpërmjet frëngjisë së portës së burgut.

Në burgun e Burrelit, ku unë ndodhem, të gjithë jemi të moshuar 65 deri në 70 vjeç dhe vuajmë me dy dhe më shumë sëmundje. Si është gjendja e tyre.

1. Abaz Fejzo vdiq. Për gjendjen e tij të rëndë u kisha shkruar.
2. Gjini Marku, që ju e keni njohur më mirë se unë, megjithëse me kancer dhe vetëm me 2 muaj dënim të pakryer akoma, i dënuar dy herë edhe në burg, lihet deri sa vdes.
3. Muhamet Prodani, e njihni vetë, vuan nga zemra dhe mbahet në qeli dimër-verë. Gruaja i vdiq. Fëmijët nuk ia lejojnë që t'i takojë. Edhe në regjimin e Zogut u lejua Qemal Stafa që të merrte pjesë në vdekjen e vëllait të tij Veliut.
4. Sadik Bektashi 73 vjeç, pas internimeve, po vuan dënimin në gjendje të sëmurë. Mbas 5 vjet burgimi lejohet të takohet me familjen, se atyre nuk u japin leje për të ardhur në takim, dhe takimi bëhet vetëm 10 minuta nëpërmjet vrimës së derës së burgut.
5. Andon Sheti, luftëtar i vjetër, vëlla dëshmori. Nga vuajtjet në burg sëmuret rëndë dhe kalon në hemorragji cerebrale.

Unë përmenda disa raste, por kështu jemi të gjithë shokët e luftës dhe të punës. Unë vetë kam 25 vjet që vuaj nga diabeti dhe ju i dini pasojat që sjell ai. Kurse nga ana morale dhe psikologjike, veç të tjerave, ajo që më rëndon vazhdimisht është shkëputja nga fëmijët. Dashuria e prindit për fëmijët ka mëse 13 vjet që më është rrëmbyer.

Ne jemi brezi që kemi bërë luftën, vumë jetën në shërbim të popullit dhe atdheut. Nga plagët e trupit të secilit prej nesh

ka rrjedhur gjak mbi truallin e vendit tonë. Prandaj nuk duhej të mbahej një qëndrim kaq i egër ndaj nesh, familjeve dhe të afërmve tanë. Mesa di unë sot, në asnjë vend të botës nuk ka më në burgje luftëtarë të rezistencës antifashiste e jo më udhëheqës të saj. Kurse ne jemi në burg më se 13 vjet.

Në letrën që ju kam dërguar më 29 janar 1986, kam shkruar se Kadri Hazbiu ka thënë se ata që dënohen (kuptohet se nuk është fjala për hajdutët), një pjesë do të çmenden, një pjesë do të vdesin, ndërsa pjesa tjetër do të bëhen agjentët e mi. Dhe të vdekur brenda tre vjetëve janë Vaskë Gjino, Gjin Marku dhe Abaz Fejzo.

Në hetuesi edhe gjatë gjykimit tim, por edhe të shokëve të tjerë është bërë çdo përpjekje të gjenin ndonjë fije ku të kapeshin për të na bërë agjentë të të huajve, sidomos të sovjetikëve dhe të jugosllavëve, por nuk kishin ku të gjenin për asnjërin prej nesh.

Edhe pas dënimit nuk më kanë lënë të qetë njerëzit e sigurimit me provokacione të herëpashërëshme, me ato akuza të lëna nga hetuesia. Habitem përse vepron kjo agjentomani, përse kjo këmbëngulje, për të bërë ish-kuadrot udhëheqëse të luftës, qoftë edhe të vdekur, agjentë, sidomos të jugosllavëve e të sovjetikëve.

Unë po ju shkruaj për këto shkelje të rënda të normave dhe të ligjshmërisë, sepse sipas meje janë në kundërshtim të plotë me ato ideale për të cilat ne luftuam. Nga sa shkruaj, që të vihet në vend ligjshmëria, ne duhet të lirohemi nga burgju.

Për ato gjëra që i shikoj të padrejta e nuk jam i të njëjtit mendim, pa marrë parasysh se kush i ka bërë, unë i kam shkruar, i shkrova në këtë letër dhe nuk do të hesht edhe në të ardhmen, edhe sikur pasojat të rëndohen edhe më shumë mbi mua, mbasi edhe në këtë rast mendoj se bëj një punë të mirë për popullin dhe vendin tim.

**Rrahman Parllaku**

*Burrel, 18.01.1988*

*Përgatiti për botim Prof. Ndreçi Plasari.  
Botoi për herë të parë gazeta "Veterani", nëntor 1996*

## **Ballë për ballë me prokurorin pas 38 vjetësh**

Në qershor 2013, fati e solli që Rrahmani të takohej rastësisht ballë për ballë në Parkun "Rinia", me Murat Kamanin. Rrahmani e pyeti: "Po si ore Murat dhe dënim me vdekje për Beqir Ballukun, Petrit Dumen dhe Hito Çakon dhe 75 vjet burg për mua?". Përgjigjja e tij ishte: "Dëgjo, Rrahman, akoma beson ti se këtë vendim e kemi marrë ne si prokurori dhe gjykatë? Ne na kishte ardhur vendimi nga udhëheqja e lartë e partisë për dënimin kapital të të katërve. Ti shpëtove sepse një ditë para shpalljes së vendimit erdhën Kadri Hazbiu dhe Feçor Shehu dhe na thanë se udhëheqja e partisë ka mendimin se dënimi i të katërve me vdekje, njëlloj, do të intepretohej dhe kuptohej keq nga masat poshtë, prandaj t'i falet njërit jeta. U gjykua të mbetesh ti. Ndërsa dënimi me burg patjetër do të ishte maksimal."

Natyrisht që hetimi është i rëndë. Hetuesi drejtohet gjithnjë me ashpërsi: "Fol armik!". Në mes të natës të zgjojnë nga gjumi dhe fillon hetimi nga e para.

Një ditë erdhi për ta takuar dhe për të bindur Rrahmanin që të pranonte akuzën Ministri i Brendshëm i kohës, Kadri Hazbiu. Piro dhe Kadriu ishin kushërinj dhe Piro donte që ta mbyllte hetimin sipas direktivës.





# VII

Kalvari i vuajtjeve  
të familjes

## **Përndjekja u shtri deri tek nipërit**

Pas arrestimit të Rrahmanit drejtimin e familjes Parllaku, e mori, si dikur në kohën e luftës antifashiste, i vëllai, Selimi.

Si kryetar i një familjeje tradicionale shqiptare të Veriut, Selimi mbloodhi fëmijët e tij dhe të Rrahmanit.

“Ti Fitret, - iu drejtua bashkëshortes së Rrahmanit, - kujdesu për vajzat, kjo është detyra jote, këtë kërkojmë prej teje, unë dhe nëna.

Ndërsa ne, - iu drejtua djemve, - do të mbështesim dhe do të kujdesemi për Rrahmanin, në çfarëdo rrethane dhe gjatë gjithë kohës së burgut, që ai të mos e ndjejë mungesën e familjes dhe të afërmëve.

Kështu që në ditët e para të burgut, Selimi, kunata, (Lazja) dhe fëmijët nuk iu ndanë në asnjë moment, duke e vizituar rregullisht dhe ndihmuar materialisht me të gjithë pasojat që mund të kishin. Ato sakrifikuan nga vetja e tyre, vetëm e vetëm që sadopak, t’ja lehtësonin vuajtjet në qeli.

Përndekja e atij regjimi nuk mund të mos vepronte dhe mbi familjen e Selimit.

Kështu djalin e madh të tij, Mazllumin e liruan nga ushtria, (aviacioni). Ndonëse ishte inxhinier, e dërguan punëtor tek serat në fermë.

Të dytin, Tekiun, nga oficer kufiri e çuan punëtor nëntoke në minierën e Mushqetasë, ndërsa të tretin, Hazbiun e degdisën në Pukë. Pavarësisht këtyre, asnjëherë ata, për asnjë çast nuk iu ndanë Rrahmanit.

Pas sëmundjes së Selimit, një rol të madh për mbështetjen e Rrahmanit ka dhënë kunata e tij, Lazja. Aty ku nuk hynin të tjerët, kur nuk u lejohej, shkonte Lazja, kjo grua burrneshë që i kishte shoqet e rralla.

Kjo përkujdesje vazhdoi edhe pas daljes nga burgu të Rrahmanit. Hazbiu, ndonëse kishte mundësi të qëndronte në Austri, la Austrinë dhe u kthye për t'u kujdesur për katër prindërit e moshuar, Selimin, Lazen, Rrahmanin dhe Fitretin. Ai e quante detyrim të luante realisht rolin e djalit për Rrahmanin, pasi Rrahmani kishte tre vajza dhe nuk kishte djalë.

## Bashkëshortja, Fitretja

Fitrete Sami Parllaku (Çuçi) rridhte nga një familje fisnike gjirokastrite. Ajo kishte virtyte të larta njerëzore; shquhej për sinqeritet, ndershmëri dhe urtësi. Këto virtyte, ajo i kishte shfaqur që në vitet e zjarra të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Që në moshën e rinisë mori pjesë në aksionet luftarake kundër pushtuesve fashistë të vendit. Aktivitetin kryesor e ka zhvilluar me Rininë dhe Gruan Antifashiste, duke qenë një agjitore e flaktë për çlirimin e vendit nga pushtuesi. E kalitur në zjarrin e luftës partizane, ajo edhe pas çlirimit të vendit do të shquhej për korrektesë në kryerjen e të gjitha detyrave të ngarkuara, në funksion të rimëkëmbjes së vendit e të progresit shoqëror dhe për merita të veçanta në luftë dhe në punë ajo është dekoruar dy herë nga Kuvendi i Shqipërisë.

Si bashkëshortja e Gjeneral Lejtnant Rrahman Parllakut, një prej personaliteteve të rralla të LANÇ-it e të Ushtrisë Shqiptare, të dy njerëz parimorë, krijuan një familje shembullore ku mbizotëronte harmonia dhe mirëkuptimi, me baza të shëndosha morale.

Fitretja, shembull i qëndresës dhe humanizmit njerëzor, do t'i qëndronte gjithmonë pranë dhe do ta mbështeste me të gjitha aftësitë e mundësitë e saj bashkëshortin e përkryer, gjeneralin e strategun e luftës, ideatorin, organizatorin e drejtuesin e Ushtrisë Shqiptare, "Heroin e Popullit" Rrahman Parllaku, edhe në vitet e kalvarit të mundimshëm që ai vuajti gjatë viteve të ferrit në burgjet e diktaturës. Nuk u përkul e

nuk u gjuhëzua nga pesha e akuzave të sajura e absurde që diktatori Enver Hoxha dhe suita e tij i bënë bashkëshortit, as nga persekutimi i tejskajshëm që bastardët i bënë asaj, tre vajzave të shkëlqyera si dhe gjithë të afërmve të farefisit.

Lirikës, vajzës së madhe të Gjeneralit, për të shkuar në punë, i duhej të merrte çdo ditë, për vite të tëra rrugën e fshatit Perondi të Beratit me djalin e vogël për dore, kurse vajzës së vogël, Shpresës, megjithëse nxënëse e shkëlqyer, ju mohua shkolla e lartë dhe u detyrua të largohej nga familja për të punuar në Kombinatin Metalurgjik të Elbasanit.

Fitrete Parllaku qëndroi me stoicizëm kundër diktaturës, e bindur në fundin fatal të saj.

Vitet e demokracisë, kur dhe bashkëshorti Rrahmani do të çlirohej nga inkuizicioni, do t'i përjetonte me gëzim e krenari të pamatë. Një familje e krijuar në zjarrin e luftës partizane dhe e konsoliduar gjatë viteve të mëvonshme në bazë të punës e vetëmohimit të pashembullt, pas viteve '90 kur në Shqipëri triumfoi demokracia dhe pluralizmi, do të shfaqej edhe me solide, mbështetëse e denjë e të gjitha proceseve demokratizuese dhe reformave properëndimore që po ndërrmerte Shqipëria dhe klasa e saj e re politike. Vetëm në këto vite, familja Parllaku do të ndjente gëzimin e madh që i falnin tre vajzat shembullore, intelektuale, nipërit e mbesat që rriteshin e edukoheshin me ndjenjën e atdhedashurisë dhe që përvetësonin me zell dije e programe bashkëkohore, për t'i vënë ato në shërbim të progresit të pandalshëm të Shqipërisë sonë të dashur e të shtrenjtë, ashtu siç bëri gjatë gjithë jetës së saj edhe nëna e gjyshja e tyre e shtrenjtë.

Ajo u nda nga jeta më 4 Mars 2009.

## **Laze Parllaku, kunata e Rrahmanit, gruaja që nuk u tremb nga organet e diktaturës**

Lazja ishte një grua e thjeshtë, por me shpirt e zemër të madhe. Më mirë se kushdo tjetër, dashurinë dhe humanizmin njerëzor ajo i dëshmoi gjatë viteve kur kunati i saj, Rrahman Parllaku, vuajti izolimin e egër në burgjet e diktaturës.

Lazja, me aktin e saj burrëror, duke i qëndruar pranë kunatit të saj, është bërë e njohur në të gjitha anët, madje është quajtur me të drejtë si model i të gjitha kunatave për këtë gjest.

Ajo çante me trimëri e zgjuarsis të rrallë taborret e ish-sigurimit famëkeq të shtetit të diktaturës dhe shkonte vazhdimisht në burgun e Burrelit për t'u takuar me Rrahmanin, dhe për t'i dhënë aty përkrahje morale e materiale, duke ia lehtësuar kështu sadopak vuajtjet e mundimet në vitet e atij kalvari të pashembullt.

Me kurajon e një gruaje burrneshë, ajo i thoshte gjithmonë Rrahmanit: "Ty të ka dënuar diktatori Enver Hoxha, por jo Zoti. Na ke ne, që do të të duam e respektojmë dhe do të të qëndrojmë pranë në çdo rrethanë.

Ne do të të respektojmë dhe do të të duam si më parë, se e dimë që nuk je fajtor". Kjo ishte kurajo e madhe që i jepej Rrahmanit në kushtet e izolimit në burgun më të egër që ka njohur historia e njerëzimit, siç qe ai i Burrelit.

Këto akte e bënë Laze Parllakun simbolin e një kunate që sakrifikon për kunatin, simbolin e një gruaje trimëshë që nuk i trembet syri.

## **Si shpëtoi pa u burgosur vajza e Rrahmanit, Tatjana**

Strategjia e sulmit të Enver Hoxhës ndaj kundërshtarëve ishte e thellë. Pushkatim apo burgim të përjetshëm për kundërshtarët, divorcim nga gratë, burgosje edhe për fëmijët e rritur, përndjekje, lënie pa shkollë, punë të detyruar, stërmundime.

Kështu ndodhi edhe me Tatjanën, vajzën e mesme të Rrahmanit.

Familja Parllaku ishte larguar nga Tirana dhe ishte dërguar në Kavajë. Nënë dhe bijë, Fitretja dhe Tatjana, kishin filluar punën në Fabrikën e Poçerisë. Puna ishte e rëndë, sepse ato të dyja ishin caktuar në procese akoma edhe më të vështira. Tatjana kishte mbaruar Fakultetin Gjuhë-Letërsi dhe punonte në repartin e zbukurimeve të qelqit, sepse ishte e talentuar dhe i kishte duart e arta.

Një ditë erdhi makina BÇ 01 ose siç njihet rëndom nga populli gazi i degës së brendshme. Nga gazi zbritën dy oficerë të Ministrisë së Brendshme që zakonisht rrinin civilë. U futën në zyrën e drejtorit të fabrikës. Pas pak minutash, drejtori i skuqur në fytyrë pyet për Tatjanën. I thonë se është tek reparti i zbukurimeve artistike.

Oficerët e MB kishin kërkuar arrestimin e Tatjanës. Drejtori kishte thënë se nuk mund ta merrnin pa dijeninë e Sekretarit të Parë të Partisë së rrethit, sepse tanimë familja Parllaku ishte në territorin e rrethit të Durrësit, qytetit të Kavajës. Kështu ishin rregullat e kohës. “Ta kishit arrestuar kur ishte me banim në



Tiranë, tani unë do të njoftoj Sekretarin e Parë”, - këmbënguli drejtori i befasuar dhe i skuqur në fytyrë nga sikleti që po kalonte.

I ra telefonit dhe kërkoi Sekretarin e Parë të Rrethit të Durrësit, Iljaz Rekën. Iljazi ishte nga ata të luftës. Të gjithë e njihnin për njeri të mirë. Iljazi dhe Rrahmani ishin njohur personalisht para dënimit të Parllakut. Fatmirësisht, Iljazi doli në telefon. Drejtori e informoi për situatën dhe i kërkoi që ta mbante këtë punëtoore të mirë.

“Çfarë pune kanë me familjen? Dënimin le ta vuajë ai që e ka bërë fajin”, -përgjigjet Iljaz Reka dhe kërkoi që të fliste me oficerët e sigurimit. Në fillim, ata kundërshtuan të flisnin, por, pas këmbënguljes së Iljaz Rekës, iu afruan telefonit duke dëgjuar zërin e sigurtë të tij: “Këtu jam unë Sekretar i Parë dhe urdhërat për arrestime në rrethin ku unë drejtoj kalojnë me dijeninë time, prandaj largohuni prej fabrike”.

Kështu ndodhi. Makina BC 01 dhe dy oficerët u larguan pa e realizuar misionin e tyre.

# VIII

Pafajësia dhe vitaliteti  
i Heroit



*Drejtues të OBVL-së*

## Pafajësia

Falsitetin e gjyqit politik dhe mungesën e provave të fajësisë së këtyre gjeneralëve, e tregon Vendimi i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Shqipërisë Nr.119 datë 20.07.1994 që shpall pafajësi dhe hedh poshtë akuzat edhe të Kodit të atëhershëm Penal.

### REPUBLIKA E SHQIPERISË GJYKATA E KASACIONIT PLENIUMI

*Nr.65 i Regj.Themeltar*

*Nr.119 i Vendimit KL*

### VENDIM "NË EMËR TË POPULLIT"

Pleniumi i Gjykatës së Kasacionit i përbërë prej:

Zef Brozi	Kryetar i Gjykatës së Kasacionit
Avni Pema	Zv.kryetar i " "
Agim Shkupi	" " i " "
Agim Gjoleka	Anëtar i " "
Petrit Plloçi	" "
Metush Saraçi	" "
Kristofor Peçi	" "
Vangjel Kosta	" "
Zef Nika	" "

Vitore Tusha	Anëtare e “
Bardha Selenica	“ e “
Tefta Zana	“ e “

Të asistuar nga sekretarja Anila Pinari, me pjesëmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm Alush Dragoshi, më datën 20.7.1994 shqyrtoi çështjen penale Nr.63 që i përket të gjykuarve:

1. Beqir Balluku
2. Petrit Dume
3. Hito Çako
4. Rrahman Parllaku

Të akuzuar: Për tradhëti ndaj atdheut sipas nenit 64 të Kodit Penal.

Me vendimin Nr.10 datë 5.11.1975 të Gjykatës së Posaçme Ushtarake janë deklaruar fajtor të gjykuarit dhe janë dënuar tre të parët me vdekje dhe Rr. Parllaku me 25 vjet heqje lirie.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë Prokurori i Përgjithshëm, duke parashtruar këto shkaqe për prishjen e tij:

Gjykata, pa të drejtë, i ka deklaruar fajtor të gjykuarit për tradhëti, sepse nuk rezulton të jetë kryer një krim i tillë, pra mungojnë elementët e domosdoshëm për të patur këtë figurë krimi. Veprimtaria kundër rolit udhëheqës të partisë në ushtri nuk konsiderohej pa botim. Nuk janë pyetur si dëshmitarë shumë persona që do sqaronin këtë veprimtari.

Të gjykuarit, padrejtësisht, janë akuzuar edhe si pjesëmarrës në organizatë kriminale sipas nenit 76 të Kodit Penal.

## PLENIUMI I GJYKATËS SË KASACIONIT

Pasi dëgjoji relacionin e anëtarit Kristofer Peçi, Prokurorin e Përgjithshëm Alush Dragoshi që u shpreh për pranimin e kërkesës.

## VËREN:

Vendimi i Gjykatës së Posaçme Ushtarake, përsa i përket akuzave që përmenden në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, është i pabazuar prandaj duhet të prishet.

Gjykata i ka deklaruar fajtor katër të gjykuarit për krimin e tradhëtisë ndaj atdheut, të sabotimit dhe agjitacionit e propagandës, sipas neneve 64, 72, e 73/3 të Kodit Penal dhe tre të parët edhe për vjedhje të pasurisë shtetërore e shpërdorim sipas neneve 80/I e 323 të Kodit Penal që ishte në fuqi në atë kohë.

Nga shqyrtimi i çështjes, Pleniumi arrin në përfundimin se gjykata pa të drejtë i ka deklaruar fajtor të gjykuarit për krimin e tradhëtisë, sepse veprimtaria e tyre nuk është kryer në ndonjë nga format që parashikonte Neni 64 i Kodit Penal, pra mungojnë elementët e domosdoshëm të kësaj figure krimi.

Edhe veprimtaria e të gjykuarve kundër rolit udhëheqës të partisë në ushtri, pa të drejtë është konsideruar nga gjykata si sabotim në bazë të Nenit 72 të Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite nuk konsiderohej krim veprimtaria që synonte në minimumin e rolit të partisë, por vetëm për minimumin e ekonomisë, industrisë, sistemit monetar e kreditit dhe degëve të tjera të ekonomisë. Lidhur me akuzën e sabotimit në fushën e mbrojtjes (të artit ushtarak, përgatitje luftarake e të fortifikimit) ndonëse gjykata shprehet në vendimin se kjo u vërtetua plotësisht, nuk rezulton një gjë e tillë. Nuk evidentohet asnjë fakt ose prove fajësie, por përkundrazi ka vlerësime të përgjithshme të bëra për veprimtarinë e të gjykuarve nga organet e larta të partisë në pushtet. Gjithashtu, nuk mbështeten në prova të plota edhe në lidhje me sabotimin në fushën e organizimit e të drejtimit shtetëror të ekonomisë në ushtri si dhe ajo në frontin ideologjik. Të gjykuarit padrejtësisht janë akuzuar edhe si pjesëmarrës në një organizatë kriminale sipas nenit 76 të Kodit Penal, ku nga dosja nuk evidentohet asnjë provë në këtë drejtim. Edhe në këtë rast, konstatimet e gjykatës për një grup komplotistësh

në kokë të ushtrisë, për “puç ushtarak”, “veprimtari plotësisht e organizuar”, “qëllim kriminal të likuidimit me anë të puçit, etj., janë vlerësime politike të bëra nga organet partiake që nuk gjejnë mbështetje në provat e administruara në dosje.

Gjykata ka gabuar duke u bazuar thjesht në pohimet e të gjykuarve, të cilat janë reflektime të mëvonshme të tyre lidhur me pikëpamjet e mendimet e mëparshme që kanë patur, por që nuk përmbajnë elementë të asnjë figure krimi për të cilat janë akuzuar.

Meqenëse të gjykuarit nuk përfitojnë në bazë të ligjit Nr.7759 datë 8.6.1993 “Për disa shtesa në ligjin Nr. 7660 datë 14.1.1993”, “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 7514 datë 30.9.1991”, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të përndjekurve politik”, çështja do të zgjidhet në rrugë gjyqësore nga ky plenum, duke prishur vendimin e gjykatës e pushuar akuzat për veprat penale të parashikuara nga nenet 64,72,73/3 e 76 të Kodit Penal për të gjithë të gjykuarit.

## PËR KËTO ARSYE

Pleniumi i Gjykatës së Kasacionit, në bazë të nenit 135/1 e 3 të Kodit të Pr.Penale.

## VENDOSI:

Prishjen e vendimit Nr.10 dt. 5.11.1975 të Gjykatës së Posaçme Ushtarake për pjesën që ka deklaruar fajtor e dënuar të gjykuarit Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, e Rrahman Parllaku, për veprat penale të parashikuara nga nenet 64,72,73/3 e 76 të Kodit Penal dhe pushimin e akuzave për shkak se mungojnë elementët e veprave penale.

*Tiranë, më 20.7.1994*

## **Në krye të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar**

Gjeneral Rrahman Parllaku është ndoshta i vetmi, nga ish të burgosurit politik të regjimit komunist, që pas daljes nga burgu ku kishte vuajtur mbi 16 vjet, iu drejtua Gjykatës së Kasacionit për të fituar pafajësinë. Sepse ishte i pafajshëm, nuk kishte tradhëtuar atdheun dhe asnjë akuzë e të kaluarës komuniste ndaj tij, nuk qëndronte. Gjykata e Kasacionit me vendimin Nr 119 datë 20.07.1994 i dha pafajësinë.

Por Parllaku nuk mund të militonte në një organizatë veteranësh me ata që e dënuan për karriken e tyre, me Komitetin Kombëtar të Veteranëve të LANÇ-it që edhe sot mbrojnë sistemin diktatorial të E.Hoxhës. Ai së bashku me një grup veteranësh të tjerë, kryesisht ish-të burgosur politikë, para 20 vitesh formuan Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL).

Pas vdekjes së Dr. Ymer Dishnicës, kryetarit të parë të kësaj organizate, Parllaku zgjidhet kryetar i OBVL dhe po e drejton atë me përkushtim të rrallë që nga viti 1998.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (OBVL) është një organizatë shoqërore atdhetare. Gjatë këtyre dy dekadave të fundit, gjeneral Parllaku në krye të OBVL ia doli të përmbushë misionin kryesor, vlerësimin realisht të historisë së Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare, të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit totalitar, mohimet dhe politizimet e bëra si rezultat i regjimit, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamerituar.



Për dy dekada në drejtimin e kësaj organizate, Parllaku ka dhënë shembullin e intelektualit vizionar e të guximshëm dhe si i tillë ka dënuar me forcë, fakte e argumente krimet e diktaturës komuniste dhe ka mbështetur proceset demokratike, krijimin dhe konsolidimin e shtetit ligjor.

Gjatë afro 20 viteve të ekzistencës së OBVL-së, kreu i saj, Rahman Parllaku, duke punuar me përkushtim ka bërë një punë të madhe për përforcimin dhe zgjerimin e radhëve, për propagandimin dhe njohjen e vlerave të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Këtë e ka arritur nëpërmjet mbledhjeve të bëra çdo vit për përkujtimin e krijimit të çetave, batalioneve, brigadave dhe njësisve të tjera partizane, si dhe duke përkujtuar figura të shquara të LANÇ-it, si Spiro Moisiu, Ymer Dishnica, Dali Ndreu, Nexhip Vinçani, Vaskë Gjino, Tahir Kadare, etj.

Një punë voluminoze, OBVL, e drejtuar me mençuri dhe largpamësi nga "Heroi i Popullit" Rahman Parllaku, ka bërë për plotësimin e kërkesave të veteranëve, për dhënien e statusit që gëzojnë sot ata, etj.

Në periudha kritike për kombin, siç ishte lufta për çlirimin e Kosovës nga okupatori serb, gjeneral Parllaku dhe OBVL që ai ka drejtuar e drejton, ka përkrahur me të gjitha forcat popullin vëlla të Kosovës, nëpërmjet konferencave, artikujve e prononcimeve në media, ndihmave, etj.

Po ashtu ka mbajtur lidhje dhe ka bashkëpunuar edhe me drejtuesit e shoqatave e organizatave homologe të vendeve të tjera, si me Organizatën e Veteranëve të Konfederatës së Zvicrës, me Shoqatën e LANÇ-it të Kosovës, etj.

Si rezultat i drejtimit me përkushtim e profesionalizëm nga Rahman Parllaku, OBVL është anëtare me te drejta të plota e Federatës Botërore të Veteranëve të Luftës e të viktimave, me qendër në Paris, ku aderojnë 84 organizata dhe shoqata të veteranëve nga e gjithë bota.

Këtë vit, kjo organizatë përgatitet të festojë 20-vjetorin e krijimit dhe për këtë, kreu i saj, gjeneral Parllaku ndjen krenari legjitime.

## **Parllaku me Presidentin Berisha në festimet e 50-vjetorit të fitores mbi nazifashizmin**

**Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare, jo vetëm me luftën e saj të lavdishme për çlirimin e Atdheut, por edhe me kontributet e saj në luftën antifashiste të popujve të tjerë, e bëri Shqipërinë pjesëtare të denjë të shteteve fitimtare kundër nazifashizmit në luftën e dytë botërore.**

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Zoti Sali Berisha, pas pjesëmarrjes në festimet e 50-vjetorit të fitores mbi nazifashizmin gjatë luftës së II Botërore, i kthyer nga Parisi, Londra e Moska, në takim me veteranët e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare u shpreh: “U ndjeva krenar dhe i emocionuar kur pashë flamurin tonë kombëtar të valvitej krahas flamujve të shteteve fitimtare të Luftës së Dytë Botërore kundër nazifashizmit. Gjithashtu, kur më bëheshin nderet si President i Republikës së Shqipërisë, më shkante mendja te ata djem e vajza që ranë dëshmorë në lulen e rinisë dhe te ju e te dhjetra mijë bashkëluftëtarët tuaj që bëtë sakrificë mbinjerëzore për të arritur fitoren në atë luftë të lavdishme”.

*Në 85-vjetorin e "Heroit të Popullit" Rrahman Parllaku*

## **Bashkëluftëtarët urojnë Gjeneral Parllakun**

### **Ceremoni e organizuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës**

Ministria e Mbrojtjes dhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës organizuan më 17 prill 2004 një takim jubilar me rastin e 85-vjetorit të lindjes të Gjeneral Lejtant, në pension, Rrahman Parllakut, "Hero i Popullit".

Në ceremoninë e organizuar në sallën e Qendrës Kulturore të Ushtrisë në Tiranë merrnin pjesë veteranë të luftës, shokë, miq dhe bashkëluftëtarë të heroit, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe kuadro të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes.

Për të urrear këtë figurë të shquar të popullit dhe kombit shqiptar kishin ardhur Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, Ministri i Mbrojtjes, Pandeli Majko, deputetë dhe përfaqësues të partive politike.

Mbi aktivitetin e zotit Parllaku, në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, foli Gjeneral Major Luan Hoxha.

Në emër të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës përshëndetën Edip Ohri, Sekretar i Përgjithshëm i OBVL, Skënder Malindi, Kolonel, në pension, nënkryetar i OBVL.

Nga të pranishmit u mirëprit në veçanti përshëndetja e Presidentit të Republikës, Alfred Moisiu.

Një moment vërtet emocional, jo vetëm për "Heroin e Popullit", por dhe për bashkëluftëtarët, miqtë dhe të afërmit e tij ishte dhënia e Emblemës të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, z. Parllaku nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm,

Gjeneral Leitnant Pëllumb Qazimi.

Më pas shtrëngime duarsh, përqafile të përzemërta dhe lule të shumta për Kryetarin e OBVL, e bënë edhe më të larmishme këtë ceremoni që u mbyll me një pritje koktej për të pranishmit.

Çaste vërtet emocionante dhe të paharruara për Gjeneral-Leitnant në pension Rrahman Parllaku dhe familjen e tij, edhe të nesërmen e ceremonisë festive, tashmë jo në mjedise publike, por në shtëpinë e tij. Shokë, miq, të afërm, bashkëlufëtare të heroit, i uruan atij në mjedisin e ngrohtë familjar jetë të gjatë në të mirë të atdheut dhe kombit.

### **Presidenti Moisiu:**

#### **Gjen. Parllaku, shembull frymëzimi për brezat**

Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, mori pjesë më 17 prill 2004, pasdite, në ceremoninë e organizuar nga Ministria e Mbrojtjes në Qendrën Kulturore të Ushtrisë në Tiranë, me rastin e 85-vjetorit të lindjes së Gjeneral Leitnant në pension Rrahman Parllaku.

Kryetari i shtetit, duke i uruar jetë të gjatë e shëndet në këtë jubile, vlerësoi kontributin e veçantë të ish-Zv/shëfit të Shtabit të Përgjithshëm, etapat e jetës së të cilit lidhen me zhvillime të rëndësishme të ushtrisë dhe vendit. "Ai kontriboi në Luftën Antifashiste dhe pas çlirimit. Në sajë të punës dhe përpjekjeve arriti të bëhet një nga drejtuesit e lartë të ushtrisë sonë. Provoi trajtimin e keq në burgun e Burrelit, si shumë ushtarakë të asaj kohe, nuk u ligështua dhe pasi doli nga burgu me fillimin e proceseve demokratike u përfshi për të dhënë ndihmesën e tij nëpërmjet organizatës së veteranëve në interes të atdheut", - ishte vlerësimi i Moisiut.

Në 85-vjetorin e ditëlindjes, Gjeneral Leitnant Parllakun e uruan edhe krerët e PBL-së, Teodor Laço e Shaqir Rexhvelaj, të pranishëm në aktivitetin që u organizua më 17 prill në Qendrën Kulturore të Ushtrisë.

# **Ndjesë se nuk i plotësuam premtimet që kishim dhënë gjatë luftës**

## **Fjala falenderuese e Gjeneral Rrahman Parllakut**

*Të nderuar Zonja e Zotërinj!*

Në këto momente ndihem tepër i emocionuar kur jam i rrethuar nga kaq shumë shokë, miq, bashkëluftëtarë, bashkëpunëtorë e bashkëvuajtës, me të cilët kam kaluar momente gëzimi në luftë, punë e jetë, por kam kaluar edhe momente dëshpërimi, ku më janë dashur përpjekje e sakrifica mbinjerëzore për t'i përballuar. Fatmirësisht, gjithnjë me mbështetjen jo vetëm të familjarëve, por edhe të shokëve, miqve e të bashkëpunëtorëve munda t'i kapërcej ato e të mbijetoj.

Sot, unë ju falenderoj të gjithë ju që më nderuat me pjesëmarrjen tuaj!

Me këtë rast falenderoj nga zemra në mënyrë të veçantë Presidentin e Republikës, z. Alfred Moisiu, për nderin që më bëri me pjesëmarrjen e tij në këtë ceremoni me rastin e 85-vjetorit të lindjes sime.

Falenderoj Ministrin e Mbrojtjes, z. Pandeli Majko dhe Shtabin e Përgjithshëm, me në krye Gjeneral-Leitnant Pëllumb Qazimi, që më nderuan me pjesëmarrjen dhe me organizimin e kësaj ceremonie. Falenderoj gjithë familjarët e mi që m'u gjendën afër në kushtet më të vështira të jetës sime e në mënyrë të veçantë Lazen, kunatën time, që në ato momente me përkujdesjen e saj m'u bë më tepër se motër.

Me këtë rast u bënë për mua shumë urime e lavdërime për luftën, punën e gjithë veprimtarinë time jetësore.

Këto vlerësime më bëjnë të ndihem krenar për atë çfarë kam bërë, por unë bashkë me brezin tim të luftës, e në mënyrë të veçantë ne që patëm funksione të larta shtetërore, e kemi për detyrë morale t'i kërkojmë falje shoqërisë shqiptare, se nuk i plotësuam detyrat e premtimet që kishim dhënë gjatë luftës. Nuk mundëm të vendosnim një shtet ligjor ku populli të gëzonte liri të plotë, të zhvillohej e begatohej si të gjithë kombet me të cilët aspirojmë të bashkohemi.

Unë pata fatin që në këtë moshë t'i përjetoj ndryshimet demokratike dhe me gjithë tranzicionin shumë të vështirë që po kalojmë, kam besim të plotë në energjinë e mençurinë e popullit tonë dhe jam i bindur se ai do të çajë rrugën drejt zhvillimit për të hyrë në familjen e përparuar të kombeve.

Unë, gjithashtu, pata fatin e arrita të shoh edhe ndryshimet thelbësore në rrafshin kombëtar.

Pashë Kosovën të lirë dhe që ka hyrë në rrugën e pakthyeshme drejt Pavarësisë.

Populli shqiptar në Maqedoni, me përpjekjet dhe luftën e tij, po afirmohet si komb me të drejta të barabarta në trojet e veta etnike.

Dhe kam bindjen se shqiptarët kudo që të jetojnë në trojet e tyre, do të jenë të lirë e të barabartë me të tjerët.

Është kjo jetëgjatësi edhe që m'i dha këto privilegje.

Së fundi, ju falenderoj edhe njëherë nga zemra të gjithëve, duke ju uruar: Gëzime paçi në jetë dhe në familje!

## Gjenerali i pavdekshëm

*(Kushtuar Gjeneral Rrahman Parllakut,  
"Hero i Popullit", në 85-vjetorin e lindjes)*

Njeriu lind një ditë dhe vdes një ditë. Por disa njerëz nuk vdesin pasi janë të pavdekshëm, sepse bëmat e tyre janë të pavdekshme. I tillë është edhe Gjeneral Rrahman Parllaku.

Ai nuk vdiq kur u plagos dy herë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, nuk vdiq kur e burgosën dhe e internuan gjatë diktaturës komuniste. Nuk vdiq pasi nuk vdesin heronjtë e këtij populli të pavdekshëm.

Rrahman Parllaku është nga Novosej i Kukësit, nga Luma, nga ai vend ku nga një pasha turk e mbysnin për vjet, ashtu siç thotë kënga popullore: "Djemtë e Lumës nuk kanë dert/ nga një pashë e mbysin përvjet". Është nga ai vend ku serbët u zmbropsën me turp, sepse udhëhiqeshin nga kryetrimi Ramadan Zaskoci.

I rritur në këtë vend me kaq shumë tradita të mëdha patriotike, nuk kishte si të dilte ndryshe, veçse të bëhej edhe ai një hero i popullit shqiptar.

Djaloshi kuksian e filloi veprimtarinë e tij luftarake në Vlorë që më 28 nëntor 1941, ku shumë shpejt u bë drejtues dhe organizator i grupeve guerrile të këtij qyteti të Jugut të Shqipërisë. Më vonë u zgjodh komisar batalioni në Br. V. S., Zv.Komisar i Br. VIII-të S., Komandant i Divizionit të V-të në nëntor 1944 dhe Komisar i Korparmatës së II-të në prill 1945.

I plagosur në Kallarat të Kurveleshit dhe në Junik të

Kosovës, ai është shembull i trimërisë mbarëkombëtare dhe i qëndresës njerëzore.

Rrahman Parllaku është njeriu që gjithë jetën e tij ia kushtoi Luftës Nacionalçlirimtare, ushtrisë shqiptare dhe çështjes mbarëkombëtare. Drejtor Politik më 1948, Zëvendësministër i Mbrojtjes më 1952, Zëvendësshëf i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Gjeneral Lejtnant me gradë të fituar në luftë dhe në betejat e mbrojtjes së atdheut, Komandant i forcave tokësore, detare, ajrore dhe i logjistikës, ushtaraku që njihte çdo rrahje të zemrës së ushtrisë, ky ishte Rrahman Parllaku. “Heroi i Popullit Shqiptar”, hero i popujve që luftuan dhe fituan në Luftën e II-të Botërore, Gjeneral Rrahman Parllaku u burgos nga diktatura komuniste, sepse njerëz të tillë viganë, patriotë dhe të përgatitur nuk i donte diktatura.

Por a burgosen viganët, a vdesin heronjtë?! Sigurisht që jo. Përsëri në krye të Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Popullit Shqiptar qëndron “Heroi i Popullit” Rrahman Parllaku.

Heronjtë nuk mposhten. Heronjtë nuk vdesin. Rron lavdia e tyre. Rron dhe do të rrojë në shekuj Shqipëria që do t’i nderojë bijtë e saj. Gëzuar ditëlindjen, Hero!

*Sakip Cami*

*Gazetar ushtarak*

*Gazeta “Veterani”, 17 prill 2004*



*Në 90-vjetorin e lindjes*

**Ministri i Mbrojtjes, Gazmend Oketa, dekoron Gjeneral  
Rahman Parllakun**

## **Gjenerali i ushtrisë shqiptare, në tre epoka**

Gjenerali i shquar Rahman Parllaku u dekorua nga Ministri i Mbrojtjes, Gazmend Oketa, në 90-vjetorin e lindjes së tij me motivacionin “Për kontribut të shquar në shërbimin ndaj Atdheut, Kombit dhe Ushtrisë Shqiptare”.

Më 18 prill 2009, miq e të afërm si dhe personalitete të vendit uruan në këtë ditë të veçantë Gjeneral Parllakun si dhe vlerësuan kontributin e tij, mes tyre znj. Liri Belishova.

Vetë Parllaku e konsideroi një kënaqësi të madhe një përvjetor të tillë. Gjenerali i tre epokave vlerësohet për kontributin e shquar gjatë Luftës Antifashiste kundër okupatorëve italianë e gjermanë, ku luftoi me trimëri dhe heroizëm deri në vitin 1945, duke mbetur i plagosur dy herë e duke patur poste të larta drejtuese në formacionet partizane, duke filluar nga komisar batalioni, komisar brigade, komandant divizioni dhe komisar korparmate.

Në 90-vjetorin e tij, Gjeneral Rahman Parllaku, ja si e komenton hyrjen e Ushtrisë Shqiptare në NATO: “Hyrja në NATO është në nderin e Shqipërisë, është në nderin tonë që flamuri ynë vihet në radhën e parë me kombet e tjera”.

Në emër të OBVL-së përshëndeti anëtarja e kryesisë së OBVL-së, znj. Liri Belishova, e cila vlerësoi rolin e Gjeneral

Parllakut si të pashembullt: “Sot ne kemi përpara një hero të gjallë, një komandant divizioni të Luftës Antifashiste, komandantin e Divizionit të V-të Sulmues që luftoi edhe për çlirimin e Kosovës dhe të viseve shqiptare në ish- Jugosllavi.

Sot kemi përpara një gjeneral që u ndesh me gjeneralët e Traktatit të Varshavës për mbrojtjen e Shqipërisë dhe të Bazës Detare të Pashalimanit.

Sot kemi përpara një gjeneral, që ndonëse në moshë të thyer, shkoi në Kosovë në mbështetje të UÇK-së dhe të veprimeve të NATO-s në Kosovë.”

Në emër të Shoqatës Atdhetare Kulturore “Luma”, në kryesinë e së cilës është edhe “Krajli”, Gjen. Rrahman Parllaku, përshëndeti kryetari i kësaj shoqate, Prof. Dr. Dritan Spahiu.

## I nderuar me të gjitha dekoratat që ka shteti shqiptar

*Nga fjala e Prof. Dr. Dritan Spahiu*

Është kënqësi e veçantë për mua që të përshëndes përzemërsisht Gjeneral Rrahman Parllakun në 90-vjetorin e lindjes së tij, duke i uruar në emër të Shoqatës Atdhetare Kulturore “Luma” dhe në emrin tim personal: Jetë të gjatë, shëndet të plotë dhe memorie të fortë për të pasqyruar fuqishëm dhe realisht epokat që përfaqëson dhe që ka jetuar.

90 vjet përbëjnë një rrugë të gjatë jetësore që ka kaluar gjenerali ynë. Gjeneral Parllaku demonstroi qartë cilësitë dhe virtytet më të mira të malësorit lumjan, siç janë respekti dhe dashuria për njerëzit me të cilët ka punuar dhe jetuar, serioziteti dhe përkushtimi për aktivitetet dhe detyrat e vështira që merrte përsipër për të realizuar.

Gjatë gjithë jetës së tij, ai demonstroi një qëndrim të spikatur patriotik dhe atdhedashuri të madhe. Në 90 vitet e jetës së tij, Gjeneral Rrahman Parllaku u përball me shumë guxim me sfidat e jetës dhe i përballoi ato me vendosmëri. Jeta e vështirë në vendin e tij të lindjes e detyruan atë të zgjedhë Vlorën për një jetë më të mirë. Në Vlorë, me punën e tij të ndershme, me sjelljen shembullore dhe korrekte fitoi respektin e madh të vlonjatëve që e deshën me gjithë zemër. Në qytetin bregdetar, ai u ndodh në vitet e vështira të pushtimit fashist të Shqipërisë dhe Luftës së II-të Botërore. Në atë periudhë vihej në rrezik serioz vetë ekzistenca e shtetit shqiptar. Në këtë periudhë,

Parllaku u vu plotësisht në shërbim të luftës kundër fashizmit dhe të mbrojtjes së trojeve shqiptare.

Pas lufte, ai përsëri vuri jetën e tij për mbrojtjen e atdheut duke punuar me përkushtim dhe si shpërblim mori burgimin në burgjet e diktaturës.

I nderuar me të gjitha dekoratat që ka shteti shqiptar deri tek më e larta, ajo e “Heroit të Popullit” dhe me dy dekorata ndërkombëtare për kontributin e tij edhe si Gjeneral i Luftës së II-të Botërore, Gjeneral Rrahman Parllaku i bën nder Lumës që e rriti dhe gjithë kombit shqiptar.

Urimet më të mira, jetë të gjatë dhe shëndet të plotë!

E shtunë, 15 tetor 2011

Çmimi: 30 centë

# lajm

www.parrotlajm.net

E përditshme, 90.210.000

## LUFTA E UÇK-së, KURORË E LAVDISHË

Isk-generalit i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (IF) Shqipërisë, Rrahman Parllaku, pas promovimit të veprimtimit të tij "Kosova e lirë është e jeta sime", në një intervistë për "Lajm" luftën e UÇK-së e ka cilësuar si kurorën e lavdit të luftës që ka bërë populli ynë. Ai ka thënë se, megjithë dhënie të tyre, shqiptarët ende nuk kanë një platformë dhe një perspektivë të qartë kombëtare.



Rrahman Parllaku


# Mirënjohje

familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre...

*... Në luftën kombëtare me Hitlerin  
... në luftën me amerikanët dhe sovjetikët  
... në luftën me turqin. Familjet më të mira më  
... Rrahmanin që të largoi dhe ty të çoi. Por ty  
... më do të vlerësojë kurrë! Ai do të jetë gjithmonë  
... familja kombëtare. Ai do të jetë kurrë më i miri për ty  
... të mirësi si një e keqe...*



RAHMAN PARLLAKU



## KOSOVA E LIRË ëndrra e jetës sime

# IX

Publicistika dhe kontributi i  
Parllakut në historiografinë  
shqiptare

## **“Memoria historike e kombit”**

Gjeneral Rrahman Parllaku, pas daljes nga burgu, i ka hedhur në letër kujtimet e tij.

Si gjeneral i tre epokave, ai është “memoria historike e kombit”. Nëse do të dish se çfarë ka ndodhur në Vlorë në periudhën 1939-1943, pyet Rrahman Parllakun ose referoju librit të tij. Nëse do të dish për Tiranën, përsëri është gjenerali që të ndihmon. Gjithashtu, nëse kërkon informacion të detajuar për luftën e Kosovës si në vitin 1944, edhe në vitin 1999 përsëri janë shumë të vlefshme kujtimet e sakta të Rrahman Parllakut, gjeneralit të kujtesës.

Rrahman Parllaku ka botuar dy libra dhe ka në proces botimi edhe librin e tretë. Libri i parë titullohet “Mirënjohje familjeve vlonjatë që më mbajtën si birin e tyre”. Libri i dytë titullohet “Kosova, ëndrra e jetës sime”, ndërsa libri i tretë në dorëshkrim titullohet “Kujtime për shokët”.

Parllaku është një figurë publike që aktivizohet si në mediane e shkruar dhe atë vizive. Ka qenë i ftuar në disa emisione televizive të organizuara nga TV “KLAN”, “News 24”, etj. Gjithashtu, ka dhënë intervista, por edhe ka shkruar shumë artikuj në gazeta si të “Shekulli”, “Panorama”, “Standard”, “Korrieri”, “Rilindja Demokratike”, “Veterani”, etj.

Si një ndër personalitetet e pakta që kanë mbetur gjallë, ai mundohet që të krijojë një profil publicistik, por dhe të sjellë të vërtetat e hidhura të atij sistemi, shtrembërimin që iu bë idealeve të mëdha të Luftës Antifashiste, në emër të së cilës dhanë jetën e tyre të re shumë djem e vajza.

*Promovohet në Vlorë libri “Mirënjohje familjeve Vlonjate”*

## **Rrahman Parllaku është futur në hapësirat e legjendës**

Në Bibliotekën publike “Shefqet Musaraj” të qytetit të “Flamurit”, nën kujdesin e bibliotekës së qytetit, Parkut Arkeologjik “Amantia” dhe Degës së Lidhjes së Shkrimtarëve, Vlorë, më 26 Mars 2009 u përurua libri “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”, shkruar nga Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllaku, “Hero i Popullit”.

Morën pjesë studiues, punonjës të muzeve, mësues të lëndës së historisë të gjimnazeve të qytetit dhe të shkollave dhe familje që kanë kontribuar në Luftën e Dytë Botërore.

Takimin e organizuar me këtë rast e hapi Liliana Gjika, Drejtore e Bibliotekës së qytetit, e cila ndër të tjera solli ngjarje e fakte nga libri i Gjeneral Rr.Parllakut, duke e quajtur Luftën e Dytë Botërore një ndërmarrje të fuqishme kundër pushtuesit të vendit. Ajo vlerësoi kontributin në këtë luftë të Rr. Parllakut dhe i uroi autorit jetë të gjatë dhe mirëseardhje në qytetin ku organizoi e drejtoi luftën në vitet e para të pushtimit fashist të vendit.

Në emër të Shoqatës Atdhetare Kulturore “Luma” përshëndeti Prof. Dr. Shefqet Hoxha.

Për vlerat e këtij libri foli më pas Hilmi Bani, kryetar i degës së Lidhjes së Shkrimtarëve të Vlorës dhe kryetar i Shoqatës së Viktimave të Mathauzenit. Ndër të tjera, ai tha se Rrahman Parllaku është futur në hapësirat e legjendës.



Një ekspozitë më konkrete rreth këtij libri bëri Albert Abazi, sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Vlorës.

**Kryeredaktori i gazetës “Veterani”, Halil Rama, tha se ky libër është sponsorizuar nga MTKRS dhe jep të dhëna të shumta për ngjarjet e Luftës Dytë Botërore. Libri është shkruar nga një personazh që i ka jetuar ato ditë, figurë kryesore e luftës, por kontributi i tij pas çlirimit u mohua duke u dënuar nga regjimi komunist. Ndër të tjera, z.Rama vlerësoi përshkrimin në këtë libër me vërtetësi të ngjarjeve dhe datave historike të periudhës 28 Nëntor 1941 deri në Prill 1943. Këto janë përjetime të vetë autorit, ish-pjesëmarrës aktiv në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, drejtues i njësiteve guerrile në qytetin e Vlorës deri komisar batalioni, brigade e divizioni. “Qëllimi i këtij libri është nxjerrja në dritë e veprimtarisë të familjeve bazë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në qytetin e Vlorës. Vlera e librit qëndron në faktin se ngjarjet janë të përshkruara me vërtetësi e origjinalitet, si përjetime të vetë autorit”, - tha z.Halil Rama. Risi të këtij libri, sipsas tij, janë evidentimi i aktivitetit luftarak kundër pushtuesit nazifashist në qytetin dhe në Qarkun e Vlorës dhe veprimet luftarake të batalionit që vetë autori ka drejtuar. Po ashtu, libri “ Mirënjohje Vlorës” ka vlera historike për qytetin e Vlorës e më gjerë gjatë viteve të zjarrrta, plot ideale të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ai mbart vlera njohëse dhe edukative për brezat, si dhe shërben si bazë për historiografinë shqiptare. Po ashtu, është i pari i këtij lloji për historikun e Qarkut të Vlorës. Ai përbën një kontribut real në pasqyrimin me vërtetësi të historikut të LANÇ në qytetin dhe qarkun e Vlorës për harkun kohor të cilit i referohet.**

Libri, në dorëshkrim, ka marrë vlerësime pozitive nga personalitete të shquara të letërsisë dhe historisë shqiptare. Kryeredaktori i gazetës “Veterani”, z. Rama, e vlerësoi librin e z. Parllaku për përcaktimin që ai i ka bërë Luftës Nacionalçlirimtare si një vlerë e madhe kombëtare.

Studiuesi vlonjat z.Kotini përmendi kontributin e shquar të Gjeneral Parllakut në luftë dhe në njësitë guerrile të Vlorës.

Në këtë takim promovues foli dhe Dervish Mejdani, i cili vlerësoi luftën dhe heroizmin e autorit të librit në qytetin e Vlorës në kohën e Luftë së Dytë botërore.

Poeti Rushdi Bajrami, me profesion oficer, vlerësoi shpirtin e sakrificës të z. Parllaku dhe bashkëluftëtarëve vlonjatë të luftës, por shprehu keqardhje që kjo elitë intelektualësh u shkatërrua padrejtësisht pas çlirimit të vendit.

Mjeku shkrimtar dhe kryetar i shoqatës “Cakrani”, Asqeri Llanaj, në fjalën e tij, përgëzoi Rrahman Parllakun qëndrimin i tij të drejtë, korrekt dhe vlerësoi punën dinjitoze të tij në paraqitjen e ngjarjeve historike për qytetin bregdetar.

Në këtë takim mori pjesë edhe Halim Ramohito, i cili ndau me kolegët e tij këto mendime: Nuk është rasti që ky libër i mrekullueshëm starton nga qyteti dhe Qarku i Vlorës. Është një vend i shenjtëruar në shekuj nga ku Rrahmani ka marrë me meritë pagëzimin luftëtar antifashist e revolucionar.

Libri ka 280 faqe dhe është i bashkëshoqëruar me foto të pjesëmarrësve dhe heronjve të asaj periudhe kohore, të cilët bënë sakrifica sublime.

### **Parllaku zë vend të nderuar në letërsinë dokumentare të LANÇ-it**

Është fat dhe nder për qytetin e Vlorës të ketë në bibliotekën e tij librin e Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllakut, me titullin domethënës “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”. Biblioteka “Shefqet Musaraj”, së bashku me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Parkun Arkeologjik “Amantia” e organizuan me mjaft dëshirë e kënaqësi promovimin e këtij libri. E veçanta e këtij promovimi është se historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare na jepet e gjallë dhe e shkruar nga një figurë e ndritur e kësaj lufte e epopeje të lavdishme,

siç është Rrahman Parllaku. Ndër vlerat e kësaj epopeje të LANÇ-it është edhe mendimi i këtyre luftëtarëve të shquar që morën pjesë në luftën për jetë a vdekje. Ata ishin bij të thjeshtë të popullit tonë si liridashësi Rrahman Parllaku që jo vetëm e përqaftuan këtë luftë, por u bënë edhe promotorë e drejtues të saj. Trimëria dhe guximi, mbi të gjitha shpirti liridashës i këtij antifashisti të shquar njihen nga mjaft botime e shkrime të autorëve të tjerë, vetëm për të. Por botimi i librit të tij me kujtime "Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre" është një dëshmi e gjallë e kësaj lufte epope, shkruar nga vetë autori me një kulturë e stilit të veçantë. Duke lexuar këtë libër, mbi të gjitha del e gjallë edhe Vlora jonë, si një nga vatrat e mëdha të kësaj epopeje legjendare, ku autori ka qenë dëshmitar okular, pjesëmarrës në shumë beteja në trevën e Labërisë, Vlorës heroike. Në të dalin në pah personazhe historikë, luftëtarë e dëshmorë të lirisë, që përshkruhen në detaje nëpër kronika të gjalla.

Duke lexuar këtë libër, njëkohësisht kujtojmë me mall e nostalgji baballarët tanë, të cilët ishin pjesëmarrës në këto beteja.

Në mënyrë të veçantë ky libër jep tablo të plotë të organizimit të kësaj lufte, si një sakrificë sublime e tërë popullit shqiptar kundër nazifashizmit.

Autori, me një kujdes të veçantë, me një rregull e përpikmëri të atillë që e karakterizon në të gjithë librin, ka mundur të grumbullojë e të ndërthurë ngjarjet në të, si një material që buron nga gjithë ajo gurrë e thellë shpirtërore e tij.

Kujtimet e z. Rrahman Parllaku zënë një vënd të nderuar në letërsinë dokumentare të LANÇ-it, pasi ai i ka përshkruar ngjarjet e betejat e zhvilluara, pjesë e të cilave ka qenë dhe ai vetë, me origjinalitet të plotë. S'ka si të mos mallëngjehesh kur i lexon faqet e këtij libri për ato sakrifica që ata kanë bërë e kontributin që dhanë në luftën dhëmb për dhëmb me armikun, pa kursyer as jetën e tyre, edhe pse ishin fare të rinj.

Libri "Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin

e tyre” i autorit Rrahman Parllakut, gjeneralit tonë të nderuar, është një kronikë e gjallë e epopesë së LANÇ-it. Ai fare qartë përcjell për brezat që vijnë mesazhe të mëdha të lirisë dhe të atdhedashurisë. Me këtë rast, Biblioteka publike “Shefqet Musaraj” e qytetit të Vlorës, Lidhja e Shkrimtarëve e Artistëve dhe Drejtoria e Parkut Arkeologjik Kombëtar “Amantia” falenderojnë autorin e këtij botimi, për këtë dhuratë që i bëri kulturës historike të Luftës së Dytë Botërore. Mendoj se ky libër do të qëndrojë me dinjitet në raftet e Bibliotekës Shqiptare dhe do të përcjellë mesazhe të qarta për lexuesit e të gjitha grupmoshave.

*L. Gjika*

## **Dëshmi e gjallë, faqe e hipotekuar e asaj lufte lavdimbuluar**

Të flasësh për Rrahman Parllakun në Vlorë, respekton veten, se nderon Luftën e madhe Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, ngaqë dhe heroi u shpreh mirënjohje familjeve vlonjate që e mbajtën si birin e tyre.

Është detyrim moral, njerëzor, qytetar e atdhetar për çdo vlonjat, për çdo shkrimtar e artist që nderon luftën për liri, për çdo veteran e pasardhës veteran të qytetit të Vlorës, që të shprehë falenderimet e respektin më sipëror për një nga yjet e gjallë të lirisë, Rrahman Parllakun.

Është në nderin e Bibliotekës “Shefqet Musaraj” të qytetit dhe të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Vlorës që sot takohet e nderon një personalitet të vyer për historinë e Shqipërisë.

Rrahman Parllaku vjen këtu si dëshmi e gjallë, si faqe e hipotekuar e kësaj lufte në Qarkun e Vlorës, kur bijtë e nënave të merrnin gjak në vetull si vetëtima, në emër të idealit të lartë të çlirimit të Atdheut nga kthetrat e bishës nazi-fashiste.

Të gjithë e njohin Rrahman Parllakun në Vlorë nga brezi i luftës. Dhe brezat pasardhës, deri në ditët që jetojmë, e respektojnë atë, se nderojnë Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare e historinë e popullit shqiptar, nderojnë e respektojnë vetveten, sepse, në fund të fundit, jeta është respektim vlerash.

Në vitet e stuhishme të luftës për liri, Rrahman Parllaku qe një zgalem furtune, që s’ia thyen dot krahët e idealit

tramundanat e pushtimit. Në vitet e pasçlirimit i rriten përmasat e dinjitetit e si një shqiponjë sypatrembur, ndërsa vitet e pleqërisë nuk i njeh, i quan informale dhe i flak tutje me shpërfillje si të ishin një pelerinë e vjetëruar e betejave, fushimeve, përherë në lëvizje gjithmonë në veprim, vetëm në shërbim të mbrojtjes së Atdheut. Rrahman Parllaku vjen si një krenari malesh që tallet me bubullimat e më duket sikur thotë:

“Vetëm ty, Nënë Shqipëri të falem! Vetëm për ty, Nënë Shqipëri, s’ndalem vetëm te ti mbahem. Vetëm prej teje, Nënë Shqipëri, s’ndahem dhe për ty flamur kuqezi betohem dhe para teje flamur kuqezi gjunjëzohem dhe me ty kuqezi krenohem dhe për ty flamur kuqezi flijohem”.

Të flasësh për Rrahman Parllakun jo vetëm për librin e tij për Vlorën heroike, duhet pasur parasysh aktiviteti i tij shumë i gjatë në shërbim të popullit e atdheut, aktivitet që ai e ka filluar që në moshë të re, brumosur me ndjenja të fuqishme atdhetare nga ajo familje kuksiane që e lindi, e rriti dhe e përgatiti për atdhe, si të parët e tij. Në Vlorë, ai zëvendësoi në detyrë Arif Haskon, birin e shquar të Tërbaçit e Labërisë, që ne do t’ia kujtojmë deri në përjetësim emrin e tij të paharruar. Pjesëmarrës aktiv në lëvizjen dhe LANÇ-it, Rrahman Parllaku e ka përjetuar me intensitet e përkushtim atë kohë heroike, si drejtues i njësiteve guerrile të Vlorës, ku u shqua si një organizator shumë serioz, trim, i guximshëm, përgjegjës shumë i kujdesshëm në drejtimin e aksioneve, të cilat bazoheshin në rregulla shumë të forta. Emri i tij regjistrohet bashkë me ata trima të tjerë, që me heroizmat e tyre e rreshtuan Shqipërinë tonë në krah të vendeve fitimtare të luftës, në plan botëror, sepse zhvilluan një luftë të drejtë, jo pushtuese, dhe u kthyen nga aksionet, betejat e nga malet me lirinë e shkruar në ballë, të bukur si liria, të qeshur si ajo. Patjetër që Gjenerali na i sjell të pashlyeshme vetë kujtimet e tij për veprimtarinë e njësiteve guerrile të qytetit, ndaj unë do të theksoj dy cilësi të tij. Së pari, vlerën e vërtetë për mbrojtjen e Atdheut, reflektuar në arsimin më të lartë ushtarak dhe vetitë e larta komanduese e drejtuese.

Duke shfletuar koleksionin e revistës “Mbrojtja” për efekt të një studimi, Nr.1/1996, fq.18 lexoj se “Për përgjithësimin e përvojës së Luftës sonë të madhe Antifashiste dhe hedhjen e bazave të artit të vërtetë ushtarak, në qendër, u krijua një grup pune studimor, me bërthamë general-majorët: Spiro Shalsi, Thoma Xhixho e Ernest Jakova, Gjeneral-Leitnant Vaskë Gjino, Toli Naçe, Muhamet Prodani, Rrahman Parllaku, Arif Hasko, kundëradmirali Abdi Mati dhe gjeneral-majorët Mendu Backa e Abaz Fejzo. Kur rritej bërthama, grupi plotësohej me 11-13 kolonelë, midis të cilëve është dhe emri i ish-Presidentit të Shqipërisë, Alfred Moisiu.

E quaj të tepërt komentin për të evidentuar vlerat e Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllakut dhe për faktin e njohur se si arriti deri në detyrën e Zv.Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Së dyti, dua të vlerësoj respektin deri në përgjegjësi morale që ka patur Rrahmani për Gjeneral Spiro Moisiun, këtë figurë qendrore të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Po në revistën “Mbrojtja” nr.11/1994, fq. 9-11, gjej shkrimin ku Rr.Parllaku me vërtetësi e admirim thur portretin e Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, gjeneralit të parë të asaj ushtrie që i pruri lirinë Shqipërisë. Trimi respekton trimin, komandantin e guximshëm, që gëzonte besim e dashuri në ushtri e në popull, e adhuron. Dhe tërheq vëmendjen: “Historiografia jonë i është shumë borxhli veprës së Spiro Moisiut. Si një mrekulli e veçantë stoike, si një koleksion i papërshtueshëm xhevahiresh të çmuara me vlerë të pallogaritshme na ngjan shpirti i njeriut të mirë dhe gjeneralit të pathyer Rrahman Parllaku. Faleminderit, o ëndërr luftë! Mirënjohje, o realitet i lirë! Rrofsh sa shqiponjat!

*Albert Abazi*

*Nga përshëndetja e Prof. Dr. Shefqet Hoxha,  
në emër të Shoqatës Atdhetare Kulturore "Luma"*

## **"Burri i maleve të Lumës po mbahet si krajl"**

*Zonja dhe Zotërinj,  
I nderuar z. Krajli*

Paraqitja e një libri është festë. Në këtë festë të sotme ecin paralelisht dy mirënjohje: mirënjohja e Rrahman Parllakut për familjet vlonjate që e mbajtën si birin e tyre dhe mirënjohja jonë për "Krajlën", gjeneralin legjendë, të cilin ne e kemi anëtar të shoqatës sonë "Luma".

Unë në këtë tubim dola për të përshëndetur, jo për të analizuar librin, për t'i shprehur mirënjohje autorit, sepse kontributi i "Heroit të Popullit" Rrahman Parllaku vazhdon në të gjitha epokat, edhe tani në epokën e demokracisë me kujtimet e tij historike si dhe me drejtimin e OBVL-së, organizatës që vlerëson reliasht Luftën Antifashiste të popullit shqiptar.

I shprehim mirënjohjen tonë "Krajl" -it dhe jemi të kënaqur se edhe në moshë të thyer, pas gjithë atyre rropamave, burri i maleve të Lumës po mbahet si krajl.



## **Promovohet në Prishtinë libri i Gjeneral Rrahman Parllakut “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime”**

*Më datë 14 Tetor 2011, në mesditë, në sallën kryesore të konferencave të Bibliotekës Kombëtare Universitare të Prishtinës, u bë promovimi i librit të Gjeneral Rrahman Parllakut “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime.”*

*Qindra veteranë të Luftës Antifashiste të Kosovës dhe të Shqipërisë, luftëtarë të UÇK-së, studentë kosovarë dhe të ftuar nga Shqipëria kishin mbushur sallën e kësaj biblioteke që është një vepër monumentale dhe vepër arti e Kosovës. Në këtë veprimtari promovuese merrte pjesë gjithashtu edhe ambasadori i Shqipërisë në Republikën e Kosovës, z. Islam Lauka.*

Gjeneral Rrahman Parllaku, ndonëse në moshën 92-vjeçare, vjen para lexuesve me librin e tij të dytë publicistik. Pas suksesit të librit të parë “Mirënjohje familjeve vlonjatë që më mbajtën si birin e tyre”, Gjeneral Rrahman Parllaku, “Hero i Populli”, kjo figurë emblematike e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, merr përsipër dhe shkruan me sukses librin e tij të dytë për Kosovën. Ky luftëtar i dy luftërave të Kosovës e ndjen si detyrim që të shkruajë për luftën e Divizionit të V-të në Kosovë si dhe për luftën e UÇK-së, por pa harruar përpjekjet e faktorit shqiptar për ta mbështetur këtë luftë të drejtë.

Promovimin e hapi Vahide Hoxha, kryetare e Shoqatës së veteranëve të LANÇ-it Kosovë.

Në përshëndetjen e saj, zonja Vahide Hoxha, ndër të tjera tha: “Libri i Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllakut përmban

plot dokumente që dëshmojnë për ngjarje të rëndësishme të periudhës 1944-1945, kryesisht për heroizmin e forcave të Brig. III –të e V-të në Kosovë e ish-Jugosllavi.

Edhe tani, pas 65 vjetësh Gjeneral Rahman Parllaku ka një kujtesë të freskët dhe shkruan për të vërtetat e atyre viteve të stuhishme.

I uroj gjeneralit jetë të gjatë dhe libra të tjerë me kujtime për luftën.

Ndërsa Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë në Prishtinë që ka shkruar edhe parathënien e këtij libri në referatin e tij kryesor theksoi se z. Rahman Parllaku është një emër i veçantë dhe personalitet që të krijon afërsinë dhe ndjenjën e respektit për figurën e tij si dhe për ngjarjet, fenomenet dhe personazhet që i kujton gjatë bisedave spontane.

Rahman Parllaku, duke qenë një nga figurat më të shquara të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare në Shqipëri, i cili, përkundër moshës, ka një kujtesë e kondicion të lakmueshëm dhe zë një vend të veçantë në kujtesën tonë historike. Kujtimet e tij për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare janë një kontribut i çmuar.

Ai mori pjesë në luftën për çlirimin Kosovës nga fashistët si Komandat i Divizionit të V-të Sulmues.

Në këto kujtime, autori paraqet të dhëna me interes të posaçëm për kontributin e dëshmuar dhe përpjekjet e të gjitha forcave shqiptare që luftuan kundër pushtuesve në kuadër të Aleancës Antifashiste. Në pjesën e kujtimeve gjatë luftës në Kosovë, Gjeneral Parllaku sjell kujtimet e tij nga takimi me vëllezërit Hasan e Gani Kryeziu, në fshatin Devë të Gjakovës. Ai përpiket t'i sjellë shprehjet e këtyre bisedave ashtu si i ka ruajtur në kujtesën e vet për plot 62 vjet.

Rahman Parllaku ia sjell lexuesit me një stil origjinal kujtimet, duke u ndalur në momente më të rëndësishme dhe duke i interpretuar me mjeshtëri të rrallë përjetimet e tij gjatë luftës në Kosovë si: Lufta e Junikut, qëndrimi në Mitrovicë, takimi me Miladin Popoviçin dhe oficerët rusë. Ai, njëherazi,

ruan me besnikëri frymën, idetë, porositë origjinale dhe prezantimin e rrethanave të kohës, ndër më delikatët gjatë luftës.

Në kapitullin e dytë, z. Parllaku ndalet në krijimin e Divizionit të V-të si dhe sukseset e këtij divizioni drejt marshimit të përgjithshëm në Mitrovicë, Rashkë, Pazar i Ri si dhe gatishmërinë për të zhvilluar mësymjen në drejtimin Sjenice-Priepole. Duhet cekur se autori vlerëson lart forcat e Divizionit të V-të, të cilat ai i komandonte, si përfaqësues të denjë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, qëndrimin e tyre shembullor me popullin vendas, veçanërisht në terrenin e banuar me serbë e malazez.

Autori, siç është e kuptueshme, vihet në mbrojtje të të vërtetave historike, për veprimet luftarake të forcave që ai i udhëhoqte në Kosovë, si për luftimet e brigadave të III e të V për çlirimin e Krafshit të Dukagjinit, (Prizrenit, Gjakovës e Pejës me rrethinat e tyre), si dhe u kundërvihet të pavërtetave që janë shkruar për veprimet e Divizionit të V e të VI pas kthimit në Kosovë, në mes të marsit 1945, me përfundimin e luftimeve në Sanxhak, Mal te Zi dhe Bosnjë.

Në pjesën e publicistikës na jep mënyrën origjinale të të menduarit prej një patrioti të kulluar, duke undalur në momentet më të rëndësishme të shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë si dhe të Luginës së Preshevës. Për Gjeneral Parllakun, preokupimi kryesor është përpjekja për të shpjeguar rrethanat e shtypjes, të dhunës e të genocidit të egër ndaj vëllezërve shqiptarë që jetonin në viset e tyre në ish-Federatën Jugosllave.

Në përfundim mund të konstatojmë se ky libër përbën një dëshmi për personalitetin e Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllaku dhe brezin e tij.

Vehap Shita, Sekretar i Shoqatës të Veteranëve të LANÇ-it Kosovë, shkrimtar, në fjalën e tij tha se libri më i ri i Gjeneral Leitnant Rrahman Parllakut "Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime" është shkruar me njohuri prej ushtaraku e me plot emocione e dashuri të sinqertë prej një patrioti të preokupuar për fatin e

vendit e të popullit të tij me “ëndrrën e jetës” së tij që Kosovën ta shihte të lirë e të bashkuar me trungun vet, nënën Shqipëri. Këtë, jo vetëm që e ëndërronte autori, por për këtë edhe luftoi me tërë qenien e tij si drejtues partizan, si gjeneral e strateg në momentet kur vendi dhe populli i tij duhej të pozicionohej drejt që, në ato momente vendimtare të Luftës së Dytë Botërore të mos gjendej në anën e humbësve, siç ka ndodhur shpesh gjatë historisë.

Gjeneral Parllakun, në librin e tij, e shohim duke vrapuar në Kosovë nga fronti në front, në rrethin e Gjakovës, në Junik e Deçan, në Pejë e Mitrovicë, në takime e konsulta ushtarake me komandantët e njësisve të UNÇ-së të Kosovës e të Shqipërisë. E shohim gjeneralin e njësitë e ushtrisë së tij në mesin e shqiptarëve të Kosovës, në shtëpitë e tyre të pritur “me bukë e kripë e zemër”, e shohim mes ushtarëve të rinj të Kosovës që iu bashkuan njësisve të UNÇ-së të Shqipërisë dhe, së bashku, vazhduan luftën deri në përfundimin e saj.

Prof. Dr. Myslim Islami, kryetar i Shoqatës Atdhetare-Kulturore “Lidhja e Prizrenit”, me qendër në Tiranë, në fjalën e tij ndër të tjera tha:

“Në artikujt e shumtë që përmbledh ky botim dalin shumë fakte e shqetësime nëpër kohë të autorit dhe po e them me fjalët e mia, se të to gjen refleksione e konkluzione të sakta ndaj arrivistëve, karrieristëve e aventurierëve, që s’kanë patur guxim e forcë që të shkëputeshin nga mentaliteti i vjetër, nga enverizmi, kulti i gjatë, dhe do t’i gjejë si ajo lëvozhga, që shkëputet nga trungu i lisit e një ditë bie në tokë si një kalbësirë.

Rrahman Parllaku gëzonte simpati dhe ishte i popullarizuar në qytetin e Vlorës, sepse në demonstrata mbante lart flamurin. Në aksione ishte në ballë si organizator e plot iniciativa të guximshme; u bë talent me lëvizjet, me maskimet dhe me qëndresën kur binte përballë patrullave.

Në arkiva ka shumë dokumenta që e lartësojnë veprën e guximin e tij.

U zgjodh nga kuadrot e luftës Komandant i Divizionit të

V-të në Nëntor 1944, që do të kalonte në Kosovë, në Sanxhak.

U fut midis drejtuesve madhorë të ushtrisë ku iu besuan detyra e reparte tepër të rëndësishme si deri në Zv.Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Mbas studimeve në Akademinë e Lartë të Ushtrisë në ish-Bashkimin Sovjektiv, duke vlerësuar aftësitë dhe talentin e tij mori gradën e lartë Gjeneral-Leitnant, midis gjashtë gjeneralëve të parë.

Në jetën e veprën e vet, Gjeneral Rrahman Parllaku s'ka patur zikzake, por kur vendi po izolohej, po zbriste poshtë e më poshtë, megjithëse kishte një ushtri të madhe e tepër të armatosur, sepse despoti shpalli se ishte në gjendje që të thyente e të shpartallonte të dy superfuqitë e koalicionet e tyre, Rrahmani do të guxonte t'i përshtatej realitetit objektiv.

Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllaku u dënua me 25 vjet dhe vuajti 17 vjet në burgjet e diktaturës, 16 Dhjetor 1974 deri më 1991.

U burgos e dënua për motive të qarta politike bashkë me ish-Ministrin e Mbrojtjes, Beqir Balluku, ish-Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Petrit Dume, e Gjeneral Hito Çakon, që u pushkatuan pas një hetuesie intensive e një procesi farsë, me akuzën si puçistë.

Me këtë akuzë absurde u dënua 25 vjet burg edhe Gjeneral Rrahman Parllaku. Për 17 vjet në burg qëndroi si një cop shkëmb dhe trimfoi mbi despotizmin. U lirua kur u përmbys diktatura. "Heroit të Popullit" Rrahman Parllaku, sot në moshë 92 vjeç, i urojmë të rrojë mbi një shekull. Ai drejton me përkushtim Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, që nga koha kur vdiq Dr.Ymer Dishnica.

Ai ishte dhe mbetet një nga drejtuesit më me horizont të LANÇI.

E vërteta mbrohet. Personalitete si Rrahman Parllaku, sot e në të ardhmen, do të mbeten emri i skalitur në historinë e kombit e në vetëdijen e gjeneratave.

Në promovim folën gjithashtu Muharrem Xhemajli,

Kryetar i Shoqatës të Veteranëve të UÇK-së, i cili theksoi pa luftën e luftëtarëve të UÇK-së nuk do të ishte realizuar as ëndrra e Gjeneral Parllakut dhe e të gjithë shqiptarëve.

Fasli Veliu, Kryetar i Shoqatës së Veteranëve të UÇK-së të shqiptarëve të Maqedonisë, pasi bëri një ftesë që ky libër të promovohet edhe në Shkup, në kryeqytetin e shqiptarizmit, tha se ka edhe një luftë për të cilën duhet të shkruhet më shumë, ajo e Ushtrisë Çlirimtare të Maqedonisë, që bëri të mundur mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve.

Në fund, përshëndeti edhe z. Rrahman Parllaku, i cili pasi falenderoi pjesëmarrësit e pranishëm në këtë tubim për promovimin e librit të tij, theksoi se në këtë ndërmarrje të vështirë e ka mbështetur e bija, Tatjana Parllaku, që është edhe redaktorja e librit, Gjeneral Kudusi Lama, Komandant i Divizionit të Kukësit në vitin 1999, gjatë konfliktit në Kosovë, gazetari Halil Rama si dhe gazetari dhe shkrimtari Çobo Skënderi, për të cilët shprehu falenderime.

## **Kur ëndrra bëhet realitet**

*Kumtesë në Prishtinë rreth librit "Kosova, ëndrra e jetës sime" të Gjeneral Rrahman Parllakut*

Sa për njohje, fisi im shtrihet në të dy anët e Drinit të Zi, edhe aty ku ky lumë, nga më të dashurit për shqiptarët shërben si kufi shtetëror. Pra, edhe unë e kam ndjerë mbi supe, ç' do të thotë ndarje, ç' do të thotë represion, ç' do të thotë mall. Prindërit e mi i panë njerëzit e tyre të gjakut në Dibër të Madhe dhe në viset e tjera të Kosovës dhe të Maqedonisë vetëm pas 45 vjetësh, vetëm pas vitit 1991.

Kosova e lirë nuk ka qenë vetëm ëndrra juaj, por edhe ëndrra ime, ëndrra e të gjithë shqiptarëve. Me gjeneralin, këtë bir të Lumës dhe të Kosovës më lidh jo vetëm qenia ushtarak, por edhe fakti se babai im ka qenë bashkëluftëtar me të në rreshtat e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, të cilët luftuan për çlirimin e Kosovës në vitin 1944.

Atë që nuk e arritëm në vitin 1944, e arritëm 55 vjet më vonë në vitin 1999. Fati e solli që Gjeneral Rrahman Parllaku dhe disa të tjerë të ishin përsëri protagonistë të çlirimit të Kosovës, të çlirimit përfundimtar të saj. Dhe protagonist i mbetet protagonist.

Në faqen 78 të këtij libri është një fotografi shumë domethënëse. Në foto është Gjeneral Rrahman Parllaku me disa gjeneralë të tjerë të Luftës Nacionalçlirimtare e të ushtrisë shqiptare, të shoqëruar nga Kolonel Sali Onuzi në vitin 1999 që vizitojnë Kukësin dhe frontin verilindor. U emocionova shumë

nga kjo foto dhe nga këto fakte kuptimplote, sepse unë në atë kohë kam punuar si gazetar ushtarak në gazetën e Ministrisë së Mbrojtjes “Ushtria” dhe e kemi botuar këtë fotografi. Gjeneralët e vjetër, por me shpirt të ri dhe zemër të madhe nuk shkuan si vizitorë në Kukës e Morinë. Gjeneral Rrahmani ishte rritur në këto anë. Ata i thërriste zëri i atdheut, zëri i vëllezërve tanë kosovarë që luftonin në UÇK dhe që kishin sado pak nevojë për përvojën e madhe të këtyre ushtarakëve të lartë. Ata u pritën nga biri tjetër i Lumës, komandanti i Divizionit të Kukësit Gjeneral Kudus Lama, që koha jo rastësisht e thirri në skenë në këtë kohë dhe në këtë vend. Në atë kohë, gazeta “Ushtria” pa përfillur politikën shtetërore hapej me titujt bombastikë: “Plagoset Ram Buja”, “Tym dhe flakë në Grykën e Morinit”, etj. Por edhe Ministri i Mbrojtjes së asaj kohe, Luan Hajdaraga, e kishte zhvendosur stafin e tij dhe të Shtabit të Përgjithshëm në Kukës dhe në Tropojë.

Pra, nëpërmjet fakteve dhe dokumentave, artikujve, letrave, komenteve, takimeve dhe vizitave, Gjeneral Rrahman Parllaku tregon se Kosova ka qenë dhe mbetet pjesa më vitale e trupit të shqiptarëve. Atë që nuk arritëm ta mbanim dhe ta bashkonim më 1945, tani e fituam dhe nuk e lëshojmë më, aq më tepër kur miqtë ndërkombëtarë si SHBA dhe të Europës na ndihmojnë dhe i kemi përkrah. Por edhe Zoti i madh thotë: ndihmo veten të të ndihmoj unë! Pra, faktori vendimtar kanë qenë dhe janë shqiptarët, të cilët për hir të së vërtetës po punojnë mirë dhe që duhet të punojnë akoma më mirë, më të bashkuar dhe më me mençuri.

Libri i Gjeneral Rrahman Parllakut është një memorie historike për të kaluarën, është një thirrje për të tashmen, për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë territor, për të gëzuar fitoren e lirisë, por edhe për të administruar me kujdes fitoren dhe për të mos u dehur nga arritjet. Ne ushtarakët e dimë fort mirë se ç’do të thotë të lëshosh territor. Po lëshove një majë, dije se ke lëshuar një fushë të tërë më pas.

Prof. Jusuf Bajraktari, në parathënien e tij, e analizon më



me detaje librin, prandaj unë u ndala më shumë në aspektin ushtarak dhe atë historik. Pjesa e parë për kontributin e kosovarëve në Luftën e II-të Botërore dhe për çlirimin e Jugosllavisë, e divizioneve shqiptare për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi ka një rëndësi të veçantë, sepse shkruhet nga një gjeneral, nga një luftëtar konkret, dhe godet teoritë famëkeqe të serbve se kosovarët kanë qenë në anën e pushtesve gjermanë. Ashtu sikurse kundërshtarët tanë nuk lodhen së shkruari kundër nesh, ashtu edhe ne nuk duhet të rreshtin së shkruari e të argumentuari me fakte e dokumente se jemi ne ata që e kemi bërë këtë vend, se jemi ne të parët dhe më pas le të vinë të dytët e të tretët. Ne nuk jemi racistë dhe nuk ngasim njeri, por u marrim gjak në vetull kujtdo që na prek në nder dhe dinjitet.

Autori jep me emra se kush kanë qenë drejtuesit e formacioneve partizane, si u zhvillua lufta, të rënët dhe të plagosurit. Pra, është një dokument shtesë në historinë e lavdishme të shqiptarëve.

Pas daljes nga burgu komunist, ndonëse i lodhur dhe i dërmuar nga vitet e gjata të errësirës, Gjeneral Parllaku nuk pushoi së punuari për Shqipërinë dhe Kosovën. Ai u vu në krye të Organizatës së Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare, botoi me dhjetra deklarata për shtyp, artikuj dhe material në gazetat "Veterani", "Rilindja Demokratike" "Standard", "Sot", etj., në mbrojtje të devizës së shqiptarëve dhe të bashkimit të tyre. Jo rastësisht ai përveç se kryetari OBVL-së, është edhe një nga 9 anëtarët e Këshillit Koordinues të Organizatave Jo Qeveritare në ndihmë të Kosovës. Kudo ku përurohet një lapidar, ku shkruhet dhe flitet për një hero apo dëshmor të UÇK-së, ku diskutohen fatet e shqiptarëve, është Gjeneral Rrahman Parllaku. Në këtë libër publicistik nuk duhet të presim klas të lartë të stilit publicistik, megjithëse edhe ky nuk mungon, por ky libër është protestë, është këngë lirie dhe gjaku, është memorie historike, dëshmi që duhet ta dijë dhe ta ketë çdo shqiptar i Shqipërisë dhe i Kosovës.

Edit Durham në librin e saj “Brenja e Ballkanit” shkruan në vitin 1913:

“Dibra ka vuajtur rëndë si pasojë e luftës, sepse kufiri është vendosur ndërmjet dibranëve dhe qytetit të Dibrës që është tregu i tyre. Kjo ka shkaktuar pakënaqësi të madhe në të dy anët e kufirit, madje edhe ndonjë luftim.

Në asnjë rrethanë nuk duhet bërë që një kufi ta ndajë tokën e një fisi në mes, në rast se ata që e caktojnë këtë kufi dëshirojnë të vendosin paqe.”

Pas një shekulli, ata që e shkaktuan këtë padrejtësi në përcaktimin e kufijve filluan të reflektojnë dhe të korrigjojnë gabimet e tyre. Le të shpresojmë në korrigjimin e plotë dhe në bashkimin e plotë të të gjithë shqiptarëve.

Ndërsa Gjeneral Rrahman Parllaku, si një epilog testament e mbyll kopertinën e këtij libri me shënimin: “Arrita realizimin e një prej ëndrrave të mia të kahershme, pavarësinë e Kosovës. Kisha luftuar për çlirimin e saj. Kisha marrë edhe plagë në trup, por atëherë nuk u fitua liria. Po e shoh sot atë (Kosovën) të lirë, të pavarur, tek kapërcen vështirësitë dhe pengesat dhe ecën e sigurt drejt konsolidimit të pavarësisë, drejt zhvillimit dhe përparimit të saj. Kërkesë tjetër dhe aspiratë e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet bashkimi ynë kombëtar. Jam i bindur se edhe kjo ëndërr e imja do të bëhet realitet. Unë jam i moshuar dhe mund të mos ia mbërrij kësaj dite, por jam i sigurt se vijat kufitare të hedhura në harta nuk mund të mbajnë përjetësisht të ndarë popullin e një gjuhe dhe gjaku që aspiro bashkimin. Uroj që kjo të ndodhë sa më parë!

Të gjithë bashkohemi me urimin tuaj. Të urojmë edhe ty gjeneral jetë të gjatë dhe suksese në misionin tuaj fisnik! Urime për librin e dytë dhe presim sa më parë librin e tretë. Urime!

*Sakip Cami,  
gazetar ushtarak*

*Intervista në media*

**PAS DEBATIT PËR “LUFTËN CIVILE” NË SHQIPËRI  
(1939 - 1944)**

**“NE KEMI BËRË LUFTË ÇLIRIMTARE  
DHE JO LUFTË CIVILE”**

*Në një intervistë në një televizion kombëtar për debatin e hapur nëse ka patur luftë civile në Shqipëri në periudhën 1939-1944, “Heroi i Popullit”, Gjeneral Rrahman Parllaku u përgjigj në mënyrë kategorike se ne nuk kemi luftuar kundër ballistëve dhe as ballistët kundër partizanëve, ndonëse në historinë 5-vjeçare të luftës ka patur përplasje sporadike midis forcave tona.*

*Më poshtë po japim intervistën e Gjen. Parllakut dhënë gazetarit Ilir Bushi për gazetën “SOT”, datë 5 Tetor 2011*

**Zoti Parllaku, a është zhvilluar luftë civile në Shqipëri gjatë viteve 1939- 1944?**

E para gjë që duhet të pranojmë, ka të bëjë me ndarjen e kësaj lufte në dy faza, pasi kemi dy okupatorë. Pra, kemi pushtimin italian 1939-1943 dhe pushtimin gjerman që vijon deri në nëntor 1944. Kjo ndarje na ndihmon të japim një gjykim më të plotë dhe më të saktë.

**Cili është mendimi juaj?**

Kur bëhet fjalë për luftë civile, duhet të kemi parasysh se çfarë e dallon një luftë civile nga një luftë çlirimtare. Dhe për

periudhën 1939-1943, deri në kapitullimin e Italisë fashiste, nuk bëhet fjalë për terma të tilla.

### **Përse keni arritur në këtë përfundim?**

Sepse vetë zhvillimet historike ishin të tilla. Për shembull, unë flas për Vlorën, ku komandant i forcave të Ballit Kombëtar për Jugun ka qenë Hysni Lepenica. Ky personalitet i madh jo vetëm nuk ka luftuar kundër partizanëve, por përkundrazi në luftën kundër mercenarëve të Halil Alisë që erdhën për të shkelur Lumin e Vlorës, Hysniu ka qenë bashkë me ne. Gjithashtu, në luftën për të dëbuar karabinierinë italiane dhe shoqërinë e huaj minerare të Selenicës, Hysniu ishte në krahun tonë. Po ashtu në luftën që është bërë në Patos, në Kalanë e Margllicit, ka qenë me ne. Madje këtu ka rënë një dëshmor i Ballit.

Pra, me këtë dua të them se nuk kemi patur luftë civile, por bashkëpunim të ngushtë me forcat e Hysni Lepenicës, i cili ishte padyshim një patriot.

Ndërkaq, forcat italiane kanë ndërmarrë disa operacione kundër nesh, siç ishte rasti i operacionit ku u vra komandanti i tyre me gradën e kolonelit dhe që ndihmoheshin nga forcat mercenare të Halil Alisë.

Disa ditë para kapitullimit, forcat italiane bënë operacionin e fundit kundër nesh pikërisht në zonat Mallakastër, Tepelenë, por edhe në këtë operacion ka patur bashkëpunim dhe jo luftë me forcat e Ballit.

Pra, deri në këtë periudhë nuk janë shënuar luftime në front të partizanëve kundër ballistëve apo anasjelltas. Por, për hir të së vërtetës, ka patur disa raste sporadike.

### **Cilat ishin këto?**

Në luftën e Mezhgoranit (Kuqanit) në korrik të vitit 1943, ku është vrarë Asim Zeneli. Kjo ishte beteja e parë që bëhej në shkallë kombëtare ku mori pjesë Qarku i Korçës, Gjirokastrës dhe ai i Beratit. Dhe kur po ktheheshin, forcat e Qarkut të

Korçës u ndeshën me forcat e Luan Kurtezit. Dhe aty u krijua një keqkuptim, ku u vranë dy vetë, por nuk u bë ndonjë luftë e madhe. Më vonë forcat e Safet Butkës vranë vëllain e Petrit Dumes, kur po laheshin në lumë.

### **Çfarë ndodhi pas kësaj?**

Pastaj i sollën Petritit tetë vetë që kishin kapur robër. Dhe Petriti i pyeti: “Cili nga ju e vrau?”

Ata ngritën supet dhe askush nuk u përgjigj.

Atëherë Petriti porositi që t’u merren armët dhe të lëshohen. “Unë nuk do të shpall luftë me ballistët për vrasjen e tim vëllai.” Kështu u bë. Tetë ballistët u lëshuan. Nga ana tjetër, edhe komandant Safet Butka bëri një gjest fisnik duke i përjashtuar nga radhët këta të tetë. Deri këtu nuk kemi konflikte apo përplasje të armatosur midis ballistëve dhe partizanëve.

### **Pas kapitullimit të Italisë çfarë ndodhi?**

Pas ardhjes së gjermanëve ndryshoi situata. Tani fillojnë përpjekjet midis forcave balliste të rreshtuara në krah të gjermanëve dhe forcave partizane. Pra, në thelb lufta është bërë për çlirimin e vendit. Nuk kemi një divizion, një brigadë, një njësi të Ballit Kombëtar apo të Legalitetit që të luftonte kundër partizanëve.

Operacioni i dimrit 1943-1944 që filloi nga Tropoja dhe mbaroi në Vlorë ka qenë një operacion i gjermanëve kundër forcave partizane. Nëse ka patur forca të Kadri Cakranit që ishte komandant i Ballit, këto ishin të inkuadruara në forcat gjermane.

Po kështu edhe Operacioni i Qershorit 1944 që filloi pas Kongresit të Përmetit, u zhvillua nga gjermanët kundër forcave partizane. Por këtu nuk duhet të harrojmë faktin se forcat partizane kishin struktura të rregullta të organizuara mirë ushtarakisht, duke filluar që nga çetat, batalionet, brigadat, divizionet e deri në korparmata. Pra, ishte një ushtri

e rregullt që luftonte kundër okupatorit. Lufta jonë ishte luftë antifashiste, pjesë e Aleancës Antifashiste të popujve. Luftën Nacionalçlirimtare shqiptare e njohën aleatët. Anglezët dërguan misionet e tyre për asistencë ushtarake dhe për ndihma konkrete logjistike si armë, ushqime, veshmbathje, para, etj. Forcat çlirimtare partizane kanë patur një organizim të plotë që nga Tropoja deri në Konispol.

Episode sporadike ka patur nga të dy krahët. Mund të përmend rastin e Mehmet Shehut që ka vrarë në Lushnjë, apo të Shefqet Peçit që pushkatoi 22 vetë në Buzëmadh të Kukësit dhe katër të tjerë në fshatin afër, sepse forcat e Muharrem Bajraktarit vranë komandantin e batalionit partizan Hysen Çino. Por për këto raste nuk mund të thuhet se ka patur luftë civile, sepse dihet përkuzimi i luftës civile.

Raste të tilla kanë ndodhur edhe në fundin e luftës. Unë duke qenë pjesëtar dhe drejtues i kësaj lufte nuk mund ti marr këto episode si material për të formësuar thelbin dhe për të nxjerrë konkluzionin e gabuar se në Shqipëri ka patur luftë civile, në Shqipëri ka patur pushtues të huaj që e detyruam të largohej dhe të mundej. Ne u radhitëm me fitimtarët e Luftës së II-të Botërore. Dhe ky është thelbi.

## **SI E ÇLIRUAM KOSOVËN DHE U MBËSHTETËM NGA KOSOVARËT**

*(Intervistë dhënë gazetarit të Gazetës "SOT", Ilir Bushi,  
datë 20 Tetor 2011)*

### **Z. Parllaku, kur keni qenë për herë të fundit në Kosovë?**

Në Kosovë kam qenë shpesh. Dhe kjo mund të jetë e tridhjeta herë që vij këtu. Arsyeja është e thjeshtë. Unë e dua Kosovën dhe jam pjesë integrale e Kosovës, Unë e kam dashur Kosovën edhe para se të ngarkohesha për të çliruar territoret e saj, sepse Kosova është e bukura e dheut, është dhimbja dhe krenaria jonë e ligjshme. Sepse Kosova është pjesë e trungut shqiptar dhe një ditë padyshim do të bashkohemi, e do të bëhemi si më parë në atë që quhet Shqipëria natyrale.

### **Me çfarë udhëtuar dhe sa njerëz ju shoqëronin për në Prishtinë?**

Udhëtuam me makina dhe bashkë me mua kanë ardhur rreth 30 veta, kolegë, veteranë, intelektualë, gazetarë. Udhëtuam nga rruga e re ose siç i thonë tani nëpërmjet Rrugës së Kombit.

### **Po 66 vjet më parë si keni udhëtuar drejt Kosovës?**

Sigurisht kemi ecur në këmbë, kemi marshuar, kemi zhvilluar luftime, e kemi çliruar Kosovën pëllëmbë për pëllëmbë. Ishte marshimi i dy brigadave përmes pritave të pushtuesve dhe kuislingëve, por edhe përmes dashurisë dhe ngrohtësisë së popullit kosovar. Rruga që kemi bërë atëhere

kalonte nga Kruma, Tropoja, rrafshi i Dukagjinit, Qafë Morina, Prizreni, Peja, etj.

### **Si ju erdhi urdhëri për të marshuar drejt Kosovës?**

Në prag të mbarimit të luftës apo në fund të saj, dy divizionet tona dhe pikërisht ai që komandoja unë dhe ai që komandonte Gjin Marku morën si detyrë që të luftonin matanë kufirit, në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare të Ish- Jugosllavisë.

### **Kush ua dha këtë detyrë?**

Detyrën na e dha Komandanti i Korparmatës së I-rë Gjen. Dali Ndreu, në Priskë të Tiranës, duke thënë do të shkoni në Kosovë, do të luftoni së bashku me popullin kosovar. Sepse atje duke qenë Xhafer Deva me forcat e tij mercenare, ishte hapur një nam i keq që mund t'i kushtonte Kosovës për brezat e ardhshëm.

### **Çfarë ishte ky nam i keq?**

Duke qenë Divizioni SS dhe Regjimenti Kosova, serbëve u interesonte që ta quanin popullin e Kosovës si bashkëpunëtorë të gjermanëve, për të bërë më vonë spastrime etnike. Njëlloj si mashtrimi që bënë grekët me popullsinë çame. Këtu synonte edhe plani i Cubrilloviçit për të spastruar Kosovën. Por kosovarët morën pjesë në Luftën Antifashiste. Mbi 50 mijë vetë u inkuadruan në armatat patizane jugosllave. Në Divizionin e V-të që komandoja unë, morën pjesë 1600 kosovarë. Dhe serbët e mbyllën gojën, ndërsa Titoja nuk kishte asnjë justifikim për t'i përzënë nga trojet e tyre.

### **Po me forcat e Xhafer Devës çfarë ndodhi?**

Me ata u përplasëm, sepse forcat e Xhaver Devës ishin organizuar nga gjermanët. Xhafer Deva ishte ai që kishte organizuar në Tiranë vrasjet e 4 shkurtit. Gjermanët kishin organizuar forcat e Xhafer Devës në Divizionin e Gardës, për të siguruar tërheqjen e forcave gjermane. Dhe gjatë kësaj



ata vranë 32 vetë nga divizioni ynë, ndërkohë që 40 të tjerë mbetën të plagosur. Edhe nga forcat e Xhafer Devës pati të vranë dhe të plagosur. Në fund të luftës ne zumë 27 ushtarë të tyre, por unë i lirova, sepse ata nuk kishin faj. Fajin e kishin krerët e tyre, ata që i kishin mobilizuar dhe që atë ditë ia kishin mbathur dhe i kishin lënë ushtarët.

**Gjatë kësaj vizitë në Prishtinë a do të shkoni tek varrezat e dëshmorëve të luftës që të nderoni luftëtarët që ke komanduar?**

Gjatë luftës për çlirimin e Kosovës, ne na u vranë 600 luftëtarë që janë shpallur dëshmorë dhe që janë varrosur në varrezat e dëshmorëve në Tiranë. Unë kam qenë në strukturat drejtuese të ushtrisë shqiptare dhe kam këmbëngulur që eshtrat e tyre të ktheheshin dhe kështu u bë. Tek varrezat e dëshmorëve të Prishtinës unë nderova vëllezërit kosovarë që luftuan bashkë me ne.

**Si e kujtoni ditën e çlirimit të Kosovës dhe ditën tuaj të fundit në Prishtinë?**

Me shumë emocione. Merreni me mend vetë. Kur shkova atje, gjeta ankthin e pushtimit, ndërsa kur ika që andej lashë nga pas lotët e gëzimit dhe festën e çlirimit.

Mbaj mend gjithashtu se kur ika nga Prishtina, ishte data 1 Maj e vitit 1945. Pas një ceremonie festive u përcollëm me ngrohtësi nga vëllezërit kosovarë dhe u ndamë prej tyre me lot në sy, njëllaj siç ndahet vëllai me vëllain, për t' u takuar përsëri në ditët vijuese. Për mua, janë dhjetra herë vizitat në Kosovën heroike, të cilën e kam pasur dhe e kam gjithmonë në zemër dhe në shpirt. Kosova e lirë ka qenë ëndrra e jetës sime.

*Artikuj në shtypin e kohës*

## **Historia duhet të shkruajë të vërtetën**

*Përgjigje e Rrahman Parllakut, një nga drejtuesit e formacioneve kryesore partizane në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi, për disa përpjekje për të shtrembëruar historinë e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të vërtetën e kësaj lufte*

Dua të sqaroj lexuesit për disa të pavërteta që shkruhen për veprimet luftarake të brigadave të ushtrisë nacionalçlirimtare të Shqipërisë në Kosovë dhe që fatkeqësisht mund të futen në histori.

Unë, duke qenë drejtues i luftimeve në Kosovë si Zv/Komisar i Brigadës së III-të dhe Komandant i Divizionit të V-të që kam drejtuar luftimet në Sanxhak e Bosnje, duke patur në vartësi Brigadën e III-të, të V-të dhe të XXV-së, kam shkruar në librin “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime” për luftimet e brigadave tona në tetor e nëntor të vitit 1944 për çlirimin e Kosovës.

Shkrimet e mia janë mbështetur në kujtime të jetuara dhe, ndonëse në moshën e pleqërisë së thellë, fatmirësisht kujtesën e kam akoma të kthjellët por, veç kësaj, u jam drejtuar edhe dokumentave të kohës duke u përpjekur të jem sa më objektiv në pasqyrimin e ngjarjeve e rrethanave në të cilat janë zhvilluar luftimet, forcat pjesëmarrëse në to nga të dy palët dhe qëndrimi i mbajtur ndaj popullit.

Për veprimet luftarake të forcave tona në Kosovë janë shkruar e thënë shumë të pavërteta, si për luftimet e brigadave

të III-të e të V-të, për çlirimin e Rrafshit të Dukagjinit, Prizrenit, Gjakovës e Pejës me rrethinat e tyre, ashtu edhe për veprimet e divizioneve të V-të e të VI-të pas kthimit në Kosovë në mes të marsit 1945, me përfundimin e luftimeve në Sanxhak, Mal të Zi dhe Bosnje.

Po e nis me veprimet luftarake të dy brigadave tona në Kosovë, pasi dua t'u përgjigjem akuzave se brigadat tona paskan bërë krime duke vrarë njerëz jashtë luftimeve.

Deklaroj me përgjegjesi të plotë se ato akuza janë shpifje e të pavërteta.

Brigadat tona kanë vrarë njerëz vetëm në rastet kur janë përballur me kundërshtarët në luftime, siç kanë qenë luftimet me forcat e Divizionit SS, "Skënderbeg" dhe me ato të regjimentit "Kosova", të cilat luftuan kundër nesh së bashku me nazistët gjermanë, ashtu siç kishin luftuar kundër partizanëve jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri nga Shkodra deri në Tepelenë gjithnjë në krah të gjermanëve. Gjithashtu, forcat e këtyre reparteve kanë marrë pjesë në masakrat e 4 shkurtit në Tiranë.

Forcat e Divizionit "Skënderbej" dhe të Regjimentit "Kosova" kishin marrë detyrë nga nazistët gjermanë të siguronin rrugët e tërheqjes nga Greqia e Maqedonia të forcave naziste të Gruparmatës "ERE", që kërkonin të shkonin të organizuara në frontin e perëndimit për të luftuar kundër forcave aleate, kurse ne, siç e kam shkruar, kishim një nga detyrat e marra nga Shtabi ynë i Përgjithshëm, t'i godisnim këto forca për t'i dëmtuar, penguar e vonuar duke iu ndërprerë rrugët e tërheqjes dhe t'u shkatërronim armatimin e teknikën e rëndë luftarake që nuk mund ta lëviznin jashtë rrugëve.

Kjo, siç na u tha kur morëm detyrën, ishte edhe kërkesë e përfaqësuesve aleatë pranë komandës sonë.

Gjatë luftimeve në Junik, Brigadës sonë të III-të dhe Brigadës së I-rë kosovare na u vranë 32 partizanë dhe na u plagosën mbi 40 të tjerë.

Gjatë këtyre luftimeve, forcat e Brigadës së III-të kapën 27 robër nga efektivitë e Divizionit SS “Skënderbej” dhe nuk pushkatuan asnjë.

Por më duhet të pohoj se prej asaj dite, asnjë pushkë kosovari nuk shtiu më kundër nesh dhe ky divizion u shpërbë.

Me qëndrimin tonë ndaj popullit vëlla të Kosovës demaskuam parrullat e nazistëve e të bashkëpunëtorëve të tyre, Xhafer Devës me shokë, të përhapura prej tyre në popull, se partizanët vrasin këdo që kapin. Kjo propagandë bëri që junikasit, gjatë luftimeve, të largoheshin të gjithë dhe ta linin fshatin të shkretë nga frika se mos ne do t’i pushkatonim por, pa marrë parasysh humbjet e mëdha në njerëz në luftimet e Junikut, ne i pritëm ata miqësisht kur u kthyen në fshat. Nuk prekëm asgjë nga pasuria e tyre dhe shtëpitë i gjetën siç i kishin lënë.

Ky fakt historik u vërtetua pas 60 vjetësh, kur isha i ftuar në Prishtinë për të mbajtur një ligjëratë me rastin e festimeve të 9 Majit 2005, ditës të fitores mbi nazifashizmin në Luftën e II-të Botërore dhe kur në fjalën time përmenda të vërtetën e liritë të robërve në Junik dhe bëra pyetje në drejtim të sallës nëse jetonte vallë dikush nga të liruarit e asaj kohe? Nga salla e mbushur plot me njerëz të shquar, profesorë akademikë, etj., mes të cilëve ishte dhe zoti Mahmut Bakalli (atëherë i gjallë), një zotëri u ngrit në këmbë nga fundi i sallës dhe dëshmoi: “Jam unë”.

Të gjithë kthyen kokën në atë drejtim, ndërsa unë e falenderova këtë dëshmitar të gjallë për atë që dëshmoi.

Faktin që flitet e shkruhet në Kosovë e Shqipëri se forcat e divizioneve tona kanë ndihmuar serbët në luftimet e Drenicës kundër forcave të Shaban Polluzhës, e dëgjova për herë të parë në Tiranë më 1993, në një konferencë me temë: “Lufta e divizioneve tona në Jugosllavi”.

Konferenca organizohej nga Prof. Paskal Milo, që në atë kohë ishte në kryesinë e Partisë Social Demokrate.

Si referues në këtë konferencë merrte pjesë dhe profesor

Kristo Frashëri, kurse unë isha i ftuar bashkë me shumë ish-kuadro drejtuese e partizanë që kishim luftuar në radhët e divizioneve të V-të e të VI-të në tokat e ish-Federatës Jugosllave.

Në ligjëratën e tij, Prof. Kristo Frashëri në mes të tjerave tha se forcat e divizioneve tona ndihmuan serbët në luftimet e Drenicës.

Pjesëmarrësit në konferencë, efektivë të këtyre divizioneve, drejtuan shikimin nga unë, që kisha komanduar në këto luftime Divizionin e V-të.

Kërkova fjalën dhe e nisa me pyetjen drejtuar referuesit: Profesor, kjo gota që e kam përpara a mund të ndodhet në këtë moment edhe në tavolinën tuaj?

Ai bëri të çuditurin e më tha: “Ç’është kjo pyetje?”

Po ju pyes, pasi ligjet e fizikës nuk pranojnë që një trup të ndodhet në të njëjtën kohë në dy vende të ndryshme.

Kur zhvilloheshin ngjarjet në Drenicë, forcat e divizioneve tona luftonin në Vishegrad e në Bosnje e nuk mund të ndodheshin edhe në Drenicë duke ndihmuar serbët.

Miku im, Profesori i nderuar Kristo Frashëri, pranoi se ishte një lapsus nga ana e tij për mungesë informacioni.

U zgjata në këtë sqarim, pasi për forcat e divizioneve tona edhe në Kosovë janë shkruar absurditete të tilla.

Për mendimin tim, ata që shkruajnë nuk u referohen dokumentave dhe fakteve të kohës, nuk dinë kur kanë ndodhur ngjarjet, si janë zhvilluar ato dhe cilat kanë qenë palët pjesëmarrëse në to. Nuk mund të shkruhet, “kështu kam dëgjuar”, “kështu më kanë thënë” e “kështu më kujtohet”.

Më e keqja është kur flitet e shkruhet e pavërteta me qëllim përfitimi politik. Dihet se ajo që ka ndodhur, nuk mund të ndryshohet duke falsifikuar historinë. Historia duhet të shkruajë të vërtetën, se e vërteta i ndriçon e i bashkon njerëzit.

Ne sot duam bashkim dhe jo ndarje. Mjaft na kanë mbajtur të ndarë për mëse një shekull pushtuesit e huaj e regjimet diktatoriale. Këtë duhet të këtë parasysh sipas meje kushdo që ulet të shkruajë.

Detyrë tjetër parësore, me kalimin e brigadave në Kosovë, kishim të ndihmonim kosovarët të merrnin pjesë në luftë në mënyrë masive, që Kosova nga pjesëtare e boshtit fashist, të bëhej pjesëtare e aleancës antifashiste që udhëhiqej nga Anglia, ish-Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pasi deri atëherë Kosova ndihmonte nazifashistët me forcat ushtarake të Divizionit SS "Skënderbej" dhe Regjimentit "Kosova", që kishin luftuar kundër forcave partizane në Kosovë dhe në Shqipëri. Qeveria Deva-Mitrovica ishte në shërbim të gjermanëve.

Një gjendje e tillë u interesonte serbëve kur ishin në prag të fitores dhe donin që për këtë shkak t'i akuzonin kosovarët si bashkëpunëtorë të gjermanëve, me qëllim që të kishin dorë të lirë nga aleatët për të zbatuar planin e akademikut Sava Çubrolloviç, dorëzuar Titos, për të bërë spastrimin etnik të Kosovës.

Plani i Çubrilloviçit mbeti në sirtaret e Titos. Ai u dogj nga pjesëmarrja në luftë e 50.000 kosovarëve që luftonin në armatat e ish-Federatës Jugosllave, që e shkëputën Kosovën nga blloku fashist dhe e bashkuan atë me aleancën antifashiste të popujve.

Nuk mund të përziheshin familjet shqiptare nga trojet e tyre, kur 50.000 kosovarë ishin duke luftuar kundër nazistëve.

Vetëm në divizionin që komandoja unë, erdhën vullnetarisht mbi 1600 kosovarë, prej tyre vetëm në dy brigada të III-ën e të V-ën kanë rënë dëshmorë 102 luftëtarë kosovarë, duke luftuar në Sanxhak e Bosnje.

Në historikët e këtyre brigadave figurojnë emrat e tyre, dhe për shumicën, edhe emri i fshatit nga janë. Po sa dëshmorë kanë rënë nga 50.000 luftëtarët kosovarë që luftuan në të gjithë hapësirat e ish-Jugosllavisë? Sigurisht që numri i të rënëve është i shumtë.

Megjithë sakrificat që bënë kosovarët në luftën antifashiste, nuk e fituan pavarësinë e lirinë e tyre, por arritën një fitore të madhe, qëndruan në trojet e tyre etnike, duke përballuar

edhe për afër 50 vjet provokacionet e terrorin e shovinistëve serbë.

Ata nuk e lanë të shkretë vendin dhe Kosova nuk u bë tokë e serbëve, siç ndodhi për fat të keq me Çamërinë. Në divizionin që komandoja unë, shumica e atyre që erdhën vullnetarë, kishin qenë në shërbim të gjermanëve e kishin luftuar edhe kundër nesh, por që prej ditës që u rreshtuan në repartet tona, u trajtuan pa asnjë dallim dhe si të barabartë me luftëtarët e vjetër. Ky trajtim njerëzor i bëri ata të luftonin trimërisht krah për krah me vëllezërit e tyre.

## **Kujtime për shokun dhe bashkëluftëtarin Fadil Hoxha**

Unë me Fadilin u njoha kur Brigada e III-të, ku isha Zv/ Komisar, kishte çliruar Tropojën e do të fillonte veprimet luftarake në Kosovë bashkë me partizanët e Kosovës.

Takimi i parë me Fadilin u bë kur ai erdhi bashkë me Nenadin, Komisarin e Shtabit të Kosovës në Tropojë, ku do të ishte vendkomanda e shtabit të përbashkët të drejtimit të luftimeve për çlirimin e Kosovës.

Shtabi përbëhej nga Fadili e komisari i tij, nga Komandanti i Brigadës së V-të, Shefqet Peçi, nga Komisari i kësaj brigade, Hito Çako dhe nga Komandanti i Brigadës së III-të Hulusi Spahiu.

Në këtë takim mua që do të drejtoja forcat e brigadës dhe Zyfer Musiçit, Komandant i Brigadës së IV-t të Kosovës, na u vu detyra të shkonim për të vepruar fillimisht në ndihmë të forcave të Brigadës së V-të në Gjakovë dhe më pas të vepronim sipas situatës.

Meqë forcat e Brigadës së V-të ishin tërhequr nga Gjakova, ne kërkuam leje që të fillonim veprimet luftarake kundër Junikut, ku ishin grumbulluar forcat kryesore të Xhafer Devës, (mbeturinat e Divizionit SS "Skënderbeg"), që mbështeteshin me artileri nga gjermanët.

Në mëngjesin e datës 20 tetor, forcat tona sulmuan Junikun. Luftimet qenë të ashpra. Rreth orës 12.00 e morëm Junikun dhe iu drejtuam Vokshit, por u kundërsulmuam nga forcat superiore të armikut dhe u detyruam të tërhiqeshim,



duke lënë dhjetë të vrarë e tetë të plagosur nga Brigada e III-të dhe dy të vrarë e pesë të plagosur nga Brigada e IV-t. Pas tre ditë luftimesh, ne zumë mbrojtje në kurrizin e kodrave para Batushës.

Më 23 tetor, unë e Zyfer Musiçi u thirrëm në fshatin Morinë, ku na pritën Fadili dhe Komandanti i Brigadës sonë, Hulusi Spahiu. Ata kishin përqëndruar aty, sipas kërkesës sonë, forcat e dy batalioneve të Brigadës së III-të dhe kishin urdhëruar që në Batushë të vinte një batalion i Brigadës së V-të. Kështu, përsëritjes së sulmit mbi Junik i shtoheshin edhe forcat e tre batalioneve të tjera. Aty na u vu detyra për përsëritjen e sulmit.

Zyferi do të drejtonte krahun që sulmonte Batushë- Junik, kurse unë me dy batalione do të sulmoja nga Shipshani, nga lart. Fadili më orientoi me hollësi mbi terrenin, që ishte i thyer e i pyllëzuar, pasi shfrytëzimi i mirë i terrenit dhe goditja e armikut në befasi do të ishin çelsi i suksesit në atë luftim.

Luftimet për marrjen e Junikut qenë shumë të ashpra. Humbjet ishin të mëdha, pasi ne në brigadë patëm 22 të vranë e 15 të plagosur.

Junikun e çliruar në mesditë.

Me Fadilin u takuam përsëri ditët e fundit të tetorit, kur ai erdhi në komandën tonë në Voksh, ku bashkarisht caktuam detyrat për çlirimin e Deçanit e të Pejës.

Pas çlirimit të Pejës, unë u emërova Komandant i Divizionit të V-të dhe me vendosjen e komandës së divizionit në qytetin e Mitrovicës, Fadili erdhi të më uronte për detyrën e re duke më shprehur kënaqësinë e tij.

E falenderova dhe kërkova ndihmën e tij në organizimin e marshimit tonë në drejtim të Sanxhakut, ku do të zhvillonim luftimet e ardhshme. Ai e njihte mirë terrenin dhe rrugën nga do të kalonim në kushtet e dimrit që kishte filluar, prandaj m'i sqaroi me hollësi rrugët nga do të kalonim në terrenin e thyer malor dhe kushtet në të cilat do të siguronim furnizimin e forcave tona në rajonet e Pazarit të Ri e të Sienicës, ku do të përballëshim me forcat gjermane. U ndamë përmallshëm me

të. E falenderova për vizitën, për urimet, por në veçanti për sqarimet e tij me shumë vlerë.

Kur u kthyem nga luftimet në Sanxhak e në Bosnjen Jugore, e gjeta Fadilin shumë të dëshpëruar për ngjarjet e ndodhura në Drenicë dhe të pakënaqur nga një takim që kishte patur me Enver Hoxhën në Tiranë, por pa hyrë në përmbajtje të këtij takimi.

Takimin e fundit me Fadilin e pata kur u transferova në Korparmatën e II-të, në Berat. U ndamë si shokë e miq për t'u takuar pas 45 vjetësh, në shtator të vitit 1999, në Kosovën e lirë, kur erdhëm një grup veteranësh të ftuar nga veteranët e Kosovës, por për fat të keq një pjesë e atyre që na pritën sot nuk jetojnë më, si: Fadili, Xhaviti, Ymeri e Ramadani. Nga ne mungon Sadik Bekteshi e Muhamer Spahiu.

Fadili, bashkë me zonjën Vahide, na pritën me shumë përzemërsi në shtëpinë e tyre, ku biseduam gjatë për situatën e re të krijuar pas çlirimit të Kosovës dhe për ndryshimet demokratike të Shqipërisë.

Kur flet për meritat e Fadil Hoxhës, duhet të kesh parasysh momentin historik kur ai shpalosi personalitetin e tij si udhëheqës i luftës.

Ishim nën pushtimin fashist, prandaj duhej vendosur që të luftohej fashizmi për t'u çliruar nga zaptuesi apo të lejohej lidhja e Shqipërisë dhe e Kosovës me boshtin fashist, ku po e drejtonin qeveria kuisinge në Shqipëri dhe Xhafer Deva me shokë në Kosovë.

Fatmirësisht, populli ynë në Shqipëri, në Kosovë e kudo në trojet etnike zgjodhi më të mirën. Ai u bashkua me luftën, me Aleancën e madhe Antifashiste të popujve të kryesuar nga Anglia, Bashkimi Sovjetik e Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo zgjedhje e drejtë bëri që të dështojnë planet për copëtimin e Shqipërisë e spastrimin etnik të Kosovës, që donin të realizonin me çdo kusht armiqtë tanë sllavo-grekë.

Fadili me shokë kanë edhe meritën e madhe që, brenda Federatës të ish- Jugosllavisë, luftuan që Kosova të bëhej pjesë

kushtetuese e Federatës.

Është e rëndësishme që, megjithëse nuk u njoh si republikë, Kosovës iu caktuan kufijtë me të cilat sot njihet ndërkombëtarisht, u krijuan institucionet legislative e administrative të saj, u ngrit në shkallë të lartë arsimi e kultura kombëtare, u krijua inteligjienca e re prej dhjetra mijëra vetash, u edukuan brezat e rinj me një ndjenjë të lartë kombëtare, që u shpalos me tërë fuqinë e saj në luftën çlirimtare të Kosovës.

Unë edhe sot nuk mund ta shpreh gëzimin dhe kënaqësinë e veçantë që ndjeva kur takova Fadilin dhe shokët e tjerë në Kosovën e lirë. Ishte privilegj i madh për ne që mundëm të përjetojmë të realizuara aspiratat e dëshirat tona të përbashkëta.

Duke falenderuar organizatorët dhe familjarët e Fadilit që na ftuan të marrim pjesë në këtë përkujtimore të bashkëlufëtëtarit e shokut tim Fadil Hoxha, shpreh edhe një herë bindjen time se ju, duke organizuar këtë përkujtimore, keni kryer një detyrim ndaj atij burri të shquar jo vetëm të Kosovës, por të gjithë kombit shqiptar.

Detyra jonë është t'i kujtojmë gjithmonë figurat e shquara të kombit, t'ua bëjmë të ditur brezave të rinj jetën dhe veprën e tyre, se kështu e mbajmë gjallë dhe e ngremë më lart krenarinë tonë kombëtare.

## Kontributi i Kryezinjve në Luftën Antifashiste

*(Nga fjala në Konferencën Shkencore mbajtur në Prishtinë, shtator 2006)*

Unë, në këtë konferencë, do të sjell disa kujtime që ruaj nga takimi që kam pasur me vëllezërit Hasan e Gani Kryeziu, në fshatin Devë të Gjakovës, më 18 tetor 1944. Në këtë takim, unë shoqëroja Manush Myftiun, i deleguar i Korparmatës së I-rë pranë brigadave të V-të dhe të III-të, ku isha Zëvendëskomisar i kësaj të fundit.

Takimi u bë sipas porosisë që kishte marrë Manushi nga Komanda e Përgjithshme. T'u bëhej thirrje vëllezërve Kryeziu t'i dorëzonin forcat tek brigadat tona dhe të shkonin pranë Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional Çlirimtar, ku do të kishin vendin e tyre në këtë kryesi e organe të tjera drejtuese të asaj kohe.

Dua të theksoj këtu se pritja nuk qe e këndshme për ne. U bë në një gjendje të tensionuar. Hasan Begu, në zemëratë e sipër na u drejtua neve: "Ju na kërkoni t'i dorëzojmë forcat e të vijmë pranë Shtabit e Këshillit tuaj! Na thoni, si do vijmë?! Si peng e rob, siç na keni marrë vëllain tonë, Sahitin, ashtu siç morët, arrestuat përfaqësuesit aletatë, siç na e morët dhe e vratë këshilltarin tonë politik Zoi Fundo?! E tani na ftoni të jemi pjestarë në frontin tuaj!".

U përpoqa t'i sjell këto shprehje siç i tha Hasan Begu e siç janë ruajtur në kujtesën time pas 62 vjetëve.

Kurse Gani Begu u tregua shumë më i përmbajtur, por i

prerë në qëndrimin e tij. Ai kërkoi që më parë të sqarohet përse u ndërmorën ato masa ekstreme ndaj tyre e përfaqësuesve aleatë, që mund të çonin në vëllavrasje në mes nesh. "Përse u vra pa gjyq Zoi Fundo? Duam të dimë nëse këto u bënë me urdhër të Komandës së Përgjithshme apo ishin masa ekstremiste të reparteve partizane, siç u veprua kundër Muharrem Bajraktarit në Lumë e u derdh gjak shqiptari nga të dyja anët!... Pa u sqaruar këto çështje nuk mund të kemi besim se do të jemi të mirëpritur siç po na thoni ju, e do të vlerësohet drejt kontributi ynë në luftë."

Manushi u përpoq t'i bindë se çdo gjë do të sqarohet dhe lufta e tyre do të vlerësohet, pasi ky ishte mendimi i udhëheqjes së lartë të luftës.

Bisedën e mbylli Gani Begu, me kërkesën se prisnin prova të bindeshin dhe se më parë duhej t'u kthehej Sahiti e pastaj të vendosnin për qëndrimin ndaj kësaj ftese.

Meqë ishte kohë dreke, na shtruan bukën dhe pas drekës u ndamë me vëllezërit Kryeziu.

Manushi u premtoi edhe një herë se kërkesat e tyre të plota do t'ia bënte me dije udhëheqjes së lartë të Komandës së Përgjithshme dhe Kryesisë së Frontit Nacionalçlirimtar.

E përçolla Manushin deri në Qafë-Prush e u ktheva në Brigadë.

Këto ishin kujtime direkte nga takimi që patëm me vëllezërit Kryeziu, por për aktivitetin e tyre në luftë mësova shumë nga drejtues të Brigadës së XXV-të të Malësisë së Gjakovës, e cila hyri në vartësi të Divizionit të V-të, që unë komandova gjatë luftimeve në Sanxhak e Bosnje në dimrin e vitit 1945.

Komandanti i Brigadës, Veli Niman Doçi, shefi i zbulimit të divizionit, Shpend Dega, komandanti i batalionit të Hasit Ismail Poga e të tjerë, të cilët kishin qenë më parë kuadro drejtuese të luftës në Malësi e Has, më kanë folur gjerësisht për veprimet luftarake të reparteve që komandonte Gani Kryeziu dhe për bashkëveprimin me to gjatë luftimeve kundër forcave nazifashiste.

Sipas tyre, asnjëherë nuk kishte patur konflikt në mes tyre e forcave të Gani Begut.

Ndërkohë, këto të dhëna m'i ka vërtetuar edhe shoku e kolegu im, Gjeneral Sadik Bekteshi, që gjatë operacionit nazist gjerman të dimrit 1943 - 1944 ka vepruar në krahinat e Malësisë së Gjakovës me batalionin "Perlat Rexhepi" të Shkodrës, që ai e komandonte.

Sadiku ndante të njëjtat mendime me Veliun, Shpendin, Ismailin e të tjerë.

Veçanërisht ato vlerësonin luftimet e forcave që kishte komanduar Gani Kryeziu në shkatërrimin e minierës së Kamit e lirimim e qindra të burgosurve të kombësive të ndryshme të rajonit tonë, që shfrytëzoheshin si skllevër nga nazistët.

Siç dihet, këto luftime u bënë shkak për vrasje, djegie e raprezalje në masë që bënë gjermanët në krahinën e Bytyçit, që ishte edhe baza kryesore e Kryezinjve në Malësinë e Gjakovës.

Këto vlerësime patëm parasysh unë e Sadik Bekteshi që ngulëm këmbë të njihet Lufta Antifashiste e Kryezinjve dhe luftëtarëve të tyre t'u jepet statusi i veteranit të luftës, i aprovuar me dekretin e Presidentit të asaj kohe, Sali Berisha, në nëntor 1994.

**Rrahman Parllaku**

*Ish-komandant i Divizionit të V-të Sulmues*

## **Të luftosh për liri e barazi, nuk do të thotë terrorizëm**

**(Kryetari i OBVL, Rrahman Parllaku, replikë me Lordin  
Robertson, Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s)**

Jam në moshën 83-vjeçare. Në luftë kam komanduar Divizionin e V-të të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare në luftimet në territorin e ish- Federatës Jugosllave, nga tetori i vitit 1944 e deri në fund të marsit 1945.

Luftimet i kemi përfunduar me çlirimin e qytetit të Vishegradit, bashkë me Divizionin e VI-të shqiptar. Kam shërbyer në ushtri për afro 30 vjet në funksione të larta, 15 vjet si zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe Zëvendësministër i Mbrojtjes. Mbaj gradën Gjeneral-Leitnant.

Jam nderuar me titullin e lartë “Hero i Popullit” për kontributin tim në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në Luftën e II-të Botërore.

Jam dënuar me 25 vjet burg. Kam vuajtur mbi 17 vjet dënim nga diktatura komuniste.

E bëra të gjatë këtë paraqitje, pasi dua që në emër të brezit që përfaqësoj, të falenderoj nëpërmjet jush z. Robertson, gjithë anëtarët e NATO-s e në veçanti SHBA-në e Anglinë për kontributin e veçantë që dhanë duke shpëtuar popullin shqiptar të Kosovës nga genocidi fashist e spastrimi etnik i forcave serbe të drejtuara nga kriminelin Milosheviç.

Populli shqiptar duhet t'i ngrejë përmendore NATO-s jo vetëm në Prishtinë, po edhe në Tiranë.

Zoti Robertson, ju falenderojmë juve personalisht për mbrojtjen e shqiptarëve gjatë luftimeve në Kosovë në funksionin e Ministrit të Jashtëm të Anglisë.

Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore u bashkuan me Aleancën Antifashiste të drejtuar nga Anglia, BS e SHBA.

Duke marrë parasysh popullatën prej vetëm një milion shqiptarësh, dhanë kontributin e tyre modest të paguar me 28.000 të vranë e të zhdukur. Shqipëria, si gjithë vendet e Europës, u çlirua me ndihmën e fuqive të mëdha të aleancës. Në Shqipëri nuk erdhën ushtri aleate, por ndihma e tyre qe vendimtare për fitoren mbi nazifashizmin edhe për Shqipërinë.

Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare ndihmë direkte në logjistikë i ka dhënë vetëm ushtria angleze. Në Shqipëri kanë dhënë jetën vetëm ushtarakë anglezë. Ne i nderojmë varrezat e tyre me respekt të veçantë.

Zoti Robertson, Ushtria Nacionalçlirimtare Shqiptare e çliroi vendin dhe nuk e ndërpreu luftën, por vazhdoi të japë ndihmesën e saj në kuadrin e Aleancës Antifashiste me forcat e dy divizioneve tona, të V-të dhe të VI-të, që vazhduam luftën në territoret e ish-Federatës Jugosllave.

Detyrat me të cilat u ngarkuan nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare të dy divizionet tona, ishin dy: të ndihmonim popujt e Jugosllavisë për çlirimin e tyre dhe të pengonim e vononim me çdo kusht tërheqjen e organizuar të forcave gjermane që shpejtonin të shkonin për në frontin perëndimor kundër forcave aleate që mësynin në drejtim të Gjermanisë.

Luftimet e divizioneve tona u ndërprenë në thellësi të Jugosllavisë me çlirimin e Vishegradit. Me luftën e përbashkët antifashiste, ne shqiptarët besuam se në të ardhmen do të jetonim vëllazërisht me popujt fqinjë, por ky qe një besim naiv për arsye se serbët ruanin në sirtaret e tyre planet e kahershme të viteve 60- të, shekulli i XIX- të, të Negoshës, që ngarkonte armatën serbe t'i shpërngulte shqiptarët e të pushtoheshin rrethinat e Nishit, të Kosovës, e më tej synohej dalja në Adriatik.



Këto plane u rinovuan nga Akademia e Shkencave Serbe nën drejtimin e Çubrilloviçit e u zbatuan pas Luftës së Parë Botërore. Ato vazhduan të zbatohen pas Luftës së Dytë Botërore. I vazhdoi Milosheviçi e po përpiqen t'i vazhdojnë pasardhësit e tij në Serbi e në Maqedoni.

Falë ndërhyrjes së NATO-s iu dha fund krimit e genocidit fashist të Milosheviçit në Kosovë.

Shqiptarët asnjëherë nuk kanë qenë agresivë ndaj fqinjëve të tyre, por kanë qenë të detyruar të mbrohen nga synimet e tyre grabitqare e kriminale.

**Dua të ndalem në sqarimin e disa akuzave të padrejta që u bëhen bashkëkombasve tanë nga parfaqësues të organizmave ndërkombëtare e të disa shteteve.**

Shqiptarët nuk kanë qenë dhe nuk janë terroristë. Shqiptarët luftojnë vetëm për të drejtat nacionale, liritë demokratike e njerëzore. Ata duhet të kenë të drejta njësoj si maqedonasit, si shtetas të Maqedonisë, e asgjë më tepër.

Po kështu shqiptarët e Kosovës duhet të gëzojnë liritë demokratike e njerëzore, ashtu si edhe serbët.

Askush nuk mund të japë një fakt se pjestarët e UÇK-së kanë vrarë civilë; gra, fëmijë e pleq. Pra, si mund të quhen ata terroristë?

Pse nuk po dënohet terrorizmi shtetëror maqedonas që po përdor të gjithë arsenalin ushtarak; tanke, artileri të rëndë e raketa nga toka e nga ajri në bombardimet ditë e natë mbi fshatrat e banuara nga shtetas maqedonas të kombësisë shqiptare. Nën gërmadhat e shtëpive të bombarduara vdesin gra, fëmijë e pleq shqiptarë. Qëllimi i qeverisë maqedonase është që me anë të terrorit t'i detyrojë shqiptarët të emigrojnë, duke bërë atë që bëri Milosheviçi në Kosovë.

Gjithë bota ndoqi në televizor vandalizmat e shovinistëve maqedonas në Manastir, në prani të policëve që shkatërruan shtëpi, dyqane e magazina të shqiptarëve. Kush nuk pa gjithashtu në ekranet televizive ushtarët maqedonas që nxorën nga makina e masakruan babë e bir në rrugët e Tetovës?

Nga krahasimi i këtyre veprimeve del qartë se kush janë kriminelët dhe terroristët e vertetë. Ky është shteti maqedonas, ku shqiptarët akuzohen se nxisin konflikte e krijojnë destabilitet, kur ata duan vetëm stabilitet në rajon.

Dihet se ishte qeveria demokratike shqiptare e para që njohu shtetin e pavarur maqedon, kur pavarësinë e Maqedonisë e kundërshtonte jo vetëm Serbia, por edhe fqinjët e tjerë të saj.

Konfliktet i ka nxitur qeveria maqedonase që u ka mohuar shqiptarëve, që bëjnë 40% të popullatës të shtetit maqedonas, të drejtat më elementare që janë të sanksionuara në konventat ndërkombëtare. Ajo u mohoi shqiptarëve edhe disa të drejta që u ishin dhënë nga kushtetuta jugosllave.

Prej më se 10 vjetësh janë përpjekur partitë politike shqiptare për t'i fituar këto të drejta në rrugë paqësore, po asgjë nuk kanë arritur. Ky qëndrim shovinist i drejtuesve të shtetit maqedon i detyroi shqiptarët të rrëmbejnë të drejtat e tyre dhe për këtë po quhen terroristë.

Shqiptarët po akuzohen se duan të krijojnë Shqipërinë e Madhe. Këtë akuzë e ka bërë Milosheviçi, për të justifikuar terrorin e genocidin kundër shqiptarëve të Kosovës.

Të krijosh shtetin e madh, duhet të përzesh të tjerët nga trojet e tyre. Këtë e kanë bërë Serbia e Greqia afro një shekull më parë, kur dëbuan qindra mijëra shqiptarë nga trojet e tyre. **Nuk mund të gjendet asnjë fakt që shqiptarët të kenë përzënë të tjerët nga trojet e tyre. Shqiptarët janë në trojet e tyre etnike shumë shekuj para dyndjeve sllave në Ballkan. Nëqoftëse vendbanimet shqiptare në Maqedoni, Serbi e gjetkë i përkasin Shqipërisë së Madhe, le të na kthehen.**

Akuzohen shqiptarët se duan të ndryshojnë kufijtë me forcë. Këtë e përgënjeshtrojnë vetë luftëtarët e UÇK-së që nuk kërkojnë të ndryshojnë kufijtë, po vetëm të fitojnë të drejta të njëjta me sllavët maqedonas e asgjë më tepër.

Gjithashtu shqiptarët po akuzohen si destabilizues të Ballkanit. Ata nuk kanë qenë e nuk janë destabilizues të rajonit.

Më lejoni edhe njëherë t'i referohem historisë. Kanë qenë

shkaktarë të destabilizimit Fuqitë e Mëdha europiane të kohës, që i copëtuan trojet shqiptare për të kënaqur kërkesat e Rusisë dhe për të plotësuar lakmitë serbe e greke, pas luftës ballkanike, me vendimet që mori pas luftës ballkanike Konferenca e Ambasadorëve e Londrës, më 1913.

Këto vendime bënë të ushtrohet një terror e genocid i paparë. U dëbuan afër një milion shqiptarë nga trojet e tyre, po fatkeqësia po vazhdon edhe sot. Shqiptarëve vazhdojnë t'u mohohen të drejtat nacionale e njerëzore. Vazhdon terrori e dëbimi nga trojet e tyre etnike dhe gratë, fëmijët e pleqtë largohen maleve për t'u shpëtuar masakrave, ndërsa mbrojtësit e tyre quhen terroristë.

Ne kërkojmë përkrahje, ndihmë e mirëkuptim nga NATO e organizmat e tjera ndërkombëtare, që shqiptarëve, kudo që jetojnë, t'iu njihen e respektohen të drejtat nacionale e liritë demokratike të njohura ndërkombëtarisht, siç i gëzojnë qytetarët e shtetit ku ata jetojnë dhe të jeni të sigurt se kjo do t'i shërbejë stabilitetit në Ballkan.

*Gjeneral Leitnant Rrahman Parllaku,*  
*"Gazeta 55", 22 Maj 2001, fq.16*

*Bisedë në Bernë me Drejtorin e Departamentit për Europën  
Juglindore ambasadorin A. Salamin, 18 Tetor 2001*

## **Shqiptarët, që në kohën e Skënderbeut, i kanë takuar qytetërimin europian**

-Zotëri, ju faleminderit që na u mundësua ky takim në Departamentin tuaj. Për ju është e njohur Shqipëria, por ne deshëm shkurtimisht t'iu paraqesim problemin shqiptar në Ballkan.

Ne shqiptarët dhe grekët jemi kombet më të vjetër të Ballkanit. Mbi vendin tonë kanë kaluar perandori të Perëndimit e të Lindjes. Ne kemi pritur vërshimet e sllavëve në shekujt VIII-XIX, të ardhur nga stepat e Ruisë. Megjithëse janë përpjekur të na asimulojnë e të na shuajnë, ne kemi qëndruar në trojet tona duke ruajtur të pacënuar gjuhën dhe identitetin. Rrënjët tona shkojnë thellë në mijëra vjet.

Vitalitetin e tyre shqiptarët e treguan në luftë kundër Perandorisë turke. Ata u udhëhoqën nga Heroi Kombëtar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, i cili në shekullin e XV-të arriti t'i bashkojë shqiptarët në një shtet të vetëm.

Atëhere kur serbët, bullgarët, rumunët e të tjerë u nënshtruan Perandorisë turke, shqiptarët të vetëm, të udhëhequr nga Skënderbeu, për rreth 25 vjet rresht përballuan me sukses sulmet e Perandorisë më të madhe të kohës. Shqiptarët me në krye burrin më të madh të kohës, Skënderbeun, mbrojtën jo vetëm vendin e tyre, por ata për 25 vjet u bënë barrierë në mbrojtje të civilizimit europian dhe i penguan ushtritë turke të marshonin drejt Perëndimit.

Duhet theksuar se burimet njerëzore dhe materiale të Shqipërisë së atëhershme nuk mund të ishin të pashtershme, për t'i bërë ballë vetëm Perandorisë Osmane, që sundonte në tri kontinente. Pak kohë pas vdekjes së Heroit legjendar Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, turqit mundën ta zaptounin edhe Shqipërinë.

Jehona e qëndresës së atëhershme ka mbetur gjallë në ndjenjat luftarake e lirisdashëse të shqiptarëve.

Në shqiptarët falenderojmë në mënyrë të veçantë qeverinë zvicerane, që vlerësoi dhe përjetësoi figurën e Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, me ngritjen e përmendores së tij në qytetin e Gjenevës. Meritë për këtë ndërmarrje historike ka pasur "SOLIDEST" dhe presidenti i saj, z. Astrit Leka.

Me dobësimin e Perandorisë turke në shekullin e XIX-të për shqiptarët u krijua një rrezik i ri. Po lindnin shtetet e reja sllavo-orthodokse në Ballkan, Greqia më 1821, Serbia 1835-'40. Shtetet sllave me mbështetjen e Ruisë synonin të shtriheshin drejt Mesdheut, me dalje në Detin Adriatik, pasi kjo u shërbente interesave ruse, por kjo shtrirje do të bëhej duke zaptuar tokat shqiptare.

Për fat të keq, synimet grabitqare të fqinjëve tanë gjetën edhe mbështetje ndërkombëtare, sidomos pas disfatës që pësuan turqit në luftën ruso-turke në Shipkë të Bullgarisë, që u ligjërua me paqën e Shën Stefanit dhe më pas me vendimet e Kongresit të Berlinit më 1878.

Në bazë të këtyre vendimeve, pjesë të tokave shqiptare u jepeshin shteteve sllave të Ballkanit dhe haraçin nuk e paguanin turqit që humbën luftën, po shqiptarët. Shqiptarët reagueshan në mënyrë të vendosur kundër vendimeve arbitrare të fuqive të mëdha europiane në kurriz të tyre. Ata me shpejtësi u mblodhën në Kuvendin e Prizrenit, formuan lidhjen mbarëkombëtare shqiptare, krijuan ushtrinë dhe dolën në mbrojtje të trojeve të tyre.

Ushtria shqiptare theu tri herë ushtrinë malazeze dhe i përzuri pushtuesit nga krahinat e Plavës e Gucisë, të Hotit e

të Gudës. Vetëm me mbështetjen e Flotës Ushtarake Detare të Fuqive të Mëdha Europiane dhe me goditjen pas shpine të ushtrisë turke, shqiptarët u detyruan t'ia lëshojnë Malit të Zi qytetet e Ulqinit e Tivarit me rrethinat e tyre.

Edhe krijimi i koalicionit sllavo-grek kundër Turqisë në Luftën Ballkanike 1912-'13, kishte për qëllim pushtimin e tokave shqiptare, që u krijonin mundësi për të dalë në Detin Adriatik. Këto qëllime ua plotësoi Konferenca e Ambasadorëve e mbledhur në Londër më 1913. Përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha me vendimet e tyre, duke shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e shqiptarëve, u dhanë grabitqarëve 2/3 e territorit të Shqipërisë. Edhe këto vendime u morën nën ndikimin rus dhe për interesa të veçanta të disa fuqive të mëdha.

Me pushtimin e këtyre territoreve, serbët e grekët bënë raprezalje të egra ndaj popullatës shqiptare. U vranë, u masakruan dhe u shpërngulën nga trojet e tyre etnike rreth një milion shqiptarë. Kjo ka qenë në atë kohë masakra më e madhe e bërë në qendër të Europës, si rrjedhim i vendimeve të fuqive të mëdha dhe e pranuar në heshtje prej tyre.

Në Luftën e Dytë Botërore, Shqipëria që nga vendet e para që pushtuan fashistët italianë. Shqiptarët nuk e ndërprejnë rezistencën kundër pushtuesve. Ne u radhitëm vendosmërisht në koalicionin antifashist të popujve, drejtuar nga anglo-sovjeto-amerikanët. Në këtë luftë Shqipëria me një popullsi prej një milion banorësh mobilizoi në luftë 70 mijë luftëtarë, pati 28 mijë të vrarë, shumë të plagosur e dëme kolosale materiale. Ne e çliruam vendin vetë, pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate, por ndihma aleate ka qenë vendimtare edhe në çlirimin e vendit tonë, pasi ata shkatërruan forcat kryesore nazifashiste.

Me çlirimin e vendit, ne nuk e ndërpreme luftën kundër forcave naziste, duke vazhduar të japim kontributin tonë në Luftën Antifashiste. Ushtria shqiptare me forcat e dy divizioneve, Divizionin e V-të, që pata fatin ta komandoja unë, e vazhdoi mësymjen në territorin jugosllav.

Detyra ishte të ndihmonim në çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhe të pengonim tërheqjen në mënyrë të

organizuar të forcave të Armatës ERE Gjermane, që po shpejtonte për në frontin perëndimor për luftë kundër forcave aleate që kishin zbarkuar në Francë.

Pas 4 muaj luftimesh, dhjetor 1944 - mars 1945, në bashkëveprim me forcat e Korpusit XXII jugosllav i plotësuar detyrat e ngarkuara, çliruan Sanxhakun, Malin e Zi dhe pjesë të Bosnjës deri në çlirimin e qytetit të Vishegradit. Në luftë me jugosllavët u bëmë aleatë të ngushtë dhe besuam se në të ardhmen problemet e trashëguara historikisht do t'i zgjidhnim miqësisht me marrëveshje dy palëshe, ashtu siç ishte rënë dakord në konferencat e Jaltës e Posdamit, ku ishte vendosur që shteteve pjesëtare të Aleancës Antifashiste nuk do t'iu ndryshoheshin kufijtë me forcë dhe problemet që kishin mes tyre për çështje kufijsh do t'i zgjidhnim me bisedimet bilaterale, por megjithë premtimet jugosllave, nuk u bë asgjë.

Përkundrazi, me shkaputjen e Jugosllavisë nga blloku lindor, raprezaljet, krimet e shpërnguljet e shqiptarëve nga trojet etnike u bënë masive, deri në aprovimin e Kushtetutës të Federatës Jugosllave të vitit 1974.

Gjatë kësaj kohe janë vrarë, e burgosur mbi 40 mijë shqiptarë e janë dëbuar nga trojet e tyre etnike rreth 200 mijë vetë, kryesisht në Turqi.

Edhe me grekët luftuam në një front kundër nazi-fashizmit dhe mendohej se marrëdhëniet pas lufte do të ishin miqësore. Problemet e mbetura historike do të zgjidheshin me mirëkuptim, që minoriteti shqiptar në Greqi të kishte të drejta e trajtim sipas ligjeve ndërkombëtare për minoritetet, por pa marrë parasysh faktet historike e ligjet ndërkombëtare, grekët pa asnjë shkak më 1945, pasi masakruan me mijëra shqiptarë, përzonë nga trojet e tyre etnike 40 mijë të tjerë, të gjithë shqiptarë myslimanë, kurse shqiptarët kristianë të mbetur në trojet e tyre etnike nuk gëzojnë asnjë të drejtë nacionale. Atyre u ndalohet edhe të folurit shqip në ambientet publike, pasi sipas grekëve çdo orthodox nuk mund të jetë i tjetër kombësie, veçse grek.

Me aprovimin e Kushtetutës në vitin 1974, Tito u njohu shqiptarëve disa të drejta.

Kosova u shpall Krahinë Autonome po jo Republikë, megjithëse shqiptarët nga sasia e popullatës vinin të tretët ndër kombet që përbënin Federatën, por ata nuk ishin sllavë por shqiptarë. Republikë mund të kishin vetëm sllavët, siç ishte Mali i Zi vetëm me 400 mijë banorë.

Po, edhe ato të drejta që fituan shqiptarët me kushtetutën e 1974-s, ua hoqi me dhunë Millosheviçi më 1989. Shqiptarët për të ruajtur e mbrojtur ato të drejta nisën rezistencën paqësore, me të cilën për 10 vjet nuk arritën asgjë.

Përkundrazi, shtypja e terrori mbi shqiptarët shtoheshin çdo ditë. Kjo i detyroi ata të fillonin rezistencën e armatosur.

Në këtë luftë, forcat e armatosura jugosllave kryen genocid të paparë e krime të krahasuara vetëm me ato të nazistëve gjermanë. Ata vranë mbi 10 mijë shqiptarë, dëbuan afro një milion njerëz nga trojet etnike, dogjën e shkatërruan gjithçka në Kosovë. Vetëm ndërhyrja e vendosur e forcave të NATO-s në luftën e Kosovës i dha fund genocidit serb kundër popullatës shqiptare e u krijoi mundësi të dëbuarve të kthehen në trojet e tyre. Shqiptarët kurrë nuk do ta harrojnë ndihmën e përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, përfshi këtu edhe ndihmën e popujve të Konfederatës Zvicereane. Po në mënyrë të veçantë, kjo mirënjohje u drejtohet NATO-s e SHBA-së.

Edhe pas luftës së Kosovës, shtypja ndaj shqiptarëve në Serbi nuk ka pushuar, ajo i detyroi shqiptarët e Kosovës Lindore, (Preshevë, Bujanovc, Medvegjë), të ngrihen në luftë dhe megjithë ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar, problemi nuk është zgjidhur ende përfundimisht.

Edhe në Maqedoni, me daljen e saj nga Federata Jugosllave gjendja e shqiptarëve në vend që të përmirësohej u keqësua. Shteti maqedon u hoqi shqiptarëve edhe ato të drejta të cinguara që u ishin njohur nga Kushtetuta e Federatës e vitit 1974. Shteti maqedon nga shtet i maqedonasve, shqiptarëve e kombësive të tjera që jetojnë në Maqedoni, me aprovimin e Kushtetutës së Republikës u quajt Maqedonia



shtet i maqedonasve. Shqiptarëve nuk u njihej arsimimi i lartë në gjuhën shqipe, kufizohej punësimi i shqiptarëve në administratë, në ushtri pjesëmarrja e shqiptarëve ishte nga 2 deri 4%, ndërkohë që popullata shqiptare përbënte 40% të popullatës të kësaj republike. Kështu, shqiptarët u vunë në pozitën e njerëzve të kategorisë së dytë, përbuzeshin e diskriminoheshin. Gjatë 10 vjetëve, shqiptarët u përpoqën në rrugë paqësore e institucionale të fitonin të drejta të barabarta me maqedonasit sllavë, po nuk u arrit asgjë, përkundrazi gjendja e tyre shkonte çdo ditë në përkeqësim. Kjo gjendje diskriminuese i detyroi shqiptarët të ngrihen në luftë të armatosur, si e vetmja alternativë për të fituar të drejtat e tyre.

Lufta e shqiptarëve për të fituar të drejtat e tyre u etiketua nga qeveria dhe partitë sllave të Maqedonisë si terroriste dhe se luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) nuk ishin shqiptarë e shtetas maqedonas, por të ardhur nga Kosova e Shqipëria. Pra, ishte ndërhyrje nga jashtë e jo e qytetarëve maqedonas, të ngritur në luftë për të fituar të drejtat e liritë e mohuara nga shteti i tyre. Ky etiketim u mbështet nga Rusia, Ukrahina dhe sllavo-orthodoksit e Ballkanit, (Serbi, Bullgari e Greqi), të cilët menjëherë i ofruan ndihmë Maqedonisë.

Për fat të keq, ky etiketim u përkrah edhe nga bashkësia ndërkombëtare që e inkurajoi qeverinë maqedonase të përdorte të gjithë forcën e arsenalin ushtarak për të shtypur me zjarr e hekur popullin shqiptar. Me artileri, tanke, raketa, avionë e helikopterë u goditën fshatra të tëra të banuara nga shqiptarët. Nën gërmadhat e shtëpive të djegura e të shkatërruara u vranë, fëmijë, gra, civilë e të moshuar dhe u dëbuan nga trojet e tyre etnike rreth 100 mijë shiptarë.

Terrori maqedonas është i njëjtë me atë të Millosheviçit në Kosovë. Terroristë nuk qenë luftëtarët e UÇK-së. Nuk ka asnjë fakt që vërteton se ata mund të kenë vrarë ndonjë civil, e jo më gra, fëmijë e pleq. Ky qëndrim dinjitoz i luftëtarëve shqiptarë i bindi edhe më skeptikët, se ata nuk ishin terroristë. Terrorist është shteti maqedonas.

Luftëtarët e UÇK-së u treguan dinjitozë që në kontaktet e para me përfaqësuesit ndërkombëtarë, e sidomos në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit, për vendosjen e paqes në Maqedoni.

Ata i dorëzuan armët brenda afatit të caktuar, kurse Qeveria, Parlamenti dhe Presidenti maqedonas po përpiqen me të gjitha mënyrat ta pengojnë e të mos e zbatojnë plotësisht marrëveshjen, sidomos ato pjesë që bëjnë ndryshime në kushtetutë e që i barazojnë shqiptarët në të drejta të barabarta me sllavët maqedonas.

Nga ky qëndrim i tillë i tyre rrezikon të fillojnë përsëri luftimet. Kjo do të thotë shpërbërje e shtetit maqedonas, po mesa duket këtë duan edhe udhëheqësit maqedonas!

**A do të lejojnë ndërmjetësit ndërkombëtarë e NATO të shkelet Marrëveshja e Ohrit? Kjo është çështja, pasi rifillimi i konfliktit nuk do të shkatërronte vetëm Maqedoninë, por do të destabilizonte të gjithë rajonin.**

Sllavët e mbështetësit e tyre i akuzojnë shqiptarët se po destabilizojnë Ballkanin, por nuk janë ata destabilizues. Ballkanin e kanë destabilizuar fuqitë e mëdha europiane me vendimet që morën në Konferencën e Londrës, më 1913, për copëtimin e trojeve shqiptare e ua dhanë ato sllavëve të jugut dhe grekëve, që siç thamë më lart, vranë, masakruan e shpërngulën mbi një milion shqiptarë nga trojet e tyre etnike dhe atyre që mbetën brenda kufijve të tyre nuk u njohën e nuk duan t'u njohin të drejtat nacionale, demokratike e njerëzore të sanksionuara me akte ndërkombëtare.

Shqiptarët akuzohen se duan të krijojnë Shqipërinë e Madhe. Të krijosh një shtet të madh, duhet t'u rrëmbesh toka të tjerëve. Nuk ka asnjë fakt historik që shqiptarët janë përpjekur ta bëjnë një gjë të tillë, siç e kanë bërë fqinjët tanë me trojet tona.

Ne kërkojmë me çdo kusht që shqiptarët kudo që jetojnë të gëzojnë të drejta të barabarta si gjithë qytetarët e atij shteti. Nëqoftëse quhet Shqipëri e Madhe territori ku banojnë shqiptarët, atëherë le të quhet. Shqiptarët janë më tolerantët

në botë në marrëdhëniet ndërfaqetare, të tria fetë, myslimane, katolike e ortodokse jetojnë në harmoni të plotë.

Komunizmi, megjithëse sundoi egërsisht rreth 50 vjet në Shqipëri, nuk mundi ta zbehë qëndrimin europerëndimor të tyre. Ata që në kohën e Skënderbeut i kanë takuar qytetërimin evropian.

Bëhet pyetja a ka dhe a do të ketë problem shqiptar në Ballkan?

Them se po, por ne mendojmë se me kohë do të shemben barrierat nacionaliste e shoviniste që i ndalojnë popujt të vendosin se si është më mirë për ta. Nëse duhet ta ndërtojnë vetë të ardhmen e të zgjedhin me dëshirë me kë do të ndahen e me kë do të bashkohen. Kjo le t'i mbetet kohës ta zgjidhë.

Tani për tani, ne kërkojmë që Kosova të bëjë zgjedhjet, të ndërtojë institucionet e saj legjislative, ekzekutive, shoqërore, të sigurojë të drejta të barabarta për qytetarët e saj të çdo kombësie.

Organizmat ndërkombëtare të mos iu nënshtrohen presioneve serbe e ruse, sidomos për cënimin e kufijve.

Mitrovica t'i bashkohet autoritetit të Kosovës si pjesë e pandarë e saj e t'i jepet fund dy pushteteve në enklavat serbe, kurse për shqiptarët në Maqedoni të zbatohet Marrëveshja e Ohrit. T'u sigurohen shqiptarëve të drejta njësoj si shtetasve sllavë të Maqedonisë dhe të bëhen përpjekje të krijohet fryma e bashkëjetesës në mes shqiptarëve, sllavëve e pakicave që jetojnë në Maqedoni.

Për pakicat kombëtare shqiptare që jetojnë në Serbi, Mal të Zi e Greqi kërkojmë trajtim dinjitoz, siç përcaktohet në aktet ndërkombëtare të pranuar nga të gjithë, përfshi edhe shtetet ku jetonë shqiptarët. T'u sigurohet rikthimi në trojet e tyre të gjithë atyre që janë përzënë forcërisht.

*Gazeta "Bota Sot", 26 Nëntor 2001  
(Marrë nga "Tribun dë Geneve")*

## **Ne shqiptarët kemi fituar shumë miq në botë që na lehtësojnë punën për zgjidhjen e çështjes kombëtare**

*(Diskutim i Gjen.Leit. Rrahman Parllakut  
në Kuvendin e Lidhjes Shqiptare në botë)*

*Zonja e Zotërinj!*

Më gëzon fakti që në këtë tubim mbarëkombëtar, megjithëse në moshë të thyer, shëndeti më lejoi të marr pjesë, të shoh e të takoj bashkëkombas nga i gjithë globi, të dëgjoj ligjërime shqiptarësh që flasin e mendojnë vëllazërisht për çështjen kombëtare që aq shumë na shqetëson të gjithëve.

Falenderojmë vëllezërit Kushnini, Simonin e Mikelin, që ndezën shkëndijën për krijimin e Lidhjes Shqiptare në Botë e që po punojnë me përkushtim për çështjen shqiptare.

Falenderojmë gjithashtu, akademikët Pajazit Nushi e Esat Stavaleci për ndihmesën e tyre të veçantë në organizimin e drejtimin e këtij kuvendi.

Referati i z. Nushi, mbajtur në Kongres, i bënte një analizë historike dhe aktuale gjendjes së shqiptarëve në botë. Në referat parashtrohen qartë objektivat që duhet të arrijmë.

Edhe dokumentat e përgatitura nën drejtimin e zotit Stavaleci, si statuti e platforma, janë dokumenta që ndriçojnë rrugën në të cilën duhet të ecë Lidhja në të ardhmen.

Përsëritës zgjedhjet e para demokratike për Parlamentin e Kosovës e lirë dhe shprehim besimin se organet e zgjedhura shtetërore do të udhëheqin me siguri Kosovën drejt pavarësisë e përparimit.

Unë, si ushtarak, nga kjo tribunë përshëndes NATO-n që dha ndihmën vendimtare në çlirimin e Kosovës.

Ne shqiptarët, për fat të mirë, kemi fituar shumë miq në botë, sidomos pas luftës së Kosovës, që na lehtëson punën për zgjidhjen e çështjes kombëtare, por duhet të dimë t'i ruajmë dhe t'i respektojmë miqtë. Populli ynë thotë: "Miq të është e zorshme t'i gjesh, por është shumë e lehtë t'i humbasësh, po të mos jesh i kujdesshëm".

Ju bëj thirrje zonjave dhe zotërinjve të ardhur nga diaspora në këtë kuvend, të qëndrojnë larg ndikimeve partiake, pasi ato tek ne shqiptarët kanë prurë e sjellin përçarje, kurse neve na duhet bashkim, bashkim dhe vetëm bashkim.

Gjithashtu u bëj thirrje partive politike të mos ndërhyjnë në punët e Lidhjes. Me partitë është e domosdoshme të bashkëpunojmë e të bashkëveprojmë për zgjidhjen e çështjes kombëtare, pasi dhe partitë zgjidhjen e kësaj çështjeje e kanë në programet e tyre.

Në program edhe nga diskutantët u fol për nevojën e unifikimit dhe pastrimit të gjuhës nga fjalët e huaja dhe për përgatitjen e një abetareje të përbashkët mbarëshqiptare.

Më vjen mirë kur të huajt e flasin mirë shqipen, siç dëgjuam dhe në këtë kuvend, por ndjej keqardhje që ne shqiptarët nuk e flasim e nuk e shkruajmë drejt gjuhën tonë. Mendoj se duhet të jetë detyrë parësore e Akademisë Shkencore të Tiranës dhe të Prishtinës dhe e universiteteve shqiptare, që me punë të bashkërenduar ta zgjidhim këtë problem madhor, spastrimin e gjuhës tonë të bukur nga huazimet e huaja e të panevojshme dhe unifikimin e saj.

Kisha edhe disa propozime:

E para: E quaj detyrë të menjëhershme për Lidhjen nxjerrjen e një gazete a reviste periodike për të informuar jo vetëm organizatat e anëtarët e Lidhjes Shqiptare në Botë, por edhe të gjithë shqiptarët për veprimtarinë e Lidhjes në qendër dhe të organizatave të saj kudo në botë. Në shtyp do të trajtoheshin problemet shqiptare rajonale e botërore, do të shkëmbenim

mendime e përvoja për këto probleme midis nesh, pa patur nevojë të mbliidhemi. Nga ana tjetër, me anë të shtypit do të propagandonim çështjet tona kombëtare në botë, të mbetura të pazgjidhura deri më sot, nga padrejtësitë që i janë bërë kombit tonë nga Fuqitë e Mëdha europiane dhe fqinjët tanë grabitqarë.

E dyta: E shoh shumë të nevojshme që pranë Lidhjes, në qendër, të krijohet një qendër ndërlidhjeje e komunikimi me degët në botë, me mjetet elektronike të kohës.

E treta: Këtu u diskutua që Lidhja Shqiptare në Botë duhet ta ketë qendrën këtu në Prizren. Unë i çmoj vlerat historike të këtij qyteti, por mendoj se përderisa Kosova është protektorat dhe përfaqësuesi i OKB-së ka të drejtë të kufizojë jo vetëm veprimtarinë e qeverisë së Kosovës, por edhe atë të Lidhjes, e quaj të parakohshëm këtë mendim. Si rrjedhojë, propozoj që Lidhja ta ketë qendrën në Tiranë, kryeqytet i shtetit shqiptar.

Në Shqipëri, Lidhja fiton status të menjëhershëm, pasi në Tiranë kanë selitë e tyre përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri. Aty kanë përfaqësitë e tyre edhe shumë organizata e shoqata ndërkombëtare, që do t'ia lehtësonin punën.

**Kam edhe një propozim të fundit që, për mendimin tim, ka rëndësi të veçantë për përparimin e bashkimit e kombit tonë. E kam fjalën për ndërtimin e rrugës së re Durrës-Prishtinë. Prandaj i bëj thirrje Kongresit të dalë me një kërkesë për qeveritë e Tiranës dhe të Prishtinës që të merren vesh e të fillojë sa më shpejt projektimi dhe ndërtimi i rrugës Durrës-Prishtinë, pa të cilën nuk mund të ketë zhvillim ekonomik në Shqipëri e Kosovë dhe as ekonomi të harmonizuar mes tyre.**

Para tre vitesh, inxhinier Zef Rrakacolli ka shkruar artikullin për ndërtimin e kësaj rruge, duke e quajtur "rruga ndërshqiptare".

Unë kam me vete një projekt-ide të ndërtimit të kësaj rruge, përgatitur nga një institut privat. Sipas këtij projekti, me ndërtimin e kësaj rruge, udhëtimi Durrës - Prishtinë

bëhet brenda tre orësh, kurse sot bëhet për 12 orë. Rruga e re eviton pothuajse të gjitha kthesat, ngjitjet e zbritjet e vështira, ndërprerjet nga rëshqitjet e dëborës, etj. Ndërtimi i kësaj rruge duhet të jetë përparësi mbi çdo gjë, pasi është jetik për zhvillimin ekonomik e shoqëror, por edhe për bashkimin de facto të shqiptarëve në të dy anët.

Këtu në Kuvend kemi përfaqësues nga e gjithë diaspora. Ju lutem të gjithëve t'iu bëjmë thirrje e t'i nxisim biznesmenët shqiptarë në diasporë që të investojnë për ndërtimin e kësaj rruge me rëndësi kombëtare.

Me ndërtimin e kësaj rruge, Shqipëria do të bëhet korridor ndërlidhës në mes Lindjes e Perëndimit, siç ka qenë historikisht, kurse porti i Durrësit do të jetë porti kryesor që lidh dy brigjet e Adriatikut.

*Gazeta "Veterani", e martë, 1 Janar 2002*

## Organizimi i diasporës shqiptare mbi baza kombëtare

*Intervistë me z. Rrahman Parllaku, Kryetar i OBVL-së, që mori pjesë në Kongresin e Parë të Lidhjes Shqiptare në Botë*

**Redaksia:** Zoti Rrahman, ju morët pjesë në punimet e Kongresit të I-rë të Lidhjes Shqiptare në Botë, mbajtur në Prizren, më 26–27 nëntor. Lutemi na jepni një informacion për lexuesin tonë mbi organizimin e këtij Kongresi dhe zhvillimin e punimeve në të.

**Gjeneral Parllaku:** Sipas vendimit që kishin marrë përfaqësuesit e degëve të Lidhjes Shqiptare në Botë, në 30 Qershor 2001, në Prishtinë, u mbajt mbledhja e Kongresit të I-ë të Lidhjes Shqiptare në Botë.

Në Kongres kishin dërguar delegatë të gjitha degët e Lidhjes nga Europa, Amerika, Azia, Australia e Kanadaja. Ishin afro 500 delegatë, veç të ftuarve e miqve të huaj dashamirës të kombit shqiptar.

Pjesën më të madhe të delegatëve e përbënin intelektualë të të gjitha fushave të dijes, mjaft prej të cilëve me tituj shkencorë, si akademikë, profesorë e doktorë të shkencave, shkrimtarë, historianë, artistë të shquar, patriotë e veprimtarë të përkushtuar të çështjes kombëtare.

Një kontribut të veçantë në organizimin, përgatitjen dhe drejtimin e punimeve të Kongresit dhanë misionarët e njohur të Lidhjes, vëllezërit Simon e Mikel Kushnini, akademikët Pajazit Nushi dhe Esat Stavileci si dhe intelektualët e tjerë



të Kosovës. Falenderime merituan mikpritësit prizrenas me në krye Kryetarin e Komunës, Orhan Kubati, të cilët kishin krijuar të gjitha kushtet për punë të mbarë të Kongresit.

Në Kongres, pas përshëndetjes së hapjes të punimeve nga kryetari Simon Kushnini, e mori fjalën akademik Pajazit Nushi, i cili bëri një analizë historike dhe aktuale të gjendjes së shqiptarëve në botë. Në referat u parashtruan qartë objektivat që duhet të arrijmë në të ardhmen.

Kongresin e përshëndetën, diskutuan, bënë propozime e dhanë mendime mbi 30 delegatë e të ftuar, për një organizim e drejtim më të mirë të punëve të Lidhjes në qendër e në degët e saj kudo në botë.

Në fund të punimeve, që u karakterizuan nga një frymë vëllazërore, gatishmërie e përkushtimi për çështjen kombëtare, Kongresi miratoi në unanimitet Statutin e Platformën Kombëtare të Lidhjes dhe zgjodhi organet drejtuese të saj, Këshillin Kombëtar, Kryesinë, Kryetarin e Nënkryetarët dhe komisionet e përhershme të Lidhjes.

**Redaksia:** A mund të na jepni në mënyrë të përmbledhur objektivat që synon të arrijë Lidhja sipas Platformës Kombëtare?

**Gjeneral Parllaku:** Po citoj disa nga pikat e platformës, pasi ajo është e gjerë, analizon e përpiqet t' u japë rrugëzgjidhje një masë problemesh të sotme mbarëkombëtare shqiptare.

Sipas Platformës Kombëtare, Lidhja Shqiptare në Botë përcaktohet për këto veprimtari, si pikënisje të zbatimit të Platformës së vet Kombëtare.

Lidhja Shqiptare në Botë do të angazhohet për të zbardhur faktet historike, politike, ndërkombëtare dhe juridike të copëtimit të trojeve shqiptare dhe rrethanat e brendshme e ndërkombëtare që kanë kushtëzuar atë, me qëllim që shqiptarët të përballojnë sprovat e mëdha historike të së tashmes, të shoqëruara me lakmi të reja për gllabërimin e tokave shqiptare.

Lidhja Shqiptare në Botë do të angazhohet veçanërisht që të zbardhet procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, i cili

përfundoi me pavarësinë e popujve sllavë, të atyre popujve që vullnetarisht ishin bashkuar me të, por jo atyre popujve siç janë shqiptarët, të cilët me dhunë janë përfshirë në të.

Projekti më serioz dhe më i rëndësishëm i Lidhjes Shqiptare në Botë do të jetë sjellja e arsyeshmërisë historike, politike, ekonomike, demografike, kombëtare dhe ndërkombëtare e bashkimit kombëtar të shqiptarëve, si zgjidhje e vetme e drejtë dhe e plotë për çështjen shqiptare.

Preokupimi i rëndësishëm i Lidhjes Shqiptare në Botë do të jetë ndërtimi i strategjisë së zgjidhjes së çështjes shqiptare dhe pikërisht për këtë qëllim Lidhja Shqiptare në Botë do të arsyetojë nevojën e themelimit të Institutit Shqiptar për Studime Strategjike.

Lidhja Shqiptare në Botë e sheh me shumë interes hartimin e një Platforme të Përgjithshme Kombëtare në të cilën do të parashiheshin rrugët, kahet, faktorët dhe mundësitë e përparimit të pozitës së shqiptarëve deri në zgjidhjen e drejtë e të plotë të çështjes shqiptare. Platforma Kombëtare e Lidhjes Shqiptare në Botë paraqet një kontribut të veçantë të saj në fushën e ndërtimit të Strategjisë Kombëtare.

Duke u angazhuar për ruajtjen e lidhjeve të diasporës me atdheun, përkatësisht me njerëzit e tyre në vendlindje, me jetën zakonet, gjuhën dhe kulturën e tyre, Lidhja Shqiptare në Botë do ta përqëndrojë veprimtarinë e vet në organizimin e diasporës shqiptare mbi baza kombëtare, nëpër klube e shoqata e jo mbi baza politike e partiake që mund të çojnë në copëtimin e saj.

Lidhja Shqiptare në Botë do të interesohet veçanërisht për sigurimin e kushteve për ruajtjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve të shpërndarë nëpër botë, duke dhënë ndihmesën e vet të drejtpërdrejtë për shkollimin plotësues e cilësor në gjuhën amtare të fëmijëve të mërgimtarëve tanë.

Duke u angazhuar kundër procesit të asimilimit të tyre, Lidhja Shqiptare në Botë në veprimtarinë e vet parasheh botimin e librave të ndryshëm nga abetarja e përbashkët e deri

tek historia e përgjithshme e popullit shqiptar, vepra këto që mund të ndihmojnë për ruatjen e identitetit kombëtar të tyre.

Lidhja Shqiptare në Botë do ta ketë për detyrë të përhershme që opinionit të brendshëm e veçanërisht atij ndërkombëtar t'ua paraqesë çështjen shqiptare si gjendje të një populli të ndarë, që t'ia bëjë të njohur botës të kaluarën e hidhur të popullit shqiptar, keqtrajtimet dhe genocidin që ka përjetuar ky popull dhe t'i japë fakte të pastra botës për synimin shekullor të shqiptarëve për bashkim.

Këtu unë përmbloodha disa nga pikënisjet e Platformës Kombëtare të Lidhjes, por ajo në bazë të këtyre pikënisjeve shtron dhe përcakton objektivat, drejtimet dhe rrugët e zgjidhjes së problemeve mbarëkombëtare, ku duhet të përqëndrohet puna e aktiviteti i degëve, i anëtarëve dhe i aktivistëve të Lidhjes Shqiptare në Botë.

Lidhja Shqiptare në Botë në Platformën e saj parasheh një bashkëveprim dhe bashkëpunim me partitë politike, institucionet shtetërore e shkencore, shoqatat jopartiake, etj.

Punimet e Kongresit të Lidhjes përfunduan në ditën e festës kombëtare, 28 nëntorit, që në Kosovë këtë vit u shënuar me një manifestim madhështor e historik e me ngritjen e përmendores së heroit tonë Kombëtar Skënderbeut në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë.

Manifestimi filloi që me kalimin e përmendores në tokën e Kosovës. Në të gjithë rrugën ku kaloi përmendorja, nga Prizreni deri në Prishtinë, turma manifestuesish që kishin zënë të dy anët e rrugës, përshëndesnin e brohorisnin të entuziazmuar: Edhe tek ne, në Kosovën e lirë erdhi Skënderbeu.

Kulmi i manifestimeve ishte hyrja e përmendores në Prishtinë, ku e prisnin afro 200 mijë vetë, nga orët e para të mëngjesit e deri në mbrëmje, kur u bë përrurimi i vendosjes së saj në pedestal.

*Marrë nga gazeta "Standart", 2.12.2008*

## **Shqipëria, pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës**

*Fjala e Kryetarit të OBVL-së, Gjen. Rrahman Parllaku, në veprimtarinë jubilarë me rastin e 60-vjetorit të fitores mbi nazifashizmin mbajtur në Pallatin e Kongreseve, Tiranë, më 9 Maj 2005 dhe në Teatrin e Prishtinës, më 10 Maj 2005*

*Zonja e Zotërinj,*

Jam i nderuar që më jepet rasti të flas në emër të brezit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në 60-vjetorin e fitores mbi forcat nazi-fashiste.

Në këtë ditë, ne kujtojmë me përlulje e nderim dëshmorët që dhanë jetën për idealet e larta të lirisë, kujtojmë shoqet e shokët tanë të luftës që nuk janë më në mes nesh.

Dita e fitores përkujtohet në të gjithë botën, pasi ishte fitore botërore e forcave të lirisë kundër forcave të barbarisë.

Ne shqiptarët kemi të drejtë ta festojmë me krenari këtë ditë se me luftën e sakrificat mbinjerëzore dhe gjakun e dhjetra mijëra dëshmorëve u bëmë pjesë e bllokut antifashist të popujve të botës, të kryesuar nga aleanca anglo-sovjeto-amerikane.

Në momentin historik, populli shqiptar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo që jetonte në trojet e tij etnike u bashkua me forcat e lirisë kundër atyre të errësirës.

Në bazë të kësaj lufte e sakrificave që bëmë, ne siguroam jo vetëm pavarësinë e Shqipërisë, por të drejtën e shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje, e të shqiptarëve kudo që jetojnë të drejtën për të qëndruar në trojet e tyre etnike.

Kjo ishte fitorja e dytë më e madhe në historinë tonë kombëtare, pas shpalljes së pavarësisë dhe ngritjes së flamurit në Vlorë.

*Zonja e Zotërinj,*

Në Luftën e Dytë Botërore, i gjithë populli shqiptar ishte në rrezik. Shqipëria mund të humbiste pavarësinë. Populli shqiptar i Kosovës dhe shqiptarët të kudondodhur në trojet e tyre etnike mund të shpërnguleshin e të pësonin fatin e atyre shqiptarëve që u dëbuan me forcën e armëve nga serbët në vitet 1870 -1880, nga zonat e Nishit, Vranjës, Prokupljes, Leskovcit, etj., si edhe populli çam.

Ky rrezik vinte sepse pushtuesit italianë erdhën me parrullën e bashkimit të shqiptarëve nën kurorën e Viktor Emanuelit. Krijuan qeverinë kuislinge për t'i dhënë pamjen e një shteti të pavarur dhe me shkatërrimin e Jugosllavisë dolën me parrullën e Shqipërisë së Madhe. Në këtë mënyrë u përpoqën ta lidhin popullin tonë me bllokun fashist.

Të njëjtën rrugë ndoqi edhe Gjermania naziste pas kapitullimit të Italisë, duke mbledhur një asamble tradhtarë që e shpalli Shqipërinë të pavarur, pasi gjermanët kishin deklaruar se “ne jemi kalimtarë dhe Shqipëria do të jetë e pavarur”. Vetëkuptohet, pavarësi me nazistët brenda në Shqipëri!

Me këto parrulla, ata u përpoqën ta joshnin popullin shqiptar, ta mbanin të lidhur me ta dhe me ndihmën e kuislingëve bashkëpunëtorë të tyre ta vinin kundër Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Po të mos kishte filluar të zhvillohej Lufta Nacionalçlirimtare, kombi shqiptar do të kishte shkuar në humnerë bashkë me nazifashistët dhe do të ishin plotësuar lakmitë grabitqare sllavo-greke për copëtimin e shtetit shqiptar, për të cilat punonin edhe qeveritë mbretërore greko-serbe në ekzil.

Zhvillimi i Luftës Nacionalçlirimtare përfshiu gjithë Shqipërinë dhe vetëm brenda vitit 1942 ishin krijuar 22 çeta

partizane nga Konispoli në Jug deri në Malësinë e Gjakovës në Veri. Jehona e kësaj lufte bëri që Ministri i Jashtëm i Anglisë, Iden, i Bashkimit Sovjetik, Molotov dhe i SHBA-së, Hell, në dhjetor 1942 të bënin deklaratën se dëshironin ta shihnin Shqipërinë të çliruar nga zgjedha italiane dhe të vendosej pavarësia e saj, ndërsa forma e regjimit dhe e qeverisë që do të vendosej në Shqipëri, do të ishte një çështje që do ta vendoste vetë populli shqiptar në fund të luftës.

Megjithëse në këtë deklaratë, qeveria angleze mbante një rezervë kur shprehej se e sheh çështjen e kufijve shqiptarë pas luftës si një çështje që duhet të merret në shqyrtim në Konferencën e Paqes. Kjo deklaratë ishte mbështetje për qeveritë greko-jugosllave në ekzil, që përgatishnin plane për copëtimin e Shqipërisë, por zhvillimi i vrrullshëm që kishte marrë Lufta Nacionalçlirimtare me krijimin e reparteve sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm më 10 Korrik 1943, mori në drejtim dhe centralizoi veprimet luftarake, duke shtuar goditjet kundër pushtuesve, ku u krijuan zonat e lira.

Në këto momente, aleatët e në radhë të parë anglezët dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm që të ndiqnin nga afër luftën tonë dhe u bindën se e vetmja forcë ushtarake e organizuar në Shqipëri që bënte luftë të vendosur kundër pushtuesve nazifashistë ishte Ushtria Nacionalçlirimtare.

Pas kësaj bindje, ata i shtuan misionet e tyre në Shqipëri dhe filluan të na ndihmojnë me armatime e materiale luftarake, megjithëse shumë të kufizuara për shtimin e zgjerimin e ushtrisë sonë gjatë viteve 1943-1944.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e ushtrive aleate bënë të gjitha përpjekjet për t'i bashkuar e futur në luftë forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar e të Legalitetit, por nuk patën sukses.

Ushtria Nacionalçlirimtare, pasi theu me sukses operacionin më të madh të forcave naziste e bashkëpunëtorëve të tyre në dimrin e egër të viteve 1943-1944 e pasi çliroi hapësira

të mëdha të vendit, krijoi kushte për mbajtjen e Kongresit Antifashist në qytetin e çliruar të Përmetit. Nga ky Kongres doli Komiteti Antifashist me atributet e një qeverie provizore.

Pas Kongresit u bënë ndryshime në organizimin e ushtrisë. Ajo kaloi nga formacionet e brigadave në ato të njëjstive të mëdha, të divizioneve e korparmatave, të afta për të kryer operacione operative strategjike në të gjitha hapësirat e vendit.

Me thyerjen e operacionit gjerman të Qershorit 1944, i fundit i ndërmarrë nga nazistët në vendin tonë në korrik 1944, forcat e Divizionit të I kaluan në mësymje për çlirimin e Shqipërisë së Mesme e të Veriut dhe me çlirimin e Matit, të Dibrës e Lumës, Brigada e V u shkëput nga vartësia e Divizionit të I-rë dhe së bashku me Brigadën e III morën urdhër të kalojnë në Kosovë për të ndihmuar në çlirimin e saj.

Lufta e Brigadave tona për çlirimin e krahinave të Kosovës dha ndihmesë edhe për pjesëmarrjen e djemve të saj në luftë.

Me largimin e brigadave tona nga Kosova, në drejtim të Sanxhakut e Bosnjës, forcat serbo-sllave përfshi dhe ato çetnike u përpoqën të vënë në zbatim planin e Çubrilloviçit, por ishte vonë.

Forcat shqiptare ishin të armatosura. Ata bënë qëndresë të fortë duke luftuar për jetë a vdekje nën komandën e Shaban Polluzhës. Krimet ishin të rënda, por planet e Çubrilloviçit nuk u realizuan. Shqiptarët mbetën përjetë në trojet e tyre etnike.

Forcat e dy divizioneve tona e vazhduan luftën në tokat e Jugosllavisë, duke dhënë ndihmesën e tyre jo vetëm në çlirimin e krahinave të Malit të Zi, Sanxhakut e Bosnjës, por edhe duke penguar, dëmtuar e vonuar forcat naziste që përpiqeshin të tërhiqeshin me shpejtësi e në mënyrë të organizuar për në frontin e Perëndimit, për të luftuar kundër forcave aleate që kishin zbarkuar në Francë.

Luftimet e forcave tona në këto vende janë zhvilluar në kushte tepër të vështira, të një dimri që u kujtonte partizanëve tanë ato të dimrit 1943-1944 në Shqipëri, me mungesa të

theksuara në ushqime e mjete të tjera jetese, por ata e kryen me nder detyrën.

Dua t'ju kujtoj se në këto luftime kanë rënë afër 600 dëshmorë të dy divizioneve tona. Ky ishte edhe një kontribut i veçantë në Luftën Antifashiste.

Populli ynë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e kudo në trojet etnike është krenar se iu bashkua në luftë Aleancës së Madhe Antifashiste të Popujve. E çliruan Shqipërinë pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate, por edhe dhamë kontribut të çmuar në këtë luftë.

Në këtë ditë historike, ne shprehim falenderimet tona për ndihmën që dhanë aleatet e mëdhenj: Anglia, Bashkimi Sovjetik e SHBA në shkatërrimin e bishës nazi-fashiste, duke u siguruar popujve lirinë.

Gjithashtu, në këtë ditë të shënuar ne kujtojmë me respekt jo vetëm dëshmorët e LANÇ-it, por edhe ato të UÇK-së të Kosovës e Maqedonisë dhe çmojmë në mënyrë të veçantë ndihmën vendimtare që dhanë forcat e armatosura të SHBA e NATO-s për çlirimin e Kosovës, që mposhtën barbarinë e kriminelit Milosheviç, i cili në fund të shekullit të kaluar u përpoq të vinte në zbatim planin famëkeq të Çubrilloviçit për spastrimin etnik të Kosovës.

Lavdi dëshmorëve të kombit tonë të të gjitha luftërave çlirimtare!



## **Unë nuk kam pasur asnjë lidhje me ato që ndodhën në Tivar**

*(Fjala Gjeneral Parllakut në mbledhjen përkujtimore  
që u mbajt në Ulqin më 30-31 Mars 2013)*

*Të nderuar organizatorë të kësaj mbledhje,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Më lejoni ta quaj këtë mbledhje historike, megjithëse na sjell në kujtesë një ngjarje tepër të dhimbshme, por që duhet kujtuar dhe duhet njohur nga brezat e rinj.

Edhe pse tepër i moshuar, e prita me kënaqësi ftesën dhe e mora me shumë dëshirë rrugën për t'u bërë pjesë e kësaj mbledhje, e cila do të na ndriçojë të vërtetat tepër të dhimbshme të kësaj ngjarjeje tragjike, megjithëse kontributi im në këtë rast mbetet modest, pasi ndonëse me detyra të larta komanduese në Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare, unë nuk kam pasur asnjë lidhje me ato që ndodhën në Tivar, pasi në atë kohë ndodhesha larg që këtej, duke komanduar forcat partizane që ktheheshin nga luftimet në Bosnje për në Mitrovicë të Kosovës, në 15 Mars të vitit 1945.

Atëherë askush nuk fliste për ngjarjet e Tivarit.

Edhe kur u ktheva në Shqipëri, në takimim që pata me Enver Hoxhën, në datën 3 maj të po atij viti, gjatë analizës mbi ngjarjet e luftës, përsëri nuk m'u bë me dije asgjë se çfarë kishte ndodhur në Tivar.

Për këto ngjarje të hidhura kam dëgjuar kohë më vonë, kur ndodhesha me detyrë në Qarkun e Shkodrës, por edhe atëherë ngjarjet nuk m'u paraqitën aq tragjike sa edhe kishin ndodhur në të vërtetë.

Për masakrën e Tivarit, jam i mendimit se përgjegjësia rëndon mbi Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxen, të cilët në atë kohë ishin në krye të shtetit dhe ndonëse ishin informuar që vrasjet e të mobilizuarve fillonin që brenda trojeve shqiptare, nuk ndërmorën asnjë masë për t'i ndaluar ato dhe për t'iu ardhur në ndihmë vëllezërve tanë.

Këtë duhet ta bënin, pasi i kishin të gjitha mundësitë për sa kohë ngjarjet zhvilloheshin brenda trojeve tona, pasi ngjarjet e Tivarit u zhvilluan jashtë kufirit shqiptar.

Veçanërisht heshtja mbi ngjarjet e Tivarit është njësoj si heshtja mbi ngjarjet e Drenicës dhe fshehja e të vërtetave faktike, jo vetëm nga populli, por edhe nga ne kuadrot e larta të partisë e të ushtrisë shqiptare. Kjo është krejtësisht e pafalshme.

Këto qëndrime të pasinqerta dhe antikombëtare të udhëheqësve me të lartë të vendit, na bindin se ata i ishin nënshtruar politikës së Titos dhe po punonin për ta kthyer Shqipërinë në republikë të VII-të të Federatës Jugosllave.

Fatmirësisht, historia po e thotë sot dhe do ta thotë edhe në të ardhmen të vërtetën historike mbi tragjedinë e dhimbshme në kurriz të shqiptarëve.

Pikërisht kjo mbledhje ka marrë përsipër një mision të çmuar kombëtar, të sjellë fakte të reja mbi ngjarjen tragjike të Tivarit, të njohë bashkëkombasit tanë, kudo ku ata jetojnë e punojnë dhe veçanërisht rininë, me të vërtetat e dhimbshme historike të asaj kohe dhe t'i tregojnë opinionit ndërkombëtar se genocidi serbosllav ndaj shqiptarëve ka filluar që në mesin e shekullit të XIX-të dhe ka vazhduar deri në fund të shekullit të XX-të, me barbaritë serbe të komanduar nga kriminelin Milosheviç kundër popullit të Kosovës.

Edhe pse në moshën 94-vjeçare, jam i interesuar njësoj si ju

të njoh sa më mirë historinë e kombit tim, sado e dhimbshme qoftë ajo.

Pasi vuajta nga diktatura komuniste për 16 vjet e 3 muaj, unë munda të lirohem nga burgu vetëm me fitoren e demokracisë në Shqipëri, në moshën 72- vjeçare, por unë asnjë moment nuk kam qëndruar larg luftërave çlirimtare të popullit tonë për pavarësi kombëtare dhe kam qenë mbështetës aktiv i përpjekjeve të shqiptarëve për të fituar të drejtat nacionale dhe liritë demokratike në trojet e tyre etnike.

U përfshiva fuqimisht në veprimtarinë e organizateve me karakter kombëtar si në shoqatën "Kosova", në Lidhjen e Shqiptarëve në Botë, në Lidhjen e Prizrenit, si edhe prej më shumë se 10 vjetësh drejtoj Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare.

Në bashkëpunim me këto shoqata e organizata, ne kemi dhënë një ndihmesë të veçantë në pritjen dhe akomodimin e vëllezërve kosovarë të përzënë nga trojet e tyre.

Së bashku kemi përkujtuar ngjarje historike të luftërave për pavarësi e çlirim kombëtar. Kemi përkujtuar shumë figura të shquara me kontribute kombëtare në këto luftëra dhe përpjekimi që pluhuri i harresës të mos e mbulojë historinë e lavdishme të kombit tonë, por ajo të ruhet e freskët në kujtesën e brezave.

Masakra të përmasave të mëdha si e Tivarit, Drenicës e të tjera si këto, meritojnë të gdhenden përjetësisht në memorien historike të popullit tonë, por ato duhet të përjetësohen edhe në drama e romane, krijimtari artistike kjo, që mund të mbështetet nga biznesmenë të ndershëm e patriotë.

Unë përpiqem vazhdimisht me artikuj, fjalime e intervista të shpalosura në shtypin e përditshëm dhe në atë radio-televiziv të jap ndihmesën time në zbardhjen e këtyre ngjarjeve të paharruara dhe këtë nuk e kam bërë vetëm brenda kufijve të Shqipërisë, por jam përqëndruar hollësisht në publikimin e luftërave për liri të zhvilluara në Kosovë, në Maqedoni e kudo ku shqiptarët në trojet e tyre etnike luftojnë për të drejtat nacionale e për liritë demokratike që iu takojnë.

E kam filluar me përjashtimin e Kosovës nga Konferenca e Dejtonit, kam vazhduar me çlirimin e Kosovës, më pas me luftën çlirimtare në Maqedoni e deri te Marrëveshja e Ohrit.

Këtë pjesë të publicistikës time e kam përfshirë në librin “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime”. Në këtë libër janë përfshirë edhe veprimet luftarake të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në ndihmë të çlirimit të Kosovës në tetor-nëntor të vitit 1944.

Gjithashtu janë përfshirë veprimet e Divizionit të V-të, të kthyer pas ngjarjeve të Drenicës, nga Bosnja në Kosovë, për të ndihmuar në stabilizimin dhe normalizimin e gjendjes në atë rajon, nga 15 marsi deri në 1 maj të vitit 1945, kur unë u largova nga Kosova i ngarkuar me një detyrë tjetër.

Libri “Kosova e lirë, ëndrra e jetës sime”, u promovua në Prishtinë nën kujdesin e shoqatës të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare të Kosovës, të kryesuar nga znj. Vahide Hoxha.

Meqenëse koha ikën dhe unë s’po e ndal dot, për sa kohë do ta kem kujtesën të kthjellët, ju premtoj se do të përpiqem gjithmonë të kontribuoj në dokumentimin e të vërtetave historike në të mirë të historisë të lavdishme të kombit tonë.

**Rrahman Parllaku**

*Gjeneral-Leitnant, në pension, “Hero i Popullit”*



*Drejtues të OBVL dhe të shoqatës të veteranëve  
të LANÇ të Kosovës*

# X

Bashkëkohësit  
për gjeneralin

## Gjenerali i tre epokave

Nga **SKËNDER MALINDI**

*Nënkryetar i OBVL*

Për biografinë e Gjeneralit Rrahman Parllaku është folur shumë. Unë që kam një kohë të gjatë me të, duke qenë zëvendës i tij, do të flas më shumë për disa aspekte të veçanta të tij, si një nga drejtuesit kryesorë të ushtrisë.

Ai kishte një stil dhe metodë pune ndryshe nga të tjerët. Disa nga kolegët e tij, për zbatimin e urdhërave preferonin ngritje zëri dhe dënimet, ndërsa Rrahmani preferonte që urdhërat të zbatoheshin jo në atë mënyrë, por duke kërkuar llogari me mirësjellje, me mirëkuptim dhe me kulturë. Kjo bënte që urdhërat e të parëve të zbatoheshin vetëm se e kërkonte rregullorja, ndërsa urdhërat e Rrahmanit zbatoheshin jo vetëm sepse e kërkonte rregullorja, por edhe sepse kuadri oficer ishte i bindur dhe i vetëdijshëm për të zbatuar këto urdhëra me cilësinë më të lartë dhe në kohën e duhur. Ja pra ku qëndron ndryshimi dhe supremacia e tij ndaj kolegëve të tij drejtues të ushtrisë. Me qëndrimin e tij të qetë dhe shikimin e vëmendshëm që shprehte botën e brendshme, ai krijonte besim dhe afrueshmëri me shokët dhe bashkëpunëtorët e tij, duke lehtësuar kryerjen e detyrave të vështira në ushtri.

Rrahman Parllaku është një person me aftësi të mëdha profesionale ushtarake, shumë i zgjuar nga natyra dhe me një intuitë shumë të zhvilluar. Ai ka disa cilësi të rralla që quhen mirësjellje, mirëkuptim, gjykim, urtësi dhe komunikim

njerëzor me gjithë kuadrin oficer. Ai jepte më shumë këshilla se sa urdhëra, falte kur kishte mundësi të dënonte. Komandonte veten, pastaj komandonte të tjerët dhe mbante peshën e gjithë atyre që komandonte. Kishte cilësinë të merrte prej vartësve atë që donte. Rrahmani ishte i mirë edhe kur të kritikonte. Ai mendimet e këqija i shprehte me fjalët më të mira. Ishin të huaja për të kapërdisja e fodullëku, arroganca, egoizmi. Ai rrezatonte nga zemërgjerësia. Me të ndiheshë i sigurt dhe bashkëpunojë qetë. I kishte neveri njerëzit që fyenin shokët apo vartësit. Ai nuk dinte të shante apo të fliste prapa krahëve, nuk merrej me thashetheme, sillej me modesti dhe jo me ndjenjën e superioritetit. Por këto cilësi nuk e pengonin atë të mos i zbatoheshin urdhërat dhe udhëzimet. E them me bindje të plotë dhe e kam thënë kurdoherë ku ka qenë rasti dhe vendi para të gjithëve, se Rrahman Parllaku është gjenerali më kërkues në ushtri nga të gjithë gjeneralët e tjerë, sepse vetëm atij i zbatoheshin urdhërat dhe udhëzimet me përpikmëri dhe kjo ka qenë veçoria më e madhe e tij.

Një tjetër cilësi e Rrahmanit ka të bëjë me ndihmën që ai i jepte kuadrin oficer. Ai ishte gjithmonë i gatshëm për t'u ofruar përkrahjen dhe ndihmën kujtdo që ka patur nevojë. Ai kishte kënaqësi kur ndihmonte të tjerët në nevojat që ata kishin.

Z.Rrahman Parllaku, herë pas here, ka patur ngritje në përgjegjshi dhe ka marrë gjithmonë grada të larta, por këto nuk kanë ndikuar që ai të bëhet mendjemadh dhe të ndryshojë mënyrën e sjelljes, korrektesën, kërkesën e llogarisë dhe stilin e metodës së tij të punës. Ato kanë qenë vazhdimisht konstante gjatë gjithë karrierës së tij në ushtri.

Ai ka shërbyer në të gjitha hallkat e ushtrisë, në logjistikë, në Komandën e Mbrojtjes Ajrore, Detare, në korpuset e këmbësorisë, me post drejtues në Drejtorinë e Përgatitjes Luftarake, në Drejtorinë Politike të Ushtrisë, në Drejtorinë e Personel Organizimit, në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë si Zv. Shef Shtabi, në Ministrinë e Mbrojtjes si Zv.Ministër. Pra, në çdo qelizë të ushtrisë.



Gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare filloi si guerrilas i thjeshtë në qytetin e Vlorës, si komandant i njësiteve guerrile, si komisar batalioni, brigade, divizioni dhe deri në komisar korparmata vetëm 26 vjec.

Këto cilësi e detyra të rëndësishme e rritin edhe më shumë personalitetin e tij, i rritin vlerat dhe e bëjnë gjeneralin më të dashur dhe më të respektuar në ushtrinë shqiptare.

Këtu nuk është fjala për të zmadhuar vlerat e tij, por e vërteta është dhe duhet thënë se ai është një personalitet me virtyte të larta njerëzore. I bindur, e etiketoj gjeneral të tre periudhave: gjeneral lufte, gjeneral përballë Traktatit të Varshavës, gjeneral që ndihmon UÇK-së dhe luftën në Kosovë. Ky është "Heroi i Popullit", Rahman Parllaku.

## **Simbol i qëndresës dhe i pathyeshmërisë ndaj diktaturës**

*Nga EDIP OHRI*

Rrahman Latif Parllaku, Gjeneral Leitnant dhe Hero i Popullit, është një nga figurat e shquara të Ushtrisë Shqiptare në vite, i përkushtuar për Shqipërinë, për lirinë, përparimin, demokracinë, me vlera të mëdha njerëzore e njëkohësisht ushtarak i shquar.

Është e vështirë të mendohet një shtresë tjetër e popullsisë që ka kaq shumë njohje, edukim, devotshmëri, gatishmëri, shpirt sakrificë, interes profesional e moral për interesat kombëtare sa ajo e ushtarakëve.

Figura e ushtarakut përgjithësisht është një figurë e nderuar në të gjitha shtresat e popullsisë. Në një vend të vogël si Shqipëria, koncepti për mbrojtjen, për luftëtarët e tij është pjesë e konceptit të mbijetesës, pjesë e ndërgjegjes kombëtare.

Pavarësisht ideologjive, sistemeve shoqërore, gjatë rreth 100 viteve në Shqipëri, fati i udhëheqësve ushtarakë nuk ka qenë i mirë. Nisur nga numri i ushtarakëve të lartë të dënuar është e vështirë të gjendet një shtet tjetër që të ketë mbajtur qëndrim ndëshkues e armiqësor ndaj Lidërsipit Ushtarak, duke të krijuar kështu përshtypjen sikur vendi ka patur grushte shteti pa mbarim, duke bërë që Lidërsipi Ushtarak në Shqipëri të mos konsiderohet si “pasuri” e kombit të tyre.

Një prej këtyre figurave të shquara që patën një fat të tillë është edhe Gjenerali i shquar Rrahman Parllaku. Ai ishte një

nga komandantët e shquar të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Për merita të veçanta i është dhënë titulli “Hero i Popullit” dhe është dekoruar me 9 urdhra e tri medalje të luftës dhe 3 urdhra të shërbimit ushtarak.

Nga ky këndvështrim, “Grupi Puçist” dhe Rrahman Parllaku edhe sot e kësaj ditë vazhdon të tërheqë vëmëndjen me ngërthimin e ngjarjeve, me dramacitetin dhe njëkohësisht me absurditetin e vet: Shteti Shqiptar “hëngri” kokat e gjeneralëve të tij.

Uashington Post” e 25 maj 1976, do shkruante se: “Udhëheqësi komunist shqiptar, Enver Hoxha, ka nisur një spastrim kundër kundërshtarëve të tij politikë që krahasuar me teknikat se si po procedohet, u ngjason atyre të përdorura gjatë “Revolucionit Kulturor” kinez. ....Nga burime diplomatike perëndimore flitet se gjeneralët janë shkarkuar në kuadër të asaj që njihet si spastrimi i mundshëm i elementëve prosovjetikë në Forcat e Armatosura Shqiptare.”

Në Ushtrinë Shqiptare ishin figurat më të glorifikuara të shtetit, heronjtë e luftës, njerëz me integritet dhe që gëzonin simpati në masën e gjerë të njerëzve. Aty ishin pjesa më madhe e njerëzve që kishin merituar titullin “Hero i Popullit, titulli më i lartë, pas atij të Heroit Kombëtar. Ushtria konsiderohej trashëgimtare e drejtpërdrejtë e ushtrisë Nacional Çlirimtare dhe kishte mbi vetë edhe lavdinë e saj.

Rrahman Parllaku ishte një ushtarak i shquar e i përgatitur në shkollat e akademitë më të shquara të kohës, kishte një karrierë të shkëlqyer e të merituar. Ai ishte teknikien i shkëlqyer, konservator, besnik i skajshëm i rregulloreve, gjë e cila binte ndesh më “frymën revolucionare” që kërkonte koha e triskave e tallonave, që ashtu si në bukën, vajgurin, mishin, zarzavatet apo çdo gjë tjetër në jetën e vendit po binte edhe në radhët e ushtrisë.

“Heroi i Popullit” Rrahman Parllaku u dënua si pjesëtar i të ashtuquajturit “grup i Beqir Ballukut”. Duke pasur akuzën e

rëndë të “tradhtisë ndaj atdheut”, të ashtuquajturit pjesëtarë të këtij grupi: Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako e Rrahman Parllaku nuk amnistoheshin nga ligjet në fuqi. Gjeneral Parllaku u dënua me 25 vjet heqje lirie pa të drejtën që t’i zbritej asnjë ditë nga vuajtjet e dënimit. Burgu i Burrelit ishte emblema e kësaj procedure përçudnuese që synonte sistemi monist të përdorte për thyerjen e shpirtërave dhe të endrrave të lirisë. Me kushtet më çnjerëzore të fjetjes, ushqimit, punës sfilitesë, mungesave të paimagjinueshme, dhunës fizike dhe torturave shteti i asaj kohe trajtonte armiqtë e “partisë e të pushtetit”. Ky grup i Shtabit të Përgjithshëm, së bashku me ministrat, konsideroheshin si më të rrezikshmit për likuidimin e udhëheqjes së vendit dhe Enver Hoxhës.

Në burgun e Burrelit trupi i Rrahman Parllakut u drobit, por u forcua zemra e tij, shpirti i tij u mërzit, por mbeti e pastër, e kthjellët dhe e qartë mendja e tij.

Edhe gjatë viteve të burgosjes ai tregoi vlera të mëdha si njeri e si drejtues. Rrahman Parllaku ishte simboli i qëndresës dhe i pathyeshmërisë ndaj diktaturës. Ai i dha dorën atyre që e kishin akuzuar pa e menduar se edhe vetë një ditë do të përfundonin në burg, u dha krahun që të mbështeteshin e e të ngriheshin në këmbë, atyre që ishin rrëzuar, u dha bukën e ushqimin e vet të paktë atyre që u mungonte, u dha besim e kurajo të drobiturve nga torturat e dhuna fizike, u dha shpresë e besim te liria zemërthyerve, u dha dritë në mendje për prosperitetin e Shqipërisë atyre që ishin çorientuar, u dha forcë për të duruar vuajtjemëdhenjeve të shumtë që ishin jo të paktë në ato qeli ku dukej se për të gjithë jeta kishte ndaluar. Qëndrimi i tij në këto vite ishte një përzierje e bëmave e veprave të një njeriu, të një shënjtori, të një martiri, të një bashkëvuajtësi. Rrahman Parllaku në këto vite tregoi edhe një herë se, ashtu si në gjithë jetën e tij, ai kishte lindur për të qënë i tillë, një prijës, një udhëheqës, një drejtues, një lider i padiskutueshëm. Ai vuajti në këto burgje 16 vjet e tri muaj, nga dhjetori i vitit 1974 deri më 17 mars të vitit 1991, duke

qenë ndoshta i fundmi i burgosur politik që u lirua në vitin kur sistemi monist në Shqipëri mori tatëpjetën përfundimtare.

Në rekursin e bërë nga Rrahman Parllaku, me 20 korrik 1994, Gjykata e Kasacionit vendosi prishjen e vendimit të 5 nëntorit të vitit 1975 të Gjykatës Ushtarake, që e cilësoi fajtor ushtarakun e lartë dhe pushimin e akuzave ndaj tij, duke realizuar kështu një fitore të madhe personale, por jo vetëm, ndaj diktaturës komuniste.

Sot ai është kryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar. Nuk ka televizion apo gazetë të rëndësishme në vitet e tranzicionit në Shqipëri, që të mos ketë kërkuar ta ketë të ftuar ose bashkëpunëtor Rrahman Parllakun. Televizione, revista, gazeta të shumta e të ndryshme kanë marrë shumë prej tij për të informuar opinionin publik për periudha të rëndësishme të historisë së vendit tonë në përgjithësi e në mënyrë të veçantë me probleme delikate që lidhen me goditjen që i dha Partia e Punës grupit të ashtuquajtur “puçist”. Me një kujtesë të jashtëzakonshme, me një mendjemprehtësi të madhe, Rrahman Parllaku ka bërë analiza brilante të situatave të vështira e delikate që ka kaluar vendi dhe ushtria jonë. E veçanta e gjithë “ligjëratave” të tij në shtypin e kohës ka qënë ajo se Parllaku ka qënë gjithënjë tepër i saktë, konçiz, realist, pa mllafe, pa paragjykime, por mbi të gjitha asnjëherë nuk ka ngatërruar gabimet e udhëheqjes së partisë në momentet e caktuara me arritjet e realizuara dhe në mënyrë konsegunete ka shprehur një dashuri të madhe për njerëzit dhe punën e tyre, për veprat e krijuara në Shqipëri. Ai e ka vlerësuar gjithnjë lart Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, arritjet dhe përpjekjet e popullit jo vetëm në rindërtimin e Shqipërisë së pasluftës, por edhe ato në fushën e arsimimit, shërbimit shëndetësor, zhvillimit në tërësi të vendit, përfshirë edhe arritjet në mbrojtjen e fuqizimin e ushtrisë. Rrahman Parllaku ka mbajtur qëndrim ndaj luftës se klasave që solli eliminimin e elitave intelektuale të vendit, me izolimin e vendit nga bota, me varfërimin e skajshëm të jetës së popullit, me mungesën

e lirive e të drejtave themelore të njeriut si ajo e besimit apo e levizjes, me gjigandomaninë e sistemit që prodhonte vetëm armiq brenda vendit dhe shihte si të tillë çdo gjë jashtë tij, e një shteti që e mendonte veten të aftë të përballonte edhe koalicione të shteteve të NATO-s- e të tjera.

Të gjithë jemi dëshmitarë të asaj që Rrahman Parllaku nuk e shfrytëzoi jetëgjatësinë tij për të treguar vuajtjet e tij personale, por ka treguar vuajtjet e Shqipërisë dhe të shqiptarëve që ato të mos ndodhin e përsëriten më. Rrahman Parllaku nuk ka pranuar të japë mendime apo gjykime për të kaluarën nëpërmjet përdorimit të emrave të përveçëm lidhur me ngjarje të caktuara, por është mbeshtetur në analizimin e fakteve dhe tendencave të sistemit totalitar në përgjithësi e atij në vendin tonë në veçanti.

Gjeneral Parllakun e kam njohur në vitet e luftës dhe në vitet e punës në Ministrinë e Mbrojtjes, por edhe më shumë në vitet e bashkëpunimit si kryetar e sekretar i Organizatës së Bashkuar Veteranëve të Luftës të Shqipërisë, ku ai ka rrezatuar si gjithnjë dashuri e respekt për të kaluarën e lavdishme të popullit tonë dhe ka gëzuar për prosperitetin e tij në të ardhmen.

Jetë të gjatë e të shëndetëshme Heroit të Popullit, Gjeneral Lejtnant Rrahman Parllaku.

*Me respekt e nderim Edip Inajet Ohri*

## **Parllaku, njëri prej drejtuesve kryesorë të luftës në qytetin e Vlorës**

*Nga Gjeneral HALIM RAMOHITO*

Mund të jetë rastësi, por unë dhe “Heroi i Popullit” Gjeneral Rrahman Parllaku kemi patur të njëjtin fat, ideal e pasoja. Për shumë kohë kemi qenë në të njëjtën llogore e në vijë të parë të luftës e të punës, kemi patur të njëjtat gëzime e hidhërimet, dhe kemi provuar e përjetuar pranga, burgje, drama e tragjedi të panumërta.

Ishte dita e madhe e 28 Nëntorit 1942 kur u takuam për herë të parë në Sheshin e “Flamurit”, ai zanatçi i thjeshtë, kurse unë një nxënës i “Shkollës Tregtare” të Vlorës. Atë ditë zhvillohej një nga demonstratat e para dhe nga më të mëdhatë e asaj periudhe të lavdishme. Ajo u organizua e u udhëhoq nga bijtë e bijat e qytetit tonë përpara burgut ku ndodheshin me dhjetra luftëtarë lirë. Aty, unë e Rrahmani me shokë e shoqe lidhëm besën se do të qëndrojmë kurdoherë së bashku me rininë e popullin e Vlorës dhe të gjithë Shqipërisë. Atje ku Ismail Qemali ngrii Flamurin e Pavarësisë, ne u betuam se do të rrëmbenim armët dhe do të luftonim si të parët tanë kundër pushtuesve të të gjitha ngjyrave.

Ndodhi që të jemi së bashku edhe në vitin 1942-1943 në njësitin guerril të qytetit të Vlorës, e pak më pas u rreshtuam më 1944 në Br. V-të S, madje në të njëjtin batalion. Po së bashku luftuam për çlirimin e Kosovës, e përsëri në të njëjtin divizion.

Ky fat na ndoqi edhe pas çlirimit. Ne të dy kemi punuar disa dhjetëvjeçarë për organizimin dhe forcimin e Ushtrisë Popullore për të ruajtur kufijtë shtetëror të vendit nga shovinistët fqinjë e lakmitarët e tokës arbërore. Hallet e

jetës e prunë Rrahmanin bashkë me të vëllanë Selimin prej fshatit të largët të Novosejës në Qarkun e Vlorës. Po biri i Lumës kreshnike, që në çdo vit bënte nga një luftë me krajlët e Serbisë, erdhi në qytetin tonë me frymëzime atdhetare të mëkuara e fituara nga parardhësit e asaj treve legjendare. Ai, që në çastin e parë që u takua me antifashistët, u bashkua pazgjidhshmërisht me ta. Dyqani i tyre në rrugën e spitalit të Vlorës, sa për sy e faqe apo për t'u maskuar mbante emrin "Ëmbëltore" se në të vërtetë ishte kthyer në qendër antifashiste. Aty takoheshin drejtuesit e lëvizjes antifashiste ku hartonin plane për realizimin e aksioneve të radhës. Më kujtohet kur me vëllain e Rrahmanit, atdhetarin trim Selimin takoheshim shpesh rrugicave të qytetit. Ai, përmes patrullave fashiste, ecte duke mbajtur në kokë tavën me ëmbëlsira, të mbështjella me komunikatat e luftës nga ku merrnim edhe udhëzime e njoftime mjaft të rendësishme.

Godinën e "Shkollës së Mesme Tregtare" të Vlorës, pushtuesit duke parë se ajo po kthehej në një çerdhe antifashiste e shpërngulën nga Uji i Ftohtë në periferi të qytetit. Nga 500 nxënës të kësaj shkolle, pjesa dërrmose ishin vlonjatë. Por për hir të së vërtetës ata së bashku ndezën atë zjarr antifashist që, pavarësisht nga masat drastike që merreshin kundër tyre nuk u shua kurrë. Më kujtohet kjo ndodhi. Një mëngjes, në oborrin e shkollës tonë dhe pothuaj në të gjitha klasat, shohim një mori fletushkash të shpërndara natën nga kundërshtarët tanë politik. Nga ata të cilët vepronin pa asnjë pengesë edhe ditën më drekë të mbrojtur nga bajonetat fashiste. Në ato fletushka, përveç të tjerave shkruhej: "Ju qytetarë të Vlorës mund të pyesni se kush i drejton komunistët këtu në Vlorë? Po ua tregojmë ne. Ata i drejton një hallvaxhi i ardhur që nga Luma e largët. Dhe ky quhet Rrahman Parllaku".

Dhe kjo është e vërtetë. Rrahmani ishte njëri prej drejtuesve kryesor të luftës në qytetin e Vlorës. Ai udhëhiqte bashkërisht me bijtë e këtij qyteti dhe të krahinave të tjera të vendit. Qyteti ynë si në të gjitha kohët, edhe gjatë viteve të LANÇ-it qëndronte larg çdo fryme lokalizmi. Ai i donte, i dëgjonte, i



nderonte dhe i mbronte trimat pa asnjë dallim. Tek ai ishte rrënjosur me kohë sentenca e Vaso Pashës: “Feja e shqiptarit është shqiptaria”.

Për këto merita si pjesëtar dhe përgjegjës i njësitit guerril, si komisar i reparteve partizane, populli i Vlorës dhe shokët e armëve Rrahmanin e pagëzuan me pseudonimin “Krajli” (Mbreti). Ndoshta ideja e këtij emri lindi nga fakti se në Lumë këndohet kënga:

*“Bijtë e Lumës hiç s’kanë dert,  
Nga një luftë bëjnë për çdo vjet,  
Luftë me krajl e luftë me mbret.”*

Fjalët e melodia e këtyre këngëve epike, përhapeshin me shpejtësi rrufeje tejmbanë trojeve tona. Në to ka betim e përgjërimit për të mbrojtur atdheun e lirinë e tij prej moshës 8 deri në 80 vjeç, me çfarëdo lloj çmimi.

E mbaj mend Rrahmanin në atë periudhë, me trup të gjatë, të stralltë e të bukur. Madje, edhe tani në moshën e tretë i ruan shumë nga ato tipare rinore.

Populli i krahinës tonë i ka dashur, i ka nderuar e admiruar në shekuj trimat, pavarësisht nga cilat troje janë. Ai i kujton e respekton si shenjtorë dhe shpreh ndaj tyre mirënjohje të pafundme.

Historia e botës, por edhe e kombit tonë vërteton se edhe një luftë guerrile (partizane) nuk mund të fillojë e aq më pak të fitojë pa mbështetjen e popullit.

Mbështetja masive që i dha populli heroik i Vlorës LANÇ-it, si i gjithë Shqipërisë është e dokumentuar. Po citoj dy dokumenta të arkivave të huaja. Në vitin 1942, udhëheqja e Partisë Fashiste për Vlorën i shkruan asaj të Tiranës se: “Në qytetin e Vlorës ka shumë baza ilegale, por tashti po konstatojmë edhe faktin tjetër se nuk kemi të bëjmë me baza të veçuara ilegale, por me guerrile të organizuara mirë”. Kurse komanda e garnizonit gjerman në Vlorë i raporton më 16 Tetor 1943 komandës së korpusit të XXI-të në Tiranë se: “Komunistët në qytetin e Vlorës (lexo Fronti ANÇ, - Halim Ramohito), përkrahen nga mbi 70 % e popullatës dhe jo vetëm kaq, por

ata përgatiten që edhe me anën e një kryengritjeje të armatosur të pushtojnë edhe qytetin”.

Siç dihet, historia shekullore e kombit tonë, përfshi atë të LANÇ-it, që është pjesë e kësaj historie, me fitoren e saj e radhiti edhe vendin tonë në krah koalicionit të madh antifashist të Luftës së Dytë Botërore. Kjo histori na ka mësuar edhe ne shqiptarëve se ekzistenca dhe fitoret e kombit janë arritur para së gjithash me bashkimin tonë “pa dallim krahine, feje dhe ideje”, mësimë këto që janë e do të mbeten kurdoherë aktuale.

Për këtë liri dhe bashkim luftoi edhe Rrahman Parllaku bashkë me vlonjatët, si dhe ata të krahinave të tjera në të gjithë vendin, madje edhe me ata të trojeve tona etnike. Për këtë ideal dhe bashkim u pushkatuan të lidhur dorë për dorë në një nga sheshet kryesore të qytetit të Vlorës prej gestapos naziste: kosovari gjakovar Sheh Zenel Prushi dhe vlonjatja “Heroina e Popullit”, Qeriba Derri, në një nga ditët e marsit të 1944, si dhe kosovari Jonuz Rexhep Peja e vlonjati Elham Doçi. Të dy ishin pjesëtarë të njësitit guerril, i cili komandohej nga Rrahman Parllaku. Për këtë bashkim për liri dhe demokraci u vranë 19 lumjanë dhe 39 kosovarë së bashku me 180 lebër nga Vlora. Ata ranë bashkë në një llogore në luftë kundër pushtuesve e bashkëpunëtorëve të tyre deri në Sanxhak e Bosnje.

Ndërsa përsa i përket rrethimit dhe daljes nga fshati Salari gjatë Operacionit të Dimrit në shkurt 1944, luftimet drejtoheshin nga Rrahman Parllaku, Sali Ormeni, Reiz Malile e Hetem Gjinushi. Ato kanë qenë nga më të vështirat për forcat partizane. Aty një ndihmë të madhe për të shpëtuar jetën e luftëtarëve të lirisë dhanë barinjte e fshatrave Dhëmban e të Matohasanajve të Tepelenës. Ata i ushqyen, i mjekuan dhe i ndihmuan për të dalë në prapavijat e armikut.

Ne, bijtë e Vlorës, si të gjithë Shqipërisë, të jemi mirënjohës se ke qenë në ballë të stuhisë. Vlorës me këtë libër lapidar i ke ngritur një monument të merituar, por mjaft të ndritur. Emri yt në këtë qytet, një yll mes yjeve do të jetë.

## Gjenerali i kujtesës fenomenale

Nga Prof. Dr. MUHARREM DEZHGIU

“Heroi i Popullit”, Rrahman Parllaku, është një ndër kuadrot e njohura të qëndresës shqiptare kundër fashizmit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Pozicionimi antifashist i Rrahman Parllakut që në çastet e para të pushtimit të vendit dhe deri në fund të luftës, i ka dhënë mundësi të përjetojë dhe të sjellë para nesh përjetimet e tij për luftën, për shokët e bashkëluftëtarët e tij të shumtë. Personazhet e tregimit të tij ndodhen pothuajse në të gjithë Shqipërinë.

Duke qenë nga krahina e Lumës e duke jetuar në Vlorë, në mënyrë të natyrshme, ngjarjet që kujton Rrahman Parllaku janë të frymëzuara nga tradita e atdhetarëve të Luftës së Vlorës, ashtu edhe nga luftëtarët e krahinës së Lumës, kundër masakrave serbo-sllave që kryen në vendlindjen e tij.

Rrahman Parllakun do ta gjejmë që në protestat e para antifashiste në demonstratën e 28 Nëntorit 1941, ku siç thotë vetë, jeta e tij mori një rrjedhë të re.

Bashkë me rritjen e organizimit dhe të veprimtarisë luftarake kundër pushtuesit, rritet dhe roli i veprimtarisë së luftëtarit Rrahman Parllaku. Vetëdijësimi dhe sedra për t’i bërë punët dhe detyrat sa më të përsosura e karakterizojnë atë gjatë gjithë jetës.

Duke jetuar ngjarjet e luftës, ai i ka kyçur në kujtesën e tij fenomenale, ashtu siç kanë qenë reale e të padeformuara. Kështu, ai pohon me plot gojën pjesëmarrjen e nacionalistëve

me në krye Hysni Lepenicën në luftën e Gjormit, në janar të vitit 1943. Nga ana tjetër, nuk ka se si të mos mburret e të jetë krenar për rolin e tij si antifashist i vendosur në vrasjen e kreut të SIM-it për Vlorën, marshallin e karabinierisë, Lombardon.

Në raste të tjera, Rahman Parllaku ka kurajon të akuzojë ashpër vijën e veprimet sektare të Partisë Komuniste për vrasje të njerëzve të pafajshëm, siç ishte rasti i vrasjes së Ramize Gjebresë. "Akuzat ndaj saj, - thotë ai, - ishin të turpshme e të dhimbshme. Atë vendim makabër s'ka lumë e det që mund ta lajë". Vrasjen e Ramize Gjebresë, ai e sheh në vazhdimësinë e qëndrimeve e veprimeve ekstremiste që kishte mbajtur udhëheqja e Partisë Komuniste në Qarkun e Vlorës.

Rahman Parllaku denoncon fuqishëm vrasjet pas shpine që u bëheshin shokëve partizanë vetëm për dyshime të pabazuara.

Për fat të keq, historia e luftës ka shumë viktima të tilla të vrarë si armiq, të paverifikuara, por vetëm të papëlqyer nga njëri ose tjetri, për ambicie personale.

Me përkushtim të thellë, autori i këtyre kujtimeve u shpreh nderimin dhe respektin gjithë atyre familjeve të Vlorës që u bënë strehë e baza të luftëtarëve ilegalë. Mirënjohja që shpreh Rahman Parllaku ndaj këtyre njerëzve e ka bazën tek risku i madh që merrnin përsipër, duke kryer vepra të tilla të guximshme. Ndaj me respekt, autori gjen rastin të përulet me mirënjohje ndaj nënave vlonjate, të cilat ai i konsideronte si nëna të dyta të tij. Të tilla ishin të shumta. Dhe ja sepse ai e konsideron lagjen "Muradie" si lagja e bazave të luftës.

Rahman Parllaku me kujtesën e tij të freskët ka "regjistruar" me imtësi e saktësi me dhjetëra personazhe në lagjet e Vlorës, që i mbështetën me të gjitha mënyrat luftëtarët e lirisë. Mirënjohja që ai shpreh ndaj tyre është e pakufishme, është e pashlyeshme. "Çfarëdo të bëjmë ne ndaj tyre, - pohon ai, - ne nuk mund të shpaguehemi". Sidoqoftë, edhe duke i kujtuar më tepër se gjashtë dekadash emrat e këtyre njerëzve të thjeshtë atdhedashës, autori u bën homazh bashkëluftëtarëve të tij.

Nëpërmjet episodesh të shumta, autori lartëson shpirtin e sakrificës së shokëve të tij të idealit, për të përballuar vuajtjet dhe vështirësitë e kohës. Në të njëjtin kontekst ka spikatur në rrëfimet e tij solidariteti partizan për të ndihmuar njëri-tjetrin në kapërcimin e situatave të ndërlikuara. Sa është i ndjeshëm në përshkrimin e këtyre episodeve të vështirësive objektive të luftës, po kaq kritik tregohet autori kur pohon të metat e organizimit e të zhvillimit të luftimeve nga kuadrot drejtuese. "Një nga të metat tona, - thotë ai, - që nuk u riparua gjatë gjithë luftës, ishte se ne nuk punuam për të përgatitur pozicione, qoftë edhe për vete, përveç ndonjë guri a ledhi të gatshëm dhe kjo na kushtoi shumë jetë njerëzish" (fq.140 e librit "Mirënjohje familjeve vlonjate). Duke bërë pohime të tilla realiste, veterani pozicionohet në mënyrë kritike ndaj qëndrimeve moderniste të disa historianëve, të cilët e paraqesin ushtrinë partizane të organizuar në bazë të koncepteve të sotme moderne. Për rrjedhojë janë modernizuar dhe mënyrat e format e luftimeve, të cilat çonin kurdoherë në fitore.

Rrahman Parllaku me kujtimet që na sjell në duart tona, ka shlyer një detyrim qytetar të rëndësishëm për t'u lënë brezave një pjesë të përvojës së tij të jetuar në vitet e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

## Gega që u bë më i shquari në mes të toskëve

*Nga SHPEND TOPOLLAJ*

Për trimëritë dhe karakterin burrëror të Gjeneralit legjendar Rrahman Parllaku, kam dëgjuar që kur isha i vogël nga prindërit e mi. Im atë kishte qenë vetë luftëtar i orëve të para dhe kuadër drejtues gjatë luftës, kurse pas çlirimit të vendit kishte shërbyer për një kohë të gjatë si oficer në ushtri, prandaj kishte se çfarë të tregonte për të. Ndërsa nëna ime Hatiqe Agalliu, duke qenë bijë e një familjeje të njohur vlonjate që kishte kontribute të mëdha në përpjekjet për mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë së vendit, e kishte njohur atë shumë herët, qysh kur i thërritnin “gega dhe hallvaxhiu”, nga që ishte nga veriu dhe kishte një dyqan ëmbëlsirash në këtë qytet. Për më tepër, ajo së bashku me nënën e saj të mrekullueshme, gjyshen time Medijen, i kishin shpëtuar jetën gjatë një rrethimi që pushtuesit dhe bashkëpunëtorët e tij u kishin bërë disa ilegalëve në lagjen “Muradie”. Këtë e thotë shumë mirë vetë Rrahmani në librin e tij “Mirënjohje familjeve vlonjate që më mbajtën si birin e tyre”.

Në vitin 1967 dola oficer i ri dhe u emërova në Flotën Luftarake Detare të Durrësit dhe aty u njoha e u takova për hetë të parë me Komisararin e Forcave Detare Rrahman Parllaku. Komandant i kësaj force ishte shoku i tij i luftës dhe i ushtrisë, gjenerali tjetër, (ndonëse ishin hequr gradat), Vaskë Gjino.

Në një analizë në shtëpinë e pushimit të ushtarakëve në Durrës, kur po flitej për të ashtuquajturat masat

revolucionarizuese si heqja e gradave, rivendosja e komisarëve politikë, etj., të gjithë diskutantët, sidomos komisarët e reparteve vartëse hiqeshin sikur u kishte pëlqyer heqja e gradave. Unë, ashtu impulsiv siç isha në atë kohë, në kulmin e moshës së rinisë, u ngrita dhe thashë se këta nuk po thonë të vërtetën. Një nga presidiumi m'u drejtua: "Sipas teje gënjejnë komisarët? - Po, po gënjejnë, kështu nuk kemi përse të vazhdojmë analizën", -folta unë në diskutim e sipër.

Pati një mërmëritje të madhe, një pakënaqësi nga presidiumi dhe nga disa eprorë të mi. Një shok më kapi nga cepi i xhaketës dhe ma bëri me shenjë që të ulesha. Thosha me vete se ç'mu desh mua ky diskutim që ngjalli kaq polemika dhe inate nga eprorët.

Në pushim po më afrohej Komisar Rrahmani dhe Komandant Vaska. Ma bënë me shenjë që të afrohesha. U paraqita ushtarakisht. Rrahmani më futi krahun dhe më tha: "Eja, mor biri i Hulësiut, more kokëkrisur Kolonje se nuk gënjejnë të gjithë komisarët." . Vazhduam shëtitjen, ata të dy dhe unë "rebeli" në mes. Disa eprorë që më kishin parë me inat filluan të buzëqeshin. Kishte shkrirë akulli. Rrahmani vazhdoi: "Ne kështu i duam kuadrot që ta thonë me kurajo mendimin e tyre". Kjo thjeshtësi e bënte Rrahman Parllakun edhe më madhështor.

I bindur tek mbështetja dhe forca e tij, një ditë shkova ta takoj në Tiranë, në zyrë, për t'i kërkuar që të më jepej e drejta e studimit për në universitet pa shkëputje nga puna.

Zëvendësi i Rrahmanit, Mehdi Ramohito, më çoi tek Rrahmani dhe ia bëri të qartë kërkesën time. Parllaku u shpreh: "Ushtria ka nevojë për njerëz të shkolluar dhe me kulturë. Vetëm kështu ajo do të forcohet dhe modernizohet. Do të të dërgojmë në universitet. Ti, Mehdi, merru me këtë punë."

Pastaj m'u drejtua mua: "Ta kesh gjithmonë në shpirt ushtrinë, për të cilën babai yt me shokë luftuan dhe punuan!".

E falenderova me gjithë zemër atë burrë të pashëm, atë kreshnik malesh. Të gjithë e njihnin dhe e vlerësonin

zemërgjerësinë e tij. Dëshira për të përkrahur të tjerët ishte veti e tij e lindur. Ai ishte njohës i vërtetë i traditës, i artit ushtarak dhe luftëtar për të renë. Fliste shqipe të pastër dhe i qetë, i sigurt dhe me logjikë artikulonte mendimin.

Pas viteve '90 u takuam rastësisht në një veprimtari ndërkombëtare. Ai më puthi dhe më përqafoi. Nuk më kishte harruar. Me shaka më tha: "Ore, e paske patur mirë ti për ne komisarët.". Dhe qeshi me gjithë shpirt. Ishte po ai, gjenerali me zemër të madhe dhe me mendje të ndritur. I ekuilibruar, i urtë, i mençur, gjakftohtë, që me fjalën e tij kudo mbolli dashuri dhe bashkim.



## Ushtaraku që njihete çdo hallkë të ushtrisë

*Nga Kol. Dr. NOVRUZ ZEJNATI*

Figura e Gjeneral Rrahman Parllakut ka qenë dhe mbetet një nga më të ndriturat e LANÇ-it, të cilat i japin nder kombit tonë. Ai figuron i pari gjeneral nga rrethi verior i Kukësit në historinë e deritanishme të Forcave të Armatosuara Shqiptare.

Për punën, luftën dhe kapacitetet e tij organizativo-drejtuuese është dekoruar me 12 urdhëra dhe 4 medalje, ndër to edhe urdhëri më i lartë i “Heroit të Popullit”, medalja “Zhukov” e Presidentit rus Jeltzin, për kontributin e tij në Luftën e II Botërore.

Biri dhe gjenerali i Kukësit është zgjedhur deputet në 7 legjislatura të Kuvendit Popullor, duke përfaqësuar me dinjitet popullin e Lumës, Kukësit dhe të gjithë Shqipërisë.

Pikëpamjet e tij, ashtu sikurse e pjesës më të madhe të gjeneralëve të arsimuar e të përgatitur, me përvojën e drejtimit edhe në Luftën Nacionalçlirimtare, binin ndesh me vijën e PPSH-së dhe të Enver Hoxhës për të luftuar të vetëm kundër dy aleancave ushtarake të botës, Traktatit të Varshavës, nga i cili u larguam pas prishjes me sovjetikët dhe NATOs.

U gjet rruga e dënimit të të ashtuquajturit grupit puçist, Ballukut, Dumes, Çakos dhe Parllakut, mënyra më e mirë për diktaturën dhe diktatorin për të siguruar jetëgjatësi në luftën për pushtet.

Kështu, Gjen. Rrahman Parllaku u dënua 25 vjet burg, nga ku vuajti nga dhjetori 1974 deri në vitin 1991.

Burri i malësisë, patrioti, gjithmonë i thirrur me respekt gjeneral, përqafoi zhvillimet demokratike dhe u vu në krye të Organizatës së Bashkuar të Veteanëve të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar, ku përkrahu shtetin ligjor, orientimin e ushtrisë drejt NATO-s dhe mbështeti fuqishëm deri edhe fizikisht duke shkuar në Kosovën luftën e drejtë të UÇK-së dhe çlirimin e Kosovës, me të cilën ka lidhje tradicionale dhe historike.

Gjeneral Rrahman Parllaku çmohet si gjenerali me kontribut madhor në historiografinë ushtarake shqiptare.

Ai ka bashkëpunuar me ushtarakët anglezë në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare dhe duke e renditur Shqipërinë me fitimtarët, ka përfaqësuar Shqipërinë dhe ka luftuar kundër aneksimit të ushtrisë dhe shtetit shqiptar nga Jugosllavia, ka përfaqësuar Shqipërinë dhe ka luftuar për mbrojtjen e bazave detare nga ushtarakët sovjetikë pas prishjes me to, ka mbështetur veprimtaritë për pranimin e Shqipërisë në NATO.

Mbi të gjitha, Rrahman Parllaku ka dhënë një kontribut madhor politik dhe ushtarak për mbrojtjen e trojeve tona kombëtare.

# Personalitet me përmasa shumëdimensionale që u ndrit brezave, kohërave dhe historisë

*(Në 95-vjetorin e ditëlindjes së “Heroit të Popullit”,  
Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllaku)*

*Nga Emin ZYBERI\**

Është detyrim moral dhe human, përgjegjësi e madhe qytetare dhe njerëzore, të flasësh apo të shkruash për “Heroin e Popullit”, z. Rrahman Parllaku.

Janë të pamjaftueshme superlativat më të mira për këtë bir të Novosejës së Krahinës të Lumës, të Lumës kreshnike, me vlera të mëdha historike dhe virtyte të larta atdhetare e patriotike.

Luma e Kuqe, e kuqe nga gjaku i derdhur i të rënëve në luftë për mbrojtjen e Atdheut, ka nxjerrë gjithmonë ndër vite figura të shquara patriotike si: Seit Gega, Ejup Topojani, Islam Spahiu, Ramadan Zaskoci, Jemin Alia, etj.

Në plejadën e luftëtarëve për liri e çlirim kombëtar kundër fashistëve dhe nazistëve italo-gjermanë, në kujtesën historike të brezave një vend të veçantë zë z.Rrahman Parllaku.

Në trevën e Lumës, fisi “Parllaku” i Novosejës është i njohur si një fis me gen trimërie, bujarie e fisnikërie. I pari i këtij fisi, i njohur me emrin Ali, një burrë shumë i hijshëm, ka qenë luftëtar e prijës i revoltave të popullit kundër turqëve. Për trazirat e shkaktuara, Sulltani e kërkonte me mbiemrin “Parllak” që në turqisht do të thotë “i ndritshëm”. Aliu u kap, iu pre koka me ferman të Sulltanit dhe në nderim të tij i tërë fisi mori mbiemrin “Parllaku” .

Në këtë mjedis atdhetar e patriotik brez pas brezi u lind dhe u rrit "Heroi i Popullit".

Edukimin dhe mësimet e para i mori në vendlindje, në odat e malësorëve lumjanë ku flitej e këndohej për bëmat e luftëtarëve të rënë në Prekuple, Nish, Kaçanik, Duhël, Carralevë, Shtimje, Koritnik, Glloboçicë, Kullë e Lumës, Kolesian. etj.

Për të përballuar jetesën dhe për të fituar bukën e gojës, si shumë bashkëkrahinarë të tjerë, Rrahmani, në moshë të njomë, së bashku me vëllain e tij Selimin morën rrugën e kurbetit. Në fillimet e viteve '30-të, ata u vendosën fillimisht në Mallakastër dhe më pas në Vlorën e Ismail Qemalit, në Vlorën e 1920-ës, e cila si Luma e 1912-ës kishin shkruar epopetë më të lavdishme të kombit shqiptar. Me të drejtë, duke sjell fakte e argumente bindëse, historianë e studiues vendas e të huaj, betejat e këtyre dy krahinave i kanë krahasuar me betejën e Termopileve.

Biri i Lumës kreshnike, kontaktet fillestare i pati me antifashistët e parë të rinisë vlonjate, me të cilët u lidh përjetësisht.

Virtytet e tij njerëzore si çiltërsia, sinqeriteti, trimëria dhe besnikëria, bënë që të fitojë zemrat e lebërve, toskëve, gegëve, duke u afirmuar si luftëtar antifashist dhe si drejtues e komandant besnik i formacioneve luftarake; njësiteve guerrile, çetave partizane, batalioneve, brigadave e divizioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Po sjell në vëmendjen e lexuesve disa episode:

Kanë kaluar mbi 50 vjet që nga kontakti i parë me gjeneralin. Më kujtohet si sot vizita e tij në familjen time, në fshatin Brekijë të Kukësit. Imazhet dhe impresionet e para ishin shumë mbresëlënëse kur në oborrin e shtëpisë time pashë një burrë me trup të gjatë, veshur me uniformën e gjeneralit që i shkonte mjaft bukur. Pasi u përshëndet me gjyshen time dhe me pjesëtarët e tjerë, u ul në një fron të ulët prej dërrase dhe filloi të bisedonte shtruar.

Asokohe, me kureshtjen e një fëmije, po e dëgjoja dhe e vështroja me shumë kujdes dhe më bëri përshtypje të veçantë,

se Zoti i madh, krahas bukurisë fizike, i kishte dhuruar pa kursim dhe bukurinë shpirtërore. Me kujtohet fytyra e tij e qeshur, zëri i tij i ëmbël, një njeri i dashur që fliste me nostalgji për figurën e patriotit të krahinës, Jemin Alia, si dhe pyeste dhe interesohej sesi po përballonim vështirësitë e jetës së përditshme.

Ndodh shpesh që postet, gradat apo ofiqet e ndryshme, e tjetërsojnë karakterin dhe psikologjinë e njeriut, madje duke e bërë arrogant, mendjemadh dhe mospërfillës. Dukuri e shfaqje të tilla ishin krejtësisht të huaja për këtë personalitet, i cili gjithmonë gjeneroi e gjeneron mirësi, tolerancë, respekt njerëzor dhe humanizëm.

Në kontaktet që kisha me të, vija re një cilësi të veçantë të karakterit të tij: thjeshtësinë.

Një herë, miku im kleriku Kadri Shehu nga fshati Nangë, i cilësuar kulak ekonomik dhe politik nga shteti monist, kishte udhëtuar në këmbë me orë të tëra për në Topojan të Kukësit, për të takuar deputetin e zonës, Rrahman Parllakun, i cili po zhvillonte një takim me zgjedhësit. Pas mbarimit të mbledhjes, deputeti e dëgjoi me vëmendje klerikun për padrejtësinë që i ishte bërë, i dha të drejtë dhe mori përsipër për ta biseduar me drejtuesit e rrethit.

Në ndarje, "hallexhiu", tepër i emocionuar dhe me sy të përlotur m'u drejtua mua që isha i pranishëm në takim: "Dëgjo, more bir, edhe sikur të mos më zgjidhet problemi, jam i lumtur se takova Njeriun e Allahut". Duhej të kishe kurajo njerëzore, dinjitetin dhe shpirtin humanist të një lumjani dhe shqiptari të mirë, që të veproje siç vepronte gjenerali.

Mirënjohje dhe respekt në jetë të jetëve për Gjeneralin, në emër të atyre njerëzve hallexhinj e në nevojë, të cilëve jeta dhe sistemi u ka shkaktuar shumë dhimbje e vuajtje.

Në fund të viteve '60-të, isha student dhe kisha shkuar për vizitë tek prindërit e Rrahmanit, të cilët banonin në Tiranë.

Babai i tij, Latifi, rridhte nga një familje e madhe dhe e kamur. Ishte një burrë i zgjuar dhe me kulturë. Kishte studiuar

në një shkollë fetare dhe zotëronte 3 gjuhë të huaja: turqisht, serbo-kroatisht dhe greqisht.

Nëna e tij, Kadimeja, ishte një grua zonjë, mjaft e urtë dhe dinjitoze, mund të them pa e tepruar me cilësitë e një shenjtozeje.

Asokohe, partia dhe shteti ishin ngritur në këmbë, duke bërë një luftë të madhe kundër besimeve fetare për një Shqipëri ateiste. Kohë absurditetesh...

Pas meje, erdhi zoti Rrahman për të takuar prindërit e tij, pasi do të nisej me një shërbim jashtë Tirane. Prindërit e tij, si besimtarë që ishin, po kryenin ritualin e faljes në dhomën e tyre. Më bëri përshtypje që megjithëse ai nuk kishte kohë, priti derisa ata mbaruan ritualin, u përshëndet me ata dhe u largua.

Që nga ajo kohë, kanë kaluar dekada, por duke u kthyer prapa në vite, kujtoj se organet e medias, gazetat, radiot përcillnin çdo ditë lajme e mesazhe për prishjen e rrafshimin e objekteve të kultit, të kishave, xhamive dhe monumenteve të kulturës fetare. Gjatë kohës që Rrahmani po priste për t'u takuar me prindërit e tij, mendoja me vete se do te debatonte me ta për çështjen e besimit fetar, por një gjë e tillë nuk ndodhi. Ai i nderonte në mënyrë të veçantë, me një respekt ndaj tyre deri në adhurim.

"Kostumi i tij politik" apo statura e tij prej shtetari kishin një prerje krejtësisht tjetër në dallim nga zbatuesit e tjerë fanatikë, sharlatanë e megallomanë, zëdhënës të urdhërave të partisë-shtet.

Paranoja e diktatorit Hoxha nga mesi i viteve '70 mori kosën e vdekjes ndaj ushtarakëve të lartë, duke e dënuar gjeneralin me 25 vjet burg. Ndonëse provoi "ferrin e të gjallëve", ndonëse provoi pranga, drama e tragjedi të pamërituara, në saj të karakterit të tij të fortë dhe të ndërgjegjjes së pastër, nuk vdiq shpirtërisht dhe është fat që e kemi midis nesh.

Më kujtohet mirë se dhe gjatë kohës që bëhej një propagandë e shfrenuar kundër të ashtuquajturit "grup puçist", njerëzit për të shprehurin keqardhje dhe konsiderata, kuptohet nën zë.

Sentenca ishte e qartë: kush i nderon njerëzit, nderohet edhe nga ata; kush i përbuz, sado i madh që të jetë, nuk shpëton pa u përbuzur.

Gjenerali, ndonëse në moshë tepër të thyer, është i pranishëm në çdo aktivitet me karakter kulturor e patriotik, me prirje gjithmonë nga e mira, i ndarë me të shkuarën e hidhur, mirënjohës ndaj demokracisë, me një kujtesë brilante dhe gjykim të shëndoshë e racional, për të cilat duhet patur zili.

Çdo bashkëbiseduesi me të i bën përshtypje urtësia, thellësia në gjykimin e ngjarjeve, të figurave historike si dhe ekuilibri i kujdesshëm i tij, duke mbajtur një qëndrim kritik ndaj falsifikimit apo politizimit të tejskajshëm, hiperbolizimit të ndonjë figure historike ose lënies në harresë të ndonjë tjetri.

Një jetë të tërë, ai luftoi e punoi me ndershmëri. I fortë dhe vital vjen edhe në këtë 95-vjetor, pasi për të nuk ka mplakje kurrë. Kështu e paçim gjithmonë këtë simbol të njeriut të pamposhtur në jetë!

Jeta e tij ka qenë sa e bukur dhe e vështirë. Lum si ai që me veprën e tij do të mbetet brez pas brezi i paharruar, i nderuar dhe i fisnikëruar.

Personalitete të tilla, njeriu rrallë takon në jetë. Ne bashkëkrahinarët e tij ndjehemi krenarë për jetën dhe veprën e tij, për kontributin e dhënë në shërbim të shoqërisë, të atdheut dhe të kombit.

Në këtë 95-vjetor të ditëlindjes së tij i uroj nga zemra jetë sa më të gjatë!

*\* I afërm i familjes, bashkëkrahinar*

*Tiranë, më 25.03.2014*

# I vetmi hero i gjallë i Luftës Antifashiste

*Nga* **LIRI BELISHOVA**

Nëntëdhjetë e pesë vjet është një kuotë shumë e lartë. Gjeneral Rahman Parllaku ka meritën se e ka rritur këtë kuotë të lartë, megjithëse i është dashur të përballojë shumë furtuna gjatë jetës dhe ç'është më kryesorja e ka arritur jo i drobitur, por në formë të shkëlqyer fizike dhe mendore, një formë që do ta kishin zili edhe të rinjtë. Edhe shumë vite të tjera, kështu siç je, vital dhe aktiv!

Ju faleminderit të gjithëve, ju që e nderoni Gjeneral Rahman Parllakun, që nga Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar, në krye të së cilës drejton ai, Organizata e Veteranëve të Luftës së Kosovës dhe të gjithë ju të pranishëm që njihni dhe vlerësoni jetën dhe veprën e këtij njeriu sa të thjeshtë, aq edhe madhështor.

Duke nderuar Gjeneral Parllakun, ju nderoni të gjithë brezin që bëri Luftën Antifashiste dhe dërgoni një mesazh të rëndësishëm dhe të qartë, mesazhin se shteti demokratik vlerëson luftën e drejtë të rinisë dhe të popullit shqiptar kundër pushtuesve nazifashistë gjatë Luftës së II-të Botërore, luftë që shprehte një kontribut shumë të madh në raport me popullsinë në Aleancën Antifashiste, që e renditi vendin tonë në krahun e fitimtarëve.



Sot, ne kemi përpara një hero të gjallë, një komandant divizioni të kësaj lufte, Komandantin e Divizionit të V Sulmues që luftoi edhe për çlirimin e Kosovës dhe të viseve shqiptare në ish-Jugosllavi.

Sot kemi përpara një gjeneral që u ndesh me gjeneralët e Traktatit të Varshavës për mbrojtjen e Shqipërisë dhe të bazës detare të Pashalimanit.

Sot kemi përpara një gjeneral, që ndonëse në moshë të thyer, shkoi në Kosovë në mbështetje të UÇK-së dhe të veprimeve të NATO-s në Kosovë.

Ja pra, ky është Gjeneral Rrahman Parllaku, Kryetari ynë i OBVL-së, Organizatës së Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste të Popullit Shqiptar.

Gjeneral Parllaku është dekoruar edhe nga Presidenti rus Boris Jelstin për kontributin e tij në Luftën e II Botërore, kontribut që Enver Hoxha dhe regjimi i tij ia mohoi dhe ia shpërbleu me dënim 25 vjet burg. Ky regjim diktatorial dënoi të gjitha figurat kryesore të Luftës Antifashiste, duke i shpallur armiq të diktaturës së proletariatit nga frika e humbjes së pushtetit.

Kjo ka qenë dhe është arsyeja që Rrahman Parllaku militon që nga viti 1994 në Organizatën e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste të popullit shqiptar dhe që pas vdekjes së Dr. Ymer Dishnicës në krye të saj, duke luftuar fort për demokratizimin e shoqërisë shqiptare, për shtetin e së drejtës, për pasqyrimin e drejtë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, për dënimin e krimeve të komunizmit, për mbështetjen e UÇK-së dhe të shtetit të Kosovës, që është ëndrra e tij tashmë e realizuar.

Gjeneral Rrahmani ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës, doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe sot është gjenerali më i vjetër, por me mendje të re që mbështeti anëtarësimin e Shqipërisë dhe të ushtrisë shqiptare në NATO.

Një urim kam edhe për atdheun tonë, që të ketë sa më shumë burra si Rrahman Parllaku që t'i dalin zot!

Një falenderim kam për autorët e librit për heroin Rrahman Parllaku, zotërinjtë Halil Rama dhe Sakip Cami, për vajzat e tij Lirika, Tatjana dhe Shpresa që po ia bëjnë edhe më të lumtur jetën, për nipërit e tij Mazllum, Hazbi e Teki Parllaku, që e kanë dashur dhe mbështetur gjatë gjithë jetës, për të gjithë ata që kontribuan për 95-vjetorin e ditëlindjes së tij.

Figura dhe veprimtari të tilla do të mbeten në memorien e kombit dhe i duhen shumë kombit tonë.

## **Kuadër shumëdimensional, zemërgjërë, kërkues**

*Nga ISA TARE, Mjeshtër i Merituar Sporti*

Përveçse një ushtarak i shkëlqyer, Gjeneral Rahman Parllaku ishte edhe një mbështetës i sportit dhe i jetës artistike në ushtri.

E kam njohur Gjeneral Parllakun në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë, kur ai kryente detyrën e Zv/ministrit të mbrojtjes për përgatitjen luftarake, sidhe më vonë, detyrën e Zv/shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë.

Unë atëhere isha oficer në këtë ministri, drejtues për problemet e sportit, por njëkohësisht edhe sportist i ekipit të ushtrisë, "Partizani" dhe i ekipit kombëtar.

Tek Gjeneral Parllaku ne shkonim shpesh, e shqetësonim atë edhe për problemet e sportit. Parllaku na priste me dëshirë dhe përkushtim, me qëllimin e mire për të na ndihmuar. Ne i kërkonim të na ndihmonte që ndonjë ushtar sportist që kryente ushtrinë në rrethe, ta transferonte në Tiranë, dhe më pas ta federonim me ekipin e "Partizani"-t, të cilin e donim dhe e admironim që të gjithë, ne ushtarakët, bijtë e tyre, veteranët dhe shumica e pullit.

Nuk vononte aspak, kur shihnim që ushtari sportist të kishte ardhur në repartin e Tiranës dhe menjëherë të fillonte stërvitjen tek ekipi ynë i zemrës.

Rahmani mbështeste edhe artistët. Në Ansamblin e

ushtrisë me Gaqo Avrazin në krye dhe në Estradën e Ushtarit kanë punuar dhe janë promovuar pothuajse të gjithë artistët më në zë të popullit tonë.

Kur e larguan nga Tirana artisten e madhe Vaçe Zela, ishte ndërhyrja e Gjeneral Parllakut, që ajo të fillonte punë në Estradën e Ushtarit. Dhe më vonë mbas kërkesave të Ansambllit të Shtetit, përsëri Vaçja u kthye atje ku e meritonte, tek Ansambli Kombëtar, sepse Vaçja ishte artiste me përmasa mbarëkombëtare.

Ja pra, ky ishte Rrahman Parllaku, kuadër shumë-dimensional, zemërgjërë, kërkues që të imponohej.

# **Dashuri në të gjitha dimensionet, që shtrihet në të gjitha epokat**

*Nga Lindita BUSHGJOKAJ\**

Të gjithë kemi ëndrra dhe iluzione. Realizimi i tyre të fal kënaqësi pafund. Prandaj dhe bota është e bukur! Rruga drejt realizimit të tyre është e mbushur me sfida dhe peripeci, ku drejt arritjes së qëllimit njeriu njeh dhe dështimin. Kjo është e domosdoshme për të vlerësuar gjërat që ke. Drejt kësaj rruge ka gjithnjë një burim frymëzimi. Dhe unë e gjej tek librat, por jo vetëm; tashmë kam krijuar edhe idealin tim, heroin tim që me shumë dinjitet përbën shembull inspirimi drejt një jete të denjë .

Vetë prezenca e tij më shkakton emocionet më të bukura dhe të pastra.

Një libër është shumë pak për të shpalosur vlerat e rralla të Gjeneral Parllakut, që me emrin e veprën e tij bëri epokë. Ndaj çdo ditë që kalon, çdo moment dhe sekondë mund të gjesh cilësi të çmuara që i mbijetojnë çdo epoke....Ky është legjenda në kufirin e dy kohëve, Rrahman Parllaku. Për këtë figurë, sa popullore aq edhe poliedrike është folur e shkruar. Nuk po ndalem tek historia, bëmat, heroizmi i tij që njihen tashmë, por tek ato vlera, që arrita te evidentoj nga leximi plot pasion i jetës së tij, të shpalosur mirëfilli në këtë libër të bashkëautorëve të mirënjohur Halil Rama e Sakip Cami, shumë i çmuar dhe cilësisht tejet i arrirë. Në të nuk shikohen, thjesht nënkuptohen: thjeshtësia, mënçuria dhe larpamësia e Heroit të Popullit, gati një shekullor.

Në një botë ku mbisundon egoja dhe ku shpesh mënjanohen vlerat, figura e tij të le të kuptosh që “gjërat e bukura janë të thjeshta dhe të bukurat arrihen me thjeshtësi”. Më frymëzon lufta për të mbrojtur gjërat që të përkasin dhe stoicizmi për të rezistuar, pasi qëllimi për të mbrojtur nderin, dinjitetin qëndron edhe mbi vdekjen.

Jeta dhe vepra e Gjeneral Parllakut, e përshkruar gjer në detaje në këtë libër, më bëri të kuptoj që duhen vlerësuar dhe disfatat, pasi përbalja me to të bën karkater më të fortë për të luftuar “armikun”. Në kohën e gjeneralit ishin okupatori nazifashist dhe diktatura e egër komuniste, ndërsa në kohën tonë simbolizon pengesat në rrugën e jetës, ku lufta është gjithnjë e pranishme. Me armë, metoda apo strategji të sofistikuara ajo ka një synim: LUMTURINË, e cila nënkupton dashurinë. Sesa e njohim, mbrojmë apo meritojmë, kjo varet nga sa pastër luftohet. Më së miri e dallojmë këtë edhe te miqtë e ngushtë të gjeneral Parllakut. Njëri prej tyre, është Fiqiri Kllari – Konsull Nderi i Shqipërisë në Bosnjë, që e ndjek dhe mbështet “Heroin e Popullit” në çdo hap e aktivitet të tij.... Si Fiqiriu ka me dhjetra, qindra, e pse jo me mijëra, në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, në gjithë hapësirën mbarëshqiptare që mësojnë nga përvoja, urtësia e thjeshtësia e “legjendës në kufirin e dy kohëve” dhe orientohen drejt vlerave që rrezatojnë mirësi e admirim në çdo aspekt të jetës.

Gjeneralin me plot bindje e identifikoj me dashurinë, një ndjenjë që i është ushqyer që në vegjëli, duke luftuar dhe sakrifikuar jetën në shërbim të saj...Dashuri për çdo pëllëmbë tokësore, dashuri në të gjitha dimensionet, që shtrihet në të gjitha epokat dhe çdo brez, i vjetër apo i ri e ndjen.

Me fjalët më të thjeshta shpreh mirënjohjen, respektin, dashurinë dhe krenarinë për Heroin, “Krajlin”, Gjeneralin., për njeriun që jeton midis dy epokave...Faleminderit që ekziston!!!

*\*Studente në degën e gazetarisë*

# PASTHËNIE

## Kodet që njeriun e bëjnë gjeneral

Nga Dr. FEJZULLA GJABRI

*Nëse do të njohësh kodet që njeriun e bëjnë 'gjeneral' (jo vetëm ushtarak), referoju Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllakut.*

Rrahman Parllaku tashmë ka një Curriculum Vitae. Kaq. Kaq është kjo monografi për një jetë shekullore. Them kështu, se unë jam i privilegjuar të bëj një shkrim për të, e jo të përmbledh me pak fjalë atë që shkruhet në jetën e tij. Janë disa arsye që më bëjnë të arsyetoj kështu.

Së pari, kur e shoh sot, sikur shoh një pjesë të historisë kombëtare e ndjej emocione. Ndryshe, nuk do të doja të isha pjesë e historisë së jetës së një njeriu që nuk ndjen asnjë emocion kur tregon një histori të jetës së vet. Gjenerali di të tregojë, prandaj të detyron të ndihesh 'pak Rrahman Parllak'. Dikush ka thënë: "Madhështia nuk qëndron tek forca logjike që ke, por tek mënyra si e përdor atë". Edhe sot Rrahmani ruan atë madhësi burrërore, se gjen mënyrën si ta shfaqë atë, kujtesën, ashtu siç ka qenë.

Së dyti, Kam një kujtesë të vockël për Gjeneralin deputet.

Isha në shkollë fillore kur e kam pa për herë të pare, në një livadh të ulur këmbëkryq me burra, duke dëgjuar problemet e hallet e fshatit tim. Nga fundi i grumbullit të njerëzve, vëreja atë burrë të pashëm, falë një simetrie të përkryer, (që Zoti i

kishte dhënë), simetri që e ruan edhe sot. Nuk e dija nëse do ta takoja ndonjëherë dhe jo më të shkruaja një rresht për të. Por, ja që edhe kjo ndodhi. Më bënë miqtë e mi dibranë Halil Rama e Sakip Cami, që të jem pjesë a mikropjesë e këtij punimi.

Së treti, sigurisht nuk është thjesht një punim i zakonshëm. Nëpër këtë libër gjen materiale që plotësojnë më së miri njohjen e figurës së Gjeneral Rrahman Parllakut. Gjejmë fitoren, por nuk është e thënë të fitosh gjithmonë, sepse edhe humbet. E rëndësishme është se autorët kanë dhënë më së miri tiparin kryesor të tij, vendosmërinë, ngadhënjimin: Edhe kur humbet, të mos dorëzohesh asnjëherë. Kjo vlen për Rrahman Parllakun, gjeneralin lumjan që diti të kapërcejë vështirësitë e diktaturës. Mund të shkruhej më shumë? Sigurisht që po.

Në këtë punim ka risi. Kjo, pasi figura e Gjeneral Rrahman Parllakut nuk është e panjohur. Vetë ka treguar, vetë ka shkruar për veprimtarinë e tij, ka folur me shokë e në studio televizive. Risia më e rëndësishme këtu gjendet në vetë figurën e Gjeneralit, pasi është ndryshe kur flet vetë, e ndryshe kur flasin të tjerët. Tashmë çdo gjë e ka të dokumentuar. Kjo duhet çmuar në punimin e autorëve, sepse kanë kërkuar të veçantat, kanë çmuar vlerat, kanë dashur e çmuar dinjitetin e tij, si pjesë e pasqyrës së njeriut qëndrestar. Nga këtu mësojmë se kemi të bëjmë me veprimtarin që është njerëzor dhe i ndjeshëm me njerëzit, njerëzor dhe i ashpër me njerëzit e ashpër.

Rrahman Parllaku lindi, u rrit dhe mbeti patriot. Lufta Antifashiste, mbrojtja e vendit, "lufta e brrylave", qëndrimi në qeli e deri dhe Lufta e Kosovës më 1999, e forcuan karakterin e tij. Sokrati thoshte: "Patriotizmi nuk kërkon që individi të pajtohet me gjithçka që bën vendi i tij, por promovon shtrimin e pyetjeve analitike dhe kritikave që synojnë ta bëjnë vendin sa më të përparuar që të jetë e mundur". Kjo nuk i ka munguar Gjeneralit e kjo jepet edhe në këtë punim.

Libri nis me vendlindjen, Novosejn, fundja si gjithë katundet e tjera të Lumës, me përbashkësitë dhe veçantitë



e saj. Vazhdon me fëmijërinë, fundja si fëmijët e tjerë, por me këmbënguljen për shkollim edhe jashtë katundit të tij. Në rini kërkoi 'diamantet' rreth vetes, se diamante ka çdokush, por ai diti artin e pastrimit të tyre dhe i bëri që të shkëlqejnë fort. Ky shkëlqim e shoqëroi gjatë gjithë jetës. Njëri nga bashkëpunëtorët e tij (brenda këtij libri) thotë: "Ai kishte një stil dhe metodë pune ndryshe nga të tjerët. Disa nga kolegët e tij, për zbatimin e urdhërave preferonin të ngrinin zërin dhe dënimet, ndërsa Rrahmani preferonte që urdhërat të zbatoheshin pa të bërtitura, por duke kërkuar llogari me mirësjellje, me mirëkuptim dhe kulturë. Kjo bënte që urdhërat e të parëve të zbatoheshin vetëm se e kërkonte rregullorja, ndërsa urdhrat e Rrahmanit zbatoheshin natyrshëm...".

Autorët, përmes fjalëve të të tjerëve për Gjeneralin, kanë dhënë ndër kodet më të rëndësishme të njeriut që mban emrin Rrahman Parllaku, kodin e mirësjelljes, kodin e kulturës dhe kodin e drejtësisë. Ai që bazohet në drejtësinë, është i mbështetur në një godinë të fortë, që nuk shembet kurrë. E kundërta ngjet kur bazohesh në forcë: bie për tokë e humbet, sapo të thyhet forca. Pikërisht kjo del qartë në këtë punim.

Si gjeneral i tre epokave, ai është memoria historike e kombit. Autorët kanë dhënë gjithashtu një mesazh: "Nëse do të dish se çfarë ka ndodhur në Vlorë në periudhën 1939-1943, pyet Rrahman Parllakun ose referoju librit të tij; nëse pyet për Tiranën, përsëri referoju Parllakut. Nëse do të dish me detaje për luftën e Kosovës si në '44 dhe në '99, përsëri referoju Parllakut. Ai është gjenerali i kujtesës".

Mua më mbetet të shtoj: Nëse do të njohësh kodet që njeriun e bëjnë 'gjeneral' (jo vetëm ushtarak), referoju Gjeneral-Leitnant Rrahman Parllakut.

Së fundi, mbështetja e të dhënave për punimin është tepër e gjerë dhe dëshmon punën serioze të autorëve, gjë që vihet në dukje dhe nga përzgjedhja e materialeve të paraqitura. Veç autorëve, këtu është vetë Rrahman Parllaku, janë kolegë e miq të tij, janë ushtarakë, gazetarë e personalitete të kulturës

e shkencës, gjë që dëshmon për njohje të mirë të literaturës dokumentare nga ana e autorëve.

Tashmë, Gjenerali po shkon drejt shekullit. Mosha është porsi ngjitja në mal: sa më shumë që ngjitesh, ndjen se lodhesh dhe ngushtohet fryma, por zgjerohet shikimi dhe sheh më shumë prej lart.

Ky është Rrahman Parllaku, Gjenerali që hyn në hapësirat e legjendës.

*Tiranë, 2014*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kabineti i Presidentit

Tiranë, me 04. 11. 2002

Nr. 3260 Prot

**VERTETIM**

Vërtetohet se **GJENERAL RRAHMAN LATIF PARLLAKU** është i dekoruar me:

- Urdhrin “Ylli Partizan” kl.I, dekret 165, datë 23.11.1945
- Urdhrin “Ylli Partizan” kl.II, dekret 81, datë 09.07.1945
- Medaljen e Kujtimit, dekret 81, datë 09.07.1945
- Medaljen e Çlirimit, dekret 85, datë 21.06.1946
- Urdhrin e Skënderbeut kl.II, dekret 359, datë 07.07.1947
- Urdhrin e Flamurit, dekret 359, datë 07.07.1947
- Urdhrin e Trimërisë, dekret....., datë.....v.1947
- Urdhrin “Shërbime Ushtarake”, dekret 1358, datë 01.12.1951
- Medaljen e Trimërisë, dekret 1375, datë 07.12.1951
- Urdhrin “Shërbime Ushtarake”, dekret 1534, datë 29.08.1952
- Urdhrin “Ylli i Kuq”, dekret 1885, datë 21.06.1954
- Urdhrin e Skënderbeut kl.III, dekret 2714, datë 09.07.1958
- Urdhrin e Lirisë kl.III, dekret 3665, datë 10.04.1963
- Urdhrin e Skënderbeut kl.II, dekret 3700, datë 25.06.1963
- Titullin “Hero i Popullit”, dekret 4600, datë 24.11.1969

**Filip Rrumbullaku**


**Sekretari i Përgjithshëm**





*Gjeneral Parllaku gjatë viteve të LANÇ*





*Rrahman Parllaku*

*Rrahmani,  
Komandant i  
Divizionit të V,  
me kuadro të  
këtij divizioni*





*Drejtuesi i lartë i ushtrisë shqiptare, Rrahman Parllaku, gjatë procesit stërvitor*





*Në nderim të të rënëve në Luftën Nacionalçlirimtare*



*Kurvelesh, pranë busteve të Heronjve të Popullit,  
Xh. Beqiri dhe S. H. Nivica*



*Bashkëshortët Rrahman dhe Fitrete Parllaku*







*Bashkëshortët Parllaku me tre vajzat:  
Lirika, Tatjana dhe Shpresa*



*Familja e vajzës së madhe, Lirika Parllaku (Shahaj), me bashkëshortin dhe fëmijët.*





*Familja e  
vajzës së dytë,  
Tatjana Parllaku  
(Çarkaxhiu),  
me bashkëshortin  
dhe fëmijët.*





*Familja e vajzës  
së tretë,  
Shpresa Parllaku  
(Rrena),  
me bashkëshortin  
dhe fëmijët.*





*Familja e vëllait të madh të Rrahmanit, Selim Parllaku*



*Me familjarë dhe të afërm*





*Familja e vëllait të  
madh të Rrahmanit,  
Selim Parllaku*

*Me familjarë  
dhe të afërm*





*Nga festimet e 85-vjetorit të ditëlindjes së  
Heroit të Popullit, Rahman Parllaku*



*Gjeneral Rahman Parllaku gjatë një veprimtarie  
kushtuar moshës së tretë*



*Ish Ministri i Mbrojtjes, Gazmend Oketa, dekoron Gjeneral Parllakun në 90-vjetorin e ditëlindjes*



*Në mes gjeneralëve të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë*





*Me përfaqësues të LANÇ dhe të UÇK-së  
të Kosovës e Maqedonisë*







*Gjatë një takimi miqësor me kryetarin e  
Bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha*



*Komuna e  
Kurveleshit e ka  
shpallur gjeneral  
Parllakun  
“Qytetar Nderi”*





*Në New York me nipin Hazbiun, 22 dhjetor 2003*



*Në Bujan, me nipin Hazbiun dhe gazetarin Halil Rama,  
31 janar 2014*





*Në përkujtim të Masakrës së Tivarit.*





*Kryetari i Kuvendit, Ilir Meta, në mbledhjen jubilarë për 70-vjetorin e Konferencës së Bujanit, organizuar nga Gjeneral Parllaku*



*Bujan, në përkujtim të 70-vjetorit të konferencës historike*



*Me mjeshtrin e merituar të sportit, Isa Tare dhe bashkëautorët e librit, Sakip Cami dhe Halil Rama*



*Libri i H. Ramës dhe S. Camit, një punë serioze për jetën e “Heroit të Popullit” Rrahman Parllaku nuk mund të jetë ezaurues, sepse ai është një figurë aq interesante, e madhe do të thosha pa droje, sa të tërheqë edhe më vonë pena të tjera.*

*Teodor Ligo*

*“Gjeneral Parllaku ia doli mbi të gjitha furtunat e jetës, doli fitimtar nga Lufta Antifashiste, doli gjallë nga burgu komunist, doli fitimtar në luftën për pavarësinë e Kosovës dhe sot është gjenerali më i vjetër; por me mendje të re që inkurajon dhe mbështet integrimin euroatlantik të Shqipërisë”*

*Iiri Belishova*

*Nëse do të njohësh kodet që njeriun e bëjnë ‘gjeneral’ (jo vetëm ushtarak), referoju Gjeneral-Lëitnant Rrahman Parllakut.*

*Dr. Fejzulla Gjabri*

ISBN 978-9928-172-24-2



Çmimi: 1000 lekë

